



KLSH

UDHËZUES I AUDITIMIT FINANCIAR





REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

ISSAI 1000 - 2999

Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) janë produkt i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, INTOSAI. Për më shumë informacion vizitoni www.issai.org

UDHËZUES I AUDITIMIT FINANCIAR

(Shënimet praktike)

KOMITETI I INTOSAI-T PËR STANDARDE PROFESIONALE

NËN-KOMITETI PËR AUDITIMIN FINANCIAR- SEKRETARIATI

Riksrevisionen • 114 90 Stockholm • Sweden

Tel.: +46 5171 4000 • Fax.: +46 5171 4111 • E-mail:
projectsecretariat@riksrevisionen.se

INTOSAI



Sekretariati i përgjithshëm i INTOSAI¹⁾/ RECHNUNGSHOF

(Austrian Court of Audit)

DAMPFSCHIFFSTRASSE 2

A-1033 VIENNA

AUSTRIA

Tel.: ++43 (1) 711 71 Fax.: ++43 (1) 718 09 69

intosai@rechnungshof.gv.at

<http://www.intosai.org>

1) INTOSAI: International Organization of Supreme Audit Institutions (Organizata Nderkombetare e Institucioneve Supreme te Auditimit)

Titulli:

UDHËZUES I AUDITIMIT FINANCIAR

Redaktoi: Irena Islami

Art design: Kozma Kondakçiu

Seria Botime KLSH 05/2013/15

© Mundësohet përdorimi i materialeve të këtij botimi,

Kundrejt citimit të burimit, KLSH.

ISBN 978-9928-159-11-3

Shtypur në shtypshkronjën “KRISTALINA-KH”

Tiranë, 2013

Përmbajtja e ISSAI²⁾ 1000 - 2999³⁾

1. ISSAI 1000 - HYRJE E PËRGJITHSHME NË UDHËZUESIT E INTOSAI-t PËR AUDITIMIN FINANCIAR15
2 ISSAI 1003 - Fjalor i termave të Udhëzuesve të INTOSAI-t për auditimin financiar73
3. ISSAI 1200 - Objektivat e përgjithshme të audituesit të pavarur dhe kryerja e një auditimi në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit87
Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA ⁴⁾ 20088
4. ISSAI 1210 - Rënia dakord me kushtet e angazhimit të Auditimit97
Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA 21098
5. ISSAI 1220 - Kontrolli i Cilësisë për një Auditim të Pasqyrave Financiare111
Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA 220112
6. ISSAI 1230 - Dokumentimi i auditimit115
Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA 230116

2 ISSAI: The International Standards of Supreme Audit Institutions (Standartet Nderkombetare te Institucioneve Supreme te Auditimit)

3 INTOSAI deri tani ka përgatitur standarde të auditimit financiar deri në ISSAI 1810, duke u bazuar në standartet e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve(IFAC).

4 ISA : The International Standards of Audit (Standartet Nderkombetare te Auditimit)

7. ISSAI 1240 - Përgjegjësitë e audituesit lidhur me mashtrimin në një Auditim të Pasqyrave Financiare123
Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA 24124
8. ISSAI 1250 - Mbajtja parasysh e ligjeve dhe e rregulloreve në një auditim të Pasqyrave Financiare149
Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA 250150
9. ISSAI 1260 - Komunikimi me personat e ngarkuar me mwnaxhimin155
Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA 260156
10. ISSAI 1265 – Komunikimi i mangësive në Kontrollin e Brendshëm të Personave të ngarkuar me manaxhim dhe drejtimin.163
Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA 265164
11. ISSAI 1300 – Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare.167
Shënim Praktik për Standardin Ndërkombëtar të Auditimit ISA 300168
12. ISSAI 1315 – Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të anomalive përmes njohjes së entitetit dhe mjedisit të tij174
Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA 315175
13. ISSAI 1320 – Materialiteti në planifikimin dhe kryerjen e auditimit184
Shënim Praktik për Standardin Ndërkombëtar të Auditimit ISA 320185
14. ISSAI 1330 – Reagimet e audituesit ndaj risqeve të vlerësuara191
Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA 330192
15 ISSAI 1402 –Konsiderata auditimi për një entitet që përdor një Organizatë Shërbimi197

Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA 402198
16. ISSAI 1450 – Vlerësimi i anomalive të identifikuara gjatë auditimit207
Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA 450208
17. ISSAI 1500 – Evidenca e Auditimit213
Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA 500214
18. ISSAI 1501 – Evidenca e Auditimit – Konsideratat e veçanta për artikujt e zgjedhur222
Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA 501223
19. ISSAI 1505 – Konfirmimet e jashtme228
Shënim praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA505229
20. ISSAI 1510 – Angazhimet fillestare të auditimit – Bilancet Hyrëse233
Shënim praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA510234
21. ISSAI 1520 – Procedurat Analitike237
Shënim praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA520238
22. ISSAI 1530 – Përzgjedhja e dokumenteve të auditimit243
Shënim praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA530244
23. ISSAI 1540 – Auditimi i llogarive financiare duke përfshirë vlerësimin e drejtë të llogarive financiare të lidhura me dhënien e informacioneve shpjeguese251
Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA 540252
24. ISSAI 1550 – Palët e ndërlidhura259
Shënimi për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA 550.....	260

25. ISSAI 1560 – Ngjarjet vijuese266
Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA 560267
26. ISSAI 1570 – Problemet në vijim271
Shënimi për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA 570.....	272
27. ISSAI 1580 – Pasqyrimi me shkrim279
Shënimi për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA 580.....	280
28. ISSAI 1600 – Konsideratat e veçanta – Auditimet e Pasqyrave Financiare në Grup (përfshirë punën e auditorëve shtesë)289
Shënimi për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA 600.....	290
29. ISSAI 1610 – Si të përdorim punën e audituesve të brendshëm306
Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA610307
30. ISSAI 1620 – Si të përdorim punën e një eksperti të auditimit311
Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA620312
31. ISSAI 1700 – Krijimi i një mendimi mbi raportimin e pasqyrave financiare317
Shënim i Praktikës për Standardin Ndërkombëtar të Auditimit ISA700318
32. ISSAI 1705 – Ndryshimet e opinionit në raportin e pavarur të auditorit325
Shënim për Standardin Ndërkombëtar të Auditimit ISA 705.....	326
33. ISSAI 1706 – Rëndësia e paragrafëve dhe çështjeve të tjera në raportin e pavarur të auditorit332
Shënim i Praktikës për Standardin Ndërkombëtar të Auditimit ISA706333
34. ISSAI 1710 – Informacion Krahasues – Shifrat përkatëse dhe pasqyrat financiare krahasuese337
Shënim për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA 710.....	338

35. ISSAI 1720 – Përgjegjësitë e audituesit lidhur me informacione të tjera në dokumentet që përmbajnë Pasqyrat Financiare të audituara342
Shënim i Praktikës për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA 720343
36. ISSAI 1800 – Konsiderata të veçanta – Auditimi i Pasqyrave financiare i përgatitur sipas kornizave për qëllime specifike346
Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA 800347
37. ISSAI 1805 – Konsiderata të veçanta – Auditimi i Pasqyrave Financiare të vetme dhe elementëve specifikë, llogarive ose zërave të një Deklarate Financiare353
Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA805354
38. ISSAI 1810 – Angazhimet në Raportimin e Përmbledhjeve të Deklaratave Financiare360
Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISA 810361

Parathënie

Zyra e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit, me botimin « Udhëzues i Auditimit Financiar (Shënimet Praktike)» sjellin në shqip përpara audituesit shqiptar një punë rreth 12 vjeçare të komunitetit ndërkombëtar të auditimit suprem, për të vendosur rregulla të qarta në auditimin financiar. Janë 38 shënime praktike për zbatimin e Standardeve të Auditimit Suprem ISSAI 1000-2999, të njohura dhe të pranura ndërkombëtarisht. Këto shënime orientojnë saktë audituesin tonë në sfidat e punës së përditshme për një auditim financiar sa më të plotë dhe cilësor.

Që në fund të shekullit të kaluar, institucionet supreme të auditimit publik(SAI), anëtarë të INTOSAI, shprehën nevojën për një udhëzues më të fortë dhe të detajuar që t'i mbështesë audituesit në punën e tyre. Në vitin 2001, Kongresi i 17-të i INTOSAI-t në Seul i dha Komitetit të Standardeve të Auditimit detyrën për ta plotësuar këtë nevojë, duke u mbështetur tek standardet e auditimit të njohura globalisht dhe të zhvilluara nga organizatat e tjera profesionale.

Në vitin 2002, Bordi Qeverisës i INTOSAI miratoi një projekt për të plotësuar nevojat e SAI-ve anëtarë në auditimin financiar. INTOSAI nisi bashkëpunimin me Federatën Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC), bashkëpunim i cili prodhoi pjesën më voluminoze të nivelit të katërt të standardeve të INTOSAI (Udhëzuesit e Auditimit). Që nga ajo kohë, të 38 standardet e auditimit financiar dhe shënimet praktike

të tyre janë pjesërisht riparë dhe rinovuar në çdo Kongres të INTOSAI-t, duke qenë pjesë e pandare dhe reference e përhershme e punës profesionale të audituesve publike kudo në botë.

Shënimet janë pjese jo vetëm e nismës me të rëndësishme standard-berese të INTOSAI-t në historinë e tij të derisotme, por përbejnë edhe një hartë të plotë e të detajuar ku audituesi mund të orientoje punën e tij, nga planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare, identifikimi dhe vlerësimi i risqeve të anomalive materiale, e deri tek kontrolli i cilësisë për një auditim të pasqyrave financiare.

Sjellja e tyre në gjuhën shqipe është frut i Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Zyrës së Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit, lidhur në shkurt të vitit 2012. Procesi ka gjetur mbështetjen e plotë dhe angazhimin personal të Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës, zotit Lars Lage Olofsson, një personalitet i shquar i auditimit publik evropian e me gjere.

Nen drejtimin e z. Olofsson, Zyra e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës (ZAP) ka kryer në katër vitet e fundit një transformim të plotë, duke shtuar me here numrin e auditimeve të saj financiare, duke rinovuar stafin dhe rritur ndjeshëm cilësinë e punës audituese, sipas standardeve të INTOSAI-t. Kjo Zyre ka fituar besimin e palëve të interesit në Kosove, përfshirë dhe komunitetin ndërkombëtar dhe agjensitë ndërkombëtare të zhvillimit të pranishme atje.

Në fund të nëntorit 2011, në platformën që paraqita përpara Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit, në cilësinë e kandidatit të nominuar nga Presidenti i Republikës për Kryetar të Kontrollit të Lartë të Shtetit, theksova orientimin e ardhshëm të KLSH-së për konsolidimin e auditimit financiar, në përputhje me kërkesat e standardeve ndërkombëtare të INTOSAI-t, përmirësimin e komunikimit dhe transparencës, nëpërmjet botimeve shkencore dhe pranisë së

shtuar në media, si dhe intensifikimin e bashkëpunimit me institucionet homologe të auditimit të vendeve të BE-së, të vendeve të rajonit dhe në veçanti, me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës.

Shënimet praktike në shqip të standardeve ndërkombëtare të auditimit financiar ISSAI 1000-2999 janë pune e përbashkët e stafeve të ZAP dhe KLSH, për t'i sjelle audituesit shqiptar referencën me të plotë dhe orientimin me të saktë të praktikave të mira e të suksesshme të komunitetit ndërkombëtar (rreth 90 Institucione Supreme të Auditimit kane kontribuar në përgatitjen e Udhëzuesit).

Në botimet e deritanishme të KLSH-së, një vend të rëndësishëm zënë « Standartet e Auditimit INTOSAI » (ISSAI 10, 20, 30, 40, 100, 200, 300, 400) për shkak të rolit të padiskutueshëm që ka zbatimi i tyre në konsolidimin e Institucionit dhe në rritjen e dijeve profesionale të audituesve të tij. Botimi i këtyre standarteve përputhet me synimin kryesor strategjik të KLSH për vitet 2013-2017, modernizimin e tij, me qëllim që veprimtaria e institucionit të jetë në përputhje të plotë me standardet INTOSAI dhe me objektivat e Strategjisë për Zhvillim të EUROSAI 2011-2017.

Një nga objektivat e planit të Zhvillimit Strategjik të Institucionit është edhe përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës. Këtij qëllimi i shërben edhe botimi nga KLSH i librit "Udhëzues i Auditimit të Performances, ISSAI 3000-3100". Auditimi i performancës në KLSH po konsolidohet me tej, duke rritur numrin e auditimeve të realizuara dhe zgjerimin e tematikës së përzgjedhur. Ky lloj auditimi do të jetë një nga dy aktivitetet me të rëndësishme në gjithë veprimtarinë e institucionit. KLSH, në këtë drejtim po ndjek trendin e SAI-ve të vendeve të zhvilluara për t'i dhënë prioritet Auditimit të Performances, duke vlerësuar këtë lloj auditimi si një nga mënyrat kryesore përmes të cilit sigurohet përdorimi i fondeve publike me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

Paralalelisht me « Udhëzuesin e Auditimit Financiar », KLSH po boton në bashkëpunim dhe me ndihmën e SIGMA edhe « Udhëzuesin për Auditimin e Perputhshmerise ». Me këtë botim, KLSH arrin shifrën e 15 botimeve, brenda një harku kohor prej një viti e gjysëm. E gjithë kolana e botimeve të KLSH-së i shërben rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, duke bërë një hap të rëndësishëm sasior dhe cilësor në kontributin ndaj mirëqeverisjes, përmes bërjes publike dhe transparente të të gjithë veprimtarisë së tij dhe rritjes së kapaciteteve në fushën e auditimit publik.

KLSH falenderon në mënyrë të veçantë z. Lars Lage Olofsson për kontributin e tij në realizimin e këtij botimi, si dhe të gjithë ata auditues të Kosovës dhe të Shqipërisë që punuan me përkushtim e cilësi për përkthimin e « Shënimeve Praktike të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit Financiar », nën frymën dhe moton e INTOSAI-t « Experientia Mutua Omnibus Prodest (Nga eksperiencia e Përbashkët fitojmë të gjithë) ».



ISSAI 1000

Udhëzues i Auditimit Financiar

*HYRJE E PËRGJITHSHME NË
UDHËZUESIT E INTOSAI-t
PËR AUDITIMIN FINANCIAR*

Përmbajtje e ISSAI 1000

	Paragrafi
Hyrje	1-9
Historiku	10-13
Qëllimi i Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar	14-17
Fushëveprimi i Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar	18-23
Struktura dhe përmbajtja e Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar	24-27
Zbatimi i Udhëzuesve të INTOSAI-it për Auditimin Financiar si standarde	28-29
Zbatimi i Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar për të mbështetur Parimet Themelore të INTOSAI-t	30
Zbatimi I Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar për të mbështetur Standardet e tjera	31
 Autoriteti	
Autoriteti – Udhëzuesit e Auditimit Financiar dhe Parimet Themelore të INTOSAI-t	32-36
Autoriteti – Standardet Ndërkombëtare të Auditimit	37-43
Çështje të përgjithshme në Auditimet e Entiteteve të Sektorit Publik	
Sistemet e ndryshme të auditimit brenda Sektorit Publik	44-45
Terminologjia e përdorur tek Udhëzuesit	49-51
Gjykimi dhe skepticizmi profesional	52

Pranimi dhe vazhdimi i angazhimit	53-54
Objektivi i auditimit të pasqyrave financiare	55-58
Rënia dakord me kushtet e angazhimeve të auditimit	59-63
Proceset e sigurimit të cilësisë	64-66
Letrat e Punës dhe dokumentimi i auditimit	67
Komunikimi	68-70
Identifikimi i Mashtrimit dhe Gabimit	71-74
Konsiderata e audituesit për ligjet dhe rregulloret	75-76
Vlerësimi i riskut dhe procedurat e auditimit	77-80
Materialiteti në auditimet e entiteteve të sektorit publik	81-84
Raportet e audituesit në sektorin publik	85-86

Përkthimi i Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar	87-91
--	--------------

Shtojca 1 – Lidhja mes Parimeve Themelore të INTOSAI-t për Auditimin (ISSAI 100-400) dhe Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar (ISSAI 1000-2999)

Shtojca 2 – ISSAI-të në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që fillojnë më 15 dhjetor 2009 ose më pas

Shtojca 3 – Autoriteti i ISA-ve

Shtojca 4 – Rekomandimet për përkthim

Shtojca 5 – Lista e shkurtesave

Hyrje e përgjithshme në udhëzuesit e INTOSAI-t për auditimin financiar

Hyrje

1. Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar ofrojnë udhëzime për kryerjen e auditimeve financiare në entitetet e sektorit publik.
2. Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar përfaqësojnë nivelin e katërt (Udhëzues Auditimi) të Kornizës së Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI, ku Parimet Themeluese përbëjnë nivelin e parë, Parimet dhe Udhëzuesit për Institucionet Supreme të Auditimit SAI përbëjnë nivelin e dytë, dhe Parimet Themelore të Auditimit (Standardet e INTOSAI-t për Auditimin) përbëjnë nivelin e tretë⁵⁾.
3. Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar përfshijnë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISAhartuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë (NSBoAS). INTOSAI kontribuon për hartimin e këtyre standardeve duke marrë pjesë në Task Forcat e NSBoAS, të cilat janë përgjegjëse për hartimin e standardeve të reja ose rishikimin e standardeve ekzistuese.
4. Shënimet Praktike (SHP), të cilat janë të përfshira në Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar, japin udhëzime, përveç atyre që ofrohen në ISA korresponduese, të cilat janë relevante për zbatimin e çdo ISA-je në auditimet financiare të entiteteve të sektorit publik.

5) Shtojca 1 paraqet një ilustrim të lidhshmërisë mes Parimeve Themelore të INTOSAI-t për Auditim (ISSAI 100-400) dhe Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin e Rregullsisë (ISSAI 1000-2999)

5. Duke zbatuar Udhëzuesit e INTOSAI-t për auditimin financiar të entiteteve të sektorit publik, Institucionet Supreme të Auditimit e pranojnë së ISA-të dhe SHP-të formojnë së bashku udhëzuesin. Nëse i referohemi raportit të audituesit dhe faktit së auditimi është kryer në përputhje me ISSAI-të, shohim së audituesit e sektorit publik veprojnë në pajtueshmëri me të gjitha ISSAI-të relevante për auditimin, siç shpjegohet në pjesën për autoritetin (Paragrafët 28-43).

6. Në krahasim me objektivat e një auditimi të pasqyrave financiare në përputhje me ISA-të (d.m.th. për të shprehur një opinion nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar), objektivat e një auditimi të rregullsisë së entiteteve të sektorit publik mund të përfshijnë përgjegjësi shtesë për auditim dhe raportim. Për shembull, nga audituesit e sektorit publik mund të kërkohet që të raportojnë për: pajtueshmërinë ose jo-pajtueshmërisë e një entiteti të sektorit publik me autoritetet, duke përfshirë buxhetin dhe llogaridhënien; efektivitetin e kontrollit të brendshëm mbi raportimin financiar; ose për ekonomikitetin, efikasitetin dhe efektivitetin e programeve, projekte dhe aktiviteteve.

7. Mandati i auditimit për një Institucion Suprem të Auditimit apo detyrimet për entitetet e sektorit publik që rrjedhin nga legjislacioni, rregulloret, direktiva ministrore, kërkesat e politikave qeveritare apo rezolutat e legjislativit, mund të rezultojnë gjithashtu në përgjegjësi shtesë për audituesit e sektorit publik për auditim dhe raportim.

8. Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar nuk përmbajnë udhëzime të detajuara mbi përgjegjësitë e auditimit dhe raportimit lidhur me pajtueshmërinë me autoritetet. Udhëzuesit e Auditimit të Pajtueshmërisë e përmbajnë një udhëzim i tillë. ISSAI 4200 ofron udhëzime për auditimet e pajtueshmërisë kur kryhen së bashku me një auditim të pasqyrave financiare. Ato janë ndërtuar mbi Parimet Themelore të INTOSAI-t për Auditim dhe janë të dizajnuara për të ndihmuar audituesit e sektorit publik që kanë

përgjegjësi në lidhje me pajtueshmërinë me autoritetet⁶⁾. Kur këto përgjegjësi janë më të mëdha, ISSAI 4200 e plotëson dhe duhet të lexohet së bashku me Udhëzuesit e Auditimit të Rregullsisë ISSAI 1000-2999.

9. Udhëzuesit e Auditimit të Rregullsisë, kur zbatohen së bashku me Udhëzuesit e Auditimit të Pajtueshmërisë, kanë për qëllim që të pajisin audituesit e sektorit publik me një paketë gjithëpërfshirëse udhëzimesh për auditimin e pasqyrave financiare në sektorin publik, kur pajtueshmëria me autoritetet përfshihet në objektivin.

HISTORIKU

10. Standardet origjinale të INTOSAI-t për Auditimin⁷⁾ janë hartuar nga Komiteti i INTOSAI-t për Standardet e Auditimit në qershor 1992 dhe Kodi i Etikës i INTOSAI-t u miratua në Kongresin e XVI-të të INTOSAI-t (INCOSAI)⁸⁾ i cili u mbajt në Montevideo në vitin 1998. Standardet e INTOSAI-t për Auditimin u ristrukturuan më pas dhe Kodi aktual i Etikës dhe Standardet aktuale të Auditimit të hartuara nga INTOSAI u miratuan nga INCOSAI I XVII-të që u mbajt në Seul në vitin 2001. Të dyja janë të bazuara në Deklaratën e Limës mbi Udhëzimet për Rregullat e Auditimit. INCOSAI⁴⁾ në Montevideo fillimisht i dha Komitetit të INTOSAI-t për Standardet e Auditimit detyrën për të hartuar udhëzues për implementimin e standardeve të auditimit. Ky mandat iu përsërit Komitetit gjatë Kongreseve pasuese në Seul (2001) dhe Budapest (2004). Komisioni prezantoi Udhëzuesit e INTOSAI-it për Auditim të Performancës për tu miratuar nga Kongresi në vitin 2001 dhe më pas vazhdoi me adresimin e udhëzuesve për auditimin Financiar.

6) ISSAI 4000, Hyrje e përgjithshme në Udhëzuesit për Auditimin e Pajtueshmërisë dhe ISSAI 4200, Udhëzuesit për Auditimin e Pajtueshmërisë të lidhura me Auditimin e Pasqyrave Financiare.

7) ISSAI 100-400 paraqitur si Parimet Themelore të INTOSAI-t

8) INCOSAI është Kongresi I INTOSAI-t i cili mbahet çdo tre vjet

11. Si përgjigje ndaj nevojës së shprehur nga anëtarët e INTOSAI-t, Komiteti I INTOSAI-t për Standardet e Auditimit ra dakord që të hartojë udhëzues për Auditimin Financiar bazuar në ISA-të e hartuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë. Komiteti gjithashtu ka ranë dakord që të hartojë udhëzime mbi përgjegjësitë shtesë të audituesve të sektorit publik për auditim dhe raportim. Detyra për hartimin e Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar iu dha Grupit Punues për Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar.
12. Në shtator të vitit 2005, INTOSAI u riorganizua në përputhje me Planin e ri Strategjik të INTOSAI-t dhe Komiteti i INTOSAI-t për Standardet e Auditimit u zëvendësua nga Komiteti i Standardeve Profesionale (KSP) i INTOSAI-t. Përgjegjësitë e Grupit Punues për Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar u morën përsipër nga Nën-komiteti i INTOSAI-t për Udhëzuesit mbi Auditimin Financiar, i krijuar në kuadër të strukturës së komitetit të ri. Nën-komiteti për Udhëzuesit mbi Auditimin Financiar raporton tek Komiteti i Standardeve Profesionale (KSP).
13. Në kornizën e ISSAI-së është bërë një dispozitë për përfshirjen e Kodit për Kontrollin e Cilësisë (ISSAI 40) në nivelin e dytë të strukturës së ISSAI-së që do të aplikohet nga Institucionet Supreme të Auditimit në të gjitha llojet e aktiviteteve të auditimit

Qëllimi i Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar

14. Qëllimi kryesor i Udhëzuesvetë INTOSAI-t për Auditimin Financiar është që të pajisin anëtarët e INTOSAI-it me një paketë gjithëpërfshirëse udhëzimesh për auditimin e pasqyrave financiare të entiteteve të sektorit publik. Përveç ISA-ve të hartuara nga NSBoAS, Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar përfshijnë SHP-të e hartuara nga INTOSAI. Ato së bashku formojnë një udhëzues në kornizën e standardeve të INTOSAI-t.
15. Parimet Themelore të INTOSAI-t sigurojnë parimet thelbësore për performancën dhe raportimin e auditimeve të kryera nga Institucionet Supreme të Auditimit. Megjithatë, duke shfrytëzuar detaje të ISA-ve për

aq sa është e rëndësishme për auditimet financiare të kryera nga Institucioneve Supreme të Auditimit, dhe duke hartuar SHP të cilat trajtojnë konsideratat e veçanta për auditimet financiare të entiteteve të sektorit publik, INTOSAI ofron një paketë gjithëpërfshirëse udhëzimesh për auditimin financiar të cilat mund të përdoren nga të gjitha Institucionet Supreme të Auditimit në të gjitha mjediset institucionale dhe mjediset e auditimit.

16. Shënimet Praktike sigurojnë një pasqyrë të qartë mbi zbatueshmërinë e ISA-së në auditimet e entiteteve të sektorit publik, si dhe udhëzime shtesë në auditorët e sektorit publik mbi ISA. SHP-të i adresohen audituesve të sektorit publik, të cilët përfshijnë, kur është e përshtatshme, edhe auditues të që kryejnë auditime financiare të subjekteve të entiteteve të sektorit publik. Ku është e aplikueshme, edhe ato trajtojnë udhëzime të përgjithshme mbi përgjegjësitë shtesë të audituesve të sektorit publik për auditim dhe raportim. Për çdo ISA ka një SHP të veçantë. SHP-të hartohen në vazhdimësi atëherë edhe kur NSBoASnxjerr ISA të reja apo i rishikon ato. Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar zbatohen për auditimin e pasqyrave financiare, siç përcaktohet nga ISSAI 1200⁹⁾ dhe i adresojnë konsideratat shtesë të auditimit në sektorin publik. Përgjegjësitë e Institucioneve Supreme të Auditimit për auditim dhe raportim që lidhen me auditimet financiare mund të përfshijnë aspekte shtesë të auditimeve të rregullsisë (siç sqarohet në Paragrafin 19). Në sektorin publik, auditimet e pasqyrave financiare shpesh kombinohen me auditimet e pajtueshmërisë me autoritetet. ISSAI 4200¹⁰⁾ i adreson këto përgjegjësi shtesë për auditim dhe raportim. Auditimet e pajtueshmërisë me autoritetet përfshijnë vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare, dhe informacioni që ipërfshihen apo pasqyrohen në llogaritë ose pasqyrat financiare janë në pajtueshmëri me rezolutat e aplikueshme të legjislativit, duke përfshirë ligjet ose vendimet për buxhetin, ofrimin e fondeve, kontratat, marrëveshjet për grantet etj.

9) ISSAI 1200 Objektivat e përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

10) ISSAI 4200 Udhëzuesit e Auditimit të Pajtueshmërisë lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare

17. Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar aplikohen për auditimet në të gjitha nivelet e Qeverisë. Varësisht nga mandati i auditimit ose ligji i Institucionit Suprem të Auditimit, Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar mund të aplikohen tek auditimet në entitetet e sektorit publik kur ata janë të përfshirë në menaxhimin e shërbimeve publike ose parave publike, për shembull përmes marrëveshjeve për partneritet ose si përfitues të granteve publike ose subvencioneve.

Fushëveprimi i Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar

18. Objektivi i Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar është që të ofrojë udhëzim për auditimet pasqyrave financiare në sektorin publik, duke përfshirë udhëzimin e përgjithshëm mbi objektivat shtesë për auditim dhe raportim të lidhura me auditimin e pasqyrave financiare të sektorit publik.

19. Parimet Themelore të INTOSAI-t nuk e përkufizojnë auditimin e pasqyrave financiare. Sipas ISSAI 100¹¹⁾ fushëveprimi i plotë i auditimit të qeverisë përfshin auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditimi i rregullsisë përfshin:

- a) Verifikimin e llogaridhënies financiare të entiteteve llogaridhënëse, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e të dhënave financiare dhe dhënien e opinioneve mbi pasqyrat financiare;
- b) Verifikimin e llogaridhënies financiare të administratës qeveritare si e tërë;
- c) Auditimin e transaksioneve dhe sistemeve financiare, përfshirë vlerësimin e pajtueshmërisë me statutet dhe rregulloret e zbatueshme;
- d) Auditimin e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm;
- e) Auditimin e ndershmërisë dhe përshtatshmërisë së vendimeve administrative të marra në entitetin e audituar;

11) ISSAI 100 Standardet e INTOSAI-t për Auditimin – Parimet themelore, paragrafët 38 dhe 39

f) Raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga auditimi, ose lidhen me të, për të cilat Institucionet Supreme të Auditimit mendojnë së duhet të shprehen.

20. Prandaj, fushëveprimi i auditimit të rregullsisë, i kryer sipas ISSAI 100, është më i gjerë se fushëveprimi i një auditimi të pasqyrave financiare, i kryer sipas ISA-ve.

21. Për më tepër, përkufizimi i auditimit financiar brenda secilit Institucion Suprem të Auditimit varet nga rregulloret, mandati, dhe struktura organizative. Mandati i një Institucioni Suprem të Auditimit mund të specifikojë përgjegjësitë e auditimit dhe raportimit të ndryshëm nga auditimi i pasqyrave financiare apo ti shtohen tij. Përgjegjësitë e tilla ose mund të përfshihen në auditimin e pasqyrave financiare, ose mund ti shtohen atij. Auditimi i këtij informacioni kërkon nga audituesit e sektorit publik që të kryejnë punë shtesë nga ajo që kërkohet vetëm për auditimin dhe raportimin e pasqyrave financiare sipas ISA-ve.

22. Për shkak të përfshirjes së INTOSAI-t në hartimin e ISA-ve, ISA-të përfshijnë material për tu përdorur gjatë zbatimit, i cili është relevant për auditimin financiar të entiteteve të sektorit publik dhe shpesh gjendet nën tituj të veçantë. SHP-të ofrojnë udhëzim shtesë që duhet të merret parasysh nëse do të ishte relevant për mandatin e Institucioneve Supreme të Auditimit.

23. Edhe pse Udhëzuesit e Auditimit Financiar mund të ofrojnë udhëzim mbi përgjegjësitë e auditimit dhe raportimit përveç atyre në ISA-të, ata nuk kanë qëllim që të ofrojnë udhëzim mbi fushëveprimin e plotë të një auditimi të rregullsisë që kryhet sipas Parimeve Themelore të INTOSAI-t, apo mbi të gjitha përgjegjësitë shtesë ose të ndryshme të mandateve të Institucioneve Supreme të Auditimit për auditim dhe raportim. Për përgjegjësitë që ndryshojnë nga auditimi i pasqyrave financiare, audituesve të sektorit publik mund tu nevojitet të zbatojnë udhëzues të tjerë relevant të INTOSAI-t.

ISSAI4200¹²⁾ ofrojnë udhëzim mbi përgjegjësitë e auditimit që lidhen me auditimin e pajtueshmërisë si pjesë e auditimit të pasqyrave financiare.

12) ISSAI 4200 Udhëzuesit e Auditimit të Pajtueshmërisë lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare' 9 ISSAI 1003 « Fjalor I termave të Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar' »

Struktura dhe përmbajtja e Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar

24. Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar përmbajnë fillimisht 38 ISSAI. 36 prej tyre përfshijnë nga një ISA dhe një Shënim Praktik që mbështet përvetësimin dhe përdorimin e ISA-së në sektorin publik. ISA-ja dhe SHP-ja së bashku përbëjnë një udhëzim mbi lëndën në shqyrtim. ISSAI-të që mbeten, të cilat nuk bazohen mbi një ISA ose nuk e përfshijnë atë, janë ISSAI 1000 Hyrje e Përgjithshme në Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar dhe ISSAI 1003 Fjalori, i cili përfshin Fjalorin dhe IASB¹³⁾ dhe ofron terma dhe shpjegime shtesë mbi sektorin publik.
25. Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar paraqiten në sistemin e renditjes së INTOSAI-t si ISSAI, duke filluar me ISSAI 1000 deri tek ISSAI 2999. Tre shifrat e fundit në numrin e ISSAI-së tregojnë numrin korrespondues të ISA-së (p.sh. ISSAI 1800 përfshin ISA 800 dhe Shënimin Praktik për ISA 800). Në Shtojcën 2 paraqiten ISSAI-të që lidhen me auditimin financiar.
26. ISA-të kanë një strukturë ku informacioni paraqitet në pjesë të veçanta:

a) Hyrje

Përveç përgjegjësive të audituesve dhe të tjerëve në kontekstin në të cilin është caktuar ISA-ja, materiali hyrës mund të përfshijë informacion që ka lidhje me qëllimin, fushëveprimin dhe lëndën e ISA-së.

b) Objektivi

Çdo ISA përmban një pasqyrë të qartë të objektivit të audituesit në fushën e auditimit që adresohet në atë ISA.

13) International Auditing Standard Board (Bordi Nderkombetare i Standardeve të Auditimit)

c) Përkufizimet

Për të kuptuar më mirë ISA-të, në secilën ISA jepen përkufizimet e termave të përdorura.

d) Kërkesat

Objektivi (at) mbështetet nga kërkesat e paraqitura qartë. Kërkesat gjithmonë shprehen me frazën “Audituesi do të”. Gjatë zbatimit të Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar si udhëzim, fjala “do të” ka kuptim “mund”. Autoriteti i ISA-së ndiqet kur në raportin e audituesit referimi bëhet në ISA-të.

e) Materiali tjetër shpjegues dhe për zbatim

Materiali tjetër shpjegues dhe për zbatim shpjegon në mënyrë më të saktë se çfarë do të thotë një kërkesë apo çfarë ka për qëllim të mbulojë ose përfshin shembuj të procedurave të cilat mund të jenë të përshtatshme nën rrethana të caktuara. Materiali tjetër shpjegues dhe për zbatim mund të përfshijë nëntituj për konsideratat e veçanta për entitetet e sektorit publik. Këto paragrafë përfshihen në pajtim me IASB-në për të mbështetur zbatimin e auditimeve financiare të entiteteve në sektorin publik. Disa ISA përmbajnë gjithashtu “konsiderata specifike për auditimet e entiteteve më të vogla. Në auditime të entiteteve të sektorit publik dhe entiteteve që marrin fonde nga Qeveria, këto konsiderata zakonisht nuk janë të zbatueshme, edhe nëse entiteti i sektorit publik ka pak punonjës, veprimtari të thjeshtë, ose buxhet relativisht të vogël. Në këto situata, entiteti i sektorit publik mund të ketë transaksione të ndërlikuara, siç janë transferet nga entitetet e tjera të Qeverisë si dhe nevojën që të veprojnë në pajtim me ligjet, rregulloret, politikat, dhe sistemet e përcaktuara nga një nivel më i lartë i qeverisë si dhe për llogaridhënie për përdorimin e parave të taksapaguesve. Prandaj, audituesit e sektorit publik e shqyrtojnë me kujdes rëndësinë e këtyre konsideratave. Shënimet Praktike mund të përfshijnë udhëzim shtesë në këtë fushë atëherë kur ai konsiderohet i rëndësishëm

që të shtohet tek auditimet e entiteteve të vogla të sektorit publik.

27. Shënimet Praktike të ISA-ve paraqiten në pjesë të veçanta:

a) Hyrja

Materiali i hyrjes mund të përfshijë informacionin në lidhje me ISA-në siç është hyrja në ISA dhe përmbajtja e Shënimit Praktik.

b) Zbatueshmëria e ISA në auditimin e sektorit publik

Çdo Shënim Praktik përmban një pasqyrë të qartë të zbatueshmërinë të ISA-së për auditime të entiteteve të sektorit publik. Çështjet që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e caktuara me ligj të audituesve të sektorit publik dhe mandatit të vazhduar të audituesve të sektorit publik (çështjet e ligjshmërisë/rregullsisë, pajtueshmërisë dhe performancës) mund të ndikojnë në zbatueshmërinë. Në disa SHP¹⁴⁾, këto referenca përfshihen kur konsiderohet se ato janë thelbësore për fushëveprimin e SHP-së.

c) Udhëzim shtesë mbi çështjet e sektorit publik

Kjo pjesë ofron udhëzim të veçantë shtesë mbi sektorin publik në një nivel të përgjithshëm për të ndihmuar audituesit e sektorit publik gjatë zbatimit të ISA-së në auditimet e entiteteve të sektorit publik. Ai mund të strukturorë pas titujve të ISA-së. Atëherë kur është relevante, paragrafët në këtë pjesë i referohen paragrafëve përkatës të ISA-së. Udhëzimi mund të përmbajë gjithashtu shembuj që janë më shumë relevante për auditimin e entiteteve të sektorit publik sesa ato të ofruar në ISA. Atëherë kur është relevante, në këtë pjesë mund të jepet përkufizimi i termaveshtesë të aplikueshme. Kjo pjesë është strukturuar me nën-pjesët për çdo fushë. Shembuj të çështjeve që janë marrë në konsideratë në këtë pjesë përfshijnë:

- i. Çështjet që lidhen me legjislacionin specifik të aplikueshëm në sektorin publik;

14) Shenime praktike

- ii. Çështjet që lidhen me shqetësimet gjithëpërfshirëse të sektorit publik, për shembull, administrimi, llogaridhënia dhe transparenca;
- iii. Çështjet që lidhen me modelet e ndryshme të Institucioneve Supreme të Auditimit (modelet e Audituesit të Përgjithshëm dhe Gjykatës së Llogarive) të cilat e kontraktjnë punën tek firmat e jashtme të auditimit;
- iv. Çështjet që lidhen me praktikat dhe parimet e kontabilitetit që janë të veçanta për entitetet e sektorit publik;
- v. Çështjet që lidhen me entitetet e veçanta qeveritare (ministritë, agjencitë, institucionet pothuajse qeveritare) dhe sektorët (financat, mbrojtja, drejtësia, shëndetësia, ambienti etj) nëse ka.
- vi. Çështjet e tjera që lidhen drejtpërsëdrejti me zbatimin e ISA-së në auditimet e financave të entiteteve të sektorit publik.

Zbatimi i Udhëzuesve të INTOSAI-it për Auditimin Financiar si Standarde

Zbatimi i Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar

28. Referimi për përdorimin e standardeve mund të bëhet në një nga katër mënyrat, në varësi të standardeve të vëna në zbatim dhe mandati i SAI-ve.
- a) Sipas ISSAI-ve (1000-2999); që do të thotë pajtueshmëri të plotë me të gjitha ISA-të relevante dhe udhëzimin shtesë të dhënë në Shënimet Praktike të ISA-ve të INTOSAI-t.
 - b) Sipas ISA-ve; që do të thotë pajtueshmëri të plotë me të gjitha ISA-të relevante;
 - c) Sipas Parimeve Themelore të INTOSAI-t për Auditimin, por jo në pajtueshmëri të plotë me ISA-të të cilat aktualisht janë të përfshira si pjesë e Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar (ISSAI 1000-2999).

d) Sipas Standardeve të tjera kombëtare ose relevante të Auditimit.

29. Audituesit e sektorit publik, të cilët në raportin e tyre të auditimit mbi pasqyrat financiare shprehen se auditimi është kryer në pajtueshmëri me ISA-të, inkurajohen gjithashtu që të zbatojnë udhëzimin shtesë për sektorin publik nga ISSAI 1000-2999. Referimi në standardet e vëna në zbatim është gjithashtu i nevojshëm kur audituesit e sektorit publik kanë përgjegjësi shtesë për auditim dhe raportim.

Zbatimi i Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar për të mbështetur Parimet Themelore të INTOSAI-t

30. Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar janë hartuar për të mbështetur zbatimin e Parimeve Themelore të INTOSAI-t dhe të ISA-ve (si standarde ose si udhëzim së bashku me Shënimet Praktike). Parimet Themelore të INTOSAI-t janë shkruar që të ofrojnë standarde të përgjithshme për të gjitha aktivitetet e auditimit të kryera nga një Institucion Suprem i Auditimit. Zbatimi i Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar si udhëzim nuk do të zvogëlojë përdorimin e Parimeve Themelore të INTOSAI-t si standarde të sakta të auditimit. Në këtë rast, referimi bëhet në Parimet Themelore të INTOSAI-t si standarde të sakta të vëna në zbatim.

Zbatimi i Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar për të mbështetur standardet e tjera

31. Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar mund të përdoren gjithashtu, nëse është relevante, nga Institucionet Supreme të Auditimit për të mbështetur përdorimin e standardeve të tjera kombëtare për auditimet financiare. Kjo është e përshtatshme vetëm atëherë kur standardet kombëtare të auditimit janë të përshtatura me Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar.

Autoriteti

Autoriteti – Udhëzuesit e Auditimit Financiar dhe Parimet Themelore të INTOSAI-t

32. Parimet Themelore të INTOSAI-t¹⁵⁾ përmbajnë parimet bazë të auditimit për punën që kryhet nga Institucioni Suprem i Auditimit. Ndonëse është përgjegjësi e çdo Institucioni Suprem të Auditimit që të gjykojë nivelin e pajtueshmërisë së standardeve me mandatin e tij (parë në rrethana të veçanta kushtetuese, ligjore dhe të tjera të organizatës audituese) një nga parimet e paraqitura në Kodin e Etikës¹⁶⁾ të INTOSAI-t është detyrimi i audituesve të sektorit publik për të zbatuar standardet e auditimit të pranuar gjerësisht.
33. Parimet Themelore të INTOSAI-t do të mbeten korniza e standardeve të auditimit për të anëtarët e INTOSAI-t dhe autoriteti i këtyre standardeve nuk zvogëlohet në asnjë mënyrë nga botimi i Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar, përfshirë ISA-të dhe SHP-të. INTOSAI e pranon se kjo kornizë bashkë me udhëzimet e dhëna nga Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar do tu ofrojë anëtarëve të INTOSAI-it konceptet relevante dhe udhëzime për kryerjen e auditimeve financiare.
34. Në Hyrjen e Parimeve Themelore të INTOSAI-t thuhet se, edhe pse fjala “standard” përdoret në të gjithë dokumentet, është e kuptueshme që kjo fjalë do të përdoret në mënyrë sinonime në përputhje me rregullat e funksionimit të çdo Institucioni Suprem të Auditimit. Në Parathënien për Parimet Themelore të INTOSAI-t thuhet se, ndonëse Standardet e INTOSAI-t për Auditim nuk janë të zbatueshme me mandat, ato pasqyrojnë një konsensus për “praktikën më të mirë” mes Institucioneve Supreme të Auditimit dhe për këtë arsye çdo institucion duhet të gjykojë nivelin në të cilin standardet janë në pajtueshmëri me mandatin e tij.

15) ISSAI 100-Standardet e INTOSAI-t për Auditim – Parimet themelore, ISSAI 200- Standardet e INTOSAI-t për Auditim – Standardet e Përgjithshme, ISSAI 300- Standardet e INTOSAI-t për Auditim – Standardet e Përgjithshme, dhe ISSAI 400- Standardet e INTOSAI-t për Auditim – Standardet e Raportimit.

16) ISSAI 30-Kodi I Etikës I INTOSAI-t.

35. Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar duhet të merren në konsideratë duke iu referuar Parimeve Themelore të INTOSAI-t. Si rezultat, Shënimet Praktike të Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar nuk përcaktojnë kërkesat për zbatim dhe nuk përdorin termat “do të” apo “duhet”. ISA-të përfshijnë terma të tilla dhe bëjnë dallimin mes kërkesave dhe materialeve të tjera shpjeguese dhe për zbatim. Megjithatë, këto nuk duhet të konsiderohen në mënyrë të ngjashme si të detyrueshme për Institucionin Suprem të Auditimit.
36. Audituesit e sektorit publik mund të përdorin Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar si udhëzim gjithëpërfshirës për kryerjen e auditimeve financiare. Kur udhëzuesit përdoren si standarde, audituesit e sektorit publik respektojnë autoritetin e ISA-ve. Paragrafët 37-43 trajtojnë autoritetin e ISA-ve.

Autoriteti – Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

37. Objektiv i IAASB¹⁷⁾-së është që ti shërbejë interesit publik duke vendosur, në mënyrë të pavarur dhe nën autoritetin e tij, standard të cilësisë së lartë për auditimin, sigurinë, kontrollin e cilësisë dhe shërbime të lidhura me to, si dhe duke lehtësuar perputhshmerinë e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare, duke bërë në këtë mënyrë që të rritet cilësia dhe njëtrajtshmëria e praktikës në të gjithë botën dhe të forcohet besimi i publikut në profesionin e audituesit .
38. IAASB harton ISA-të, Standardet Ndërkombëtare mbi Angazhimet për Rishikim(ISA) dhe Standardet Ndërkombëtare mbi Angazhimet për Siguri. Këtyre standardeve iu referohemi si Standardet e IASB ¹⁸⁾ mbi Angazhimet. IASB harton gjithashtu Standardet Ndërkombëtare mbi Kontrollin e Cilësisë

17) The International Auditing and Assurance Standards Board

18) The International Auditing Standards Board

(SNKC). Standardeve mbi Angazhimet dhe SNKC-ve iu referohemi si Standarde Ndërkombëtare. Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar përfshijnë ISA-të. Ata nuk hedhin poshtë ligjet ose rregulloret vendore që drejtojnë auditimin e pasqyrave financiare apo angazhimet për sigurimin e një informacioni tjetër në një vend të veçantë, të cilat kërkohen që të kryhen sipas standardeve kombëtare të atij vendi. Në rastin kur ligjet ose rregulloret vendore ndryshojnë nga Standardet e IASB ose janë në kundërshtim me to, atëherë auditimi i kryer sipas ligjeve dhe rregulloreve vendore automatikisht nuk do të jetë në pajtim me standardet e IASB. Një kontabilist profesionist nuk duhet të përfaqësojë pajtueshmërinë me Standardet e IASB përveç rasteve kut ai/ajo vepron në pajtueshmëri të plotë me të gjitha ato standarde që janë relevante për angazhimin.

39. Sipas Parathënies për Standardet Ndërkombëtare të Kontrollit të Cilësisë, Auditimit, Rishikimit dhe Shërbimevetë tjera lidhur me të , ISA-t hartohen në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare nga një auditues i pavarur (veç nëse nuk shprehet ndryshe në IFAC, kjo do të thotë pasqyra financiare që përbëjnë informacionin historiko - financiar). Objektivi i auditimit të pasqyrave financiare është të mundësojë audituesin që të shprehë një opinion nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. ISA-të, të marra së bashku, ofrojnë standardet për punën e audituesit në përmbushjen e këtij objektivi.

40. Ndërkohë që ISA-të e hartuara nga IASB janë duke u pranuar vazhdimisht nga komuniteti ndërkombëtar si standardet ndërkombëtare mbi auditimin e pasqyrave financiare, ato ofrojnë një bazë të gjere udhëzimi mbi mënyrën se si zbatohen Parimet Themelore të INTOSAI-t.

41. Që nga viti 2003, INTOSAI ka lidhur një Memorandum Mirëkuptimi me IAASB. Në bazë të kushteve të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, INTOSAI emëron ekspertët e marrë nga anëtarësia më e gjerë e INTOSAI-t që të marrin pjesë në Task Forcat e IAASB përgjegjëse për hartimin e ISA-ve të

reja ose rishikimin e atyre ekzistuese. Ekspertët e Task Forcave të IAASB promovojnë përfshirjen e konsideratave mbi sektorin publik në ISA-të, duke rritur kështu zbatimin e ISA-ve në auditivet financiare të entiteteve të sektorit publik. Natyra e Standardeve Ndërkombëtare kërkon nga kontabilistët profesionistë që të ushtrojnë gjykimin profesional gjatë zbatimit të tyre.

42. Fushëveprimi, data e zbatimit dhe çdo kufizim i veçantë i zbatueshmërisë së një ISA-je të veçantë bëhet e qartë në ISA. Nëse thuhet ndryshe në ISA, kontabilistitprofesionist i lejohet të zbatojë një ISA para datës së hyrjes në fuqi të specifikuar në të.
43. Nëse audituesit e sektorit publik shprehen në raportin e tyre mbi auditimin e pasqyrave financiare që auditimi është kryer në pajtim me ISA-në, ata duhet të respektojnë autoritetin që i është dhënë ISA-ve, siç përcaktohet në ISA 200 (Shtojca 3).

Çështjet e përgjithshme në auditimet e entiteteve të sektorit publik

44. Kjo pjesë trajton disa çështje të përgjithshme që kanë të bëjnë me sektorin publik. Ajo nuk është planifikuar të mbulojë të gjitha çështjet e sektorit publik që mund të jenë relevante për tu marrë parasysh gjatë kryerjes së auditimeve financiare në një ambient standard të sektorit publik. Megjithatë, këto çështje janë konsideruar të kenë rëndësi të përgjithshme për audituesit e sektorit publik gjatë zbatimit të ISSAI—ve në auditimin financiar.
45. Konceptet e paraqitura në paragrafët 46-88 kanë të bëjnë me çështje relevante për audituesit e sektorit publik, të cilat janë të shpjeguara më tepër në secilin SHP. Megjithatë, pjesa kryesore e udhëzuesve duhet të merret në konsideratë gjatë zbatimit të udhëzuesve.

Sistemet e ndryshme të auditimit brenda sektorit publik

46. Në botë ekzistojnë modele të ndryshme të auditimit të jashtëm. Tre sistemet më të zakonshme janë:

- a) Modeli i Audituesit të Përgjithshëm
- b) Modeli i Gjykatës së Llogarive (ose Auditimit)
- c) Modeli i Bordit ose Kolegjit

47. Megjithatë, çdo vend mund të ketë modelin e tij unik dhe ekziston një numër i madh i varianteve kombëtare për mënyrën se si vepron një Institucion Suprem i Auditimit, e cila mund të ndikojë në mënyrën e përvetësimit dhe të zbatimit të ISSAI-ve. ISSAI-të janë hartuar që të ofrojnë udhëzime për të gjithë audituesit e sektorit publik pavarësisht nga sistemi në të cilit ata veprojnë. Sistemi i Audituesit të Përgjithshëm zakonisht fokusohet shumë mbi auditme financiare dhe vepron në kushte të atilla ku përvetësimi i ISSAI-ve mund të jetë më shumë relevant. Modeli i Bordit apo Kolegjit është i ngjashëm me modelin e Audituesit të Përgjithshëm, por ndryshon nga struktura e brendshme e institucionit të auditimit. Një ndryshim i rëndësishëm në sistemin e Gjykatës së Llogarive është se në një sistem të tillë zyrtarët e qeverisë bëhen zakonisht personalisht përgjegjës për pagesat e paautorizuara ose të paligjshme që janë kryer. Megjithatë, sanksione të ngjashme mund të zbatohen edhe për disa modele të Audituesit të Përgjithshëm. Në mjedise të tilla, Institucionet Supreme të Auditimit mund të vendosin gjopa ose ndëshkime për zyrtarët e audituar. Fokusi kryesor i punës audituese shpesh është verifikimi i ligjshmërisë së transaksioneve sesa dhënia e një opinionimi mbi saktësinë e pasqyrave financiare. Edhe modeli i Bordit apo Kolegjit mund të ketë këto funksione gjyqësore. Në Parimet Themelore të INTOSAI-t¹⁹⁾ thuhet se për shkak të qasjes dhe strukturës së disa Institucioneve Supreme të Auditimit, jo të gjitha Standardet e INTOSAI-t për Auditim janë të zbatueshme në të gjitha aspektet e punës së tyre, p. sh, natyra gjyqësore e rishikimeve të kryera nga Gjykata e Llogarive i bën disa aspekte të punës së tyre të jenë krejtësisht të ndryshme nga auditimet financiare dhe të performancës që kryhen nga Institucionet Supreme të Auditimit, të cilat organizohen sipas një hierarkie të udhëhequr nga Audituesi i Përgjithshëm ose Kontrollori i Përgjithshëm.

19) ISSAI 100 Standardet e INTOSAI-t për Auditim – Parimet Themelore, Paragrafi 13

Standardet e INTOSAI-t nuk i mbulojnë në detaje këto përgjegjësi juridike.

48. kur është konsideruar si e nevojshme, në ISSAI-të 1000-2999 janë përfshirë udhëzimespecifike për Institucionet Supreme të Auditimit. Fokusi i madh mbi çështjet e pajtueshmërisë në kuadër të një sistemi të tillë mund të shfaqë nevojën për përvetësimin e Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin e Pajtueshmërisë²⁰⁾ si dhe Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar.

Terminologjia e përdorur tek Udhëzuesit

49. Në kuadër të bashkëpunimit mes INTOSAI-t dhe IASB, terminologjia e sektorit-neutral përfshihet në ISA-të, kështu që ato të mund të kuptohen dhe të zbatohen lehtë si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Kjo bëhet duke përfshirë tekstin e duhur në standardet ose në fjalorin përkatës. Përkufizimet shtesë, të paraqitura në Shënimet Praktike, mund të gjenden gjithashtu në fjalorin e Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar²¹⁾.

50. Një shembull i një koncepti themelor në ISA është se ka shumë çështje të rëndësishme me interes publik që lidhen me auditimet e entiteteve të renditura (entitetet e cituara në një bursë të pranuar). ISA-të paraqesin disa kërkesa që lidhen në mënyrë specifike me entitete e renditura. Entitetet e renditura, si të tilla, nuk mund të jenë të zakonshme në sektorin publik. Mirëpo, entitetet e sektorit publik që janë të rëndësishme për shkak të madhësisë, kompleksitetit apo aspekteve të interesit publik, mund të kenë një gamë të gjerë të palëve të interesit dhe mund të jenë të krahasueshme me entitetet e renditura. Shënimet Praktike trajtojnë koncepte të tilla të cilat të duhet të interpretohen në një mënyrë të ndryshme në sektorin publik.

51. Përdorimi i termave specifike tipike për sektorin publik siç janë “firmë” dhe “kompani” janë zëvendësuar në ISA deri në një farë shkalle me termat e sektorit neutral për të reflektuar përdorimin më të gjerë. Në disa ISSAI,

20) ISSAI 400, ISSAI4001 dhe ISSAI 4002

21) ISSAI1003 Fjalor i Termave të Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar

siç është ISSAI1315²²⁾, gjatë përshkrimit të strukturës dhe komponentëve të kontrollit të brendshëm si dhetë procesit të vlerësimit të riskut referimet janë bërë në termat e përdorura në ISA siç janë biznes, marketing dhe personeli për shitje. Termat korresponduese në sektorin publik janë mandat, objektiva të programit, menaxherët e programit dhe stafi tjetër i programit.

Gjykimi dhe skepticizmi profesional

52. Termat gjykimi profesional dhe skepticizmi profesional²³⁾ janë përdorur shpesh në ISA gjatë formulimit të kërkesave që lidhen me vendimet e audituesve mbi rrjedhën e duhur të veprimit dhe për të shprehur qëndrimin e një personi që merr në pyetje. Këto koncepte janë publike në Parimet Themelore të INTOSAI-t. Parimet Themelore të INTOSAI-t²⁴⁾ adresojnë konceptin e kujdesit të duhur dhe në to thuhet: «Auditorët duhet të jetë vigjilentë për situatat, dobësitë e kontrollit, mangësitë në evidencim, gabimet dhe transaksionet e pazakonta apo rezultatet që mund të jenë treguese të mashtrimit, shpenzimeve jo të duhura ose të paligjshme, veprimeve të paautorizuara, shpërdorimeve, mos efikasitetit ose mungesës së ndershmërisë.

Pranimi dhe vazhdimi i angazhimit (në auditim)

53. ISA-të kërkojnë që në situata të caktuara, audituesi të mohojë opinionin ose të tërhiqet (apo të japë dorëheqje) nga një angazhim atëherë kur kjo është e mundshme në kuadër të ligjit dhe rregullores së zbatueshme. Tërheqja mund të kërkohet, kur:

- Audituesi dhe drejtuesit nuk bien dakord mbi kushtet e auditimit;
- Nuk plotësohen kërkesat etike;
- Hasen vështirësi domethënëse, siç është pamundësia për pasur në dispozicion dokumente ose për të kryer procedurat e kërkuara;

22) ISSAI1315 Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të anomalive materiale përmes të kuptuarit të entitetit dhe ambientit të tij

23) Shiko ISSAI 1003, fjalor i termave të udhëzuesve të INTOSAI-t për auditimin financiar për përkufizimin e plote

24) ISSAI 200 - Standardet e INTOSAI-t për Auditim – Standardet e Përgjithshme' paragrafi 2.41

- Audituesi rrezikon të ndeshet me informacion çorientues; dhe
- Kufizimi i fushëveprimit e ndalon ata që të marrë dëshmitë e mjaftueshme dhe të duhura mbi të cilat të mbështesë opinionin e tij të auditimit.

54. Normalisht, ligji ose rregulloret e një Institucioni Suprem të Auditimit nuk lejojnë për tërheqje dhe Shënimet Praktike ofrojnë udhëzime për veprime të tjera të mundshme për këto situata.

Objektivi i auditimit të pasqyrave financiare

55. ISA-të shkruhen në kontekstin e një audituesi që kryen një auditim të pasqyrave financiare në pajtim me ISA. Ndërkohë këto auditime mund të jenë vetëm një pjesë e detyrës së auditimit në sektorin publik. ISA 200²⁵⁾ përshkruan kornizën se kur zbatohen ISA-të. ISA-të nuk trajtojnë në mënyrë specifike angazhimet e veçanta për raportimin mbi auditimet e performancës, pajtueshmërisë me ligjet ose rregulloret apo çështjet siç janë sistemet joadekuate të kontrollit. ISA 200 shpjegon objektivin kryesor të audituesit në kryerjen e auditimit të pasqyrave financiare, si p.sh.

- a) Për të marrë siguri të mjaftueshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, duke i bërë të mundur kështu audituesit që të jap një opinion nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar; dhe
- b) Për të raportuar mbi pasqyrat financiare dhe komunikuar siç kërkohet në ISA, në pajtim me gjetjet e audituesit.

56. Qëllimi i një auditimi është që të rrisë shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare. Kjo arrihet përmes dhënies së opinionit nga audituesi nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Në rastin e shumicës

25) ISA 200 - Objektivat e përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

së kornizave më qëllim të përgjithshëm, opinionin është nëse pasqyrat financiare janë prezantuar në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale ose nëse japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë, në përputhje me kornizën. Ligjet dhe rregulloret për organizatat e auditimit në sektorin publik mund të përshkruajnë përdorimin e shprehjeve të tjera për të dhënë opinionin. Në një auditim të kryer në pajtim me ISA-të, kërkesat përkatëse etike i mundësojnë audituesin të japë një opinion nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e identifikuar për raportimin financiar.

57. Në Deklaratën e Limës²⁶⁾ thuhet se Auditimi nuk është një qëllim në vetvete, por është komponenti domosdoshëm i një sistemi rregullator, i cili ka për qëllim të zbulojë devijimet nga standardet e pranuar dhe shkeljet e parimeve të ligjshmërisë, efikasitetit, efektivitetit, ekonomikitetit si dhe të menaxhimit financiar. Ky sistem do të bënte të mundur ndërmarrjen e veprimeve korigjuese në raste të veçanta, pranimin e përgjegjshmërisë për ata që duhet të japin llogari, marrjen e kompensimit ose marrjen e masave për parandaliminose të paktën për vështirësimin e shkeljeve të tilla. Kjo është një detyrë shumë më e gjerë sesa dhënia e një opinionin mbi pasqyrat financiare. Këto objektiva më të gjera e më të përgjithshme të auditimit mund të adresohen në pjesët e tjera të Kornizës së INTOSAI-t për Standardet Profesionale. Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar janë relevante për auditimet financiare të entiteteve të sektorit publik. Përgjegjësitë më të gjera shpesh mund të rezultojnë në nevojën për zbatimin e ISSAI-ve të tjera për përgjegjësi shtesë.

58. Parimet Themelore të INTOSAI-t përcaktojnë²⁷⁾ (ISSAI 100) se për disa elemente të mandatit të Institucionit Suprem të Auditimit, veçanërisht për sa i përket auditimit të pasqyrave financiare, objektivat e auditimit të Institucionit Suprem të Auditimit mund të jenë të ngjashme me objektivat

26) ISSAI 1 – Deklarata e Limës

27) ISSAI 100 – «Standardet e INTOSAI-t për Auditim – Parimet Themeluese

e auditimit në sektorin privat. Në ISSAI 300²⁸⁾ thuhet se audituesi duhet të formulojë hapat dhe procedurat e auditimit për të ofruar siguri të mjaftueshme për zbulimin e gabimeve, parregullsisve dhe veprimeve joligjore që mund të kenë një efekt të drejtpërdrejtë dhe material mbi shumat e pasqyrave financiare ose rezultat e auditimeve të rregullsisë. Kërkesat e rregullsisë në sektorin publik rrallë herë janë më pak të rëndësishme në llogaridhënien publike sesa dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare në kuadër të lejimeve të materialitetit. Objektivat e ISA-ve imundësojnë audituesit të japë një opinion nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e identifikuar për raportimin financiar. Kështu, objektivi për auditim i një Institucioni Suprem të Auditimit është më i gjerë sesa objektivat e një auditimi sipas ISA-ve. Më tutje, përdoruesi raportit auditimi të pasqyrave financiare në sektorin publik është më i interesuar për një llogaridhënie më të gjerë se ajo që shprehet në ISA 200 (vendimet ekonomike të përdoruesve). Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar së bashku me Standardet dhe udhëzuesit e tjerë të INTOSAI do ti shërbejnë objektivit më të gjerë të auditimit në sektorin publik.

Rënia dakord me kushtet e angazhimeve të auditimit

59. ISA-të në përgjithësi trajtojnë detyrat që kryhen përmes marrëveshjeve me subjektet/klientët. Institucionet Supreme të Auditimit normalisht marrin përsipër detyra që kanë për qëllim që ti ofrojnë raporte llogaridhënie organeve legislative apo të qeverisjes. Këto detyra janë të mandatuara zakonisht nga legjislativi dhe Institucionit Suprem të Auditimit i kërkohet që të ushtrojë funksionet e ngarkuara. Në disa mjedise të sektorit publik, përveç përgjegjësive të mandatuara, mund të ketë masa kontraktimi për detyrat të auditimit.

28) ISSAI 300 – «Standardet e INTOSAI-t për Auditim – Standardet e Përgjithshme» 22 ISA 210 – «Rënia dakord për kushtet e Angazhimit të Auditimit

60. ISA 210²⁹⁾ trajton kushtet e një angazhimit dhe paraqet kërkesat për audituesin në lidhje me pranimin e një detyre. Këto kërkesa ilustrjnë besueshmërinë në ISA në një marrëdhënie me subjektin/klientin dhe jo kompetencat legjislative të Institucioneve Supreme të Auditimit. Megjithatë, nevoja për një marrëdhënie bashkëpunuese me entitetin e audituar është e zakonshme për të dy.
61. Përveç kërkesave dhe udhëzimeve të përcaktuara në ISA, mund të ketë konsiderata të mëtejshme për audituesit e sektorit publik në ndërmarrjen e angazhimeve të auditimit. Për shembull, aftësitë dhe kompetencat e kërkuara në një auditim mund të jetë më të gjera dhe të përfshijnë nevojën për të kuptuar marrëveshjet e zbatueshme për raportim, siç janë kërkesat për raportimin tek legjislativi, organi qeverisës ose publiku. Audituesve të sektorit publik mund t'ju nevojitet ndonjëherë që të përshtatin qasjen e tyre në mënyrë që të promovojnë pajtueshmërinë me kërkesat e ISA-ve. Ata mund të bëjnë këtë, për shembull, duke kryer procedura të tilla si ato të lidhura me pranimin e klientit dhe vazhdimin për të marrë informacion të vlefshëm për të vlerësuar riskun dhe kryer përgjegjësitë e raportimit.
62. Institucioneve Supreme të Auditimit ju kërkohet zakonisht që të kryejnë auditime siç parashikohen në mandatin e tyre. Ata zakonisht nuk e kanë mundësinë për të refuzuar një detyrë. ISA 210 përfshin rastet kur audituesin mund të mos pranojë një angazhim (nëse nuk janë plotësuar rrethana të caktuara) përveç rasteve kur kërkohet ta bëjë këtë sipas ligjit ose rregullores. Në raste të tilla, kur kërkesa e tij nuk është e zbatueshme, Shënimi Praktik ofron udhëzime shtesë mbi veprimet e përshtatshme për audituesit e sektorit publik.
63. ISA 210 kërkon që audituesi të marrë pëlqimin e drejtuesit ose të atyre të ngarkuar menaxhimin, që ata i pranojnë dhe kuptojnë përgjegjësinë e tyre. Nëse ligji apo rregullorja përcakton në detaje të mjaftueshme kushtet e angazhimit, ndoshta nuk do të jetë e nevojshme që ato të regjistrohen në

29) ISSAI 2010 – Renia dakord per kushtet e angazhimit te auditimit

një dokument filimit të auditimit apo formë tjetër të përshtatshme për marrëveshje me shkrim. Një përjashtim mund të jetë pëlqimi idrejtuesit ose i individëve të ngarkuar me menaxhimin, që ata i pranojnë dhe kuptojnë përgjegjësinë e përcaktuara në ISA. Angazhime të tilla shpesh ekzistojnë në sektorin publik dhe marrëveshjet me shkrim për kushtet e auditimit nuk janë përdorur shpesh. Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar mbështesin futjen e marrëveshjeve të tilla në auditimin e sektorit publik për shkaqe të përcaktuara në Shënimin Praktik.

Proceset e sigurimit të cilësisë

- 64 Parimet Themelore të INTOSAI-t nuk përmbajnë një standard të veçantë mbi kontrollin e cilësisë për punën e auditimit, por disa udhëzime përfshihen në standardet e përgjithshme. Këto nuk tregojnë qartë përgjegjësitë e secilit auditues për kontrollin e cilësisë, por fokusohen në përgjegjësinë e Institucionit Suprem të Auditimit për të hartuar marrëveshje për sigurimin e cilësisë³⁰. ISA 220³¹ kërkon nga audituesi që të zbatojë procedurat e kontrollit të cilësisë në secilin auditim. Dispozitat e ISA 220 janë të zbatueshme për punën e Institucioneve Supreme të Auditimit. Ky ISA përmendet mbi bazën se firma (ose ekuivalenti në sektorin publik) i nënshtrohet procedurave të kontrollit të cilësisë sipas SNKC 1³² ose kërkesave kombëtare që janë të paktën po aq kërkuese.
65. Në firmat e auditimit të sektorit privat, partnerët e angazhuar zakonisht kanë përgjegjësi individuale për auditimin dhe gjithashtu kanë autoritetin që të përfshihen në firmën e auditimit. Institucionet Supreme të Auditimit, Audituesi i Përgjithshëm, Bordi ose Gjykata e Llogarive kanë përgjegjësi të përgjithshme edhe pse përgjegjësitë operative të ditë-për-ditshme mund të delegohen tek të tjerët. Për shembull, të gjithë ata që kanë përgjegjësinë e Partnerit në angazhim në një Institucionit Suprem të Auditimit me një

30) ISSAI 200 - Standardet e INTOSAI-t për Auditim – Standardet e Përgjithshme’ paragrafi 1.27

31) ISA 220 - Kontrolli i Cilësisë për një Auditim të Pasqyrave Financiare’

32) SNKC1 Kontrolli i cilësisë për firmat që kryejnë auditime dhe rishikime të pasqyrave financiare dhe angazhimet për shërbimet që lidhen me sigurinë’

sistem të Audituesit të Përgjithshëm përfundimisht do ti raportojnë Audituesit të Përgjithshëm për shkak të strukturës hierarkike. Në sektorin publik, është e rëndësishme që të zgjidhen rishikues të auditimit për kontrollin e cilësisë të cilët janë të pavarur nga entiteti i audituar dhe që mund të ofrojnë një vlerësim objektiv edhe pse janë pjesë e të njëjtës udhëheqje strategjike siç është dhe personi që ka përgjegjësinë e partnerit të angazhuar.

66. Më tutje, SNKC 1³³⁾ kërkon një rotacion të partnerit të kontraktuar për entitetet e renditura pas një periudhe të paracaktuar. Në sektorin publik, kjo kërkesë mund të aplikohet për entitetet me interes publike të rëndësishëm. Megjithatë, legjislacioni që vendos emërimet dhe kushtet e Zyrës së Audituesit të Përgjithshëm mund të bëjë rotacionin jopraktik. Institucionet Supreme të Auditimit mund të vendosin politika dhe procedura për të nxitur pajtueshmërinë me frymën e kësaj kërkesë (p.sh. duke lëvizur personelin kryesor me përgjegjësi operative për angazhimin e auditimit, duke kërkuar rishikim të angazhimit për kontrollin e cilësisë ose duke kryer rishikime të rregullta mes kolegëve).

Letrat e Punës dhe Dokumentimi i Auditimit

67. Në Parimet Themelore të INTOSAI-t³⁴⁾ thuhet se audituesi duhet të sigurojë që letrat e punës përmbajnë dëshmi të mjaftueshme që mbështesin të gjitha konkluzionet, rekomandimet dhe opinionet. Më tutje, paragrafi 5.5 kërkon nga audituesit që të dokumentojnë në mënyrë të mjaftueshme dëshmitë e auditimit në letrat e punës, duke përfshirë bazën dhe shtrirjen e planifikimit, punën e kryer dhe gjetjet e auditimit. ISA 230³⁵⁾ kërkon nga audituesi që të sistemojë të gjithë dokumentacionin e auditimit në një dosje auditimi dhe të përfundojë procesin administrativ të sistemimit të

33) SNKC 1 Kontrolli I cilësisë për firmat që kryejnë auditime dhe rishikime të pasqyrave financiare dhe angazhimet për shërbimet që lidhen me sigurinë. Ky standard vendos kërkesat mbi firmat e auditimit që lidhen me kontrollet e cilësisë dhe nuk përfshihet në Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar

34) ISSAI 300 – Standardet e INTOSAI-t për Auditim – Standardet e terrenit* Paragrafi 2.3 (d)

35) ISA 230 – Dokumentimi I Auditimit

dosjes përfundimtare të auditimit në afate kohore, pas datës së raportit të audituesit. Ai gjithashtu kërkon nga audituesi që të mos fshijë apo hedhë dokumentacionin e auditimit të çfarëdo natyre para përfundimit të periudhës së ruajtjes së dosjes. SNKC 1³⁶⁾ (ose kërkesat kombëtare që janë të paktën po aq kërkuese) kërkon nga organizatat e auditimit që të hartojnë politika dhe procedura për përfundimin me kohë të dosjeve të auditimit. Në sektorin publikushtet për ruajtjen dhe konfidentalitetin e dokumentacionit mund të rregullohen nga legjislativi. ISQC 1 përcakton kërkesat për firmat audituese (dhe ekuivalentet në sektorin publik) në lidhje me kontrollet e cilësisë. Shënimi Praktik për ISA 230 ofron udhëzime shtesë në lidhje me dokumentacionin.

Komunikimi

68. ISA 260³⁷⁾ përcakton ata që janë të ngarkuar me drejtimin si “personi (at) ose organizata (t) me përgjegjësi për mbikëqyrjen e drejtimin strategjik të entitetit dhe detyrime në lidhje me llogaridhënien e entitetit.” Në sektorin publik, identifikimi i personave drejtues të ngarkuar me menaxhimin mund të jetë një sfidë. Entiteti që do të auditohet mund të jetë pjesë e një strukture më të madhe ose më të gjerë me organe qeverisëse në nivele të ndryshme organizative. Në disa raste, mund të ketë edhe kërkesa të veçanta për raportim në lidhje me aspektet e auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë që përfshijnë organe të veçanta qeverisëse. Shënimet Praktike të ISA-ve trajtojnë komunikimin, japin udhëzime të përshtatshme për të përmbushur nevojat dhe pritshmëritë e rregullatorëve të ndryshëm ose të legjislativit.
69. ISA 260 përcakton kërkesat për raportim vjetor të pajtueshmërisë me kërkesat etike lidhur me pavarësinë e audituesit. Përveç përcaktimeve të përshkruara në ISSAI, çështjet e përcaktuara në Kodin e Etikës së INTOSAI-t, siç është neutraliteti politik, mund të jenë gjithashtu të rëndësishme për audituesit e sektorit publik.

36) SNKC 1 Kontrolli I cilësisë për firmat që kryejnë auditime dhe rishikime të pasqyrave financiare dhe angazhimet për shërbimet që lidhen me sigurinë

37) ISA 260 Personat e ngarkuar me qeverisjen⁴

70 Audituesit e sektorit publik mund të kenë gjithashtu përgjegjësi komunikimi më të gjera se ato të parashikuara në ISA 260. Siç thuhet në Shënimet Praktike përkatëse, audituesit e sektorit publik mund të kenë përgjegjësi të tilla për të komunikuar me legjislativin, rregullatorët e ndryshem apo me agjencitë përkatëse financuese.

Identifikimi i Mashtrimit dhe Gabimit

71. Në Parimet Themelore të INTOSAI-t³⁸⁾ thuhet se Institucioni Suprem i Auditimit duhet të sigurojë se teknikat e përdorura janë të mjaftueshme për të zbuluar të gjitha gabimet dhe parregullsitë materiale të matshme. ISA 240³⁹⁾, si një parim themelor, kërkon nga audituesi që kur të planifikojë auditimin, të vlerësojë riskun që mashtrimi ose gabimi mund të sjellin si rezultat pasqyra financiare që përmbajnë gabime materiale. Ai gjithashtu kërkon nga audituesi të marrë në pyetje drejtuesin në lidhje me çdo mashtrim që është zbuluar. Audituesit e sektorit publik kanë zyrtarisht përgjegjësinë për të zbuluar mashtrimin, dhe përveç kësaj, përdorimi i parave publike tenton të imponojë një profil më të lartë mbi çështjet e mashtrimit. Si rezultat, audituesve ju duhet ti përgjigjen pritshmërisë së publikut në lidhje me zbulimin e mashtrimit.

72. Një fushë tjetër që mund të përfshijë dallime të mëdha në krahasim me auditimet e sektorit privat, lidhet me përgjegjësitë e audituesve të sektorit publik, në disa mjedise të sektorit publik për veprimet që duhet të ndërmerren kur zbulohen veprat kriminale. Shënimi Praktik për ISA 240 referojnë përgjegjësitë e mundshme për raportim të sektorin publik, për të adresuar shqetësimet rreth llogaridhënies publike.

73. Shumë Institucione Supreme të Auditimit janë përgjegjëse për të kontribuar në parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit në përputhje me Parimet Themelore të INTOSAI-t. ISA 240 zgjerohet në standardet e rrisqeve të auditimit dhe trajton zbatimin e tyre në lidhje me risqet e anomalive materiale

38) ISSAI 300 – Standardet e INTOSAI-t për Auditim – Standardet e terrenit⁴ Paragrafi 5.3

39) ISA 240 - Përgjegjësitë e Audituesit në lidhje me mashtrimin në një auditim të pasqyrave financiare⁴

për shkak të mashtrimit. Në sektorin publik, përgjegjësitë e audituesve mund të rezultojnë nga legjislacioni, rregullorja, direktivat në lidhje me entitetin e audituar ose mund të mbulohen veçmas nga mandatiauditimit. Si rezultat, ato përgjegjësi nuk mund të kufizohen në rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare për shkak të mashtrimit. Përgjegjësitë e audituesit në lidhje me mashtrim mund të jenë më të gjera se sa në sektorin privat dhe mund të përfshijnë aspektet e pajtueshmërisë, llogaridhënies publike dhe menaxhimit të shëndoshë të financave në sektorin publik.

74. Fushat ku audituesit e sektorit publik janë vigjilentë ndaj rreziqeve të mashtrimit përfshihen në Shënimin Praktik përkatës dhe përfshijnë fusha të tilla si prokurimi, grantet, privatizimet, keqinterpretimet me dashje të rezultateve ose informacionit dhe keqpërdorimi i autoritetit apo pushtetit.

Konsiderata e audituesit për ligjet dhe rregulloret

75. ISSAI 300⁴⁰⁾ thekson se auditimi i rregullshmërisë është një element thelbësor i auditimit të qeverisë. Një objektiv i rëndësishëm i këtij lloji auditimi është që të sigurohet, me të gjitha mjetet e mundshme, se Buxheti dhe llogaritë e shtetit janë të plota dhe të vlefshme. Kjo do të japë siguri Parlamentit dhe përdoruesve të tjerë të raportit të auditimit në lidhje me madhësinë dhe zhvillimin e detyrimeve financiare të Shtetit. Për të arritur këtë objektiv, audituesit e sektorit publik mund të shqyrtojnë llogaritë dhe pasqyrat financiare të entitetit të audituar, për të siguruar që të gjitha operacionet janë ndërmarrë, përfunduar, paguar dhe shpjeguar në mënyrë korrekte. Parimet Themelore të INTOSAI-t përqendrohen në rëndësinë e shqyrtimit të pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret gjatë auditimit në sektorin publik, sepse vendimmarrësit duhet të dinë nëse ligjet dhe rregulloret janë duke u zbatuar, nëse ato kanë dhënë rezultatet e dëshiruara dhe nëse jo, çfarë rishikimesh janë të nevojshme për t'u bërë⁴¹⁾. Përveç auditimit të pasqyrave financiare, shumë angazhime në sektorin publik

40) ISA 300 - Standardet e INTOSAI-t për Auditim - Standardet e terrenit' Paragrafi 4.1

41) ISA 300 - standardet e INTOSAI-t për auditim - standardet e terrenit' Paragrafi 4.2

përfshijnë përgjegjësitë shtesë për auditim në lidhje me shqyrtimin e ligjeve dhe rregulloreve të cilat nuk kanë efekt material në pasqyrat financiare. ISSAI 4200⁴²⁾ adreson përgjegjësitë e audituesit për sa i përket auditimit të pajtueshmërisë në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare.

76. ISA 250⁴³⁾ thekson se audituesi nuk është përgjegjës për parandalimin e mospajtueshmërinë me ligjin dhe rregulloret. Ndërsa audituesit e sektorit publik mund të kenë përgjegjësi shtesë lidhur me pajtueshmërinë me ligjin dhe rregulloret. Përveç kësaj, pritshmëritë e publikut mund të merren në konsideratë gjatë planifikimit dhe kryerjes së procedurave të auditimit.

Vlerësimi i rrezikut dhe procedurat e auditimit

77. Standardet e riskut të auditimit janë themelore për qasjen e auditimit të bazuar në risk. Këto standarde normalisht i referohen riskut të veprimtarisë, të cilin ISA⁴⁴⁾ 315 e përkufizon si “një risk që rezulton nga kushtet, ngjarjet, rrethanat, veprimet e rëndësishme ose mosveprimet që mund të ndikojnë negativisht në aftësinë e një entiteti për të arritur objektivat e tij dhe ekzekutuar strategjitë e e tij ose nga vendosja e qëllimeve dhe strategjive të papërshtatshme. “Riskui veprimtarisë është më i gjerë se sa riskui anomalive materiale në pasqyrat financiare”.
78. Koncepti i përgjithshëm i riskut të veprimtarisë zbatohet në kontekstin e identifikimit dhe vlerësimit të rrezikut të auditimit në sektorin publik. Në sektorin publik, risku i veprimtarisë lidhet me riskun që aktivitetet qeveritare, duke përfshirë programet përkatëse, planet strategjike dhe objektivat nuk do të përfundohen apo arrihen. Përveç kësaj, risqet e lidhura me çështje të tilla si klima politike, interesi publik dhe ndjeshmëria e programit apo mospajtueshmëria potenciale me legjisllacionin ose autoritetin e duhur, janë relevante në kontekstin e sektorit publik.

42) ISSAI 4200- Auditimi i Pajtueshmërisë në lidhje me Auditimin e Pasqyrave Financiare

43) ISA 250- konsideratat për ligjet dhe rregulloret në një auditim të pasqyrave financiare

44) ISA 315 - Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të anomalive materiale përveç të kuptuarit të entitetit dhe ambientit të tij, ISA 330- Përgjigja e audituesit ndaj rreziqeve të vlerësuara dhe ISA 500 - Dëshmitë e auditimit'

79. Përveç kërkesave dhe udhëzimeve të përcaktuara në ISA-të për rrezikun, mund të ketë më shumë konsiderata për audituesit e sektorit publik në vlerësimin e rrezikut dhe hartimin e procedurave të auditimit. Për të kuptuar entitetin, audituesit e sektorit publik marrin parasysh mandatin e tyre të gjerë, si dhe legjislacioni përkatës, rregulloret, direktivatose kërkesat e tjera që ndikojnë në operacionet e entitetit. Objektivat e drejtimit, përfshirë çështjet e llogaridhënies publike, merren gjithashtu në konsideratë. Informacioni për vlerësimin e riskut mund të merret gjithashtu edhe nga audituesit e performancës apo burime të tjera relevante, siç janë dëshmitë nga zyrtarët e qeverisë apo raportet ose procesverbalet e legjislativit.
80. Audituesit e sektorit publik kanë përgjegjësi raportimi për ato çështje që lidhen me efektivitetin e kontrollit të brendshëm apo pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret, të cilat audituesit e sektorit privat nuk i kanë. Rishikimet e audituesve të sektorit publik mbi kontrollet e brendshme mund të jenë më të gjera dhe më të hollësishme se ato në sektorin privat. Kërkesat e raportimit mund të jenë më të gjera, prandaj audituesve të sektorit publik mund t'u kërkohej që të raportojnë tek legjislativi apo tek një organ tjetër qeveritar të gjitha mangësitë e identifikuara të kontrollit të brendshëm ose devijimet e pajtueshmërisë (jo vetëm ato që janë materiale). Udhëzimi për çështjet e vlerësimit të riskut është dhënë në Shënimet Praktike përkatëse.

Materialiteti në auditimet e entiteteve të sektorit publik

81. Riskui anomalisë materiale është përkufizuar në ISA 200⁴⁵⁾ si: “Risku që pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale para auditimit”. Në një auditim të pasqyrave financiare anomalia materiale është e vetme ose e bërë bashkë me anomalitë tjera, kur ajo mund të pritët të ndikojë në vendimet ekonomike që përdoruesit marrin duke u bazuar në pasqyrat financiare. Materialiteti ka dy aspekte, atë sasior dhe atë cilësor. Në sektorin

45) ISA 200 - Objektivat e përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit⁴

publik, materialiteti mund të mos jetë i kufizuar në vendimet ekonomike të përdoruesve. Ligjvënësit dhe rregullatorët janë shpesh përdoruesit primarë të pasqyrave financiare të sektorit publik. Ata mund të përdorin pasqyrat financiare jo vetëm për të marrë vendimet ekonomike, por edhe për të vendosur nëse programe të caktuara qeveritare ose grantet financiare do të vazhdojnë. Aspektet cilësore të materialitetit në përgjithësi luajnë një rol më të madh në sektorin publik se sa në sektorin privat.

82. ISA-të që trajtojnë materialitetin përcaktojnë procedurat për përcaktimin e niveleve të materialitetit. Në sektorin publik, nivelet e materialitetit mund të përcaktohen në një nivel më të ulët se ato të parashikuara nga ISA-të për shkak të konsideratave të tilla si natyra e ndjeshme e transaksioneve ose programeve të caktuara, interesi publik, nevoja për mbikëqyrjen dhe rregullimin efektiv nga legjislativi si dhe natyra e anomalisë apo devijimit (p.sh. në qoftë se ajo është e lidhur me mashtrim ose korrupsion).
83. Mandati më i gjerë në sektorin publik mund të kërkojë auditime të aspekteve të caktuara që lidhen me pajtueshmërinë dhe kontrollin e brendshëm. Ndërsa anomali të shumave të vogla monetare mund të konsiderohen të parëndësishme, devijimet e vogla që lidhen me pajtueshmërinë ose kontrollin e brendshëm, nga natyra e tyre, në përgjithësi nuk shihen si të parëndësishme. Edhe në qoftë se një transaksion - pavarësisht nga madhësia - regjistrohet saktë në pasqyrat financiare, transaksioni përfaqëson një shembull të mos-pajtueshmërisë ose të devijimit nga kontrolli nëse është i paligjshëm, mashtrues, ose nëse kontrolli nuk është kryer.
84. Audituesit i sektorit publik kanë përgjegjësi që të raportojnë drejtuesve dhe tyre të ngarkuar me menaxhim të gjitha anomali të identifikuara (jo vetëm ato të parëndësishmet) si dhe shmangiet nga pajtueshmëria dhe kontrolli. Anomali apo devijime të tilla mund të kenë impakt në një kontekst më të gjerë. Bazuar në mandatet e tyre, disa Institucione Supreme të Auditimit mund të urdhërojnë që të gjitha rastet e mos-pajtueshmërisë të korrigjohen.

Raportet e audituesit në sektorin publik

85. Lidhja logjike e brendshme në raportet e auditimit nxit besueshmëri pasi mund të thuhet fare lehtë se raporti është përgatitur në bazë të standardeve profesionale. Ai gjithashtu ndihmon lexuesit që të identifikojnë më lehtë ndonjë modifikim të opinionit të audituesit dhe gjetjet e auditimit siç janë mangësitë e kontrollit brendshëm dhe rastet e mospajtueshmërisë me autoritetet. ISA-të 700, 705, 706, 800, 805, dhe 810 trajtojnë formën e raportit të audituesit që nevojitet për auditimet e kryera në përputhje me ISA-të. Në sektorin privat, raporti i auditimit në përgjithësi është një mënyrë e komunikimit të një anshëm drejtuar palëve përkatëse, siç janë aksionarët ose bordi i drejtorëve. Ai identifikon auditimin e kryer dhe standardet mbi të cilat është bazuar puna. Përgjegjësitë e audituesit dhe të drejtuesit paraqiten në të dhe opinionit të audituesit shprehet qartë. Në rrethana të caktuara, raporti gjithashtu mund të përfshijë paragrafë shtesë që trajtojnë edhe më shumë çështje me rëndësi.
86. Struktura e njëjtë është zakonisht relevante për raportin e auditimit në sektorin publik dhe pse ai ka tendencën të jetë më i gjatë dhe të përfshijë një gamë të gjerë çështjesh. Në ligjet e sektorit publik, mandati i auditimit apo praktika e zakonshme mund të bëjnë që audituesi i sektorit publik të raportojë gjetjet, konkluzionet, rekomandimet dhe përgjigjet e drejtuesit. Raportimi i tillë është plotësues për raportin e auditimit mbi pasqyrat financiare në pajtim me ISSAI 1700⁴⁶⁾

Përkthimi i Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar

87. FAS⁴⁷⁾ ka krijuar procedurat për përkthimin e udhëzimeve të INTOSAI-t të përfshira në Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar në gjuhët zyrtare të INTOSAI-t⁴⁸⁾. Procedurat ndjekin drejtimet e dhëna nga Komiteti Drejtuesi INTOSAI-t për Standardet Profesionale, siç janë formuluar gjatë takimit në Uashington DC, në qershor të vitit 2006.

46) ISSAI 1700 - Krijimi i një Opinioni dhe raportimi i pasqyrave financiare

47) Financial accounting standards (standardet e kontabilitetit financiar)

48) Gjuhët zyrtare të INTOSAI-t janë Arabishtja, Anglishtja, Frëngjishtja, Gjermanishtja, dhe Spanjishtja

88. Të gjitha udhëzimet e hartuara nga INTOSAI si pjesë e Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar janë të publikuara në gjuhën angleze për komente. Komentet pranohen në të gjitha gjuhët zyrtare të INTOSAI-t.
89. Përkthimi në gjuhët zyrtare të INTOSAI-t bëhet para miratimit të ISSAI-ve nga INTOSAI. Sigurimi i cilësisë së përkthimeve bëhet nga anëtarët e FAS-it, ekspertët e angazhuar në hartimin e Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar dhe organet e tjera të INTOSAI-t.
90. Megjithatë, ISA-it e hartuara nga IASB dhe miratuara si pjesë e Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar, janë hartuar në anglisht dhe nuk janë përkthyer nga INTOSAI. ISA-të janë subjekt i të drejtave të autorit nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (FNK). FNK ka hartuar një bazë të dhënash rreth botimeve të FNK-së të përkthyer nga palët e treta. Ajo përfshin gjuhët, titujt e botimeve, Emrat e organizatave që kanë bërë përkthimin dhe, aty ku është e mundur, listat e termave kryesore të përkthyer. FNK nuk ka rishikuar cilësinë e botimeve ose termat kryesore të përkthyer. Për t'i shërbyer interesit publik dhe për të nxitur respektimin e standardeve profesionale të cilësisësë lartë, si dhe për të çuar më tej konvergjencën ndërkombëtare të standardeve të tilla, FNK ka krijuar këtë bazë të dhënave rreth përkthimeve, e cila është në dispozicion në faqen e saj të internetit⁴⁹⁾.
91. Çdo përkthim tjetër i Udhëzuesve të INTOSAI-t për Auditimin Financiar nga ISA-të duhet të jetë në pajtim me rekomandimet e përkthimit të përcaktuara në Shtojcën 4 dhe, nëse ISA-të janë subjekt i procesit të përkthimit, me Politikën për përkthimin dhe riprodhimin e standardeve të hartuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve⁵⁰⁾, e publikuar në dhjetor 2008.

49) <http://www.ifac.org/Translations/database.php>

50) <http://www.ifac.org/Downloads/TranslationOfStandards.pdf>

Shtojca 1 - Lidhja ndërmjet Parimeve Themelore të INTOSAI-t për auditimin të (ISSAI 100-400) dhe Udhëzimeve të INTOSAI- për auditimin financiar (ISSAI 1000-2999)

1. Kjo shtojcë shërben për të pasqyruar lidhjen ndërmjet Parimeve themelore të INTOSAI-t për auditim dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, të përfshira në Udhëzuesit e INTOSAI-t për auditimin financiar së bashku me një Shënim praktik. Pikënisja e kësaj lidhje është paraqitur në parimet themelore INTOSAI-t për auditim. Për secilën temë ose paragraf relevant të Parimeve themelore, ku mund të gjenden udhëzime mëtejshme në një ISSAI të përfshira në Udhëzuesit për auditim financiar, është paraqitur ISA përkatës me numrin dhe titullin si dhe një përshkrim i shkurtër i kontekstit.
2. Kjo listë nuk është menduar të jetë një listë e plotë e të gjithë paragrafëve të Parimeve Themelore të INTOSAI-t, si dhe ISSAI-të të lidhura me të. Kjo listë ka për qëllim të paraqesnjë pasqyrë të asaj se si udhëzimet për auditim financiar dhe ISA-të ndërthuren në strukturën e INTOSAI-t.

ISSAI 100 – Parimet themelore për auditimin e qeverisë

<i>Standardet e përgjithshme</i>	<i>Udhëzimi i ndërlidhur në ISSAI 1000- 2999</i>	
Përgjithshëm	ISSAI 1000	Hyrje në Udhëzuesit e INTOSAI-T për auditimin financiar
Përgjithshëm	ISSAI 1200	Objektivat e përgjithshme të audituesit të pavarur si dhe kryerja e auditimit në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
§ 8- 11	ISSAI 1320	Materialiteti gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit
§ 16	ISSAI 1500	Dëshmitë e auditimit
	ISSAI 1501	Dëshmitë e auditimit- shqyrtimet e veçanta për pozicione të caktuara
§ 31	ISSAI 1315	Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve të anormalive materiale përmes njohjes së entitetit dhe mjedisit në të cilin operon
	ISSAI 1450	Vlerësimi i anormalive të identifikuara gjatë auditimit

ISSAI 200 – Standardet e përgjithshme në auditimin e qeverisë dhe standardet me rëndësi etike

<i>Standardet e përgjithshme</i>	Udhëzimi I ndërlidhur në ISSAI 1000- 2999	
Përgjithshëm	ISSAI 1000	Hyrje në Udhëzuesit e INTOSAI-T për auditimin financiar
Përgjithshëm	ISSAI 1200	Objektivat e përgjithshme të audituesit të pavarur si dhe kryeja e auditimit në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
§ 1.2. (d), 1.15	ISSAI 1300	Plani fikimi i auditimit të Pasqyrave financiare
<i>Standardet me rëndësi etike</i>	Udhëzimi i ndërlidhur në SNISA (ISSAI) 1000- 2999	
Përgjithshëm	ISSAI 1200	Objektivat e përgjithshme të audituesit të pavarur si dhe kryeja e auditimit në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
Përgjithshëm	ISSAI 1210	Rënia dakord me kushtet e angazhimeve të auditimit
§ 2.34- Opinioni i auditimit	ISSAI 1700	Formulimi i opinionit dhe raportimi mbi pasqyrat e auditimit financiare
§ 2.35-43	ISSAI 1220	Kontrulli i cilësisë për auditimin e pasqyrave Financiare
§ 2.2.37	ISSAI 1520	Procedurat analitike
Metodologjitë	ISSAI 1530 ISSAI 1315	Mostrat për auditim
§ 2.41 Mashtrimi	ISSAI 1450 ISSAI 1240	Identifikimi dhe vlerësimi i rrisht të anomaliave materiale përmes njohjes së entitetit dhe mjedisit në të cilin operon Vlerësimi i gjetjeve të identifi kuara gjatë auditimit
§ 2.2.43-45	ISSAI 1600	Përgjegjësia e audituesit në lidhje me mashtrimin gjatë auditimit të pasqyrave financiare
	ISSAI 1610 ISSAI 1620	Shqyrtimet e veçanta- Auditimet e pasqyrave financiare të grupit (përfshirë edhe punën e audituesve që auditojnë komponentët e veçanta) Përdorimi i punës së audituesve të brendshëm
§2.46- Konfidencialiteti	ISSAI 1230	Përdorimi i punës së ekspertit të cilin e angazhon Audituesi Dokumentimi i auditimit

ISSAI 300 – Standardet e terrenit gjatë auditimit të qeverisë

<i>Standardet me rëndësi etike</i>	Udhëzimi i ndërlidhur në ISSAI 1000- 2999	
§ 1.1- 1.4.	ISSAI 1300	Planifikimi i auditimit të Pasqyrave financiare
	ISSAI 1315	Identifikimi dhe vlerësimi i riskut të anomalive materiale përmes njohjes së entitetit dhe mjedisit në të cilin operon
	ISSAI 1320	Materialiteti gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit
§ 2.1- 2.5	ISSAI 1330	Përgjigjet e audituesit ndaj risqeve të vlerësuara
	ISSAI 1220	Kontrolli i cilësisë për auditimin e pasqyrave financiare
§ 3.1- 3.4	ISSAI 1315	Identifikimi dhe vlerësimi i riskut të anomalive materiale përmes njohjes së entitetit dhe mjedisit në të cilin operon
Studimi dhe vlerësimi i kontroleve të brendshme	ISSAI 1330	Përgjigjet e audituesit ndaj rreziqeve të vlerësuara
	ISSAI 1250	Shqyrtimi i ligjeve dhe rregulloreve gjatë auditimit të pasqyrave financiare
§§ 4.1 – 4.7	ISSAI 1240	Përgjegjësia e audituesit në lidhje me mashtrimin gjatë auditimit të pasqyrave financiare
Pajtueshmëria me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme	ISSAI 1315	Identifikimi dhe vlerësimi i riskut të anomalive materiale përmes njohjes së entitetit dhe mjedisit në të cilin operon
§ 5.2- Sistemet kompjuterike	ISSAI 1330	Përgjigjet e audituesit ndaj riskut të vlerësuara
	ISSAI 1320	Materialiteti gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit
§ 5.3 – Materialiteti	ISSAI 1500	Dëshmitë e auditimit
§ 5.1 – 5.7	ISSAI 1501	Dëshmitë e auditimit- shqyrtimet e veçanta për pozicione të caktuara
	ISSAI 1230	Dokumentimi i auditimit
	ISSAI 1505	Konfirmimet e jashtme
	ISSAI 1510	Angazhimet fillestare të auditimit- Gjendjet fillestare
	ISSAI 1520	Procedurat analitike
	ISSAI 1530	Mostrat për auditim
	ISSAI 1540	Auditimi i pasqyrave kontabël, përfshirë auditimin e pasqyrave kontabël sipas vlerës reale si dhe gjetjet e konstatuara
	ISSAI 1550	Palët e ndërlidhura
	ISSAI 1560	Ngjarjet pasuese
	ISSAI 1570	Vazhdueshmëria e operimit
Dëshmitë e auditimit	ISSAI 1580	Deklarimet në formë të shkruar
	ISSAI 1520	Procedurat analitike
§ 6.1 – 6.4 Analiza e pasqyrave financiare	ISSAI 1520	Procedurat analitike

ISSAI 400 – Standardet e raportimit gjatë auditimit të qeverisë

	Udhëzimi i ndërli dhur në ISSAI 1000- 2999	
Raportime të Përgjithshme	ISSAI 1700	Formulimi i opinionit dhe raportimi i pasqyrefinanciare
	ISSAI 1705	Modifikimi i opinionit në raportin e audituesit të pavarur
	ISSAI 1706	Paragrafët mbi identifikimin e çështjes dhe paragrafëte tjera në raportin e audituesit të pavarur
	ISSAI 1260	Komunikimi me personat përgjegjës për drejtimin
	ISSAI 1265	Komunikimi i mangësive në kontrollët e brendshme personave përgjegjës për drejtimin dhe Menaxhim
	ISSAI 1800	Shqyrtime të veçanta- Auditimet e pasqyrefinanciare individuale si dhe elementet specifike, llogaritë apo artikujt e pasqyrave financiare
	ISSAI 1805	Shqyrtime të veçanta- Auditimet e pasqyrefinanciare të përgatitura në pajtim me Kornizat përqëllime të veçanta
	ISSAI 1810	Angazhimet për të raportuar në lidhje me përmblendhjen e pasqyrave financiare
§ 4.3- Objektiva	ISSAI 1200	Objektivat e përgjithshme të audituesit të pavarursi dhe kryerja e auditimit në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
§ 4.17 – Kontrolli	ISSAI 1315	Identifikimi dhe vlerësimi i riskut të anomalive materiale përmes njohjes së entitetit dhe mjedisit në të cilin operon i brendshëm
§ 4.17 - Mashtrimi	ISSAI 1240	Përgjegjësia e audituesit në lidhje me mashtrimin gjatë auditimit të pasqyrave financiare

Shtojca 2 –ISSAI, efektive për auditimin e pasqyrave financiare për periudhat që fillojnë më 15 dhjetor 2009 ose më pas

Nr. I ISSAI	Shënimi	Përshkrimi
ISSAI1000	* ⁴³	Hyrje e përgjithshme në Udhëzuesit e INTOSAI-T për auditim financiar
ISSAI1003	** ⁴⁴	Fjalorth termash për Udhëzuesit e INTOSAI-T për auditim financiar
ISSAI1200	** ⁴⁵	Objektivat e përgjithshëm të audituesit të pavarur si dhe kryerja e auditimit në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI 1210	**	Rënia dakord me kushtet e angazhimeve të auditimit
ISSAI1220	**	Kontrolli i cilësisë në auditimin e pasqyrave financiare
ISSAI1230	**	Dokumentimi i auditimit
ISSAI 1240	**	Përgjegjësia e audituesit në lidhje me mashtrimin gjatë auditimit të pasqyrave financiare
ISSAI1250	**	Shqyrtimi i ligjeve dhe rregulloreve gjatë auditimit të pasqyrave financiare
ISSAI 1260	**	Komunikimi me personat përgjegjës drejtues
ISSAI1265	**	Komunikimi i mangësive në kontrollet e brendshme personave përgjegjës për drejtimin dhe menaxhimin
ISSAI1300	**	Planifikimi i auditimit të Pasqyrave financiare
ISSAI1315	**	Identifikimi dhe vlerësimi i rezikut të anomalive materiale përmes njohjes së entitetit dhe mjedisit në të cilin operon
ISSAI1320	**	Materialiteti gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit
ISSAI1330	**	Përgjigjet e audituesit ndaj rreziqeve të vlerësuar
ISSAI1402	**	Shqyrtimet e auditimit lidhur me një entitet i cili përfitonshërbimet e një organizate tjetër
ISSAI1450	**	Vlerësimi i anomalive të identifikuara gjatë auditimit
ISSAI 1500	**	Dëshmitë e auditimit
ISSAI1501	**	Dëshmitë e auditimit- shqyrtimet e veçanta për pozicione të caktuara
ISSAI1505	**	Konfirmimet e jashtme
ISSAI1510	**	Angazhimet fillestare të auditimit- Gjendjetfilltare
ISSAI1520	**	Procedurat analitike

43* Këto SNISA(ISSAI) përbëhen nga udhëzuesi i hartuar I INTOSAI-t

44 *** SNISA(ISSAI) 1003 do të përfshijë një fjalor të lëshuar nga BSNA(ISA)S si dhe shpjegimet shtesë që janë relevante për auditimet e entiteteve të sektorit publik.

45 ** Këto SNISA(ISSAI) përbëhen nga Standardet përkatëse Ndërkombëtare për Auditimin dhe një Shënim Praktik të lëshuar nga INTOSAI.

ISSAI1530	**	Mostrat për auditim
ISSAI1540	**	Auditimi i vlerësimeve kontabël, përfshirë auditimin e vlerësimeve kontabël sipas vlerës reale si dhe gjetjet e konstatuara
ISSAI 1550	**	Palët e ndërlidhura
ISSAI 1560	**	Ngjarjet pasuese
ISSAI1570	**	Vazhdueshmëria e operimit
ISSAI1580	**	Deklarimet në formë të shkruar
ISSAI1600	**	Shqyrtimet e veçanta- Auditimet e pasqyrave financiare të grupit (përfshirë edhe punën e audituesve që auditojnë komponentët e veçanta të grupit)
ISSAI 1610	**	Përdorimi i punës së audituesve të brendshëm
ISSAI1620	**	Përdorimi i punës së ekspertit të cilin e angazhon audituesi
ISSAI 1700	**	Formulimi i opinionit dhe raporti mi i pasqyrave financiare
ISSAI1705	**	Modifikimi i opinionit në raportin e audituesit të pavarur
ISSAI1706	**	Paragrafët mbi identifikimin e gjetjeve dhe paragrafët e tjera në raportin e audituesit të pavarur
ISSAI 1710	**	Informacionet krahasuese/ Shifrat korresponduese dhe pasqyrat financiare krahasuese
ISSAI1720	**	Përgjegjësitë e audituesit në lidhje me informacionet e tjera në dokumentet që përmbajnë pasqyrat financiare të audituara
ISSAI1800	**	Shqyrtime të veçanta-Auditimet e pasqyrave financiare individuale si dhe elementet specifike, llogaritë apo artikujt e pasqyrave financiare
ISSAI 1805	**	Shqyrtime të veçanta- Auditimet e pasqyrave financiare të përgatitura në pajtim me Kornizat për qëllime të veçanta
ISSAI1810	**	Angazhimet për të raportuar në lidhje me përmbledhjen e pasqyrave financiare

Shtojca 3 – Autoriteti i bashkangjitur ISA-ve

Ekstrakt nga ISA 200 (të vlefshme për periudhat që fillojnë më 15 dhjetor 2009 ose më pas)

ISA-të janë të shkruara në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare nga një auditues. Ata mund të adaptohen sipas nevojës në rrethanat kur aplikohet gjatë auditimeve të informacioneve të tjera historike financiare. ISA-të nuk adresojnë përgjegjësitë e audituesit, të cilat mund të ekzistojnë në legjislacion, rregullore ose të tjera si p.sh në lidhje me ofrimin e sigurisë për publikun. Përgjegjësi të tilla mund të dallojnë nga ato të përcaktuara në ISA. Rrjedhimisht, ndërsa audituesi mund të gjej aspekte të dobishme të ISA për rrethana të tilla, është përgjegjësi e audituesit të sigurojë pajtueshmërinë me të gjitha detyrimet përkatëse ligjore, rregullatore apo profesionale.

Auditimi i Pasqyrave financiare

2. Qëllimi i auditimit është që të rrisë shkallën e besimit të përdoruesve në pasqyrat financiare. Kjo arrihet me shprehjen opinionit nga ana e audituesit nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Në rastin e kornizave më qëllim të përgjithshëm, opinionin lidhet me atë nëse pasqyrat financiare janë prezantuar në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale ose japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë, në përputhje me kornizën. Një auditim i kryer në përputhje me ISA dhe kërkesat etike përkatëse i mundëson audituesit ta formuloj atë opinion. (Ref.: Para A1)

3. Pasqyrat financiare që i nënshtrohen auditimit janë pasqyra të entitetit, të përgatitura nga drejtuesit e entitetit nën mbikëqyrjen e personave të ngarkuar me drejtim. ISA nuk imponojnë përgjegjësi mbi drejtuesit ose të ngarkuarit me drejtim dhe anashkalojnë ligjet dhe rregulloret që

percaktojnë përgjegjësitë e tyre. Megjithatë, një auditim në përputhje me ISA kryhet në supozimin se drejtuesit ose të ngarkuarit me menaxhim kanë pranuar përgjegjësi të caktuara që janë thelbësore për kryerjen e auditimit. Auditimi i pasqyrave financiare nuk e çlirojnë drejtuesin apo të ngarkuarit me menaxhim nga përgjegjësitë e tyre. (Ref.: Para A2-A11)

4. Si bazë për opinionin e audituesit, ISA kërkojnë nga audituesi të marrë siguri të arsyeshme në lidhje me atë nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Siguria e arsyeshme është një nivel ilartë i sigurisë. Ajo merret atëherë kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit për ta reduktuar rrezikun e auditimit (që është, rreziku që audituesi të shprehë një opinion të papërshtatshëm atëherë kur pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale) në një nivel të ulët të pranueshëm. Megjithatë, siguria e arsyeshme nuk është një nivel absolut i sigurisë sepse ka kufizime të vetvetishme të auditimit, të cilat rezultojnë në atë që në shumicën e dëshmive të auditimit mbi të cilat audituesi nxjerr konkluzione dhe bazon opinionin e auditimit të jenë bindëse sesa përfundimtare. (Ref.: Para A28- A52)
5. Koncepti i materialitetit aplikohet nga audituesi si gjatë planifikimit ashtu edhe gjatë kryerjes së auditimit dhe për vlerësimin e efektit të anomalive të identifikuara në auditim si dhe anomalive të pakorrigjuara, nëse ka të tilla, në pasqyrat financiare⁵¹⁾. Në përgjithësi, deklaratimet jo të sakta përfshirë lëshimet, konsiderohen të jenë materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye mund të pritet që ato të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra duke u bazuar në këto pasqyra financiare. Gjykimet në lidhje me materialitetin bëhen në bazë të kushteve rrethore dhe janë të ndikuara nga perceptimin e audituesit, të nevojave për informacion financiar të përdoruesve të pasqyrave financiare si dhe nga madhësia apo natyra e një entiteti, ose një kombinim të dyjave. Opinioni

51) ISA 320 Materialiteti në planifikimin dhe Kryerjen e Auditimit' dhe ISA 450 Vlerësimi I anomalive të vlerësuara gjatë auditimit

i audituesit trajton pasqyrat financiare si tërësi dhe për këtë arsye audituesi nuk është përgjegjës për zbulimin e anomalive të cilat nuk janë materiale për pasqyrat financiare si tërësi.

6. ISA-të përmbajnë objektivat, kërkesat dhe aplikimin si dhe materiale të tjera shpjeguese që janë formuluar ta mbështesin audituesin në marrjen e siguri së arsyeshme. ISA-të kërkojnë nga audituesi ta ushtrojë gjykimin profesional dhe të mbajë skepticizmin profesional përgjatë gjithë planifikimit dhe kryerjes së auditimit:
 - Të identifikojë dhe vlerësojë risqet e gabimeve materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, bazuar në të njohurit mbi entitetin dhe mjedisit ku vepron, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të entitetit.
 - Të marrë dëshmi të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit në lidhje me atë nëse anomali të materiale ekzistojnë, nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të përgjigjeve të duhura për risqet e vlerësuara.
 - Të formuloj një opinion mbi pasqyrat financiare duke u bazuar në konkluzionet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit.
7. Forma e opinionit të shprehur nga audituesi do të varet nga korniza e zbatueshme për raportim financiar dhe cilindo ligj ose rregullore të aplikueshme. (Ref.: Para A12-A13)
8. Audituesi gjithashtu mund të ketë disa përgjegjësi të tjera të komunikimit dhe raportimit karshi përdoruesve, drejtuesve, personave të ngarkuar me menaxhim ose palëve jashtë entitetit në lidhje me çështjet që rezultojnë nga auditimi. Të njëjtat mund të përcaktohen nga ISA-të apo nga ligjet ose rregulloret e zbatueshme⁵²).

52) Shiko p.sh. ISA 260 Komunikimi me personat e ngarkuar me qeverisje' paragrafi 43 të ISA 240, Përgjegjësitë e audituesit lidhur me mashtrimin në një auditim të pasqyrave financiare'

Data e hyrjes në fuqi

9. Ky ISA për auditimin e pasqyrave financiare ka hyrë në fuqi për periudhat që fillojnë më 15 dhjetor 2009 ose më pas.

Objektivat e përgjithshme të audituesit

10. Objektivat e përgjithshme të audituesit gjatë kryerjes së auditimit të pasqyrave financiare janë:

a) Të marrë siguri të arsyeshme në lidhje me atë që pasqyrat financiare në tërësi janë të lira nga gabimet materiale, kjo për shkak të mashtrimit apo gabimit, duke mundësuar që audituesi të shpreh një opinion nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materialet, në pajtim me kornizën e zbatueshme për raportim financiar; dhe

b) Të raportojë për pasqyrat financiare dhe të komunikojë siç kërkohet nga ISA-të, në përputhje me gjetjet e audituesit.

11. Në të gjitha rastet kur nuk mund të merret siguri e arsyeshme dhe opinionin i kualifikuar në raportin e audituesit është i pamjaftueshëm, në rrethanat për qëllime të raportimit ndaj përdoruesve të synuar të pasqyrave financiare, ISA-të kërkojnë që audituesi të përmbahet në dhënien e opinionit apo të tërhiqet (ose japë dorëheqje)⁵³⁾ nga angazhimi, atëherë kur tërheqja është e mundur bazuar në ligj dhe rregulloret në fuqi

53) Tek ISA-të përdoret vetëm termi tërhiqet’.

Përkufizimet

12. Për qëllime të ISA, termat e mëposhtëm kanë kuptimet e dhëna më poshtë:

- a) Korniza e aplikueshme për raportim financiar – Korniza për raportim financiar e miratuar nga drejtuesit dhe kur është e përshtatshme, personat e ngarkuar me menaxhim, për përgatitjen e pasqyrave financiare që është e pranueshme për natyrën e entitetit dhe objektivitetin të pasqyrave financiare, apo që kërkohet me ligj ose rregullore. Termi – Korniza për paraqitje të drejtë është përdorur për t’iu referuar një kornize për raportim financiar që kërkon pajtueshmëri me kërkesat e kornizës dhe:
 - i. Pranon në mënyrë të qartë dhe të padyshimtë se, për të arritur paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, do të mund të jetë e nevojshme që drejtuesi të paraqesë mendime përtej atyre të kërkuara në mënyrë specifike nga korniza; ose
 - ii. Pranon në mënyrë eksplicite se do të mund të jetë e nevojshme që drejtuesit të shmangjet nga një kërkesë e kornizës për të arritur paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Shmangiet e tilla priten të jenë të nevojshme vetëm në rrethana jashtëzakonisht të rralla.

Termi – Korniza e pajtueshmërisë është përdorur për t’iu referuar një kornize për raportim financiar që kërkon pajtueshmëri me kërkesat e kornizës, por nuk përmban pranimet e përmendura në (i) ose (ii) më sipër.

- b) *Dëshmitë e auditimit*– Informacione që përdoren nga audituesi për të arritur në konkluzionet mbi të cilat bazohet opinioni i audituesit. Dëshmitë e auditimit përfshijnë informatat që gjenden në regjistrat kontabël në kuadër të pasqyrave financiare dhe informacione të tjera. Për qëllime të ISA:
 - i. Mjaftueshmëria e dëshmimeve të auditimit është masa e sasisë së dëshmimeve të auditimit. Sasia e nevojshme e dëshmimeve të auditimit varet nga vlerësimi

irisqeve të anomalive materiale nga ana e audituesit dhe gjithashtu nga cilësia e dëshmive të tilla të auditimit.

- ii. Përshtatshmëria e dëshmive të auditimit është masë e cilësisë së dëshmive të auditimit; apo rëndësia dhe besueshmërinë e saj në ofrimin e mbështetjes për konkluzionet në të cilat bazohet opinionin e audituesit.
- c) Risku i auditimit – Risku që audituesitë shpreh një opinion të papërshtatshme të auditimit, kur pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale. Risku i auditimit është një funksion i risqeve të anomalive materiale dhe riskut për zbulim.
- d) *Auditues* - Audituesi është përdorur për t'iu referuar personit ose personave që kryejnë auditimin, zakonisht partneri i angazhuar apo anëtarë të tjerë të ekipit të angazhimit, ose, sipas rastit, firma. Kur një ISA shprehimisht synon që një kërkesë apo përgjegjësi të përmbushen nga partneri i angazhimit, në vend të termit – partner i angazhimit përdoret termi – auditues. – Partneri i angazhimit dhe – firma duhet të lexohen duke iu referuar ekuivalentëve të tyre të sektorit publikë, aty ku është relevante.
- e) *Risku i zbulimit* - Risku që procedurat e zbatuara nga audituesi për të reduktuar riskun e auditimit në një nivel të ulët të pranueshëm nuk do ta zbulojnë një anomali që ekziston dhe që mund të jetë materiale, qoftë individualisht ose kur është së bashku me gabime të tjera.
- f) *Pasqyrat financiare* - Një përfaqësim i strukturuar i informatave historike financiare, duke përfshirë edhe shënimet përkatëse, e synuar të komunikoj burimet ekonomike të një entiteti ose detyrimet në një moment të caktuar kohor ose ndryshimet në to për një periudhë kohe në përputhje me një kornizë për raportim financiar. Shënimet e bashkëlidhura zakonisht përbëjnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe shënime të tjera sqaruese. Termi – pasqyra financiare zakonisht i referohet një vargu të plotë të pasqyrave financiare siç përcaktohet me kërkesat e kornizës së aplikueshme për raportim financiar, por gjithashtu mund t'i referohet një pasqyre të vetme financiare.

- g) *Informacionet historike financiare*– Informacione shprehur në terma financiare në lidhje me një entitet të veçantë, që burojnë kryesisht nga sistemi kontabël i atij entiteti, për ngjarjet ekonomike që kanë ndodhur në periudha të shkuara kohore ose për kushtet ekonomike apo rrethanat në periudha kohore në të shkuarën.
- h) Menaxheri – Personi (at) me përgjegjësinë ekzekutive për zhvillimin e operacioneve të entitetit. Për disa entitete në disa juridiksione, drejtuesit përfshin disa ose të gjithë ata të ngarkuar me drejtim, për shembull, anëtarët ekzekutivë të një bord drejtues ose një pronar-menaxher.
- i) Anomali – Një diferencë ndërmjet shumës, klasifikimit, prezantimit apo shpalosjes së një zëri të një pasqyre financiare të raportuar si dhe shuma, klasifikimi, prezantimi apo paraqitja që është i nevojshëm që zëri të jetë në përputhje me kornizën e aplikueshme për raportim financiar. Anomali të mund të burojnë nga gabimi apo mashtrimi. Kur audituesi shpreh opinionin nëse pasqyrat financiare janë prezantuar në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale ose nëse japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, deklarimet jo të sakta përfshijnë edhe rregullimet e shumave, klasifikimet, prezantimet apo paraqitjet që, sipas gjykimit të audituesve janë të domosdoshme që pasqyrat financiare të paraqiten në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale ose të japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë.
- j) Premisa lidhur me përgjegjësitë e drejtuesve ose personave të ngarkuar me drejtim, ndaj të cilëve kryhet auditimi – që drejtuesit ose personat e ngarkuar me drejtim (menaxhim) kanë pranuar dhe kuptuar se ata mbajnë përgjegjësitë e mëposhtme janë thelbësore për kryerjen e një auditimi në përputhje me ISA-të. Pra, përgjegjësi për:
- i. Përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kornizën e zbatueshme për raportim financiar, përfshirë aty ku është relevante, prezantimin të tyre të drejtë;
 - ii. Kontrollin e brendshëm në mënyrë që drejtuesi ose personat e ngarkuar me menaxhim të përcaktojnë se është i nevojshëm për të mundësuar

përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabimemateriale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; dhe

iii. T'i sigurojë audituesit:

- a. Vënien në dispozicion në të gjitha informacioneve për të cilat drejtuesi ose personat e ngarkuar me manaxhim janë të vetëdijshëm se janë të rëndësishme për përgatitjen e pasqyrave financiare siç janë të dhënat, dokumentacioni dhe të tjera;
- b. Informacione shtesë që audituesi mund t'i kërkojë drejtuesit ose personave të ngarkuar me menaxhim për qëllime të auditimit
- c. Takimin e pakufizuar me personabrenda entitetit nga të cilët audituesi mendon se është e nevojshme për të marrë dëshmi të auditimit.

Në rastin e një kornize për prezantim të drejtë, (i) kjo më sipër mund të riformulohet – për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me kornizën për raportim financiar, ose – për përgatitjen e pasqyrave financiare që japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në përputhje me kornizën për raportim financiar – Premisa, lidhur me përgjegjësitë e drejtuesit ose personave të ngarkuar me menaxhim, ndaj të cilëve kryhet auditimi mundet po ashtu të referohet si – premisë.

k. Gjykimi profesional - Aplikimi i njohurive, trajnimit dhe përvojës përkatëse, brendakontekstit të dhënë nga standardet e auditimit, kontabilitetit dhe etikës gjatë marrjes së vendimeve të informuara në lidhje me veprimet që janë të përshtatshme në rrethanat e angazhimittëauditimit.

(l) Skepticizmi profesional - Një qëndrim që përfshin një opinion pyetës, duke qenë vigjilent për kushtet të cilat mund të tregojnë anomali të mundshme për shkak të gabimitose mashtrimit dhe një vlerësim kritik të dëshmive të auditimit.

m. Sigurimi i arsyeshëm – Në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare, një nivel i lartë ose jo absolut i sigurisë .

- n. Risku i gabimeve materiale - Risku që pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale para auditimit. Kjo përbëhet prej dy komponentëve, të përshkruara si më poshtë në nivel pohimi:
- i. Riskui vetvetishëm – Ndërlikueshmëria e një pohimi në lidhje me një kategori të transaksionit, bilanci të llogarisë apo shfaqjen e një anomalie materiale e cila mund të jetë e vetme ose në grup me anomali të tjera, para marrjes në konsideratë të ndonjë kontrollit të ndërlidhur.
- ii. Riskui kontrollit – Risku që një anomali që mund të ndodh në një pohim në lidhje me një kategori të transaksionit, bilanc të llogarisë apo shfaqja e një anomalie e cila mund të jetë e vetme ose në grup me anomali të tjera, nuk do të parandalohen, zbulohen ose korrigjohen, në kohën e duhur nga ana e kontrollit të brendshëm të entitetit.
- o) Të ngarkuarit me drejtimin - Personi(at) ose organizata (t) (p. sh. njëadministrues i besuar korporatash) me përgjegjësi për mbikëqyrjen e drejtimin strategjik të entitetit dhe detyrimeve në lidhje me llogaridhë-nien e entitetit. Kjo përfshin mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar. Për disa entitete në disa juridiksione, të ngarkuarit me drejtim mund të përfshijnë personelin menaxhues, p. sh. anëtarët ekzekutivë të një bordi drejtues të një entiteti të sektorit publik apo privat, ose një pronar - menaxher.

Kërkesat

Kërkesat etike lidhur me auditimin e Pasqyrave financiare

13. Audituesi duhet t'u bindet kërkesave etike përkatëse, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me pavarësinë, në lidhje me angazhimin e auditimit të pasqyrave financiare. (Ref.: Para A14- A17)

Skepticizmi profesional

14. Audituesi duhet të planifikojë dhe të kryejë auditimin me skepticizëm profesional duke pranuar se mund të ekzistojnë rrethana që shkaktojnë anomalimateriale në pasqyrat financiare. (Ref.: Para A18- A22)

Gjykimi profesional

15. Audituesi do të ushtrojë gjykimin profesional gjatë planifikimit dhe kryerjes së një auditimi të pasqyrave financiare. (Ref.: Para A23- A27)

Dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse të auditimit dhe rreziku i auditimit

16. Për të marrë siguri të arsyeshme, audituesi duhet të marrë dëshmi të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit për të reduktuar rrezikun e auditimit në një nivel të ulët të pranueshëm dhe t'i mundësojë në këtë mënyrë audituesit të nxjerrë konkluzione të arsyeshme mbi të cilat do ta bazojë opinionin e audituesit. (Ref.: Para A28- A52)

Kryerja e një kontrolli në përputhje me ISA

Bindja ndaj ISA relevante për auditim

17. Audituesi duhet t'iu bindet të gjitha ISA relevante për auditimin. Një ISA është relevante për auditimin kur ISA është në fuqi dhe rrethanat të cilat adreson ISA ekzistojnë. (Ref.: Para A53- A57).
18. Audituesi duhet ta kuptojë gjithë tekstin e një ISA, duke përfshirë zbatimin e tij dhe materiale të tjera shpjeguese, për të kuptuar objektivat e saj dhe për të zbatuar kërkesat e saj siç duhet. (Ref.: Para A58- A66).
19. Audituesi nuk do të përfaqësojë pajtueshmëri me ISA-të në raportin e audituesit përveç nëse audituesi i është bindur kërkesave të këtij ISA dhe të gjitha ISA të tjerë relevant për auditimin.

Objektivat e deklaruara në ISA individuale

20. Për të arritur objektivat e përgjithshme të auditimit, audituesi do të përdorë objektivat e përcaktuara në ISA përkatëse gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit, duke pasur parasysh marrëdhëniet në mes të ISA-ve, (Ref.: Para A67- A69)
- a) Për të përcaktuar nëse ndonjë procedurë e auditimit, përveç atyre që kërkohen nga ISA, janë të nevojshme në zbatim të objektivave të përcaktuara në ISA; dhe (Ref: Para A70).

- b) Për të vlerësuar nëse janë marrë dëshmi të mjaftueshme të auditimit. (Ref.: Para A71)

Pajtueshmëria me kërkesat përkatëse

21. Subjekt i paragrafit 23, audituesi duhet të përmbush çdo kërkesë të një ISA përveç nëse, në rrethanat e auditimit:

- a) E gjithë ISA nuk është relevant; ose
- b) Kërkesa nuk është relevante sepse ajo është e kushtëzuar dhe nuk ekziston kushti. (Ref.: Para A72-A73)

22. Në rrethana të jashtëzakonshme, audituesi mund ta gjykojë të nevojshme të shmanget nga një kërkesë përkatëse në një ISA. Në rrethana të tilla, audituesi do të kryejë procedura alternative të auditimit për të arritur qëllimin e kësaj kërkesë. Nevoja që audituesi të shmanget nga një kërkesë përkatëse pritet të lindë vetëm atëherë kur ekziston kërkesa për kryerjen e një procedure të veçantë dhe në rrethana të veçanta të auditimit, që procedura do të jetë e pa efekt për arritjen e qëllimit të kërkesës. (Ref.: Para A74)

Dështimi për të arritur një objektiv

23. Nëse një objektiv në një ISA përkatës nuk mund të arrihet, audituesi duhet të vlerësojë nëse kjo e pengon audituesin në arritjen e objektivave të përgjithshme të auditimit dhe në këtë mënyrë kërkon nga audituesi, në përputhje me ISA-të, ta modifikojë opinionin e audituesit ose të tërhiqet nga auditimi (atëherë kur është e mundur tërheqja sipas ligjit ose rregullores në fuqi). Dështimi për të arritur një objektiv të rëndësishëm paraqet një çështje të rëndësishme që kërkon dokumentacionin në përputhje me ISA 230⁵⁴⁾

(Ref.: Para A75- A76).

54) ISA 230 Dokumentimi i Auditimit* Paragrafi 8I.

Shtojca 4 – Rekomandimet për përkthim

1. Rekomandimet janë të bazuara në përvojat e FAS dhe IFAC dhe ofrojnë këshilla për përkthimin e Shënimeve praktike. Përkthimi e ISA bëhet me leje me shkrim nga IFAC në përputhje me Politikën për Përkthimin dhe Riprodhimin Standardeve të hartuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve⁵⁵⁾ e lëshuar në dhjetor 2008.
2. Një Institucion Suprem i Auditimit nuk duhet t'i referohet Udhëzimeve të INTOSAI-T për auditim financiar në raportet e tija të auditimit, përveç nëse rastet kur ka siguruar ekzistencën e një përkthimi cilësor të të gjithë udhëzimeve në gjuhën/gjuhët e tyre të punës.
3. Për të siguruar një përkthim të cilësisë më të lartë, rekomandohet që organizata që përkthen Udhëzuesit e INTOSAI-T për auditim financiar:
 - Të formulojë dhe zbatoj një proces përkthimi që do të mundësojë një përkthim besnik, pa asnjë ndryshim ose shtim (përveç footnote të përkthimit) në publikim. Një përkthim besnik respekton qëllimin, tonin dhe organizimin e publikimit.
 - Të përdorë listën e termave kyç të IFAC për aq sa të jetë e mundur për të përkthyer termat kyç (fjalorthi), dhe mban listën e përkthyer të termave kyç. Gjatë përkthimit të termave kyç është e rëndësishme që organizata që bënë përkthimin të tentoj të kuptoj qëllimin e hartuesve burimor të publikimit në mënyrë që të evitohen keqkuptimet për shkak të përkthimit të përshtatshëm të tekstit anglisht
 - Të sigurojë që termat kyçe janë përdorur si duhet gjatë përkthimit të publikimit dhe aty ku është e zbatueshme, gjatë përkthimit të publikimeve të reja dhe atyre të rishikuara. Shënimet në fund të faqes e

55) <http://www.ifac.org/Downloads/TranslationOfStandards.pdf>

përkthimit mund të përdoren për t'iu referuar përdorimeve më të përhapura në një vend, kur termi kyç i ruajtur dallon nga ai i përdorur.

Përveç kësaj,

- Duhet përkthyer teksti i plotë i të gjitha udhëzimeve për auditim financiar.
- Është e rekomanduar që për qëllime të përkthimit të përdoren udhëzimet në versionin në gjuhën angleze, e cila është gjuha në të cilën ato janë hartuar.

Aty ku është e mundur, organi që bën përkthimin (zakonisht Institucioni Suprem i Auditimit) këshillohet :

- Të angazhojë shërbimet e një përkthyesi profesionist⁵⁶⁾ i cili do të veprojë si përkthyes kryesor. Përkthyesi kryesor, në konsultim me organin që bën përkthimin, duhet të hartoj dhe zbatojë një proces përkthim i cili do të mundësojë një përkthim besnik siç shpjegohet më sipër.
- Të identifikojë një përkthim të ISA-ve që do të miratohen si pjesë e Udhëzimeve të INTOSAI-T për auditim financiar në gjuhën e përzgjedhur dhe të marrë në konsideratë shfrytëzimin e ISA të përkthyer si dhe listën e tij të termave kyç. Për shkak se ISA-të e përkthyerat i nënshtrohen kufizimeve të drejtave autoriale, kjo normalisht do të përfshijë mbajtjen e lidhje me IFAC për të marrë leje për qasje dhe përdorim të përkthimit.
- Të ngrejë një grupi për shqyrtimin e përkthimit të përbërë nga njohës të gjuhës përkatëse të cilët kanë njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze dhe përvojë në përdorimin e standardeve dhe udhëzimeve specifike të publikuara nga INTOSAI-T dhe/ose IFAC. Grupi për shqyrtimin e përkthimit analizon përkthimin e përkthyesit kryesor, të termave kyç dhe merr përgjegjësinë për cilësinë e tij.

56) Gjatë angazhimit të përkthyesit profesionist, rekomandohet që të merret parasysh kompetenca profesionale e përkthyesit në kontekstin e detyrës specifike p.sh. kualifikimet profesionale të përkthyesit, njohuritë profesionale, aftësitë e përkthimit, shkathtësitë e përkthimit në kombinimin e gjuhës specifike dhe aftësinë për të përkthyer thëniet në fushën e auditimit.

- Të mbaj lidhje me të tjerë që mund të ketë interes në përkthimin apo kanë përkthyer Udhëzuesit e INTOSAI-T për auditim financiar apo ISA-të në gjuhën e njëjtë për të arritur marrëveshje mbi përkthimin e listës së termave kyç dhe së fundi në fund të fundit, të punohet në drejtim të një përkthimi të Udhëzimeve të INTOSAI-T për auditim financiar në atë gjuhë⁵⁷⁾.
 - Të siguroj që proceset janë duke u zhvilluar dhe të kujdesur që përkthimi është duke shkuar përpara.
4. Në rast të ndonjë mosmarrëveshje sa i përket kuptimit të një fjale apo fraze të përkthyer të udhëzimeve, versioni anglisht i udhëzimeve do të mbizotërojë.

57) Pjesët thelbësore të rekomandimeve për përkthim janë kopjuar drejtpërsëdrejti nga Politika për Përkthimin dhe Riprodhimin Standardeve të Lëshuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve e lëshuar në dhjetor 2008

Shtojca 5 – Lista e shkurtimeve

FAS	Nën-komiteti i INTOSAI-T për Udhëzuesit e Auditimit Financiar
IAASB	Bordi për Standarde Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INCOSAI	Kongresi i INTOSAI-t
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISA-S	Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Sigurisë
SNKC (ISA)R	Standardi Ndërkombëtar i Kontrollit të Cilësisë Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Rishikimit
SNSHN	Standardet Ndërkombëtare për Shërbimet e ndërlidhura
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
SHP	Shënim praktik
KSP	Komiteti për standarde profesionale i INTOSAI-t

ISSAI 1003

Udhëzues i Auditimit Financiar

*FJALOR I TERMAVE TË
UDHËZUESVE TË INTOSAI-T PËR
AUDITIMIN FINANCIAR*

Përmbajtja e ISSAI 1003

Fjalor i termave të Udhëzuesve të INTOSAI-t për auditimin financiar

Hyrje.....1-6

Fjalor i termave të Udhëzuesve të INTOSAI-t për auditimin financiar

Fjalor i termave të Udhëzuesve të INTOSAI-t për auditimin financiar

Hyrje

1. Udhëzuesit e INTOSAI-t për auditimin financiar shërbejnë si udhëzues për auditimin financiar të sektorit publik.
2. Udhëzuesit e INTOSAI-t për auditimin financiar përfaqësojnë nivelin e katërt (Udhëzime Të Auditimit) të kornizës së Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI), ku parimet themelore përbëjnë nivelin një, Kodet për Institucionet Supreme të Auditimit nivelin dy dhe Parimet themelore të auditimit nivelin e tretë të (duke përfshirë Standardet e Auditimit të INTOSAI-t).
3. Udhëzuesit e INTOSAI-t për auditimin financiar mbështeten, për aq sa është e mundur, mbi Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të nxjerra nga Bordi për Standarde Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë (IAASB). INTOSAI-t kontribuon në zhvillimin e këtyre standardeve duke marrë pjesë në Task Forcat e IAASB të cilat janë përgjegjëse për zhvillimin e standardeve të reja apo rishikimin e standardeve ekzistuese.
4. Si pjesë e bashkëpunimit ndërmjet INTOSAI-t dhe IAASB, termi – sektori neutral është përfshirë në ISA ku ka qenë e mundur, në mënyrë që ato lehtësisht të kuptohen dhe zbatohen si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Kjo është bërë duke përfshirë tekstin e duhur në vet standardet ose në fjalorthin përkatës. Përkufizimet shtesë, të paraqitura në Shënimet praktike gjithashtu mund të gjenden në fjalorthin e mëposhtëm.

5. Shënimet praktike (SHP), të cilat janë të përfshira në Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin Financiar, shpjegojnë se si të aplikohet secila ISA gjatë auditimit financiar në sektorin publik. Ato po ashtu përmbajnë udhëzime të rëndësishme për auditimet financiare në sektorin publik, përveç atyre të dhëna në ISA korresponduese. Shënimet praktike së bashku me ISA përkatëse përbëjnë një udhëzues brenda strukturës të standardeve ISSAI.

6. Duke zbatuar Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditim Financiar gjatë auditimeve financiare në sektorin publik, Institucionet Supreme të Auditimit pranojnë se ISA dhe ShP së bashku formojnë udhëzime. Nëse referenca në raportin e audituesit thekson se auditimi është kryer në pajtim me ISA, audituesit e sektorit publik iu binden të gjitha ISA-ve relevante për auditimin.

Fjalor i termave të Udhëzuesve të INTOSAI-t për auditimin financiar⁵⁸⁾

Abuzimi - Sjellja është e mangët ose e pahijshme në krahasim me sjelljen që një person i matur do ta konsideronte një praktikë të arsyeshme dhe të nevojshme të biznesit duke marrë parasysh faktet dhe rrethanat. Abuzimi gjithashtu përfshin keqpërdorimin e autoritetit ose pozitës për përfitime financiare personale ose të një anëtari të afërt apo të menjëhershëm të familjes apo të një bashkëpunëtori afarist. Abuzimi jo domosdoshmërisht përfshinë mashtrimin, shkeljen e ligjeve, rregulloreve, të dispozitave të një kontrate ose marrëveshje për grant. Abuzimi është largimi nga koncepti i drejtësisë, i cili ndërlidhet me parimet e përgjithshme të menaxhimit të shëndoshë financiar të sektorit publik si dhe sjelljen e zyrtarëve të sektorit publik.

Llogaridhënia - Parimi se individët, organizatat dhe komunitetit janë përgjegjës për përdorimin e fondeve të tyre publike dhe se nga ta mund të kërkohet të shpjegojnë përdorimin e fondeve publike.

Agjenci - Një lloj organizate qeveritare apo parlamentare.

Ndarja e fondeve - Autorizimi që jep një organ legjislativ për shpërndarjen e fondeve për qëllime të specifikuar nga legjislativi apo autoritetet e ngjashme.

Mandati i auditimit - Autoriteti, përgjegjësitë, liria e veprimit dhe detyrat e auditimit të dhëna një Institucioni Suprem të Auditimit sipas kushtetutës apo ndonjë autoriteti tjetër të ligjshëm të një shteti.

Objektivi i auditimit - Në auditimin financiar të një entiteti të sektorit privat, objektivi i auditimit është i kufizuar në shprehjen e një opinionit të bazuar mbi një sërë pohimesh. Objektivat e një auditimi financiar në sektorin publik, shpesh janë më të gjera se sa shprehja e një opinionit nëse pasqyrat financiare janë

⁵⁸⁾ Fjalori i termave të FNK-së përdoret për auditimet e kryera në pajtim me ISA-të. Ky fjalor i termave ofron përkufizime shtesë të zbatueshme në sektorin publik.

përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme për raportim financiar (d.m.th. fushëveprimi i ISA). Mandati i auditimit apo obligimet e entiteteve të sektorit publik, që burojnë nga legjislacioni, rregulloret, udhëzimet ministrore, kërkesat e politikave qeveritare ose vendimet e legjislativit mund të rezultojë me objektiva shtesë.

Këto përgjegjësi mund të përfshijnë, p.sh kryerjen e procedurave dhe raportimin e rasteve të mos pajtueshmërisë tek autoritetet si dhe efektshmërinë e kontroleve të brendshme. Megjithatë edhe kur nuk ka objektiva të tilla shtesë, pritjet e përgjithshme të publikut mund të jenë prezent në këtë drejtim.

Organizatë e auditimit - Një entitet i kontabilistëve profesionistë dhe profesionistëve të specializuar në auditim. Në sektorin privat, organizatat mund të jetë të përbëra nga një person i vetëm, ortakëri ose korporatë; në sektorin publik Organizata mund të jetë një Institucion Suprem i Auditimit.

Entiteti i audituar- Një organizatë, program, aktivitet apo funksion i cili është subjekt i auditimit.

Audituesi i Përgjithshëm- kreu i një Institucioni Suprem të Auditimit të strukturuar sipas modelit të Audituesit të Përgjithshëm.

Modeli i Audituesit të Përgjithshëm - (Shih Audituesi i Përgjithshëm)

Autoritetet-Aktet apo rezolutat relevante të legjislativit apo instrumentet e tjera ligjore, instruksionet dhe udhëzimet e nxjerra nga organet e sektorit publik me kompetenca të parapara me statut, të cilave entiteti i audituar pritet t'iu përmbahet. (Shih gjithashtu ISSAI 4200⁵⁹).

Modeli i Bordit apo Kolegjit - Sipas sistemit të Bordit apo Kolegjit, Institucioni Suprem i Auditimit përbëhet nga një numër anëtarësh të cilët formojnë kolegjin ose bordin qeverisës të tij dhe bashkërisht marrin vendimet. Organet kolegjiale të auditimit zakonisht janë pjesë e një sistemi parlamentar të llogaridhënies. Raportet dhe opinionet e dakorduara nga kolegji i

59) ISSAI 4200 "Udhëzuesit e INTOSAI-t për Auditimin e Pajtueshmërisë" - Auditimi i Pajtueshmërisë në lidhje me Auditimin e Pasqyrave Financiare

dorëzohen Parlamentit, në të cilin zakonisht ekziston një formë e Komitetit Publik të Llogarive i cili vepron në bazë të tyre. Organet kolegjiale mund të kenë gjithashtu funksione gjyqësore.

Mandat më i gjerë - (shih objektivin e auditimit)

Risku i biznesit - I referohet rriskut që aktivitetet - duke përfshirë programet përkatëse, strategjitë dhe objektivat e programeve- të mos përmbushen apo realizohen. Përveç kësaj, risqet që lidhen me çështje të tilla si klima politike, interesi publik dhe ndjeshmëria e programit apo mospajtueshmëria eventuale me legjislacionin ose autoritetin e duhur janë relevante në kontekstin e sektorit publik. (Shih gjithashtu Fjalorin e termave të IFAC).

Auditimi i pajtueshmërisë - Auditimi i pajtueshmërisë trajton shkallën deri në të cilën entiteti i audituar ndjek rregullat, ligjet dhe rregulloret, politikat, kodet e përcaktuara ose të dakorduara mbi terma dhe kushte, etj. Auditimi i pajtueshmërisë mund të mbulojnë një gamë të gjerë çështjesh. Në përgjithësi, qëllimi i auditimit së pajtueshmërisë është t'u ofrojë përdoruesve të synuar siguri në lidhje me rezultatin e vlerësimit apo peshimin e një çështje kundrejt kritereve të përshtatshme.

Për kryerjen e auditimeve të pajtueshmërisë ekzistojnë dy koncepte të rëndësishme në kontekstin e Parimeve themelore të INTOSAI-T për auditim:

- a) Rregullsia- koncepti që aktivitetet, transaksionet dhe informacionet të cilat janë të pasqyruara në pasqyrat financiare të një entiteti të audituar janë në pajtim me legjislacionin autorizues, rregulloret e nxjerra në bazë të legjislacionit qeverisës si dhe të tjera, ligje, rregullore dhe marrëveshje relevante, përfshirë ligjet buxhetore dhe të jenë sanksionuar siç duhet;
- b) Përshtatshmëria- parimet e përgjithshme të menaxhimit të shëndoshë financiar të sektorit publik dhe sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik.

Në varësi të mandatit të Institucionit Suprem të Auditimit, auditimi i pajtueshmërisë mund të jetë një auditim i rregullsisë ose përshtatshmërisë, ose të dyja.

Duke qenë se përshtatshmëria nuk është diçka e prekshme për verifikim objektiv,

mund të jetë e vështirë e në disa raste e pamundur që përshtatshmëria të auditohet deri në një nivel të sigurimit të arsyeshëm. Shpesh nuk ka pika referimi të qarta dhe objektive kundrejt të cilave do të matej përshtatshmëria - ajo që mund të jetë e pranueshme për një pjesë të sektorit publik por mund të mos jetë e pranueshme gjatë.

Udhëzuesit për auditimit të pajtueshmërisë- Udhëzuesit e INTOSAI-t për auditimin epajtueshmërisë përbëhen nga:

- a) ISSAI4000 – Një hyrje e përgjithshme në Udhëzuesit mbi auditimin e pajtueshmërisë;
- b) ISSAI 4100 – Udhëzime për auditimin e pajtueshmërisë për auditimet e kryera të ndaranga auditimi i pasqyrave financiare;
- c) ISSAI 4200 – Udhëzime për auditimin e pajtueshmërisë në lidhje me auditimin epasqyrave financiare.

Kontrollori i Përgjithshëm - Roli i Audituesit të Përgjithshëm mund të kombinohet me atë të kontrollorit. Funkzioni i kontrollorit ka të bëjë më shumë me kontroll sesa auditim dhe kryhet para se shpenzimet të ndodhin.

Gjykata e Llogarive - Në modelin e Gjykatës së Llogarive, Institucioni Suprem i Auditimit është një pjesë integrale e sistemit gjyqësor që vepron në mënyrë të pavarur nga degët ekzekutive dhe legjislative. Ndodh të ketë vetëm një marrëdhënie të kufizuar me Parlamentin e vendit. Institucioni Suprem i Auditimit është i njohur zakonisht si Gjykata e Llogarive (ose Gjykata e Auditimit) dhe në përgjithësi është një Gjykatë e veçantë që merret vetëm me çështjet financiare. Më rrallë, e njëjta mund të jetë pjesë e Gjykatës Supreme dhe atëherë zakonisht njihet si Dhoma e Llogarive.

Karakteristikat kryesore janë:

- Institucioni Suprem i Auditimit është një gjykatë dhe anëtarët janë gjyqtarët që mund të imponojnë masa ndëshkuese ndaj zyrtarëve të audituar;
- Staf i profesionist në Institucionin Suprem të Auditimit është i prirë të

posedoj prapavijë ligjore në vend të kontabilitetit ose auditimit; dhe

- Përcjellja e kufizuar e raporteve të Gjykatës nga ana e Parlamentit. Brenda modelit të gjerë gjyqësor të përshkruar mund të ketë variacione nga një shtet në tjetrin.

Partneri i angazhuar -Partneri apo personi tjetër në organizatën e auditimit i cili është përgjegjës për angazhimin dhe punën e saj, si dhe për raportin që nxirret në emër të organizatës së auditimit dhe kur kërkohet, ka autoritetin e nevojshëm nga një organ profesionist, ligjor apo rregullator. Në shumë juridiksione, është vetëm një Auditues i Përgjithshëm i emëruar i cili vepron në një rol të barazvlefshëm me atë të – partnerit të angazhimit dhe mban përgjegjësinë e përgjithshme për auditimin e sektorit publik. Megjithatë, në qoftë se Audituesi i Përgjithshëm emëron një punonjës ose person tjetër të kualifikuar për të kryer një auditim në emër të tij/saj, atëherë audituesi i emëruar është ai i cili në mënyrë efektive përmbush obligimet e partnerit të angazhimit. Për institucionet supreme të auditimit që veprojnë në një mjedis gjyqësor llogarish, termat duhet të interpretohen në kontekst të organizimeve të vet institucioneve supreme të auditimit për udhëheqjen strategjike të organit qeverisës, si dhe definicioneve të përgjegjësive të anëtarëve kyç të ekipit angazhimit. (Shih gjithashtu Fjalorin e termave të IFAC).

Auditimi Financiar- Një vlerësim i pavarur që rezulton në një opinion të arsyeshëm, nëse gjendja e raportuar financiare e një entiteti, rezultatet dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur në mënyrë të drejtë, në përputhje me kornizën e raportimit financiar. (Shih auditimin e rregullsisë)

Firma - (Shih organizatat e auditimit)

Bordi Drejtues i INTOSAI-T- Përbëhet nga 18 anëtarë dhe si rregull, mbledhet në baza vjetore ndërmjet kongreseve. Për të siguruar përfaqësim të balancuar të të gjitha vendeve anëtare, secili prej shtatë grupeve rajonale të punës të INTOSAI-T si dhe llojet kryesore të sistemeve publike të auditimit është i përfaqësuar në Bord.

Ndërmarrjet tregëtare të qeverisë- Përfshihen ndërmarrjet tregëtare, siç janë shërbimet komunale dhe ndërmarrjet e tilla financiare si institucionet financiare. Ndërmarrjet ekonomike të qeverisë, në thelb, nuk ndryshojnë nga entitetet që kryejnë veprimtari të ngjashme në sektorin privat; ndërmarrjet atregëtare të qeverisë në përgjithësi veprojnë për të realizuar fitim edhe pse disa mund të kenë detyrime të kufizuara për ti ofruar shërbime komunitetit sipas të cilave ato janë të detyruara ti furnizojnë disa individë dhe organizata në komunitet me mallra dhe shërbime si pa pagesë ashtu edhe me një tarifë të reduktuar në mënyrë të konsiderueshme.

Ndërmarrjet tregëtare të qeverisë kanë të gjitha karakteristikat e mëposhtme:

- a) Është një entitet me fuqi të kontraktive në emër të tij;
- b) I është dhënë autoriteti financiar dhe operativ për të ushtruar një biznes;
- c) Në rrjedhën normale të biznesit të tij, entiteteve të tjera ju shet mallra dhe shërbime me fitim apo mbulesë të plotë të kostos;
- d) Nuk varet nga financimi i vazhdueshëm i qeverisë për ta siguruar vazhdueshmërinë (përveç blerjeve të outputeve në mënyrë autonome); dhe
- e) Kontrollohet nga një entitet i sektorit publik.

Entitetet qeveritare - një zyre qeveritare, njësi, agjenci, byro, departament, ministri ose një grup i konsoliduar i entiteteve të tilla.

Pavarësia - Siç është përcaktuar në Deklaratën e Limës⁶⁰⁾ si dhe Kodin e Etikës së INTOSAI-t⁶¹⁾. (Shih gjithashtu Fjalorin e termave të IFAC).

Shembull i mospajtueshmërisë me autoritetet- Dështimi për t'iu përmbajtur ligjit ose rregulloreve, përfshirë autoritetin buxhetor, gjatë një veprimi apo transaksioni.

60) ISSAI 1 Deklarata e Limës⁴ - Pjesa e 5

61) ISSAI 30 Kodi i Etikës⁴ Kapitulli 3

Kontrolli i brendshëm - Sistemi i kontrolleve financiare dhe të tjera, përfshirë edhe strukturën organizative, metodat, procedurat dhe auditimin e brendshëm, i themeluar nga drejtuesit në kuadër të qëllimeve tyre të përbashkëta, për të ndihmuar në kryerjen e biznesit të entitetit të audituar në një mënyrë të rregullt ekonomike, efikase dhe efektive; duke siguruar përkushtimin për politikat drejtuesit; duke ruajtur pasuritë dhe burimet; duke siguruar saktësinë dhe plotësinë e regjistrave kontabël dhe duke prodhuar informacione financiare dhe të menaxhimit me kohë dhe të besueshme. (Shih gjithashtu Fjalorin e termave të IFAC).

Juridiksioni - E drejta dhe fuqia për të interpretuar dhe zbatuar ligjin.

Legjislativi - Një organ i zgjedhur zyrtarisht apo në mënyrë tjetër i pajisur me përgjegjësi dhe fuqi për të bërë ligje për një njësi sovraane, të tillë si një shtet apo komb.

Legjislacioni- Një ligj ose pako ligjesh të propozuara nga qeveria dhe të miratuara ngaparlamenti.

Ligjvënësi- Një anëtar i organit legjislativ.

Ministria - Departamenti i qeverisë i kryesuar nga një ministër.

Partner - (Shih partneri i angazhimit).

Auditimi i performancës - Auditimi i ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit me të cilin entiteti i audituar përdor burimet e tij gjatë ushtrimit të përgjegjësive të tij, i njohur gjithashtu si auditimi i Vlerës për para.

Shënimi praktik - Të përfshira në Udhëzuesit e INTOSAI-t për auditimin financiar. Shënimi praktik shpjegon se si të aplikohen ISA gjatë auditimit financiar në sektorin publik. Ato gjithashtu përmbajnë udhëzime relevante për auditimin e entiteteve të sektorit publik, përveç sa parashihet në ISA.

Pajtueshmëria- (Shih Auditimin e pajtueshmërisë)

Audituesi i sektorit publik- Një person ose persona të emëruar në bazë të statutit ose marrëveshjes, një person apo persona që veprojnë si agjent i një

agjencie kombëtare të auditimit ose një gjykatë të llogarive të përbërë nga gjyqtarët.

Auditimi i rregullshmërisë - Sipas ISSAI 100⁶²⁾, auditimi i rregullsisë përfshinë:

- a) vërtetimin e përgjegjshmërisë financiare të entiteteve llogaridhënëse, që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e të dhënave financiare si dhe dhënien e opinioneve mbi pasqyrat financiare;
- b) vërtetimin e llogaridhënies financiare të administratës qeveritare si një tërësi;
- c) auditimin e sistemeve financiare dhe transaksioneve, përfshirë edhe vlerësimin e pajtueshmërisë me statutet dhe rregulloret në fuqi;
- d) auditimin e kontrollit të brendshëm dhe funksioneve të auditimit të brendshëm;
- e) auditimin e ndershmërisë dhe përshtatshmërisë së vendimeve administrative të marra në kuadër të entitetit të audituar;
- f) raportimin e çfarëdo çështje tjetër që rezulton apo lidhet me auditimin që Institucioni Suprem i Auditimit konsideron se duhet të shpalosen.

Termat – auditimi i rregullsisë dhe – auditimi financiar shpesh përdoren në mënyrë alternative. Referencat e tilla në auditim përfshijnë auditimin e pasqyrave financiare dhe disa ose të gjithë elementeve të përcaktuar nga pika a) deri f) më lart, të varura këto v nga mandati i Institucionit Suprem të Auditimit.

Kërkesat përkatëse etike - Siç është përcaktuar në Kodin e etikës së INTOSAI-t⁶³⁾. (Shih gjithashtu Fjalorin e termave të IFAC).

Ndërmarrjet shtetërore - (Shih ndërmarrjet tregtare të Qeverisë) - Të përcaktuara apo kontrollohet me ligj.

62) ISSAI 100 Parimet Themelore të Auditimit në Qeveri'

63) ISSAI 30_Kodi i Etikës'

Institucioni Suprem i Auditimit - Organ publik i një shteti i cili sido që të jetë i emëruar, i themeluar apo i organizuar, ushtron duke u mbështetur në ligj funksionin më të lartë publik të auditimit të atij shteti. Në disa Institucione Supreme të Auditimit ekziston vetëm një auditues i përgjithshëm i emëruar i cili vepron në një rol të barazvlefshëm me atë të – partnerit të angazhimit dhe ka përgjegjësinë e përgjithshme për auditimin e sektorit publik. Institucione e tjera supreme të auditimit mund të jenë të organizuara si gjykata të llogarive ose të kenë një sistem kolegjal apo të bordit.

Të ngarkuarit me menaxhim - Në sektorin publik, përgjegjësitë e menaxhimit mund të ekzistojnë në disa nivele organizative, si dhe në disa funksione (p.sh. vertikalisht apo horizontalisht). Si rezultat, mund të ketë raste kur disa grupe të ndryshme të identifikohen si ato ngarkuara me menaxhim. Për më shumë, auditimi i sektorit publik mund të përfshijë qoftë objektivat e pasqyrave financiare po ashtu edhe objektivat e pajtueshmërisë dhe në disa raste mund të përfshijnë organe të veçanta të qeverisjes. (Shih gjithashtu Fjalorin e termave të IFAC

ISSAI 1200

Udhëzues i Auditimit Financiar

*OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME
TË AUDITUESIT TË PAVARUR
DHE KRYERJA E NJË AUDITIMI
NË PAJTIM ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE TË AUDITIMIT*

Shënim Praktik⁶⁴ për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 200

PËRMBAJTJA

SHËNIMI PRAKTIK PËR ISA 200	Paragrafi
Historiku	
Hyrje në ISA	
Përmbajtja e Shënimit Praktik	P1
Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik	P2
Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik	P3
Fushëveprimi i ISA-së	P4-P9
Një auditim i Pasqyrave	P10-P14
Objektivat e përgjithshme të audituesit	P15
Përkufizimet	P16
Kërkesat etike në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare	P17-P18
Kryerja e një auditimi në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit	P19
Dëshmitë e mjaftueshme dhe të duhura të auditimit dhe risku i auditimit	P20

64) Të gjitha shënimet praktike konsiderohen së bashku me ISSAI 1000 — Hyrje e Përgjithshme në ONISA Udhëzime të Auditimit Financiar.

Objektivat e përgjithshme të audituesit të pavarur dhe kryerja e një auditimi në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

Historiku

Shënimi Praktik ofron udhëzim shtesë mbi ISA 200 - Objektivat shtesë të audituesit të pavarur dhe kryerja e një auditimi në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Ky shënim lexohet së bashku me ISA. ISA 200 që ka hyrë në fuqi për auditimin e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar më 15 dhjetor 2009 ose më pas. Shënimi Praktik ka hyrë në fuqi në po të njëjtën datë sikurse dhe ISA.

Hyrje në ISA

ISA200 trajton përgjegjësitë e përgjithshme të audituesit të pavarur kur ai kryen një auditim të pasqyrave financiare në pajtim me ISA-të. Në mënyrë të veçantë ai vendos objektivat e përgjithshme të audituesit të pavarur dhe shpjegon natyrën dhe fushëveprimin e një auditimi i hartuar në mënyrë të atillë që t'i japë mundësi audituesit të pavarur të përmbushë këto objektiva. Ai gjithashtu shpjegon fushëveprimin, autoritetin dhe strukturën e ISA-ve dhe përfshin kërkesat që përbëjnë përgjegjësitë e përgjithshme të audituesit të pavarur të zbatueshme për të gjitha auditimet, përfshirë detyrimin për të qenë në pajtim me ISA-të. Në vijim, termi auditues i pavarur është referuar me termin auditues'.

Përmbajtja e Shënimit Praktik

P1 Shënimi Praktik ofron udhëzim shtesë për autorët e sektorit publik mbi:

- a) Fushëveprimin e ISA
- b) Një auditim të Pasqyrave Financiare
- c) Objektivat e përgjithshme të audituesit

d) Përkufizimet

e) Kërkesat etike në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare

f) Kryerjen e një auditimi në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

g) Dëshmitë e mjaftueshme dhe të duhura të auditimit dhe risku i auditimit.

Zbatueshmëria e ISA-së në Auditimin në sektorin publik

P2 ISA 200 aplikohet nga audituesit e entiteteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të pasqyrave financiare.

Udhëzim shtesë mbi çështje të sektorit publik

P3. ISA 200 përmban zbatimin dhe materiale të tjera shpjeguese me konsiderata të veçantapër auditimet në sektorin publik, në paragrafët A11 dhe A57 të ISA-së.

Fushëveprimi i ISA-së

P4. ISA-të janë shkruar në kontekst të një auditimi të pasqyrave financiare. Në kontekst të INTOSAI, një auditim i pasqyrave financiare⁶⁵⁾ mund të jetë një pjesë e një auditimi më të gjerë të rregullsisë (financiar). Sipas ISSAI 100⁶⁶⁾, paragrafit 39, një auditim i rregullsisë (financiar) përfshin:

a) Verifikimin e llogaridhënies financiare nga entitetet llogaridhënëse duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e të dhënave financiare si dhe dhënien e opinioneve mbi pasqyrat financiare;

65) Opinioni i audituesit mbi pasqyrat financiare ka të bëjë me faktin nëse pasqyrat janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Një opinion i tillë është i përbashkët për të gjitha auditimet e pasqyrave financiare. Për këtë arsye, opinioni i auditorit nuk jep siguri, për shembull, për qëndrueshmërinë e ardhshme të entitetit dhe as për efikasitetin ose efektivitetin me të cilën drejtuesit kanë kryer punët e këtij entiteti. Megjithatë, në disa juridiksione, ligji apo rregulli i zbatueshëm mund të kërkojnë që auditorët të japin opinione për çështje të tjera të veçanta, të tilla si efektiviteti i kontrollit të brendshëm ose koherenca e një raporti të veçantë të drejtimit me pasqyrat financiare. Ndonëse ISA të përfshijnë kërkesat dhe udhëzimet në lidhje me çështje të tilla deri në atë masë që ato janë të rëndësishme për formimin e një opinioni mbi pasqyrat financiare, auditori kërkohet që të ndërmarrë punë të mëtejshme, nëse ai do të kishte përgjegjësi shtesë për të dhënë këto opinione

66) ISSAI 100 Standardet e Auditimit INTOSAI - Parimet themelore.

- b) Verifikimin e llogaridhënies financiare të administratës së qeverisë si një e tërë;
- c) Auditimin e sistemeve dhe transaksioneve financiare duke përfshirë një vlerësim të pajtueshmërisë me statutet dhe rregulloret e aplikueshme;
- d) Auditimin e kontrollit të brendshëm dhe funksioneve të auditimit;
- e) Auditimin e integritetit dhe përshtatshmërisë së vendimeve administrative të marra nga entiteti i audituar; dhe
- f) Raportimin e çdo çështje tjetër që del nga auditimi ose ka të bëjë me të, të cilën Institucioni Suprem i Auditimit konsideron se duhet të shpaloset.

P5. Termet auditim i “rregullshmërisë” dhe “auditim financiar” shpesh përdoren si zëvendësim i njëra-tjetrës. Auditime të tilla përfshijnë një auditim të pasqyrave financiare, plus disa ose të gjitha nga elementet e përmendura në pikat e mësipërme nga (a) deri në (f), në varesi të mandatit të Institucionit Suprem të Auditimit. Shënimet Praktike në Udhëzimet e Auditimit Financiar të INTOSAI-t (ISSAI 1000-2999) ofrojnë udhëzim shtesë për audituesit e sektorit publik kur zbatojnë ISA-të në një auditim të pasqyrave financiare. Gjatë kryerjes së një auditimi të “rregullshmërisë” ose “financiar” në sektorin publik, udhëzim më gjithëpërfshirës mund të gjendet në kornizën e ISSAI-s, e cila, p.sh përfshin Udhëzimet e Auditimit Financiar të INTOSAI-t (ISSAI 4000⁶⁷⁾ dhe 4200⁶⁸⁾

P6. Auditimet e rregullshmërisë (financiare) kryhen në mjedise të ndryshme. Në mjediset e raportimit financiar që kanë për synim praktikën e pranuar ndërkombëtarisht, zbatimi i plotë i ISSAI 1000-2999 nga audituesit e sektorit publik do të ndihmojë në ofrimin e një strukture shtesë për transformimin e mjedisit në të cilin zhvillohet auditimi, në drejtim të praktikave të pranuar ndërkombëtarisht.

67) ISSAI 4000 Udhëzimet e Auditimit Financiar të INTOSAI-t

68) ISSAI 4200, Udhëzime të Auditimit të Pajtueshmërisë në lidhje me Pasqyrat Financiare të Auditimit

P7. Në sektorin publik, referimi në standardet relevante të auditimit mund të bëhet në njërin nga mënyrat e mëposhtme në varesi të standardeve që aplikohen:

- a) Në pajtim me ISA-të; që do të thotë në pajtueshmëri të plotë me të gjitha ISA-te relevante dhe nëse është relevante, me udhëzime shtese të përcaktuara në Shënimet Praktike të INTOSAI për ISA-të;
- b) Në pajtim me Parimet Themelore të Auditimit të INTOSAI, por jo në pajtueshmëri të plotë me ISA-në të cilat në këtë rast janë të përfshira si pjesë e Udhëzimeve të Auditimit Financiar të INTOSAI) (ISSAI 1000-2999); ose
- c) Në pajtim me Standardet e tjera kombëtare dhe relevante të Auditimit.

P8. Në kontekstin e Sektorit Publik, Shënimet Praktike përdorin termin “audituesit e Sektorit Publik” si ekuivalente me “auditues” siç përdoret në ISA.

P9. Disa ISA përmbajnë konsiderata që janë specifike për auditimet e entiteteve më të vogla.

Në auditimet e entiteteve të sektorit publik dhe entiteteve që marrin fonde qeveritare, këto konsiderata zakonisht nuk janë të aplikueshme edhe në qoftë se subjekti i sektorit publik ka vetëm disa të punësuar, operime të thjeshta ose një buxhet relativisht të vogël. Në këtë situatë, entiteti i sektorit publik mund të ketë transaksione të komplikuar, siç janë transferet nga qeveritë e tjera si dhe nevojën për të vepruar në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe sistemet e përcaktuara nga një nivel më i lartë i qeverisë dhe për llogaridhënie në përdorimin e parave të taksapaguesve. Prandaj audituesit e sektorit publik shqyrtojnë me kujdes të madh rëndësinë e këtyre opsioneve. Shënimet Praktike mund të përfshijnë udhëzime shtesë në këtë fushë kur shtimi i udhëzimit përkatës për auditimet e entiteteve të vogla të sektorit publik konsiderohet i rëndësishëm.

Një Auditim i Pasqyrave Financiare

P 10. Gjatë shqyrtimit të Paragrafit 6 të ISA-së, audituesit e sektorit publik marrin në konsideratë udhëzime të mëtejshme të përfshira në Shënimin Praktike të ISA 320⁶⁹.

P 11. Paragrafi A7 i ISA-së është një prej shumë paragrafëve që merret me kornizat prezantimit të drejtë. Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik -SNKSP (IPSAS), të hartuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik janë një shembull i kornizës së prezantimit të drejtë për tu përdorur në sektorin publik.

P 12. Paragrafi A8 i ISA-së jep shembuj të pasqyrave financiare dhe përmbajtjen e plotë të pasqyrave financiare. Një pako e plotë e pasqyrave financiare për subjektin e sektorit publik, e përgatitur në bazë akruale të kontabilitetit normalisht mund të përfshijë:
Pasqyrën e pozitës financiare;

Pasqyrën e performancës financiare;

Pasqyrën e ndryshimeve në pasuritë neto/kapitali;

- Pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme;
- Krahasimin e buxhetit dhe shumave aktuale ose si një pasqyrë financiare shtesë e veçantë ose si një barazim; dhe
- Shënimet, ku përfshihet një përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe informata të tjera shpjeguese.

P 13. Në disa mjedise, një pako e plotë e pasqyrave financiare mund të përfshijë gjithashtu raporte të tjera siç janë raportet e performancës etj

P 14. Gjatë shqyrtimit të Paragrafit A10 të ISA-së, audituesit e sektorit publik marrin në konsideratë udhëzime të mëtejshme të përfshira në Shënimet Praktike për ISA 210⁷⁰ dhe për ISA 580⁷¹.

69) ISA 320, Materialiteti në Planifikimin dhe Kryerjen e një Auditimi

70) ISA 210, Rënia Dakord me Kushtet e Angazhimit të Auditimit

71) ISA 580 Deklaratat me shkrim

Objektivat e përgjithshme të Audituesit

P15. Tërheqja nga auditimi siç shpjegohet në Paragrafët 12 dhe 24 të ISA-së nuk është një opsion normal në një auditim në sektorin publik. Kur linden rrethana që normalisht do të rezultojnë me tërheqje nga auditimi, përgjegjësitë e audituesve të sektorit publik mund të përfshijnë raportimin e zgjeruar dhe të theksuar, për shembull tek legjislativi.

Përkufizimet

P16. Kur marrin në konsideratë përkufizimet në Paragrafin 13 të ISA-së, audituesit e sektorit publik marrin shënime si në vijim:

- a) Korniza e Aplikueshme për Raportimin Financiar - si në rastin e sektorin privat, kornizat në sektorin publik mund të jenë korniza të prezantimit të drejtë ose të përputhshmërisë; dhe
- b) Auditues - termi – Partner në Angazhim dhe – Firmë. Termi – Partner në Angazhim mundet t'i referohet një Auditori të Përgjithshëm, i cili e ka përgjegjësinë e plotë për auditimet në sektorin publik ose ndonjë personi tjetër me kualifikimet e përshtatshme i deleguar për / apo i caktuar në emër të tij/saj me përgjegjësi për këtë angazhim. Termi – Firmë normalisht mund të lexohet edhe si Institucion Suprem i Auditimit apo ekuivalent i tij në nivelet rajonale apo vendore.

Kërkesat Etike lidhur me një Auditim të Pasqyrave Financiare

P17. Kodi i etikës⁷²⁾ i INTOSAI-t është një dokument i cili është relevant sa herë që Paragrafi 14 të ISA-së të përmendet.

P18. Paragrafi 15 i ISA-së kërkon nga audituesi që të planifikojë dhe kryejë një auditim me një skepticizëm profesional duke pranuar se mund të ekzistojnë rrethana të cilat bëjnë që pasqyrat financiare të përmbajnë

72) ISSAI 30 Kodi Etikës i INTOSAI-t

anomali materiale. Parimet Themelore të (INTOSAI - ISSAI 200⁷³) adresojnë konceptin e kujdesit të duhur dhe deklaron: – Audituesit duhet të jenë vigjilentë për situatat, dobësitë e kontrollit, paqartësitë në mbajtjen e evidencave, gabimet dhe transaksionet e pazakonshme ose rezultatet të cilat mund të jenë tregues të mashtrimit, shpenzimeve të gabuara ose të paligjshme, veprimeve të paautorizuara, shpërdorimeve, jo efikasitetit ose mungesës së ndershmerisë. Koncepti i skepticizmit profesional rrit dhe zgjeron konceptin e kujdesit të duhur dhe është rrënjësor për planifikimin dhe kryerjen e auditimit.

Kryerja e një auditimi në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

P19. Kur marrin në konsideratë Paragrafët 18 deri 20 të ISA-së për përputhshmëri me ISA-të respektive për auditimin, audituesit e sektorit publik marrin gjithashtu në konsideratë se në aplikimin e ISSAI-ve për auditimin e rregullsisë (financiar) në sektorin publik, ISA-të dhe Shënimet Praktike krijojnë së bashku udhëzimin për audituesit e sektorit publik. Nëse në raportin e audituesit referimi bëhet auditimit që është kryer në përputhje me ISA-të, audituesit e sektorit publik duhet të veprojnë në pajtim me të gjitha ISA-të që janë relevante për auditimin siç përcaktohet në paragrafët 18 deri 20 të ISA-së.

Dëshmitë e mjaftueshme dhe të duhura të auditimit dhe rreziku i auditimit

P20. Kur marrin në konsideratë burimet e informacionit siç përmendet në Paragrafin A28 të SNA(ISA)-së, audituesit e sektorit publik marrin gjithashtu në konsideratë që të përdorin informacionin nga auditimet e mëparshme të performancës dhe aktivitetet e tjera të auditimit në lidhje me entitetin. Ata do ta bënin këtë vetëm nëse informatat do të ishin relevante dhe të besueshme.

73) ISSAI 200, Standardet e Auditimit të INTOSAI-t - Standardet e Përgjithshme paragraf 2 60

ISSAI 1210

Udhëzues i Auditimit Financiar

***RËNIA DAKORD ME KUSHTET E
ANGAZHIMIT TË AUDITIMIT***

Shënim Praktik për Standardin Ndërkombëtare të Auditimit (ISA 210)

PËRMBAJTJA

SHËNIMI PRAKTIK PËR ISA 210⁷⁴⁾	Paragrafi
Historiku	
Hyrje në ISA	
Përmbajtja e Shënimit Praktik	P1
Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik	P2-P3
Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik	P4
Parakushtet për një Auditim	P5-P6
Marrëveshja mbi Kushtet e Angazhimit të Auditimit	P7-P10
Pranimi i një ndryshimi në kushtet e angazhimit të auditimit	P11

74) Të gjitha shënimet praktike konsiderohen sëbashku me ISSAI 1000 “Hyrje e përgjithshme në Udhëzime të Auditimit Financiar”.

Shtojca 1: Shembull i një Letre të Angazhimit të Auditimit në Sektorin Publik

Rënia Dakord me Kushtet e Angazhimit të Auditimit

Historiku

Ky Shënim Praktik ofron udhëzim shtesë mbi ISA 210 - Rënia Dakord me Kushtet e Angazhimit të Auditimit . Duhet të lexohet i lidhur ngushtë me ISA. ISA 210 ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 dhjetor 2009 e më pas. Shënimi Praktik ka hyrë në fuqi në të njëjtën datë si dhe ISA.

Hyrje në ISA

ISA 210 trajton përgjegjësitë e audituesit me rënien dakord mbi kushtet e angazhimit të auditimit me drejtimin ose me personat e ngarkuar me menadimin. Kjo përfshin vendosjen e parakushteve të caktuara për një auditim, përgjegjësinë e cila bie mbi drejtimin dhe atje ku është e përshtatshme mbi personat e ngarkuar me menaxhim. ISA 220⁷⁵⁾ ISA 220,— Kontrolli i Cilësisë për një Auditim të Pasqyrave Financiare. trajton ato aspekte të pranimit të angazhimit që janë në kontrollin e audituesit.

Përmbajtja e Shënimit Praktik

P1. Shënimi Praktik ofron udhëzim shtesë për audituesit e sektorit publik lidhur me:

- a) Parakushtet për një Auditim.
- b) Marrëveshja mbi Kushtet e Angazhimit të Auditimit.
- c) Pranimi i një ndryshimi në kushtet e angazhimit të Auditimit.

75) ISA 220,— Kontrolli i Cilësisë për një Auditim të Pasqyrave Financiare.

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik

P2. ISA 210 është i zbatueshëm për audituesit e entiteteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të pasqyrave financiare.

P3. Kushtet e një angazhimi të auditimit në sektorin publik janë zakonisht të detyrueshme dhe për këtë arsye nuk i nënshtrohen kërkesave nga ekzekutivi dhe pajtueshmërisë me të. Prandaj kërkesat eISA-së, kur zbatohen në kontekst të sektorit publik, janë të dobishme në krijimin e një mirëkuptimi të përbashkët formal të roleve përkatëse dhe përgjegjësi të drejtuesvetë ekzekutivit dhe audituesit. Kjo, pse audituesi i sektorit publik është normalisht i angazhuar nga legjislativi dhe i raporton atij, ndërsa marrëveshjet shpesh duhet të arrihen me të dyja, me legjislativin dhe ekzekutivin.

Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

P4. ISA 210 në paragrafët A27 dhe A37 përmban zbatimin dhe materialet e tjera shpjeguese, me opinione të veçanta për entitetet e sektorit publik.

Parakushtet për një Auditim

P5. Kur vendosen, nëse është e nevojshme që parakushtet të jenë të pranishme për një auditim siç kërkohet nëparagrafin 6(a) të ISA-së, audituesit e sektorit publik konsiderojnë se në sektorin publik kuadri i raportimit financiar shpesh mund të përshkruhet me ligj ose rregullore. Nëse audituesit e sektorit publik përcaktojnë se kuadri i përcaktuar me ligj dhe me rregullore nuk është i pranueshëm, ata zbatojnë kërkesat e paragrafëve 8, 19 dhe 20 të ISA-ve, dhe poashtu marrin për bazë:

- Informimin e legjislativit dhe nëse kuadri i raportimit financiar nuk është i plotë,
- Vendosjen e standardit të ndikimit nga organizatat profesionale apo rregulluese, në pajtim me ISSAI 100 paragrafi 6(e)⁷⁶.

⁷⁶ ISSAI 100, — ONISA Standardet e Auditimit - Parimet Themelore, paragraf 6 (e): Autoritetet përkatëse duhet të sigurojnë nxjerrjen e standardeve të pranueshme të kontabilitetit për raportim financiar dhe shpalosjen përkatëse për nevojat e qeverisë, më tutje, subjektet e audituara duhet të zhvillojnë objektivat specifike dhe të matshme si dhe synimet e performancës

P6. Me arritjen e pajtueshmërisë së drejtimit ose e personave të ngarkuar me menaxhimin se ata të pranojnë dhe të kuptojnë përgjegjësinë e tyre siç përcaktohet në paragrafin 6 (b) të ISA 210, audituesit e sektorit publik kanë parasysh faktin që përgjegjësitë e drejtimit të atyre që janë të ngarkuar me qeverisje në sektorin publik mund të jetë më të gjera se përgjegjësitë në sektorin privat. Forma e legjislacionit, si dhe e udhëheqjes dhe strukturat e qeverisjes mund të ndryshojnë në mënyrë të gjerë në sektorin publik, duke rritur nevojën për të formalizuar njohjen dhe të kuptuarit e përgjegjësiave të tilla.

Marrëveshja mbi Kushtet e Angazhimit të Auditimit

P7. Në sektorin publik mund të ketë çështje të tjera krahas shembujve të listuara në paragrafin A23 të ISA-ve, që audituesit e sektorit publik duhet të raportojnë nëse ata bëhen të vetëdijshëm për to gjatë rrjedhës së auditimit dhe se prandaj mund të jenë relevante për çështje të tilla si:

- Performanca joefektive e operacioneve - ka të bëjë me përgjegjësinë e drejtimit për të ndërmarrë aktivitete në mënyrë efektive dhe efikase;
- Rastet e papajtueshmërisë me autoritetet - ka të bëjë me përgjegjësinë e drejtimit për të ndërmarrë aktivitete, përdorë burimet dhe të përmbushë kërkesat e llogaridhënies në përputhje me autoritetin e dhënë nga legjislativi dhe gjitha drejtimit tjera relevante;
- Humbje - ka të bëjë me përgjegjësinë e drejtimit për të siguruar dhe të përdor burimet në mënyrë ekonomike, pa humbur asnjë para publike; dhe
- Raste të abuzimit - ka të bëjë me përgjegjësinë e drejtimit për të përmbushur pritjet e legjislativit dhe publikut pasi ato kanë të bëjnë me standardet përkatëse të sjelljes. Mund gjithashtu të jetë e këshillueshme për të përshkruar masat për të mbrojtur pavarësinë e audituesit të sektorit publik. Kur është e përshtatshme, objektiva të tjera të auditimit të përcaktuara nga mandati mund të përfshihen në letrën e angazhimit.

- P8. Përveç pikave të listuara në paragrafin A24 të ISA, audituesit e sektorit publik mund të konsiderojnë të rëndësishme të përfshijnë ndonjë marrëveshje ku auditimi është kontraktuar nga jashtë për t'u kryer nga auditues të tjerë.
- P9. Në sektorin publik, procesi i pranimit dhe vazhdimësisë i referuar në paragrafin 7 të ISA influencohet nga fakti se audituesit e sektorit publik mund të mos e kenë mundësinë për të mos pranuar ose të tërhiqen nga auditimi. Megjithatë, në rastet kur drejtimi apo legjislativi imponon një kufizim të fushëveprimit para fillimit të angazhimit, efekti mund të jetë që audituesi të mohojë opinionin mbi pasqyrat financiare. Audituesit e sektorit publik e marrin parasysh situatën dhe si kjo mund të ndikojë në vlerësimin e rrezikut, qasjen e auditimit dhe raportin e audituesit. Në disa raste ajo mund të jetë e përshtatshme për t'ju raportuar vetëm legjislativit.
- P10. Paragrafi 8 i ISA trajton faktorë të tjerë që ndikojnë në pranimin e angazhimit të auditimit. Në një situatë ku parakushtet për një auditim nuk janë të pranishme dhe kur audituesit e sektorit publik nuk kanë mundësinë për të mos pranuar angazhimin në auditimi, një përgjigje e përshtatshme përveç kërkesave në paragrafët 19 dhe 20 të ISA mund të përfshijë informimin e legjislativit.

Pranimi i një ndryshimi në Kushtet e Angazhimit të Auditimit

- P11. Kur merren parasysh kërkesat në paragrafët 14 dhe 15 të ISA, audituesit e sektorit publik mund të përmësin se kushtet e një angazhimit të auditimit në sektorin publik janë normalisht të mandatuara dhe për këtë arsye nuk i nënshtrohen kërkesave dhe marrëveshjes me drejtuesit .

Shtojca 1:

Shembull i një Letre të kryerjes së Auditimit në Sektorin Publik

Në vijim është një shembull i një Njoftim për fillimin e një auditimi një auditim me qëllimin e të përgjithshëm të auditimit të pasqyrave financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik. Kjo letër ka për qëllim të jetë vetëm një udhëzues që mund të përdoret, por do të duhet të përshtatet sipas kërkesave dhe rrethanave konkrete. Gjithashtu und të jetë inevojshëm këshillimi ligjore nëse letra e propozuar është e përshtatshme apo jo.

Drejtuar përfaqësuesit të përgjegjës për drejtimin e entitetit ose personave të ngarkuar me drejtimin e entitetit]⁷⁷⁾

Data.....

Të nderuar Zotëri/zonjë

Njoftim përfillimin e Auditimit

Hyrje

[Grupi] pasqyrat financiare prej [data] dhe për vitin e përfunduar [entiteti] dhe [degët] janë objekt i auditimit nga [Organizata e Auditimit të Sektorit Publik] në përputhje me [legjislacionin përkatës]

Qëllimi i kësaj letre është të përshkruajë:

- a) Kushtet e fillimin të auditimit, natyrën dhe kufizimet të auditimit vjetor; dhe

77) Adresat dhe referencat në letër drejtimit ose atyre të ngarkuar me qeverisjen apo legjislativit, do të jenë ato që janë të përshtatshme për rrethanat e angazhimit, duke përfshirë edhe mjedisin përkatës në sektorin publik. Është e rëndësishme t'i referohemi personave të duhur siç është e cekur në paragrafin të ISA.

- b) Përgjegjësitë përkatëse të audituesit dhe [nivelit të duhur të drejtimit] në auditimin vjetor.

Kushtet për filimin te auditimit janë përcaktuar më poshtë. Kjo letër do të mbetet në fuqi deri sa të hartohen një letër e re e angazhimit të auditimit.

Objektivi(at) i/e Auditimit

Objektivi(at) i/e auditimit vjetor janë:

- a) Për të shprehur një opinion të pavarur mbi [grupi] pasqyrat e përgatitura financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe të legjislacionit; dhe
- b)[Objektivat shtesë p.sh lidhur me pajtueshmërinë me autoritetet apo kontrollet ebrendshme].

Përgjegjësitë e Audituesit

Standardet e Zbatuara Audituese gjatë Kryerjes së Auditimit

Auditimin do ta kryejmë në [përputhje me standardet e auditimit].⁷⁸⁾

Standardet e Zbatuara të Auditimit

Planifikimi dhe kryerja e auditimit [Përmbajtja e këtij seksioni duhet të përshtatet për të pasqyruar në mënyrë të duhur standardet përkatëse të zbatuara të auditimit].

Standardet e auditimit kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare të [grupit] përmbajnë ose jo gabime materiale. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për marrjen e evidencës së nevojshme rreth shumave dhe deklarimeve që jepen në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, ku përfshihet vlerësimi i risqeve të gabimeve materiale në pasqyrat financiare, i cili vjen nga mashtrimi apo gabimi. Një auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe të arsyeshmërisë së pasqyrave kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Si rrjedhojë e kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, së bashku me kufizimet e vetvetishme të kontrollit të brendshëm, ekziston një rrezik i pashmangshëm që disa nga anomalitë materiale të mbeten të pazbuluara edhe pse Auditimi është planifikuar siç duhet dhe kryer në përputhje me [standardet përkatëse të auditimit].

78) Në sektorin publik, referenca për standardet përkatëse mund të bëhet në një nga tre mënyrat në varësi të standardevë të zbatueshme:

(a) Në pajtim me ISA që do të thotë pajtueshmëri e plotë me të gjitha ISA-të përkatëse dhe nëse është relevante me udhëzime shtesë të përcaktuara në ONISA Shënimet Praktike të ISA-ve.

(b) Në pajtim me Parimet Themelore të Auditimit të ONISA-së por jo në përputhje të plotë me ISA-të të janë aktualisht të përfshira si pjesë të udhëzimeve financiare të auditimit të ONISA-së (ISSAI 1000-2999).

(c) Në pajtim me standardet tjera kombëtare ose relevante të auditimit

Gjatë vlerësimit të riskut ne do të vlerësojmë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen e pasqyrave financiare të entitetit me qëllim që të përcaktojmë ato procedura të auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Megjithatë, ne do t'ju komunikojmë me shkrim në lidhje me ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me auditimit të pasqyrave financiare dhe që ne kemi identifikuar gjatë auditimit.⁷⁹⁾ Ky seksion mund të duhet të përshtatet nëse audituesi i sektorit publik raporton mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

[ku është e nevojshme, audituesit e sektorit publik marrin parasysh përfshirjen e informacionit mbi përgjegjësitë e tyre në lidhje me objektivat shtesë të auditimit]

Auditimi ynë nuk është i drejtuar për të raportuar gjërat në vijim, por ne do t'i raportojmë ato nëse hasim në të njëjtat gjetje gjatë kryerjes së auditimit:

- a) Performanca jo-efektive e operacioneve - ka të bëjë me përgjegjësinë e drejtimit për të ndërmarrë aktivitete në mënyrë efektive dhe efikase;
- b) Rastet e mospajtueshmërisë me autoritetet - ka të bëjë me përgjegjësinë e drejtimit për të ndërmarrë aktivitete, përdorë burime, dhe të përmbushë kërkesat e llogaridhënies në përputhje me autoritetin e dhënë nga legjislativi dhe gjitha drejtimit tjera relevante;
- c) Humbje - ka të bëjë me përgjegjësinë e drejtimit për të siguruar dhe të përdor burimet në mënyrë ekonomike, pa humbur asnjë para publike; dhe
- d) Raste të abuzimit - ka të bëjë me përgjegjësinë e drejtimit për të përmbushur pritjet e legjislacionit dhe publikut pasi ato kanë të bëjnë me standardet përkatëse të sjelljes.

79) Ky seksion mund të duhet të përshtatet nëse audituesi i sektorit publik raporton mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

Raportimi

Forma dhe përmbajtja e raportit tonë mund të kenë nevojë të ndryshohet në sajë të gjetjeve të auditimit tonë. *[Vendosni referencën e përshatshme lidhur me formën dhe përmbajtjen e pritshme të raportit të audituesit.]*

Pavarësia

Kërkesat tona etike kërkojnë nga ne që të mbetemi të pavarur nga [lloji i entitetit] dhe ne në këtë rast konfirmojmë pavarësinë tonë në lidhje me këtë auditim. Kjo do të thotë që ne jemi, në çdo rast, te zhveshur nga çdo interes që mund të konsiderohet në kundërshtim me integritetin, objektivitetin dhe pavarësinë.

[Sqaroni çfarëdo kufizimi të perceptuar të pavarësisë duke përshkruar kërcënimet dhe sigurinë e pavarësisë.]

Përgjegjësitë e drejtimit dhe personave të ngarkuar me menaxhimin

[Përgjegjësitë e drejtimit ose personave të ngarkuar me menaxhimin, si dhe identifikimi i kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar. Për qëllimet e këtij shembulli supozohet se audituesi nuk ka konstatuar se ligji apo rregulloret paraqesin në kushte të përshatshme. Përshkrimet në paragrafin 6(b) të këtij ISA-je 210 përdoren për këtë arsye. Aty ku është e nevojshme, duhet të përfshihet edhe informacioni mbi përgjegjësitë e drejtimit që është i lidhur me objektivat e tjera të auditimit.]

Auditimi ynë do të kryhet duke u bazuar në faktin që drejtimi ose personat e ngarkuar me menaxhimin pranojnë dhe kuptojnë se ata kanë përgjegjësi:

- a) Për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare ose për përgatitjen e pasqyrave financiare që i japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar;

- b) Për kontrollet e brendshme të tilla që drejtimi i konsideron si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë gabimemateriale, qoftë nga mashtrimi ashtu edhe nga gabimi; dhe
- c) T'i japin audituesit:
 - i) Të drejtën e aksesit në të gjitha informacionet për të cilat e drejtimi është në dijeni se janë të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare siç janë regjistrat , dokumentacioni si dhe çështje të tjera;
 - ii) Informacion shtesë të cilin audituesi mund ta kërkojë nga drejtimi për qëllime të auditimit; dhe
 - iii) Të drejtën e kontaktimit pa kufizim me persona brenda entitetit, nga të cilët gjykohet se është e nevojshme për të marrë evidencë auditimi.

Letër paraqitjeje

Si pjesë përbërëse e procesit të auditimit, ne do të kërkojmë nga drejtimi konfirmime me shkrim lidhur me gjetjet që kanë të bëjnë me auditimin.

Informacione të tjera të nevojshme

[Nën këtë titull mund të jetë e përshtatshme të përfshihen informacionet në lidhje me, për shembull:

- *Afatet ligjore të raportimit;*
- *Pronësia e dokumenteve të punës;*
- *Marrëveshjeve kontraktuale me ekspertë të jashtëm që bëjnë punë në emër të organizatës audituese të sektorit publik;*
- *Tarifat;*
- *Informacione të nevojshme të kontaktit, akomodimit të personelit dhe mjeteve të nevojshme; dhe*
- *Ndonjë çështje tjetër për të ndihmuar në sqarimin e boshllëkut të pritjes dhe përmirësimin e komunikimit efektiv.*

Pranimi i kushteve të angazhimit

Luteni, konfirmoni marrjen e kësaj letre dhe pranimin e kushteve të fillimit të auditimit duke nënshkruar kopjen e kësaj letre të mbyllur në hapësirën e dhënë dhe duhet të kthehet tek [të vendoset emri].

Nëse keni nevojë për ndonjë informacion shtesë, ose dëshironi të diskutoni më tej objektivat e auditimit para se të përgjigjeni, ju lutemi të mos hezitoni të më kontaktoni.

Sinqerisht,

Firmosur

.....

Audituesi i caktuar i sektorit publik

Kushtet e auditimit janë dakorduar dhe pranuar nga [*caktimi i personit i cili firmos*] në emër të [*emri i entitetit*].

.....

Firmosur

.....

.....

Emri dhe pozicioni,

Data

[*Drejtuesi ose personat e ngarkuar me menaxhimin*]

ISSAI 1220

Udhëzues i Auditimit Financiar

*KONTROLLI I CILËSISË PËR NJË
AUDITIM TË PASQYRAVE
FINANCIARE*

Shënim Praktik për Standardin Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 220

PËRMBAJTJA

SHËNIMI PRAKTIK PËR ISA 220⁸⁰⁾	Paragrafi
Historiku	
Hyrje në (ISA)	
Përmbajtja e Shënimit Praktik	P1
Zbatueshmëria e (ISA) në Auditimin e Sektorit Publik	P2
Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik	P3
Sistemi i Kontrollit të Cilësisë dhe Roli i Ekipeve të Auditimit	P4
Kërkesat Përkatëse Etike	P5
Kryerja e Angazhimit	P6

80) Të gjitha shënimet praktike konsiderohen së bashku me ISSAI 1000 "Hyrje e Përgjithshme në ONISA Udhëzime të Auditimit Financiar

Kontrolli i Cilësisë për një Auditim të Pasqyrave Financiare

Historiku

Ky Shënim Praktik ofron udhëzim shtesë mbi ISA 220 - Kontrolli i Cilësisë për një Auditim të Pasqyrave Financiare. Duhet të lexohet i lidhur ngushtë me ISA. ISA 220 ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhën që fillon me datën 15 dhjetor 2009 e më pas. Shënimi Praktik ka hyrë në fuqi në të njëjtën datë si dhe ISA.

Hyrje në ISA

ISA 220 trajton përgjegjësitë e audituesit në lidhje me procedurat e kontrollit të cilësisë për auditimin e pasqyrave financiare. Ai adreson, kur është e nevojshme përgjegjësitë e rishikuesit të kontrollit të cilësisë së angazhimit. Ky standard duhet të interpretohet në kontekstin e kërkesave etike përkatëse.

Përmbajtja e Shënimit Praktik

P1. Shënimi Praktik ofron udhëzim shtesë për audituesit e sektorit publik lidhur me:

- a) Sisteme Kontrollit të Cilësisë dhe Rolin e Ekipeve të Auditimit
- b) Kërkesat Përkatëse Etike.
- c) Kryerjen e Auditimit.

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik

P2. ISA 220 është i zbatueshëm për audituesit e entiteteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të pasqyrave financiare.

Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

P3. ISA 220 në paragrafët A7, A9, A12, A30 dhe A31 të ISA përmban zbatimin dhe materialet tjera shpjeguese me konsiderata të veçanta për entitetet e sektorit publik.

Sistemi i Kontrollit të Cilësisë dhe Roli i Ekipeve të Auditimit.

P4. ISA është në përputhje me paragrafin 2 të ISA të pranuar mbi bazën se firma është objekt i SNKC 1⁸¹⁾ ose me kërkesat kombëtare të cilat janë të paktën po aq të kërkuara. ISSAI 40, Kontrolli i Cilësisë së Auditimit për ISA-të, do të zhvillohet dhe përfshihet në nivelin e dytë të strukturës së ISSAI-së për tu zbatuar nga Institucionet Supreme të Auditimit për të gjitha llojet e aktiviteteve të auditimit.⁸²⁾

Kërkesat Përkatëse Etike

P5. Paragrafi 7 (n) i ISA përcakton kërkesat përkatëse etike. Në sektorin publik, kërkesat përkatëse etike mund të përfshijnë Kodin e Etikës të ONISA-së⁸³⁾ apo kërkesat kombëtare etike të zbatueshme për audituesit e sektorit publik me kusht që ato janë të paktën po aq kufizuese sa të ato të Kodit të Etikës së FNK-së për Kontabilistët Profesionistë.

Kryerja e Angazhimit

P6. Në disa mjedise të auditimit, të tilla si Gjykatat e Llogarive, kushtet e përdorura në paragrafin A30 të ISA-së duhet të interpretohet në kontekstin e strukturës qeverisëse së Institucionit Suprem të Auditimit.

81) SNKC 1, Kontrolli i Cilësisë për Firmat që Kryejnë Auditime dhe Rishikime të Pasqyrave Financiare dhe Angazhime të tjera të Sigurisë dhe të shërbimeve të lidhura

82) Mund të ketë ndryshime konforme në këtë Shënim Praktik si rezultat i zhvillimit të ISSAI 40.

83) ISSAI 30, Kodi Etik.

ISSAI 1230

Udhëzues i Auditimit Financiar

DOKUMENTIMI I AUDITIMIT

Shënim Praktik për Standardin Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 230

PËRMBAJTJA

SHËNIMI PRAKTIK PËR ISA⁸⁴⁾ 230

Paragrafi

Historiku

Hyrje në (ISA)

Përmbajtja e Shënimit Praktik P1

Zbatueshmëria e SNA (ISA) në Auditimin e Sektorit Publik P2

Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

Dokumentimi i Procedurave të kryera të Auditimit dhe dëshmime
të marra në auditim P3

Sistemimi i dosjes finale të auditimit P4-P5

Çështjet e konfidencialitetit dhe të transparencës P6-P14

Konsiderata të veçanta lidhur me dokumentimin për audituesit
sektorit publik me rol gjyqësor P15-P17

84) Të gjitha shënimet praktike konsiderohen së bashku me ISSAI 1000 "Hyrje e Përgjithshme në ONISA Udhëzime të Auditimit Financiar.

Dokumentimi i auditimit

Hyrje

Ky Shënim Praktik ofron udhëzim shtesë mbi (ISA) 230 - Dokumentimi i auditimit. Ky lexohet së bashku me (ISA). (ISA) ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhën duke filluar nga data 15 dhjetor 2009 e më pas. Shënimi Praktik ka hyrë në fuqi në të njëjtën datë si dhe (ISA).

Hyrje në (ISA) 230

ISA 230 trajton përgjegjësinë që ka audituesi për të përgatitur dokumentacionin e auditimit të pasqyrave financiare. Shtojca e ISA-së rendit standardet tjera të cilat përmbajnë kërkesa specifike dhe udhëzime lidhur me dokumentimin. Kërkesat specifike të ISA-ve të tjera për dokumentim nuk i kufizojnë zbatimin e këtij standardi. Ligji ose rregullorja mund të përcaktojnë kërkesa shtesë të dokumentimit.

Përmbajtja e Shënimit Praktik

P1 Shënimi Praktik ofron udhëzime shtesë për audituesit e sektorit publik në lidhje me:

- a) Dokumentimin e procedurave të kryera të auditimit dhe dëshmive të marra në auditim;
- b) Sistemimin e dosjes përfundimtare të auditimit,
- c) Çështjet e konfidencialitetit dhe të transparencës,
- d) Konsiderata të veçanta lidhur me dokumentimin për audituesit sektorit publik me rol gjyqësor.

Zbatueshmëria e ISA në auditimin e sektorit publik

P2. ISA 230 është i zbatueshëm për audituesit e entiteteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të pasqyrave financiare.

Udhëzime shtesë në çështjet e sektorit publik

Dokumentimi i Procedurave të kryera të Auditimit dhe dëshmime të marra në auditim

P3. Paragrafi 8 (c) i ISA-së kërkon nga audituesi të përgatisë dokumentimin e auditimit në mënyrë të atillë që bën të mundur që një auditor me përvojë, por pa lidhje të mëparshme me auditimin në fjalë, të kuptojë çështjet e rëndësishme që dalin në pah gjatë auditimit, konkluzionet e arritura në to dhe gjykimet profesionale të bëra për arritjen e atyre konkluzioneve. Paragrafi A8 i ISA-së shpjegon se për të gjykuar rëndësinë e një çështjeje kërkohet një analizë objektive e fakteve dhe e rrethanave dhe jep shembuj të çështjeve të rëndësishme. Audituesve të sektorit publik mund t'ju kërkohet të raportojnë për një gamë të gjerë të çështjeve të rëndësishme të cilat mund të mos jenë pjesë e raportit të tyre të auditimit të pasqyrave financiare, çështjeve që mund të mos rezultojnë në gabime materiale të informacioneve financiare ose të gjetjeve përkatëse. Shembuj të çështjeve të tilla përfshijnë mungesën e përputhshmërisë me legjislacionin ose mandatin e miratuar, shkeljet e dispozitave të kontratës ose marrëveshjeve të grandeve, shpenzimet e paautorizuara ose të papërshtatshme, ekzekutimin e buxhetit, certifikimin e deficitit/suficitit vjetor, vlerësimet e financimit të programit dhe shpenzimet dhe informacione mbi treguesit e performancës.

Sistemimi i dosjes përfundimtare të auditimit

P4. Paragrafi 14 i ISA kërkon nga audituesi që të sistemojë dokumentacionin në dosjen e auditimit dhe të kompletojë proceset administrative të sistemimit në dosjen përfundimtare të auditimit në kohën e parashikuar pas datës së raportit të audituesit. Paragrafi A21 i ISA-së e shpjegon se jo më shumë se 60 ditë pas datës së raportit të audituesit (është zakonisht

një kufi i përshtatshëm kohor) duhet kompletëhet tërësisht dosja e auditimit. Në sektorin publik procesi i përfundimit që shkon deri në datën e raportit të audituesit mund të jetë i gjatë. Kjo mund të jetë si rezultat i procedurave të konsultimeve formale me entitetin ose me të tjerët. Megjithatë, kjo nuk e përjashton sistemimin e dosjes së auditimit në kohë të duhur.

P5. Paragrafi A23 i ISA-së referohet në Standardin Ndërkombëtar të Kontrollit të Cilësisë (SNKC) - (ISQC)⁸⁵ i cili kërkon nga organizatat e auditimit që të krijojnë politika dhe procedura për ruajtjen e dokumentacionit të auditimit. Si tregohet në Paragrafin A61 të SNKC 1, periudha e ruajtjes së dokumentacionit nuk është më e shkurtër se 5 vite nga data e raportit të audituesit. Në sektorin publik mund të ketë kërkesa për të ruajtur dokumentacionin e auditimit për kohë më të shkurtër apo më të gjatë. Këto kërkesa mund të jenë për shkak të rëndësisë historike të llojeve të caktuara të dokumenteve të cilat, p.sh. mund të ruhen në arkivat kombëtare të vendit për një kohë të pacaktuar. Mund të kemi gjithashtu kërkesa shtesë në lidhje me klasifikimet e sigurisë kombëtare, duke përfshirë mënyrën se si është ruajtur dokumentacioni. Audituesit e sektorit publik duhet të familjarizohen me legjislacionin në fuqi në lidhje me ruajtjen e dokumentacionit.

85) ISQC 1 Kontrolli i cilësisë për firmat që kryejnë auditime dhe rishikime të pasqyrave financiare dhe angazhime të tjera të sigurimit dhe shërbimeve përkatëse*

Çështjet e konfidencialitetit dhe transparencës

- P6. Përderisa ISA 230 nuk i trajton çështjet e konfidencialitetit, integritetit, mundësisë së qasjes dhe rikthimit të dokumentacionit në nivelin e auditimit, ato trajtohen në SNKC 1 në kontekstin e përgjegjësive të një organizate të auditimit. Paragrafi A56 i SNKC 1 kërkon që kërkesat etike relevante të ngarkojnë personelin e organizatës së auditimit të vëzhgojë gjatë gjithë kohës konfidencialitetin e informatave të përfshira në dokumentimin e auditimit, përveç nëse entiteti autorizon publikimin e informatave të tilla apo ka detyrim ligjor apo profesional për ta bërë këtë.
- P7. Një ndryshim themelor në mes të sektorit privat dhe publik është se në sektorin publik mund të ketë kërkesa specifike legjislativë në lidhje me besueshmërinë në njërin anë dhe qasjes nga palët e treta në anën tjetër. Në sektorin publik ekziston një nevojë e vazhdueshme për të balancuar konfidencialitetin me nevojën për transparencë dhe llogaridhënie.
- P8. Raporti në mes të konfidencialitetit dhe transparencës kërkon gjykim profesional për të siguruar se dokumenti i natyrës konfidenciale identifikohet në mënyrë të qartë dhe është trajtuar si i tillë ndërsa në të njëjtën kohë garanton qasje sipas nevojës. Prandaj, është e rëndësishme që politikat dhe procedurat e institucioneve të larta të auditimit që i adresohen konfidencialitetit të familjarizohen. Procedura të tilla mund të përfshijnë llojet e dokumentacionit të auditimit të cilat do të konsiderohen konfidenciale, llojet e dokumentacionit të auditimit të cilët do të jenë në dispozicion për publikun, vijat e përcaktuara qartë të përgjegjësive për autorizimin e rishikimit së dokumentacionit të auditimit për të dhënë informata të tilla nëse kërkohen.
- P9. Për më tepër audituesit e sektorit publik mund të kenë përgjegjësi ligjore shtesë lidhur me besueshmërinë. Këto përgjegjësi mund të bazohen në mandatin e një Institucioni të veçantë Suprem të Auditimit ose në legjisllacionin që ka të bëjë me sekretet zyrtare ose privatësinë. Një legjisllacion i tillë, mund të lidhet p.sh. me auditimet e mbrojtjes, shëndetësisë, shërbimeve sociale ose të agjencive të taksave. Audituesit e sektorit publik pranojnë me kërkesat e veçanta lokale në lidhje me konfidencialitetin me të cilin janë të lidhur.

- P10. Audituesit e sektorit publik gjithashtu duhet të familjarizohen me çdo ligj që i jep qasje publike korrespondencës së auditimit, p.sh. kur mënyra elektronike apo të tjera të jenë të hapura për shqyrtim në publik. Ky lloj i korrespondencës mund të përfshijë letra për ose nga entiteti i audituar ose palët e tjera, lidhur me mbledhjen e dëshmimeve të auditimit, si dhe opinione dhe gjykimet lidhur me çështjet e auditimit.
- P11. Në sektorin publik nuk është e pazakontë që tu përgjigjen kërkesave nga palët e jashtme për të pasur qasje në dokumentacionin e auditimit. Kjo mund të jetë veçanërisht e ndjeshme kur pala nga jashtë përpiqet të marrë informacione në mënyrë indirekte nga ekipi i auditimit sepse nuk është në gjendje ti marrë drejtpërsëdrejti nga entiteti i audituar.
- P12. Parimisht, kur entiteti i audituar ka një detyrim ligjor për të mbledhur dhe mbajtur informacione të caktuara, kërkesat nga palët e jashtme për informacione të tilla normalisht referohen te entiteti i audituar.
- P13. Në situatën kur audituesit e sektorit publik konsiderojnë që të lejojnë shikimin e dokumentacionit të auditimit ato normalisht duhet të konsultohen me palët relevante (siç janë entiteti i audituar me të cilin ka të bëjë kërkesa) përpara se informacioni të bëhet i njohur. Në raste të tilla audituesi i sektorit publik siguron që ata të cilët kanë kontakt me informacionet t'i përmbahen të paktën të njëjtit nivel të konfidencialitetit si audituesi i sektorit publik.
- P14. Në disa mjedise, puna e audituesit në sektorin publik mund të kontraktohet jashtë nga Institucionet Supreme të Auditimit me audituesit tjerë. Pranimi i emërimeve të tilla normalisht kërkon nga audituesi që kryen punën të pranojë që dokumentimi i auditimit mund ti nënshtrohet inspektimit nga ana e Institucionit Suprem të Auditimit që ka caktuar audituesin. Dokumentimi i auditimit mund ti nënshtrohet gjithashtu inspektimit nga agjencitë e shqyrtimit që kanë të drejta ligjore për të marrë informata që janë relevante për detyrat e audituesit.

Konsiderata të veçanta lidhur me dokumentimin për audituesit sektorit publik me rol gjyqësor

- P15. Në disa mjedise të sektorit publik, si në Gjykatën e Llogarive, audituesit

e sektorit publik mund ti nënshtrohen ligjeve dhe rregulloreve të cilat kërkojnë nga audituesit që të kuptojnë dhe të ndjekin procedura të sakta të dokumentimit në lidhje me rregullat për administrimin e dëshmive. Audituesit e sektorit publik familjarizohen me politikat dhe procedurat të cilat përshkruajnë kërkesat shtesë në lidhje me dokumentimin e auditimit dhe që janë hartuar për të siguruar përputhshmëri me rregullat në fuqi për administrimin e dëshmive. Çështjet e mëposhtme mund të ndikojnë në dokumentimin dhe merren parasysh nga ana e audituesit.

- Legjislacioni imponon edhe kërkesa të tjera të dokumentimit të auditimit;
- Fushëveprimi e kërkesave të tilla (d.m.th. a do të imponohen ato për çdo dokument nga auditimi apo në dokumente specifike që kanë të bëjnë me çështje të caktuara të auditimit);
- Përpunime, formalitetet dhe kërkesat shtesë të cilave i nënshtrohen dokumentet e auditimit;
- Qëllimi i çdo kërkesë shtesë për sa i përket procesit të mirëfilltë gjyqësor në këto hapa të auditimit,
- Çdo pengesë e mëtejshme që mund të vihet mbi dokumentimin e auditimit për shkak të mënyrave të veçanta të kompletimit dhe/ose të prodhimit,

P16 Për audituesit e sektorit publik me rolin e tyre ligjor, siç është Gjykata e Llogarive, dokumentacioni përbën një pjesë të bazës së vendimit zyrtar. Në një mjedis të tillë, procesi i mirëfilltë gjyqësor mund të krijojë kërkesa specifike dhe të rrepta që duhet të respektohen për sa i përket konfidencialitetit të dokumentimit në lidhje me seancat gjyqësore të një rasti. Përveç kësaj, nëse vendimet mund të rezultojnë me kosto publike ligjërish të detyrueshme, mund të ketë kërkesa shtesë për ruajtjen e dokumentacionit të cilave audituesit e sektorit publik duhet t'i përmbahen.

17. Audituesit e sektorit publik që veprojnë në mjedise të tilla, të cilat përmenden në Paragrafin 15, familjarizohen me ligjet dhe rregulloret relevante në këtë drejtim.

ISSAI 1240

Udhëzues i Auditimit Financiar

*PËRGJEGJËSITË E AUDITUESIT
LIDHUR ME MASHTRIMIN NË
NJË AUDITIM TË PASQYRAVE
FINANCIARE*

Shënim Praktik për Standardin Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 240

PËRMBAJTJA**SHËNIMI PRAKTIK PËR ISA⁸⁶⁾****240Paragrafi****Historiku**

Hyrje në (ISA)

Përmbajtja e Shënimit Praktik	P1
Zbatueshmëria e (ISA) në Auditimin e Sektorit Publik	P2
Udhëzime Shtesë për çështjet e Sektorit Publik	P3
Konsideratat e Përgjithshme	P4-P5
Përkufizimet	P6
Skepticizmi Profesional	P7-P9
Diskutimi mes Anëtarëve të Grupit të auditimit	P10
Procedurat e vlerësimit të risqeve dhe veprimtaritë përkatëse	P11-P14
Identifikimi dhe vlerësimi i reziqeve të gabimeve materiale për shkak të mashtrimit	P15
Reagimet ndaj risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale për shkak të mashtrimit	P16-P17
Vlerësimi i Dëshmisë së Auditimit	P18
Pamundësia e audituesit për të vazhduar auditimin	P19
Komunikimet me drejtuesit dhe me ata që janë të ngarkuar me menaxhimin	P20
Komunikimet me autoritet rregullative dhe ato të zbatimit të ligjit	P21

86) Të gjitha shënimet praktike konsiderohen së bashku me ISSAI 1000 "Hyrje e Përgjithshme në ONISA Udhëzime të Auditimit Financiar.

Shtojca 1: Shembuj të Faktorëve të riskut të mashtrimit në mjedisin e Sektorit Publik

Shtojca 2: Shembuj të procedurave të mundshme të auditimit në lidhje me risqet e gabimeve materiale për shkak të mashtrimit

Shtojca 3: Shembuj të rrethanave në mjedisin e sektorit publik për ekzistencën e mundshme të mashtrimit

Përgjegjësitë e Audituesit lidhur me Mashtrimin në Auditimin e Pasqyrave Financiare

Historiku

Ky Shënim Praktik ofron udhëzim shtesë mbi ISA 240 - Përgjegjësitë e Audituesit lidhur me Mashtrimin në një Auditim të Pasqyrave Financiare. Duhet të lexohet i lidhur ngushtë me ISA. ISA 240 ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhën pas datës 15 dhjetor 2009 e më pas. Shënimi Praktik ka hyrë në fuqi në të njëjtën datë si dhe ISA.

Hyrje në ISA

ISA 240 trajton përgjegjësitë e audituesit lidhur me mashtrimin në një auditim të pasqyrave financiare. Në mënyrë të veçantë ai zgjeron mënyrën se si zbatohen ISA 315⁸⁷⁾ dhe ISA 330⁸⁸⁾ në lidhje me rreziqet e anomalive materiale për shkak të mashtrimit.

Përmbajtja e Shënimit Praktik

P1. Shënimi Praktik ofron udhëzim shtesë për audituesit e sektorit publik lidhur me:

- a) Reagimet e Përgjithshme.
- b) Përkufizimet.
- c) Skepticizmin Profesional.
- d) Diskutimin mes anëtarëve të grupit të auditimit.
- e) Procedurat e vlerësimit të riskut dhe veprimtaritë përkatëse.
- f) Identifikimin dhe vlerësimin e rrishtit të gabimeve materiale për shkak të mashtrimit.
- g) Reagimet ndaj risqeve të identifikuara të gabimit materiale për shkak të mashtrimit.
- h) Vlerësimin dëshmisë së auditimit.
- i) Pamundësia e audituesit për të vazhduar angazhimin.
- j) Komunikimet me menaxhmentin dhe me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen.
- k) Komunikimet me autoritetet rregullative dhe ato të zbatimit të ligjit.

87) ISA 315; – Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale Nëpërmjet Njohjes të Entitetit dhe Mjedisit të tij

88) ISA 330, – Reagimet e Audituesit ndaj Rreziqeve të Vlerësuar.

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik

P2. ISA 240 është i zbatueshëm për audituesit e entiteteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të pasqyrave financiare.

Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

P3. ISA 240 në paragrafët A6, A57 dhe A67 të ISA përmban zbatimin dhe materialet tjera shpjeguese me konsiderata të veçanta për entitetet e sektorit publik.

Reagimet e Përgjithshme

P4. Objektivat e një auditimi financiar në sektorin publik janë shpesh më të gjera se sa shprehja e një opinionit nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar (p.sh. fushëveprimi i ISA-ve). Mandati i auditimit, apo detyrimet për entitetet e sektorit publik, që rrjedhin nga legjislacioni, rregullorja, udhëzimi ekzekutiv, kërkesat e politikave qeveritare, apo rezolutave të legjislativitetit mund të rezultojë në objektiva të tjera. Këto objektiva shtesë mund të përfshijnë përgjegjësitë e auditimit dhe raportimit që lidhen me raportimin nëse audituesit e sektorit publik gjetën papajtueshmëri me autoritetet përfshirë këtu buxhetin dhe kuadret e llogaridhënies, dhe/ose raportimin në lidhje me efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Megjithatë, edhe aty ku nuk ka objektiva të tilla shtesë, mund të ketë pritje të përgjithshme publike në lidhje me raportimin e audituesve të sektorit publik për mos-përputhje të vërejtur me autoritetet ose raportimin në lidhje me efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Këto përgjegjësi shtesë dhe rreziqet e lidhura me mashtrim duhet të merren parasysh nga audituesi i sektorit publik gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit.

P5. Paragrafët 2 dhe 3 të ISA trajtojnë karakteristikat e mashtrimit. Tre janë kushtet që favorizojnë zakonisht mashtrimin. Këto kushte janë shpesh të pranishme në mënyra të ndryshme në sektorin publik. Ato përfshijnë:

- Nxitjen ose presionin (i vendosur në apo perceptuar nga drejtuesit apo punonjësit duke u dhënë atyre një arsye për të kryer mashtrimin) - Punonjësit e sektorit publik janë shpesh nën presion për të ofruar shërbime me cilësi të lartë me burime të pakta dhe për të përmbushur pritjet buxhetore. Kjo mund të jetë veçanërisht relevante në kushtet e vështira ekonomike, ku ka një presion për të mirëmbajtur tarifat dhe normat e taksave, duke rezultuar në nxitje për të zmadhuar të ardhurat dhe të zvogëlohen shpenzimet. Mund të ekzistojnë edhe nxitjet për të shpenzuar buxhetin në dispozicion deri në fund të vitit financiar;
- Mundësinë (karakteristikat apo rrethanat që lidhen me një entitet duke lejuar mundësinë për kryerjen e mashtrimit) - një mjedis i vështirë rekrutimi ose mungesa e konsiderueshme e personelit të kualifikuar mund të jetë më e përhapur në sektorin publik. Situatat e tilla shpesh mund të rezultojnë në mangësi të kontrollit të brendshëm duke krijuar mundësi për mashtrim. Përdorimi i gjerë i vëllimit të lartë, vlera e ulët e transaksioneve monetare në entitetet e caktuara të sektorit publik siç janë transaksionet monetare në komisaritet e policisë apo në klinika shëndetësore mund të çojnë në shtimin e këtyre rreziqeve. Edhe pse vlerat monetare mund të jenë të vogla, situata të tilla mund të çojnë në shkeljen e parimeve të pritshmërisë publike, të besimit dhe llogaridhënies, dhe
- Prirjet ose llogaritjet (Sjellja, karakteri apo vlerat etike që lejojnë individët për të justifikuar arsyet e tyre për kryerjen e mashtrimit) - nivelet e pagave në përgjithësi të ulëta në sektorin publik në raport me sektorin privat mund të çojnë punonjësit të besojnë se ata mund të justifikojë keqpërdorimin e fondeve. Si më lartë, kjo mund të shkelë parimet e pritshmërisë publike, të besimit dhe të llogaridhënies.

Përkufizimet

P6. Siç është përmendur në Deklaratën e Përgjithshme të Limas (INTOSAI), pjesa 1⁸⁹⁾ – koncepti dhe themelimi i auditimit trashëgohet në administratën financave publike pasi menaxhimi i fondeve publike përfaqëson një besim. Auditimi nuk është një fund në vetvete por një pjesë e domosdoshme e një sistemi rregullator, qëllimi i të cilit është për të zbuluar devijimet kundrejt standardeve të pranuar dhe shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë, efikasitetit, efektivitetit dhe ekonomicitetit të menaxhimit financiar. Ai ndihmon në ndërrmarjen e veprimeve korrigjuese në raste të veçanta i detyron se llogaridhënësit të pranojnë përgjegjësinë dhe të ndërmerren hapa për të parandaluar - ose të paktën tu vështirësohen - shkelje të tilla. Në këtë rast, audituesit e sektorit publik duhen të jenë vigjilent për të zbuluar dukuritë e abuzimit. Në këtë kontekst, Shënimi Praktik jep një përkufizim shtesë:

- Abuzimi - përbën sjellje të mangët ose të pahijshme kur krahasohet me sjelljen e një personi të matur i cili ka parasysh praktikën e arsyeshme dhe të nevojshme të punës dhënë faktet dhe rrethanat. Abuzimi gjithashtu përbën keqpërdorimin e autoritetit ose pozitës për interesa personale financiare apo interesa të një anëtari të afërt të familjes ose partnerit në biznes. Abuzimi domosdosmërisht nuk përfshin mashtrimin, shkeljen e ligjeve, rregulloreve ose dispozitave të një kontrate ose marrëveshje granti. Abuzimi është një largim nga koncepti i drejtësisë, i cila ka të bëjë me parimet e përgjithshme të menaxhimit të shëndoshë financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik.

Skepticizmi Profesional

P7. Përgjegjësia e audituesit për të mbajtur një qëndrim të skepticizmit profesional gjatë auditimit, siç është cekur në ISA, trajtohet nga ISSAI 1200.

89) ONISA 1, Deklarata e Limas

P8. Në sektorin publik, kërcënimet për mbajtjen e një qëndrimi të skepticizmit profesional gjatë auditimit, siç përshkruhet në paragrafët 12 deri 14 i ISA, mund të ekzistojë dhe të përfshijë:

- Natyrën e marrëdhënie personale apo profesionale, si rezultat i procesit politik/mjedisit;
- Mandatin ekskluziv në organizatat e sektorit publik të auditimit, duke rezultuar në mungesë të konkurrentëve të auditimit; dhe
- Në disa mjedise, mungesën e kërkesave për të alternuar auditorët rregullisht.

Prandaj audituesit e sektorit publik marrin masat e duhura për të zvogëluar kërcënimet e tilla. Veprimet e tilla mund të përfshijnë vendosjen e masave mbrojtëse siç adresohet në ISSAI 1220.

P9. Kur informacioni është i siguar tregon se abuzimi mund të ketë ndodhur, audituesit e sektorit publik vlerësojnë nëse një abuzim i tillë mund të ketë ndikuar dukshëm në pasqyrat financiare. Abuzimi i tillë mund të konsiderohet nga të dyja, si nga ana cilësore ashtu edhe nga ajo sasiore. Audituesit e sektorit publik nuk ofrojnë siguri të arsyeshme të zbulimit të abuzimit, por marrin parasysh nevojën për të raportuar raste të tilla siç është e nevojshme.

Diskutimi mes Anëtarëve të Grupit të auditimit.

P10. Paragrafi 15 i ISA kërkon diskutimin mes anëtarëve të grupit të auditimit dhe të përcaktimit nga ana e e pjestarit të grupit të auditimit se cilat çështje janë për t'u komunikuar me anëtarët e ekipit të cilët nuk janë të përfshirë në diskutim. Siç thuhet në paragrafin P4 lart, në sektorin publik, diskutimi mund të mbulojë gjithashtu objektivat shtesë dhe rreziqet e lidhura me gabimet materiale. Në një diskutim të tillë, audituesit e sektorit publik mund të përfshijnë audituesit e angazhuar në auditimet e performancës dhe aktivitetet e tjera të auditimit të entitetit.

Procedurat e vlerësimit të riskut dhe veprimtaritë përkatëse

P11. Kur merret parasysh kërkesa e paragrafin 17(c) të ISA, kur është e nevojshme, audituesit e sektorit publik mund të bëjnë hulumtime lidhur me komunikimin e drejtimit me organet e tjera qeveritare.

P12. Kur merren parasysh kërkesat për të pyetur të ngarkuarit me menaxhimin siç është përmendur në paragrafin 21 të ISA, audituesit e sektorit publik mund të përfshijnë edhe zyrtarët përgjegjës p.sh ministrin, anëtarët e bordit ose anëtarët e komisioneve përkatëse legislative.

P13. Sipas paragrafit 22 të ISA, audituesi do të vlerësojë nëse marrëdhëniet e pazakonta apo të papritura që janë identifikuar duke kryer procedurat analitike, përfshirë ato të lidhura me llogaritë e të ardhurave, të mund të tregojnë për risqet e gabimeve materiale për shkak të mashtrimit. Në sektorin publik, përveç llogarive të të ardhurave, mund të ketë fusha të tjera me rëndësi për qëllime të kryerjes së procedurave analitike në varësi të natyrës së operacioneve të entitetit. Në shumë entitete të sektorit publik, fushat e tilla si prokurimi dhe grantet mund të jetë më të rëndësishme se llogaritë e të ardhurave. Gjatë kryerjes së procedurave analitike, audituesit e sektorit publik marrin parasysh sfidat unike të përdorimit të bazës së kontabilitetit të parasë së gatshme dhe mundësitë e ndërlidhura për manipulimin e informacionit financiar.

P14. Gjatë vlerësimit të faktorëve të riskut për mashtrim siç theksohet në paragrafin 24 të ISA dhe duke marrë parasysh shembujt e dhënë në Shtojcën 1 të ISA, audituesit e sektorit publik marrin parasysh se në sektorin publik mund të ketë faktorë tjerë të riskut. Shembujt e faktorëve të tjerë të riskut të mashtrimit në mjedisin e sektorit publik janë dhënë në Shtojcën 1 të Shënimit Praktik.

Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve të gabimit material për shkak të mashtrimit

P15. Në sektorin publik, njohja e të ardhurave mund të mos jetë gjithmonë fusha më e rëndësishme për supozimin se ka risqe të mashtrimit siç kërkohet me paragrafi 26 të ISA. Njohja e të ardhurave mund të jetë shumë e rëndësishme për autoritetet tatimore ose agjencive të tjera që grumbullojnë të ardhura siç janë universitetet shtetërore dhe kolegjet, spitalet apo agjencitë rregullative, të cilat tarifojnë për shërbimet e kryera, ose janë përfituesit e fondeve të donatorëve. Megjithatë, në shumë entitete të sektorit publik përqendrimi më i madh është mbi shpenzimet dhe fushat e tilla si prokurimi dhe pagesat e granteve. Prandaj, përveç njohjes së të ardhurave, ku është e përshtatshme, audituesit e sektorit publik mund të marrin parasysh fusha të tilla të tjera ku supozohet rreziku i mashtrimit.

Reagimet ndaj risqeve të vlerësuara të gabimit material për shkak të mashtrimit

P16. Gjatë hartimit dhe kryerjes së procedurave të mëtejshme të auditimit për të cilat natyra, afati dhe shtrirja i përgjigjet rrisqeve të vlerësuara të gabimeve materiale për shkak të mashtrimit në nivel pohues, siç është cekur në paragrafin 30 të ISA dhe duke marrë parasysh shembujt e dhënë në Shtojcën 2 të ISA, audituesit e sektorit publik marrin parasysh se procedurat e tjera të auditimit mund të jenë të rëndësishme në sektorin publik. Shembuj relevant të procedurave të tjera auditimit në një mjedis të sektorit publik janë paraqitur në Shtojcën 2 të këtij Shënimi Praktik.

P17. Paragrafi 32 (c) i ISA trajton transaksionet e rëndësishme që janë jashtë veprimeve dhe aktiviteteve normale të entitetit auditues. Shembuj të transaksioneve të tilla në sektorin publik mund të përfshijnë:

- Nxitje të zhvillimit ekonomik;
- Dispozitat e vështira në kontrata sindikale;
- Paluajtshmëritë blerjet ose shitjet;
- Këmbimet e tokave;
- Dhënien e lehtësirave;
- Partneritetet publiko/ private;
- Privatizimin i shërbimeve qeveritare;
- Shuarja e hershme e borxhit; dhe
- Garancitë qeveritare apo siguritë për të shpëtuar entitetet e sektorit privat në qoftë se ata kanë vështirësi financiare.

Vlerësimi i Dëshmisë së Auditimit.

P18. Siç kërkohet nga paragrafi 35 i ISA, kur një anomali është identifikuar, audituesi vlerëson nëse kjo anomali është tregues i mashtrimit. Nëse ka një tregues të tillë, audituesi do të vlerësojë pasojat e anomalive. Shtojca 3 e ISA përmban rrethanat që mund të tregojnë mundësinë e mashtrimit. Shembuj të rrethanave shtesë për sektorin publik janë paraqitur në Shtojcën 3 të Shënimit Praktik.

Pamundësia e Audituesit për të Vazhduar auditimin

P19. Audituesit e sektorit publik normalisht kanë mundësinë të tërhiqen nga një angazhim nëauditim siç përshkruhet në paragrafin 38(c) të ISA. Prandaj, audituesit e sektorit publik marrin parasysh ndikimin e opinionit të auditimit dhe çfarëdo kërkesë të formave tjera të raportimit, duke

përfshirë, nëse ajo mund të jetë e përshtatshme për të raportuar veçmas për legjislativin dhe/ose të nxjerrë raporte konfidenciale ose të kufizuara.

Komunikimet me drejtuesit dhe me ata që janë të ngarkuar me menaxhimin

P20. Përveç atyre që janë ngarkuar me qeverisje, Audituesve të sektorit publik mund tu kërkohet ose mund të vendosin të komunikojnë çështjet e adresuara në paragrafin 41 të ISA me palët e tjera të tilla siç është legjislativi.

Komunikimet me Autoritet Rregullative dhe ato të zbatimit të ligjit

P21. Kërkesat për raportimin e mashtrimit në sektorin publik mund të jenë objekt i dispozitave të veçanta të mandatit të auditimit, legjislacionit ose rregullores, në përputhje me paragrafin 43 të ISA në lidhje me komunikimin e ndodhjes palës jashtë entitetit. Palët e tilla mund të përfshijnë autoritetet rregullative dhe të zbatimit të ligjit. Në disa mjedise, nuk mund të jetë detyrë për të referuar indikacionet e mashtrimit organeve hetimore dhe madje të bashkëpunohet me organet e tilla për të përcaktuar nëse mashtrimi apo abuzimi ka ndodhur. Në mjedise të tjera, audituesit e sektorit publik mund të jenë të detyruar të raportojnë rrethanat që mund të tregojnë mundësinë e mashtrimit ose të abuzimit tek organi kompetent juridiksional ose në pjesën e duhur të qeverisë apo legjislativit siç janë prokurorët, policia dhe (nëse është relevante e legjislativit) palët e treta të prekura. Audituesit e sektorit publik marrin parasysh nevojën për tu shmangur ndërhyrjeve të mundshme hetimore apo procedurave ligjore. Audituesit e sektorit publik duhet të kenë njohuri mbi ligjet dhe rregulloret në fuqi në lidhje me raportimin, komunikimin dhe dokumentimin e indikacioneve ose të dyshimeve për mashtrim. Për më tepër, audituesit e sektorit publik marrin për bazë nevojën për të marrë këshilla ligjore për çështjet lidhur me indikacionet e mashtrimit.

Shtojca 1: Shembuj të Faktorëve të Rrezikut të Mashtrimit në Mjedisin e Sektorit Publik

Faktorët e riskut të mashtrimit të paraqitura në këtë shtojcë janë shembuj të faktorëve që mund të ndeshen nga audituesit e sektorin publik. Megjithëse faktorët e riskut mbulojnë një gamë të gjerë të situatave, ato janë vetëm shembuj dhe varësisht me rrethanat, audituesit e sektorit publik mund të identifikojnë faktorë tjerë ose të ndryshëm të riskut. Jo të gjithë shembuj e dhënë janë të përshtatshëm për të gjitha situatat, disa prej tyre mund të jenë më të rëndësishëm e disa prej tyre më pak në entitetet me madhësi të ndryshme ose me karakteristika të ndryshme ose që veprojnë në rrethana të ndryshme. Gjithashtu, mënyra e renditjes së shembujve të mëposhtëm të faktorëve të riskut nuk është menduar të reflektojë rëndësinë e tyre relative apo shpeshtësinë e shfaqjes.

Faktorët e riskut në lidhje me Anomalitë e Shkaktuara nga Raportimi Financiar Mashtrues

Faktorët e riskut në lidhje me anomalitë e shkaktuara nga raportimi financiar mashtrues janë klasifikuar në bazë të tre kushteve që në përgjithësi janë të pranishme kur mashtrimi ekziston: Nxitjet/Presionet, Mundësitë dhe Prirjet/Llogaritjet. Shembujt e më poshtëm janë të faktorëve të riskut që lidhen me anomalitë e shkaktuara nga raportimi financiar mashtrues.

Nxitjet/Presionet

Paqëndrueshmëria financiare apo kërcënimet nga kushtet politike, ekonomike, buxhetore, ose kushtet në të cilat entiteti vepron, janë:

- Kontrollat e dobëta buxhetore;
- Privatizimet;
- Programet e reja;

- Ndryshimet e mëdha në programet ekzistuese;
- Burime të reja të financimit;
- Legjislacioni i ri dhe rregulloret apo direktivat;
- Vendimet politike të tilla si zhvendosja e operacioneve;
- Programet pa burime të mjaftueshme të alokuara dhe ato të financimit;
- Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve në industri të caktuara të tilla si mbrojtja;
- Delegimi i aktiviteteve qeveritare;
- Operacionet objekt i hetimeve të veçanta;
- Ndryshime në udhëheqjen politike;
- Partneritetet publiko private.

Presioni i tepërt ekziston për drejtuesit për të përmbushur kërkesat ose pritjet e palëve të treta ose atyre të ngarkuar me menaxhimin për shkaqe si më poshtë:

- Rritja e pritshmërisë publike;
- Pritjet më të mëdha se ato normale për të realizuar buxhetin;
- Shkurtime buxhetore pa ndonjë ulje përkatëse me pritjet e ofrimit të shërbimeve.

Mundësitë

Natyra e mjedisit të sektorit publik krijon mundësinë e raportimeve mashtruese financiare që mund të lindin nga:

- Ambient i mbyllur me rrjet dhe lidhje të forta politike;
- Strukturat hierarkike dhe burokratike e organizatës dhe kultura që vjen si rezultat i besnikërisë dhe bindjes së krijuar nga zinxhirët e forta dhe të përcaktuara mirë komanduese;

- Transferet qarkore të fondeve midis agjencive që vështirësojnë ndjekjen e – gjurmimin e parasë, e cila ka tendencë fshehjen e natyrës aktuale të fondeve në dispozicion;
- Zyrtarët në pozita të larta që mund të shfrytëzojnë rastin për të keqpërdorur autoritetin të tyre;
- Mundësi për të drejtuar sektorin privat, pas përfundimit të mandatit p.sh. si rezultat i dhënies së tenderëve;
- Toleranca e gabimeve në informacionin financiar.

Monitorimi i drejtimit nuk është efektivë si rezultat i zërave më poshtë:

- Motivet e forta politike, lidhjet dhe besnikëritë;
- Mjedis jo-stabil politik.

Ekziston një strukturë komplekse ose e paqëndrueshme organizative, siç është paraqitur në vijim:

- Numër i madh i lokacioneve me aktivitetet e qeverisë, për shembull, komunat në zonat e thella.

Komponentët e kontrollit të brendshëm janë të mangëta si pasojë e:

- Mjedisit të vështirë rekrutimi dhe/ose mungesës së personelit të mjaftueshëm të kualifikuar;
- Mungesës së TI - programeve të sofistikuar dhe platformave të veçanta të dizajnuara për nevojat e sektorit publik;
- Infrastrukturës së fragmentuar dhe e jo-integruar e TI-së.

Prirjet/Llogaritjet

- Në përgjithësi niveli i ulët i pagave në sektorin publik në krahasim me sektorin privat mund të japë punonjësve arsye për të justifikuar raportimin mashtrues financiar, veçanërisht në qoftë se stimulime të tilla si pagesa bonus janë të përfshira;

- Mospërfillje për implikimet e shkeljeve të qeverisë, e cila në sektorin privat mund të rezultojë në implikime të tilla si gjobat, shkarkimet, ose me burgim.

Faktorët e risqeve të lidhura me Anomalitë që shkaktohen nga keqpërdorimi i aktiveve

Disa nga faktorët e rrishtit që lidhen me anomalitë që shkaktohen nga raportimi financiar mashtrues mund gjithashtu të jenë të pranishme kur anomalitë dalin nga shpërdorimi i ndodhur i aktiveve. Për shembull, monitorimi jo-efektiv i drejtimit dhe dobësitë e kontrollit të brendshëm mund të jenë të pranishme kur ekzistojnë anomalitë për shkak të raportimit financiar mashtrues ashtu edhe të keqpërdorimit të aktiveve. Më poshtë jepen shembuj të faktorëve të rrishtit që lidhen me anomalitë që rrjedhin nga shpërdorimi i pasurive.

Nxitjet/Presionet

Marrëdhëniet negative midis entitetit dhe personelit që ka kontakt me mjete monetare ose aktive të tjera të ekspozuara ndaj vjedhjes, mund të motivojnë personelin për të përvetësuar pasuri të tilla. Për shembull, marrëdhëniet negative mund të krijohet nga :

- Struktura të ashpra publike kompensimi të sektorit që janë parë të jenë në kundërshtim me pritjet;
- Shpërblimi i zyrtarëve të lartë në vend të atyre me performancë të mirë.

Aspektet unike të prokurimit të sektorit publik/proceset tenderuese, si:

- Kontratat politikisht të ndjeshme;
- Konkurrenca krijuar nga kontaktet me volum të lartë/vlera të mëdha mund të krijojnë rreziqe për pagesën e ryshfeteve dhe të bakshisheve;
- Kontratat me palët ndërkontraktore,
- Natyra e rrezikshme e aktiviteteve të caktuara qeveritare p.sh. armëve, burimeve natyrore etj.

Keqpërdorimi i pushtetit apo autoritetit:

- Ryshfetet gjatë marrjes së vendimeve në fushat e ndjeshme të tilla si vendimet për grante ose aplikimet për punë, leje qëndrimi apo nënshtetësi.

Mundësitë

Karakteristika apo rrethana të caktuara mund të rrisin ekspozimin e aktiveve ndaj keqpërdorimit. Për shembull, mundësi për të keqpërdorur aktivet rriten kur ka:

- Mospërputhje midis vlerës aktuale dhe vlerës së regjistruar të aktiveve të trashëgimisë;
- Mangësitë në bazën e kontabilitetit të parasë së gatshme, siç janë:
 - Mos-regjistrimi i pasurive të caktuara;
 - Detajet e papërshtatshme të pronësisë për pasuritë si toka dhe ndërtesat;
 - Mundësia për të manipuluar periudhën për regjistrimin e transaksioneve;
 - Veprim i pakontrolluar ose pastrukturuar nga baza monetare e kontabilitetit në bazat aktuale të kontabilitetit.

Prirjet/llogaritjet

- Zyrtarët e sektorit publik nuk bëjnë dallim mes të transaksioneve personale dhe qeveritare, p.sh. keqpërdorimi i kartelave qeveritare të kredisë;
- Besimi nga ana e zyrtarëve të caktuar të sektorit publik që niveli i tyre i autoritetit arsyeton një mënyrë jetese të ngjashme me drejtuesit e sektorit privat, kur kushtet e tyre të kompensimit nuk janë të mjaftueshme për një mënyrë jetese të tillë;
- Toleranca e papranueshme e sjelljes në situata kur mund të jetë e vështirë për të shkarkuar ose të zëvendësuar të punësuarit.

Shtojca 2: Shembuj të Procedurave të Mundshme të Auditimit në lidhje me Rreziqet e Anomalive Materiale për Shkak të Mashtrimit

Reagime të Veçanta - Anomali për Shkak të Raportimit Financiar Mashtrues

Shembuj të reagimeve të zbatueshme për sektorin publik përveç shembujve të ofruar në ISAmund të përfshijnë:

Planifikimin e Auditimit

Për shkak të natyrës së përgjithshme të risqeve të dhëna në Shtojcën 1 në Shënimin Praktik, trajtimi i këtyre rreziqeve mund të nënkuptojë një proces më intensiv të planifikimit. Edhe pse procedurat mund të mbesin të njëjta si në sektorin privat, vlerësimi i mundësisë më të lartë riskun mund të kërkojë testim më të detajuar.

Vëmendje mund të jepet në vijim në lidhje me procesin më të intensifikuar të planifikimit:

Konflikt Interesi

- Formimi, mirëmbajtja dhe hulumtimi në bazë të të dhënave për informata shtesë p.sh:
 - Mashtrimin e raportuar;
 - Raportet mediale;
 - Masat e ndërmarra disiplinore ndaj personelit;
 - Ankesat;
 - Reagimet e përgjithshme të publikut dhe palëve të interesuara.
 - Lidhjet me informatat e mbledhura nga rregullatorët, prokurorët publik, zyra për krimet e rënda ekonomike apo agjencitë e tjera hetimore të konsideruara si të rëndësishme nga audituesit në sektorin publik;
 - Informata nga zyrtarat e ankesave e etj;

- Rezultatet e hetimeve të mjekësisë ligjore apo auditimeve të performancës (veçanërisht në lidhje me prokurimin dhe investimet e infrastrukturës).

Procesi i Prokurimit

Prokurimi publik është zakonisht i nënshtruar ndaj ligjeve dhe rregulloreve të shumta. Ligje të tilla dhe rregulloret shpesh përfshijnë procedurat e detajuara të prokurimit, i dizajnuar për të siguruar që të gjitha palët e interesuara, në çdo aspekt marrin pjesë të njëjta dhe të kenë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në një tender. Këto procedura janë gjithashtu të dizajnuara shpesh për të siguruar që procedurat e seleksionimit përmbushin kërkesat e një trajtimi transparent dhe të drejtë të të gjitha ofertave. Edhe pse procedura mund të mbetet e njëjtë si në sektorin privat, vlerësimi i riskut të lartë mund të kërkojë testim më të detajuar.

Vëmendje mund të jepet në vijim në lidhje me procesin më të intensifikuar të planifikimit:

Sistemi i Prokurimit

- Të kërkohej nga drejtimi nëse sistemi i prokurimit është zhvilluar dhe zbatuar dhe merret me: blerjen e mallrave dhe shërbimeve si dhe dhënie me qira të aktiveve shtetërore;
- Inspektoni dokumentacionin e sistemit të prokurimit për ndonjë kërkesë që mund t'ju drejtojë që sistemi nuk është i drejtë, i paanshëm, transparent, konkurrues dhe me kosto-efektive;
- Krahasoni dokumentacionin e sistemit të prokurimit bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- Inspektoni dokumentacionin e sistemit të prokurimit për të përcaktuar nëse trajton standardet dhe kërkesat kohore për një sistem të tillë.

Konflikt Interesi

- Përmes diskutimeve me Drejtuesit dhe inspektimin e dokumentacionit të sistemit të prokurimit dhe proces-verbaleve të komisionit të mbledhur të tenderit, inspektoni nëse zyrtarët e prokurimit dhe zyrtarët me rol tjetër:
 - Janë njoftuar dhe zbuluar me ndonjë konfliktinteresi të mundshëm;
 - Kanë trajtuar të gjithë furnizuesit dhe furnizuesit e mundshëm në mënyrë të barabartë;
 - Nuk e kanë përdorur pozitën e tyre për përfitime personale ose për të ndihmuar tëpërfitojë në mënyrë të paligjshme një person tjetër;
 - Nuk e kanë rrezikuar kredibilitetin apo integritetin e sistemit të prokurimit nëpërmjetpranimit të dhuratave, mikpritjes ose ndonjë veprimi tjetër;
 - kane qene të përpiktë në përdorimin e pronës publike;
 - Kanë ndihmuar zyrtarët e kontabilitetit/autoritetet në luftimin e korrupsionit dhe mashtrimit në sistemin e prokurimit.
- Hulumtoni dhe kontrolloni nëse institucioni ka zbatuar kontrollet për të raportuar konfliktin e interesit dhe që këto kontrolle i janë komunikuar personelit;
- Inspektoni ndonjë dokumentacion mbështetës për të konstatuar nëse sistemi i pajtueshmërisë ka qene në përputhje me standardet etike gjatë periudhës së shqyrtimit.

Sjellja e Pahijshme/Mosrespektimi

- Kërkoni nga drejtimi nëse ndonjë akuzë për sjellje të pahijshme apo mosrespektim të sistemit të prokurimit është bërë gjatë periudhës nën shqyrtim;
- Për ndonjë shkelje apo mosrespektim me sistemin e prokurimit të identifikuar gjatë çdo pjesë tjetër të procesit të auditimit, kontrolloni nëse kjo ka qene e raportuar dhe është trajtuar në mënyrën e duhur. Gjithashtu konfirmoni nëse autoritetet e duhura janë njoftuar;

- Kërkoni nga drejtimi nëse gjatë periudhës nën shqyrtim të ofertuesve në ndonjë rast ka ndodhur, është kryer ndonjë vepër mashtruese gjatë konkurrimit për te fituar kontratën. Në qoftë se raste të tilla kanë ndodhur, kërkoni nga drejtimi nëse propozime të tilla të ofertuesve janë refuzuar
- Nëse entiteti i audituar është duke përdorur një mekanizëm informimi, inspektoni se si janë raportuar rastet dhe si janë trajtuar në organizatë. Diskutoni dhe inspektoni rezultatet e ndonjë alarmimi me auditimin e brendshëm dhe inspektoni veprimet korrigjuese të ndërmarra në rastet e mosrespektimit;
- Kërkoni nga drejtimi nëse ankesat në lidhje me proceset e prokurimit/informacionet janë pranuar nga palët e interesuara gjatë periudhës nën shqyrtim. Nëse këto ankesa janë pranuar, të përcaktohet se çfarë veprimi është ndërmarre.

Testimi Substancial

- Inspektoni regjistrimet dhe dokumentacionin për të testuar:
 - Emrat dhe adresat e pazakonta të shitësit;
 - Kopjet e dokumenteve (faturat, urdhrat për blerje, etj) të pranuar në vend të origjinalit;
 - Urdhëresat e materialeve në sasi të mjaftueshme tashmë të pranuar;
 - Urdhëresat e materialeve që janë caktuar për shkatërrim për shkak të kohës se gjate të ruajtjes së tyre;
 - Urdhëresat e materialeve jo në përputhje me mandatin dhe operacionet e entitetit;
 - Blerjet nën pragun e limitit të miratuar (në sasi apo vlerë);
 - Ndarja e blerjeve duke përdorur urdhëresat e blerjeve, etj për të shmangur politikën ekzistuese;

- Pagesat për furnitorët jashtë sistemit normal të prokurimit;
- Nënshkrimet nga drejtimi/mbikëqyrësit të dokumenteve të nënshkruara nga vartësit (duke shkelur rutinën normale të kontrollit);
- Furnizuesit që marrin sasi të konsiderueshme të biznesit nga entiteti i sektorit publik;
- Çmimet e pritura të tregut, sidomos kur sasi të mëdha janë blerë;
- Modele të dhënies së kontratës që mund të tregojnë se ofertat janë ndërruar;
- Cilësia e ulët ndaj çmimeve të larta/normat e larta të rënies së produktit;
- Burim i vetëm i prokurimit në ndonjë numër domethënës;
- Përdorimi i tepruar i proceseve të jashtëzakonshme/të shkurtuara/emergjente të prokurimit

Korrigjimet Buxhetore

- Sigurohuni që procesi buxhetor është në përputhje me kërkesat ligjore;
- Sigurohuni për aprovimin e duhur të buxhetit;
- Rishikoni procesin e raportimit mujor - buxhetor dhe atë aktual:
 - Hetoni përjashtimet (mbi- dhe nën shpenzimin), arsyet për një përjashtim të tillë, si dhe veprimet e ndërmarra;
 - Konfirmoni aprovimin e përjashtimeve, ku është e nevojshme.
- Rishikoni ndonjë korrigjim të rëndësishëm buxhetor, lëvizjet e tepruara të fondeve ndërmjet programeve të bëra në, pranë, ose pas në fund të vitit dhe arsyet;
- Rishikoni raportet e performancës për mosrealizim të objektivave të vendosura sipas planit strategjik/ mbi-apo nën shpenzimin domethënës në fund të periudhës;
- Rishikoni të gjitha korrigjimet e bëra në buxhet në, pranë ose pas përfundimit të vitit për aprovimin e duhur dhe në kohë nga parlamenti, nëse kërkohet.

Kostot e Personelit

- Rishikoni raportet e shpenzimeve të udhëtimit që tregojnë për:
 - Përfshirjen e shpenzimeve personale;
 - Deklarimet për akomodim, dieta apo mikpritje të cilat nuk janë në përputhje me rregulloret;
 - Autorizimet nga dikush tjetër dhe jo nga mbikëqyrësi i zakonshëm;
 - Datat e pazakonshme dhe të paarsyeshme, koha apo detaje tjera lidhur me shpenzimet e deklaruara.

- Rishikoni pasqyrën e mungesave që tregojnë për:
 - Autorizimin nga dikush tjetër dhe jo nga mbikëqyrësi i zakonshëm;
 - Pasqyrën e humbur, të pazakontë ose të ndryshuar, sidomos nëse është e përsëritur për të punësuarit e njëjtë;
 - Numri i tepërt apo i pazakontë i orëve jashtë orarit;
 - Përdorimi i kodeve të pazakonta apo jo të duhura kohore të kodeve të klasifikimit të punonjësve.

- Kryerja e testeve substanciale e llogarive të listës së pagave që tregojnë për:
 - Numrin e tepërt ose të paautorizuar të orëve jashtë orarit;
 - Variacione të pazakonshme në lidhje me buxhetin kundrejt shifrave aktuale, apo luhatjeve sezonale;
 - Pagesat e kryera në numrat e pazakonta të llogarive bankare ose llogarive në vende të pazakonta (për shembull më shumë se një pagesë në një periudhë, në të njëjtën llogari bankare mund të tregojë punonjësit fiktive);

- Krahasimi i raportimeve në fundvit për pagat e punonjësve/grupeve të punonjësve të niveleve standarde të kompensimit për kategorinë e duhur të punonjësve.
- Rishikoni procedurat dhe kontrollet e punësimit dhe testoni nëse:
 - Është bërë autorizimi i duhur për pozicione të shpallura si vende të lira pune;
 - Pozicionet janë shpallur në pajtim me rregulloret (konkurse transparente, të hapur, të drejtë, etj);
 - Është ndjekur rutina e duhur gjatë procesit të punësimit (intervista, referencat, kontrolli i mundshëm i historikut, nivelet e përshtatshme të pagave etj);
 - Nëse ka ndonjë tregues të lidhjeve të ngushta personale, paragjykim etj që janë të pranishme dhe që janë trajtuar në mënyrë të duhur;
 - Nëse është pranuar ndonjë ankesë, e cila është trajtuar në mënyrë të duhur në lidhje me procesin e punësimit.

Shtojca 3: Shembuj të Rrethanave në mjedisin e Sektorit Publik për Ekzistencën e Mundshme të Mashtrimit

Më poshtë janë paraqitur shembuj të rrethanave që mund të jenë tregues që pasqyrat financiare mund të përmbajnë anomali materiale të shkaktuar nga mashtrimi.

Mospërputhjet në regjistrimet kontabël:

- Transferimi i konsiderueshëm i transaksioneve midis fondeve dhe/ose programeve.

Proceset e parregullta buxhetore:

- Korrigjime të konsiderueshme në buxhet;
- Kërkesa për fonde shtesë;
- Mos-aprovimi i korrigjimeve buxhetore;
- Vlera të larta të mbi-apo nën shpenzimeve;
- Informacioni i performancës tregon për mosarritje të konsiderueshme.

Proceset e Prokurimit:

- Procedurat ligjore;
- Mungesa e legjislacionit të prokurimit;
- Ndryshimet e fundit në legjislacionin e prokurimit;
- Legjislacioni i komplikuar ose i paqartë;
- Shuma të konsiderueshme monetare të përfshira (si në fushën e mbrojtjes);
- Inspektimi nga autoritetet rregullatore;

- Ankesat e pranuar nga furnizuesit e mundshëm rreth praktikave të padrejta që lidhen me dhënien e tenderave;
- Ish-zyrtarët e qeverisë operojnë si drejtues të kompanive, të cilëve iu janë dhënë tenderat.

Grantet dhe Financimi nga donatorët:

- Papajtueshmëri me kërkesat e granteve;
- Kërkesat e paqarta të granteve;
- Mos dhënia e granteve marrësit të synuar fillimisht;
- Ankesat nga marrësit potenciale apo grupet e interesit.

Aktivi:

- Përdorimi i paautorizuar i aktiveve;
- Pajisjet që janë objekt i përdorimit personal apo përdorimit jo-programor, siç janë telefonat celular, kamerat digjitale, kompjuterët, automjetet, mjetet etj;
- Asetet fizike të prekshme për përdorim personal, siç janë ndërtesat e papërdorshme ose ndërtesat jashtë vendbanimit, toka vakante, pajisje të vjetëruara, aktivet e braktisur etj;
- Humbja e materialeve të përdorura në proceset konfidenciale të qeverisjes siç janë dokumentet e identifikimit dhe pasaportat.

ISSAI 1250

Udhëzues i Auditimit Financiar

*MBAJTJA PARASYSH E LIGJEVE
DHE E RREGULLOREVE NË NJË
AUDITIM TË PASQYRAVE
FINANCIARE*

Shënim Praktik për Standardin Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 250

PËRMBAJTJA

SHËNIMI PRAKTIK PËR ISA⁹⁰⁾ 25 0 Paragrafi

Historiku

Hyrje në (ISA)

Përmbajtja e Shënimit Praktik P1

Zbatueshmëria e (ISA) në Auditimin e Sektorit Publik P2

Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik..... P3

Konsideratat e Përgjithshme P4-P7

Vlerësimi i Audituesit për Pajtueshmërinë me Ligjet dhe Rregulloret P8

Raportimi i Papajtueshmërisë së Identifikuar ose të Dyshtuar P9-P10

90) Të gjitha shënimet praktike konsiderohen së bashku me ISSAI 1000 "Hyrje e Përgjithshme në ONISA Udhëzime të Auditimit Financiar.

Mbajtja Parasysh e Ligjeve dhe e Rregulloreve në një auditim të Pasqyrave Financiare

Historiku

Ky Shënim Praktik ofron udhëzim shtesë mbi ISA 250 - Mbajtja Parasysh e Ligjeve dhe e Rregulloreve në një auditim të Pasqyrave Financiare. Duhet të lexohet i lidhur ngushtë me ISA. ISA 250 ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 dhjetor 2009 e më pas. Shënimi Praktik ka hyrë në fuqi në të njëjtën datë si dhe ISA.

Hyrje në ISA

ISA 250 trajton përgjegjësitë e audituesit për mbajtjen parasysh të ligjeve dhe rregullave në një auditim të pasqyrave financiare. Ky ISA nuk zbatohet për angazhimet tjera të sigurisë në të cilat audituesi angazhohet në mënyrë specifike për verifikimin dhe raportimin në lidhje me pajtueshmërinë me ligjet ose rregullat e veçanta.

Përmbajtja e Shënimit Praktik

P1. Shënimi Praktik ofron udhëzim shtesë për audituesit e sektorit publik lidhur me:

- a) Konsideratat e Përgjithshme.
- b) Vlerësimi i Audituesit për Pajtueshmërinë me Ligjet dhe Rregulloret.
- c) Raportimi i Papajtueshmërisë së Identifikuar ose të Dyshuar.

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik

P2. ISA 250 është i zbatueshëm për audituesit e entiteteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të pasqyrave financiare.

Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

P3. ISA 250 në paragrafët A6 dhe A20 përmban zbatimin dhe materialet e tjera shpjeguese me konsiderata të veçanta për entitetet e sektorit publik.

Reagimet e Përgjithshme

P4. Objektivat e një auditimi financiar në sektorin publik janë shpesh më të gjera se sa shprehja e një opinioni nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me Kornizën e zbatueshme të raportimit financiar (p.sh. fushëveprimi i ISA) siç u përmend në paragrafin A6 të ISA. Mandati i auditimit, apo detyrimet për entitetet e sektorit publik, që rrjedhin nga legjislacioni, rregullorja, udhëzimi ekzekutiv, kërkesat e politikave qeveritare, apo rezolutave të legjislaturës mund të rezultojë në objektiva të tjera. Këto objektiva shtesë mund të përfshijnë përgjegjësitë e auditimit dhe raportimit që ndërlidhen me raportimin nëse audituesit e sektorit publik gjetën papajtueshmëri me autoritetet përfshirë këtu buxhetin dhe llogaridhënien. Megjithatë, edhe aty ku nuk ka objektiva të tilla shtesë, mund të ketë pritje të përgjithshme publike në lidhje me raportimin e audituesve të sektorit publik për mospërputhje me autoritetet. Prandaj, audituesit e sektorit publik i kanë parasysh pritjet e tilla dhe janë vigjilentë për rastet e papajtueshmërisë.

P5. Në sektorin publik, vlerësimi i pajtueshmërisë me ligje dhe rregullore shpeshherë përfshin fushëveprim më të gjerë se sa është përcaktuar në ISA. Ky fushëveprim më i gjerë mund, për shembull, të përfshijë përgjegjësinë shtesë për të shprehur një opinion të veçantë në lidhje me pajtueshmërinë e entitetit me ligjet dhe rregulloret. Këto përgjegjësi

shtesë, lidhur me objektivat e auditimit dhe raportimit, trajtohen në udhëzimet e Auditimit të Pajtushmërisë në ONISA (ISSAI 4000⁹¹⁾ dhe 4200⁹²⁾). Audituesit e sektorit publik me përgjegjësi tilla shtesë marrin parasysh (ISSAI) 4000 dhe 4200.

P6. Siç është përmendur në paragrafin 2 të ISA, efekti në pasqyrat financiare i ligjeve dhe rregulloreve ndryshon shumë. Në sektorin publik mund, për shembull, të ketë ligje dhe rregullore të veçanta se si bëhet shpërndarja e granteve dhe subvencioneve nga një agjenci që do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në pasqyrat financiare. Korniza e raportimit financiar shpesh mund të përfshijë po ashtu edhe informacion të tillë si, raportin e buxhetit, raportin e ndarjes buxhetore, apo raportin e performancës. Kur korniza e raportimit financiar përfshin informacion të tillë, audituesit e sektorit publik mund të kenë nevojë të marrin në konsideratë ligjet dhe rregulloret e veçanta që mund të kenë një efekt të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në një informacion të tillë.

P7. Kur audituesit e sektorit publik kanë një mandat më të gjerë siç u përmend në paragrafin A6 të ISA dhe në paragrafin P4 më lartë, audituesit e sektorit publik kujdesen për të siguruar se ku çështjet të lidhura me përgjegjësi të tilla shtesë vërehen nga ana e tyre. Këto gjetje konsiderohen në bazë të kornizës së ISA-së për të vlerësuar ndikimin e tyre potencial në pasqyrat financiare dhe pastaj në raportin e audituesit.

Vlerësimi i Audituesit për Pajtushmërinë me Ligjet dhe Rregulloret

P8. Kur të merren parasysh kërkesat në paragrafin 15 të ISA, audituesit e sektorit publik gjithashtu mund të marrin parasysh rezultatet që lidhen me papajtushmërisë me ligjet dhe rregulloret nga llojet e tjera të aktiviteteve të auditimit të ndërmarra nga organizata të auditimit të sektorit publik siç janë auditimet e performancës.

91) ISSAI 4000, – Hyrje e Përgjithshme në Udhëzimet e Auditimit të Pajtushmërisë.

92) ISSAI 4200, – Udhëzimet e Auditimit të Pajtushmërisë Lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare.

Raportimi i Papajtueshmërisë së Identifikuar ose të Dyshuar

P9. Përveç kërkesës për të raportuar për ata të ngarkuar me qeverisje siç thuhet në paragrafin 22 të ISA, disa auditues të sektorit publik komunikojnë të gjitha rastet e identifikuara të papajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret, madje edhe ato që janë në mënyrë të qartë të parëndësishme. Disa organizata të auditimit të sektorit publik në bazë të mandatit të auditimit mund të urdhërojnë entitetin të bëjë korrigjimin e ndonjë rasti të papajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret. Në raste të tilla, sidomos kur ekziston një element i subjektivitetit në interpretimin e ligjeve dhe rregulloreve, audituesit e sektorit publik kanë parasysh nëse ushtrimi i këtij autoriteti mund të dëmtojë pavarësinë e tyre dhe nëse është kështu, të marrë masat e duhura për të shmangur një dëmtim të tillë.

P10. Kur të merren për bazë kërkesat në paragrafin 28 të ISA, audituesit e sektorit publik mund gjithashtu të përcaktojnë nëse për përgjegjësitë tilla përfshihet të raportohet ndarazi tek legjislativi dhe/ose autoritetet e tjera përkatëse siç janë prokurorët, policia dhe (nëse është relevante me ligjin) tek palët e treta të prekura.

ISSAI 1260

Udhëzues i Auditimit Financiar

*KOMUNIKIMI ME PERSONAT E
NGARKUAR ME QEVERISJEN*

Shënim Praktik për Standardin Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 260

PËRMBAJTJA

SHËNIMI PRAKTIK PËR ISA⁹³⁾ 260	Paragrafi
Historiku	
Hyrje në (ISA)	
Përmbajtja e Shënimit Praktik	P1
Zbatueshmëria e (ISA) në Auditimin e Sektorit Publik	P2
Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik	
Konsideratat e Përgjithshme	P3
Personat e Ngarkuar me Qeverisjen	P4-P5
Çështje për tu Komunikuar	P6-P9
Procesi i Komunikimit	P10

93)Të gjitha shënimet praktike konsiderohen së bashku me ISSAI 1000 "Hyrje e Përgjithshme në ONISA Udhëzime të Auditimit Financiar.

Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen

Historiku

Ky Shënim Praktik ofron udhëzim shtesë mbi ISA 260 - Komunikimi me personat e ngarkuar me Qeverisjen. Ky shënim duhet të lexohet i lidhur ngushtë me ISA. ISA 260 ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 dhjetor 2009 e më pas. Shënimi Praktik ka hyrë në fuqi në të njëjtën datë si dhe ISA.

Hyrje në ISA

ISA 260 trajton përgjegjësitë e audituesit për të komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen gjatë një auditimi të pasqyrave financiare. Megjithëse ky ISA aplikohet pavarësisht nga struktura apo madhësia e qeverisjes së entitetit, konsiderata të veçanta zbatohen në ato raste kur të gjithë personat e ngarkuar me qeverisjen përfshihen në drejtimin e një entiteti, si dhe për entitetet e listuara. Ky ISA nuk vendos kërkesa në lidhje me komunikimin e audituesit me drejtuesit e entiteteve apo me pronarët, me përjashtim të rasteve kur ata kanë rol të qeverisjes.

Duke pranuar rëndësinë që ka në një auditim të pasqyrave financiare, një komunikim efektiv dypalësh, ky standard jep një kuadër bazë për komunikimin e audituesit me personat e ngarkuar me qeverisjen dhe identifikon disa çështje specifike që duhet të komunikohen me ta. Çështjet e tjera që duhen të komunikohen, të cilat plotësojnë kërkesat e ISA 260 janë identifikuar në ISA-të tjera (shiko shtojcën të ISA). Më tutje, ISA 265⁹⁴⁾ përcakton kërkesat specifike për komunikim me personat e ngarkuar me qeverisjen për mangësitë e konsiderueshme në kontrollin e brendshëm, të cilat audituesi i ka identifikuar gjatë auditimit. Çështje të tjera, që nuk kërkohen nga ky standard apo ISA-të

94) ISA 265, Komunikimi i mangësive në Kontrollin e Brendshëm të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen dhe Drejtimin

tjera, mund të kërkohen të komunikohen nga ligjet apo rregullat, nga një marrëveshje me entitetin ose nga kërkesat shtesë që aplikohen për angazhimin p.sh, nga standardet e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Ky standard nuk i pengon audituesit që tu komunikojë personave të ngarkuar me qeverisjen e entitetit dhe çështje të tjera.

Përmbajtja e Shënimit Praktik

P1. Shënimi Praktik ndjek titujt e ISA dhe ofron udhëzim shtesë për audituesit e sektorit publik lidhur me:

- a)Konsideratat e Përgjithshme.
- b) Personat e Ngarkuar me Qeverisjen.
- c) Çështje për tu Komunikuar.
- d) Procesi i Komunikimit.

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik

P2. ISA 260 është i zbatueshëm për audituesit e entiteteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të pasqyrave financiare.

Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

Konsideratat e Përgjithshme

P3. Objektivat e një auditimi financiar në sektorin publik janë shpesh më të gjera se sa shprehja e një opinionit nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar (p.sh. fushëveprimi i ISA). Mandati i auditimit, apo detyrimet për entitetet e sektorit publik, që rrjedhin nga legjislacioni, rregullorja, udhëzimi ekzekutiv, kërkesat e politikave qeveritare, apo rezolutave të legjislaturës mund të rezultojë në objektiva të tjera. Këto objektiva shtesë mund të përfshijnë përgjegjësitë e auditimit dhe raportimit që ndërlidhen me raportimin nëse audituesit e sektorit publik gjejnë papajtueshmëri me autoritetet, përfshirë këtu buxhetin dhe kuadret e llogaridhënies, dhe/ose raportimin në lidhje me efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Në paragrafin 3, të ISA 260 përmendet që personave të ngarkuar me qeverisjen mund të kërkohen, tu komunikohen çështjet shtesë si rezultat i ligjeve apo rregullave, nga një marrëveshje me entitetin ose nga kërkesat shtesë që aplikohen për angazhimin.

Personat e Ngarkuar me Qeverisjen

P4. Paragrafi 11 i ISA kërkon nga audituesi të përcaktojë personin e përshtatshëm brenda strukturës qeverisëse të entitetit, me të cilët ai duhet të komunikojë. Në sektorin publik, përgjegjësitë e qeverisjes mund të ekzistojnë në disa nivele organizative si dhe tek disa funksione (p.sh. vertikalisht apo horizontalisht). Si rezultat, mund të ketë raste ku ka disa grupe të ndara, të cilat identifikohen si të ngarkuar me qeverisjen. Për më tepër, një auditim në sektorin publik mund të përfshijë të dyja, objektivat e pasqyrave financiare si dhe objektivat e pajtueshmërisë dhe në disa raste mund të përfshijë organe të veçanta të qeverisjes.

P5. Në situatat kur çështjet u komunikohen nëngrupeve të atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen, siç theksohet në paragrafin 12 të ISA, audituesit

e sektorit publik mund të kenë nevojë të përcjellin informacionin organit qeverisës, në mënyrë të plotë ose në mënyrë përmbledhëse. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në sektorin publik, ku nuk është e pazakontë për të ngarkuarit me qeverisjen të jenë të përfshirë në drejtimin e entitetit. Audituesit e sektorit publik duhet të jenë veçanërisht të ndjeshëm për të përmbushur nevojat dhe pritjet e legjislaturës ose të rregullatorëve të përshtatshëm në lidhje me çështjet e komunikuara në nivele të tjera të qeverisjes, veçanërisht kur çështjet mund të jetë me interes të gjerë publik apo me spekulime.

Çështje për tu Komunikuar

- P6. Paragrafi 15 i ISA kërkon nga audituesi të komunikojë me personat e ngarkuar me qeverisjen një përmbledhje të fushëveprimit të planifikuar dhe afatin e auditimit. Në sektorin publik, kjo kërkesë mund të arrihet me mjete të ndryshme. Për shembull, fushëveprimi dhe afati i auditimit mund të përcaktohet në legjislacionin përkatës ose në mandatin e auditimit, apo audituesit e sektorit publik mund të komunikojnë një përmbledhje të fushëveprimit të planifikuar dhe afatin e auditimit në letrën e angazhimit.
- P7. Në paragrafin A11 (b) të ISA përmendet që komunikimi në lidhje me fushëveprimin dhe afatin e planifikuar të auditimit mund të ndihmojë audituesin për të kuptuar më mirë entitetin dhe mjedisin e tij. Audituesit e sektorit publik mund të shohin të dobishme të komunikojnë sipas këndvështrimit të tyre se cilat komponentë të informacioneve financiare duhet të përfshihen në pasqyrat financiare të entitetit dhe të përdorin përgjigjet e entitetit për të verifikuar të kuptuarit e tyre. Për shembull, mund të jetë e vështirë për të përcaktuar nëse, dhe deri në çfarë mase, sipërmarrjet e përbashkëta (përfshirë entitetet e sektorit privat dhe publik) duhet të përfshihen në pasqyrat financiare të konsoliduara të njësisë ekonomike të një entiteti të audituar.
- P8. Paragrafi 16 i ISA liston gjetjet e rëndësishme nga auditimi dhe nga audituesi kërkohet t'i komunikojë ato tek personat e ngarkuar me qeverisjen. Audituesit e sektorit publik shpesh janë të mandatuar për të

audituar Qeverinë si tërësi apo pjesët e qeverisë dhe administratës së saj. Në këtë situatë, audituesit e sektorit publik mund të kenë qasje në informata nga entitete të tjera dhe auditimet e tyre, çka mund të jenë me rëndësi për personat e ngarkuar me qeverisjen. Shembuj të tillë mund të përfshijnë gabime materiale tek transaksionet e entitetit të audituar i cili ka ndikim edhe te entitetet tjera, apo modelet e kontroleve përkatëse të cilat kanë dhënë rritje të efikasitetit tek entitetet tjera. Komunikimi i këtij lloji të informacionit për personat e ngarkuar me qeverisjen mund të shtojë vlerën e auditimit kur lejojnë rrethanat. Megjithatë, ligjet, rregulloret apo kërkesat etike mund të ndalojnë komunikimin e këtij lloji informacioni.

P9. Pavarësia e Audituesit të sektorit publik dhe objektiviteti janë vendimtare për aftësinë e tyre (a) për të mbajtur qeverinë llogaridhënëse ndaj legjislacionit dhe publikut, dhe (b) të ndihmojë në identifikimin e kërcënimeve për miradministrimin e fondeve publike, siç është korrupsioni. Kërkesa në lidhje me entitetet e listuara, përmbajtja në paragrafin 17 të ISA për të komunikuar pajtueshmërinë me kërkesat përkatëse etike lidhur me pavarësinë mund të aplikohet edhe për audituesit e sektorit publik, sepse është në interes të publikut. Përveç çështjeve të Kodit të etikës për Kontabilistët Profesionistë të lëshuar nga ana e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC), çështjeve në Kodin e Etikës të INTOSAI-t, siç është neutraliteti politik, mund të jenë të një rëndësie të veçantë në kontekstin e sektorit publik.

Procesi i Komunikimit

P10. Paragrafi 22 i ISA kërkon që audituesi të vlerësojë nëse komunikimi dypalësh midis audituesit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen ka qenë i mjaftueshëm për qëllime të auditimit. Nëse komunikimi dypalësh nuk është i përshtatshëm, ISA kërkon nga audituesi të ndërmarre masat e duhura. Në sektorin publik, veprim i duhur mund të përfshijë të komunikuarit me legjislativin, rregullatorët e duhur, apo agjencitë financuese.

ISSAI 1265

Udhëzues i Auditimit Financiar

*KOMUNIKIMI I MANGËSIVE NË
KONTROLLIN E BRENDSHËM
PERSONAVE TË NGARKUAR ME
QEVERISJEN DHE DREJTIMIN*

PËRMBAJTJA

SHËNIMI PRAKTIK PËR ISA 265⁹⁵⁾

Paragrafi

Historiku

Hyrje në (ISA)

Përmbajtja e Shënimit Praktik	P1
Zbatueshmëria e (ISA) në Auditimin e Sektorit Publik	P2
Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik.....	P3
Kërkesat	P4
Identifikimi i Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në Sektorin Publik .	P5
Përcaktimi Nëse janë Identifikuar Mangësitë në Kontrollin e Brendshëm.	P6

95) Të gjitha shënimet praktike konsiderohen së bashku me (ISSAI) 1000 "Hyrje e Përgjithshme në ONISA Udhëzime të Auditimit Financiar

Komunikimi i Mangësive në Kontrollin e Brendshëm Personave të Ngarkuar me Qeverisjen Dhe Drejtimin

Historiku

Ky Shënim Praktik ofron udhëzime shtesë mbi ISA 265 - Komunikimi i Mangësive në Kontrollin e Brendshëm Personave të Ngarkuar me Qeverisjen Dhe Drejtimin. Duhet të lexohet i lidhur ngushtë me ISA. ISA 265 ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 dhjetor 2009 e më pas. Shënimi Praktik ka hyrë në fuqi në të njëjtën datë si dhe ISA.

Hyrje në ISA

ISA 265 trajton përgjegjësinë e audituesit për të komunikuar në mënyrën e duhur me personat e ngarkuar me qeverisjen dhe drejtimin lidhur me mangësitë në kontrollin e brendshëm që audituesi ka identifikuar gjatë një auditimi të pasqyrave financiare. ISA 265 nuk vendos përgjegjësi të reja mbi audituesin për të kuptuar kontrollin e brendshëm dhe për të ndërtuar e kryer teste të kontrolleve shumë më tepër nga ç'kërkohet nga ISA315⁹⁶⁾ dhe ISA 330⁹⁷⁾. ISA260⁹⁸⁾ përcakton kërkesa të mëtejshme dhe jep udhëzime lidhur me përgjegjësinë e audituesit për të komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen në lidhje me auditimin.

Përmbajtja e Shënimit Praktik

P1. Shënimi Praktik ofron udhëzime shtesë për audituesit e sektorit publik lidhur me:

- a) Kërkesat.
- b) Identifikimi i Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në Sektorin Publik.
- c) Përcaktimi Nëse janë Identifikuar Mangësitë në Kontrollin e Brendshëm.

96) ISA 315, – Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale Nëpërmjet Njohjes të Entitetit dhe Mjedisit të tij, paragrafi 4 dhe 12.

97) ISA 330, – Reagimet e Audituesit ndaj Rreziqeve të Vlerësuar.

98) ISA 260, – Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik

P2. ISA 265 është i zbatueshëm për audituesit e entiteteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të pasqyrave financiare.

Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

P3. ISA 265 në paragrafët A27 të ISA përmban zbatimin dhe materiale të tjera shpjeguese me konsiderata të veçanta për entitetet e sektorit publik.

Kërkesat

P4. Siç është cekur në paragrafin A27 të ISA, audituesit e sektorit publik mund të kenë përgjegjësi shtesë për komunikimin e mangësive në kontrollin e brendshëm. Përgjegjësi të tilla mund të përfshijnë raportimin tek të tjerët, si tek legjislativi, si dhe komunikimin e çështjeve krahas kërkesave në paragrafët 9 dhe 10 të ISA.

Identifikimi i Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në Sektorin Publik

P5. Kur të merren parasysh kërkesat në paragrafin 9 të ISA, audituesit e sektorit publik konsiderojnë se identifikimi i personave të ngarkuar me e qeverisjen në sektorin publik nuk mund të jetë aq hapur si në sektorin privat. ISSAI 1260 ofron udhëzime për audituesit e sektorit publik në lidhje me identifikimin e personave të ngarkuar me qeverisjen në entitetet e sektorit publik.

Përcaktimi Nëse janë Identifikuar Mangësitë në Kontrollin e Brendshëm

P6. Gjatë përcaktimit nëse janë identifikuar mangësitë në kontrollin e brendshëm, audituesit e sektorit publik mund të kenë nevojë për të identifikuar ndonjë legjislacion përkatës lidhur me kontrollin e brendshëm dhe kërkesat përkatëse të legjislacionit për entitetin e sektorit publik.

ISSAI 1300

Udhëzues i Auditimit Financiar

*PLANIFIKIMI I AUDITIMIT TË
PASQYRAVE FINANCIARE*

Shënim Praktik për Standardin Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 300

PËRMBAJTJA

SHËNIMI PRAKTIK PËR ISA 300⁹⁹⁾	Paragrafi
Historiku	
Hyrje në ISA	
Përmbajtja e Shënimit Praktik	P1
Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publi	P2.
Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik	
Konsideratat e përgjithshme	P3
Roli dhe Koha e planifikimit	P4 - P5
Aktivitetet Paraprake të Angazhimit.....	P6.
Aktivitetet e Planifikimit	P7
Konsiderata Specifike për entiteteve më të vogla.....	P8
Dokumentimi	P9
Konsideratat Shtesë në Angazhimet e Auditimit Fillesta	P10
Konsideratat Specifike për Audituesit e Sektorit Publik në Rolin e tyre Ligjo	P11-P12

⁹⁹⁾Të gjitha shënimet praktike konsiderohen së bashku me ISSAI 1000 "Hyrje e Përgjithshme në ONISA Udhëzime të Auditimit Financiar.

Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare

Hyrje

Ky Shënim Praktik ofron udhëzime shtesë për ISA 300 - Planifikimi i Auditimit të Pasqyrave Financiare. Ky lexohet së bashku me ISA. ISA 300 ka hyrë në fuqi për auditimin e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar 15 dhjetor 2009 ose më pas. Shënimi Praktik ka hyrë në fuqi në të njëjtën datë sikurse edhe ISA.

Hyrje në ISA

Standardi 300 trajton përgjegjësinë e Audituesit për planifikimin e auditimit të pasqyrave financiare. Ai është hartuar në kontekstin e auditimeve të njëpasnjëshme. Konsideratat shtesë për angazhime fillestare të auditimit janë veçmas të identifikuara.

Përmbajtja e Shënimit Praktik

P1. Ky Shënim Praktik ofron udhëzim shtesë për Audituesit e sektorit publik lidhur me:

- a) Konsideratat e përgjithshme
- b) Roli dhe Koha e planifikimit
- c) Aktivitetet Paraprake të Angazhimit
- d) Aktivitetet e Planifikimit
- e) Konsiderata specifike për entitete më të vogla
- f) Dokumentimi
- g) Konsideratat Shtesë në Angazhimet e Auditimit Fillestar
- h) Konsideratat Specifike për Audituesit e Sektorit Publik në Rolin e tyre Ligjor

Zbatueshmëria e SNA(ISA) në Auditimin e Sektorit Publik

P2. ISA 300 është e zbatueshme për Audituesit e entiteteve të sektorit publik në rolin e tyre si Auditues të pasqyrave financiare.

Udhëzime shitesë për Çështjet e Sektorit Publik

Konsideratat e përgjithshme

P3. Objektivat e një auditimi financiar në sektorin publik janë shpesh më të gjera se sa shprehja e një opinioni nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar (p.sh. fushëveprimi i ISA-ve). Mandati i auditimit ose obligimet për entitetet e sektorit publik që dalin nga legjislacioni, rregulloret, direktivat ministrore, kërkesat e politikave qeveritare, ose rezolutave të legjislaturës, mund të rezultojnë në objektiva shitesë. Këto objektiva shitesë mund të përfshijnë përgjegjësitë e auditimit dhe të raportimit, p.sh. në lidhje me raportimin nëse Audituesit e sektorit publik gjejnë ndonjë rast të mos pajtueshmërisë me autoritetet, përfshirë buxhetin dhe kornizën e llogaridhënies, dhe/ose raportimin për efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Megjithatë, edhe aty ku nuk ka objektiva të tilla shitesë, mund të ketë pritshmëri të përgjithshme nga publiku në lidhje me raportimin e audituesve të sektorit publik për mos pajtueshmërinë me autoritetet ose raportimin e efektivitetit të kontrollit të brendshëm. Prandaj, audituesit e sektorit publik i kujtojnë pritshmëritë tilla dhe janë vigjilent për fushat që mund të shkaktojnë rreziqe të mos pajtueshmërisë me autoritetet ose rreziqe në lidhje me efektivitetin e kontrollit të brendshëm gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit.

Roli dhe koha e planifikimit

P4. Paragrafi 2 në ISA trajton përfitimet nga planifikimi adekuat. Aplikimi dhe materialet e tjera shpjeguese në paragrafët A1-A3 të ISA ofrojnë udhëzim për rolin dhe afatet kohore të planifikimit. Në mjedisin e sektorit publik, konsideratat shitesë të planifikimit mund të përfshijnë:

- Marrjen e njohurive për kornizën ligjore dhe rregullative, e cila aplikohet

në entitet për shkak të objektivave më të gjëra të auditimit;

- Implikimet në auditimin e pasqyrave financiare nga njohuritë e marra nga auditimet e performancës dhe aktivitetet e tjera relevante për entitetin, përfshirë edhe implikimet e rekomandimeve të mëparshme;
- Implikimet në auditimin e pasqyrave financiare nga njohuritë e marra nga aktivitetet e planifikimit lidhur me departamentin dhe ministrinë relevante dhe;
- Pritshmëritë e legjislativit dhe përdoruesve të tjerë të raportit të Audituesit.

P5. Në Paragrafin A3 të ISA thuhet se Audituesi mund të vendosë të diskutojë me Drejtuesit e entitetit elemente të planifikimit për të lehtësuar kryerjen dhe menaxhimin e angazhimit të auditimit. Ligjet, rregulloret, ose mandati i auditimit mund ta kufizojnë audituesin rreth asaj se çfare mund të diskutojë ai për strategjinë dhe planin e auditimit. Audituesit e sektorit publik familjarizohen me ligje, rregullore ose mandate auditimi të tilla.

Aktivitetet paraprake të angazhimit

P6. Paragrafi 6 i ISA-së përcakton aktivitetet të cilët duhet të ndërmerren në fillim të angazhimit të auditimit. Ato janë kryerja e procedurave të kërkuara nga ISA 220, që kanë të bëjnë me vazhdimësinë e marrëdhënieve me klientin dhe angazhimit specifik të auditimit, vlerësimi i pajtueshmërinë me kërkesat etike, duke përfshirë pavarësinë, në pajtim me ISA 220, dhe njohja e kushteve të angazhimit siç kërkohen nga ISA 210. Procesi i vazhdimësisë për Audituesit e sektorit publik ndikohet nga fakti se ata nuk mund të kenë alternativën që të tërhiqen nga një angazhim. Nëse informacionet bëhen të disponueshme për Audituesit e sektorit publik që normalisht do të rezultonin në refuzimin ose ndërprerjen e angazhimit, Audituesit e sektorit publik i marrin parasysh këto informacione gjatë kryerjes së aktiviteteve të mëtejshme të planifikimit dhe vlerësimit të rrezikut. Audituesit e sektorit publik mund të kenë gjithashtu përgjegjësi ligjore për raportimin e çështjeve të tilla. Ata mund të konsultohen me avokatin ligjor në këtë drejtim.

Aktivitetet e planifikimit

P7. Paragrafi 8 në ISA përshkruan procedurat që duhet të kryhen në hartimin e strategjisë së përgjithshme të auditimit. Gjatë identifikimit të karakteristikave të angazhimit që përcaktojnë fushëveprimin e saj (si në Paragrafin. 8 (a) të ISA), Audituesit e sektorit publik marrin në konsideratë karakteristika shtesë. Shembuj të karakteristikave të tilla mund të përfshijnë:

- Përgjegjësitë shtesë të raportimit mbi entitetin e themeluar nga legjislativi që mund të ndikojë në fushëveprimin dhe afatet kohore të auditimit, dhe në natyrën e komunikimit. Shembuj të tillë të kërkesave shtesë mund të përfshijë kërkesën që entiteti të raportojë për financimin nga qeveria, duke përfshirë edhe grandet;
- Përgjegjësitë shtesë të raportimit për Audituesit e sektorit publik si rezultat i mandatit të auditimit ose kërkesa të tjera që mund të ndikojnë në fushëveprimin dhe afatet kohore të auditimit, dhe në natyrën e komunikimit. Shembuj të kërkesave të tilla shtesë për Audituesit e sektorit publik mund të përfshijnë rastet e raportimit të mospajtimit me autoritetet duke përfshirë buxhetet dhe kornizat e përgjegjësiave, ose raportimin mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.

Konsiderata specifike për entitete më të vogla

P8. Paragrafët A11, A15 dhe A19 të ISA-së përmbajnë udhëzime të cilat janë specifike për entitete më të vogla. Auditimet e entiteteve më të vogla të sektorit publik normalisht nuk kryhen nga një individ i vetëm. Për më tepër, për shkak të strukturës raportuese të entiteteve qeveritare, koncepti pronar - menaxher normalisht nuk ekziston. Në sektorin publik, strukturat e kontrollit të subjekteve të vogla janë shpesh pjesë e strukturës së kontrollit të një organi më të madh qeveritar. Prandaj, supozimi i aktiviteteve të kontrolleve të pakta siç përshkruhet në paragrafin A19 të ISA-së nuk është shpesh i përshtatshëm në sektorin publik. Audituesit mund të përfshijnë aspekte të tjera të kontrollit të organit më të madh qeveritar në planet e tyre të auditimit në sektorin publik.

Dokumentimi

P9. Paragrafi 12 i ISA-së kërkon nga Audituesi që të dokumentojë strategjinë e përgjithshme të auditimit dhe planin e auditimit, si dhe të gjitha ndryshimet e rëndësishme në ato dokumente të cilat janë bërë gjatë auditimit dhe arsyet për këto ndryshime. Në sektorin publik, dokumentimi i auditimit mund të jetë subjekt i qasjes nga pala e tretë. Si rezultat, Audituesit e sektorit publik familjarizohen me legjislacionin dhe i përcaktojnë implikimet për dokumentimin e auditimit të tyre.

Konsideratat shtesë në angazhimet e auditimit fillestar

10. Paragrafi 13 i ISA-së, plotësuar me anë të zbatimit dhe me materiale të tjera shpjeguese në Paragrafin A20 të ISA-së, kërkon që Audituesi të ndërmarrë veprime të caktuara para fillimit të auditimit fillestar. Në sektorin publik, normalisht angazhimet e auditimit nuk nisen në të njëjtën mënyrë si në sektorin privat. Audituesit e sektorit publik mund të përzgjidhen nëpërmjet një procesi konkurrimi ose të përcaktohen me statut. Megjithatë, udhëzimi të cilin e përmbajnë Paragrafët 13 dhe A20 të ISA-së është relevant për Audituesit e sektorit publik kur ekzistojnë rrethanat e përshkruara.

Konsiderata specifike për Audituesit e sektorit publik në rolin ligjor

P11. Në disa mjedise të sektorit publik, siç është ambient i Gjykatës së Llogarive, shpesh jepet një gjykim për raportin e audituesve i cili përdoret edhe për të përcaktuar implikimet personale ligjore të atyre që janë përgjegjës për aktet financiare, përfshirë edhe çështje të rëndësishme, mungesën e kontrollit dhe raste të mos pajtueshmërisë me autoritetet. Prandaj Audituesit e sektorit publik në mjedise të tilla mund të planifikojnë dhe kryejnë procedura për të përmbushur kërkesat ligjore dhe për të identifikuar ata që janë përgjegjës për aktet financiare.

P12. Audituesit e sektorit publik në këto ambiente që trajtohen në paragrafin P11 (më sipër) mund të punojnë ngushtë me prokurorët dhe policinë kur kanë të bëjnë me mashtrim financiar. Prandaj, në sektorin publik, Audituesit në mjedise të tilla mund të marrin informacione nga prokurorët dhe policia në kohën e duhur.

ISSAI 1315

Udhëzues i Auditimit Financiar

*IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I
RREZIQEVE TË ANOMALIVE
MATERIAL PËRMES NJOHJES SË
ENTITETIT DHE MJEDISIT TË TIJ*

Shënim Praktik për Standardin Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 315

PËRMBAJTJA

SHËNIMI PRAKTIK PËR ISA 315¹⁰⁰⁾ Paragrafi

Historiku

Hyrje në ISA

Përmbajtja e Shënimit Praktik P1

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik P2

Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik..... P3

Reagimet e përgjithshme P4

Procedurat e vlerësimit të rrezikut dhe aktivitetet
e ndërlidhura P5-P11

Nevoja për njohjen e ambientit të entitetit, duke përfshirë edhe Kontrollin e
Brendshëm të tij P12-P16

Identifikimi dhe Vlerësimi i rreziqeve
të anomalive materiale P17-P18

**Shtojca: Shembuj shtesë të kushteve dhe ngjarjeve që mundë të tregojnë
rreziqe të anomalive materiale**

100) Të gjitha shënimet praktike konsiderohen së bashku me ISSAI 1000 — Hyrje e Përgjithshme në ONISA Udhëzime të Auditimit Financiar

Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të anomalive materiale përmes njohjes së entitetit dhe mjedisit të tij

Historiku

Ky Shënim Praktik i ofron audituesve të sektorit publik udhëzime shtesë për ISA 315 -Identifikimi dhe Vlerësimi i rreziqeve të anomalive materiale përmes njohjes së entitetit dhe mjedisit të tij. Ky shënim lexohet së bashku me ISA. ISA 315 ka hyrë në fuqi për auditimin e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar 15 dhjetor 2009 ose më pas. Shënimi Praktik ka hyrë në fuqi në të njëjtën datë sikurse edhe ISA.

Hyrje në ISA

ISA 315 trajton përgjegjësinë e audituesit për të identifikuar dhe vlerësuar rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare përmes njohjes së entitetit dhe mjedisit të tij, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të entitetit.

Përmbajtja e Shënimit Praktik

P1. Ky Shënim Praktik ofron udhëzim shtesë për auditorët e sektorit publik lidhur me:

- a) Konsideratat e përgjithshme
- b) Procedurat e vlerësimit të rrezikut dhe aktivitetet e ndërlidhura
- c) Nevojën për njohjen e mjedisit të entitetit, duke përfshirë edhe Kontrollin e Brendshëm të tij
- d) Identifikimin dhe Vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik

P2. ISA 315 është i aplikueshëm për audituesit e entiteteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të pasqyrave financiare.

Udhëzime shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

P3. ISA 315 përmban zbatimin dhe materialet tjera shpjeguese me konsiderata të veçanta për entitetet e sektorit publik në paragrafët A21, A35, A65 dhe A113 të ISA-së.

Konsideratat e përgjithshme

P4. Objektivat e një auditimi financiar në sektorin publik janë shpesh më të gjera se sa shprehja e një opinioni nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar (p.sh. fushëveprimi i ISA-ve). Mandati i auditimit ose obligimet për entitetet e sektorit publik që dalin nga legjislacioni, rregulloret, direktivat ministrore, kërkesat e politikave qeveritare, ose rezolutave të legjislaturës, mund të rezultojnë në objektiva shtesë. Këto objektiva shtesë mund të përfshijnë përgjegjësitë e auditimit dhe të raportimit, p.sh. në lidhje me raportimin nëse auditorët e sektorit publik gjejnë ndonjë rast të mos pajtueshmërisë me autoritetet, përfshirë buxhetin dhe kornizën e llogaridhënies, dhe/ose raportimin për efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Këto objektiva shtesë mund të shpien audituesit e sektorit publik në vlerësimin e rreziqeve të tjera të anomalive materiale. Megjithatë, edhe aty ku nuk ka objektiva të tilla shtesë, mund të ketë pritshmëri të përgjithshme nga publiku në lidhje me raportimin e audituesve të sektorit publik për mos pajtueshmërinë me autoritetet ose raportimin e efektivitetit të kontrollit të brendshëm. Prandaj, audituesit e sektorit publik i kujtojnë pritshmëritë tilla dhe janë vigjilent për fushat që mund të shkaktojnë rreziqe të mos pajtueshmërisë me autoritetet ose rreziqe në lidhje me efektivitetin e kontrollit të brendshëm gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit.

Procedurat e vlerësimit të rrezikut dhe aktivitetet e ndërlidhura

P5. Gjatë kryerjes së procedurave të vlerësimit të rrezikut dhe aktivitetëve të ndërlidhura të përmendura nga Paragrafi 5 deri tek Paragrafi 10 të ISA-së,

audituesit e sektorit publik i marrin parasysh objektivat më të gjera të mandatit të auditimit, siç përshkruhet në Paragrafin P4 më sipër.

P6. Gjatë pyetjeve që u bëjnë Drejtuesve të entitetit dhe të tjerëve brenda tij si pjesë e procedurave të vlerësimit të rrezikut, të përshkruara në Paragrafët 6(a) dhe A6 të ISA-së, audituesit e sektorit publik mund të marrin informacione nga burime shtesë siç janë:

- Audituesit e përfshirë në performancë dhe auditime të tjera që kanë të bëjnë me entitetin;
- Zyrtarët qeveritar, dhe
- Raportet ose procesverbalet e legjislativit.

P7. Gjatë kryerjes së procedurave analitike, si pjesë e procedurave të vlerësimit të rrezikut,

siç përshkruhet në Paragrafin 6(b) dhe nga Paragrafi A7 deri tek Paragrafi A10 të ISA-së, audituesit e sektorit publik mund të marrin gjithashtu në konsideratë marrëdhënie të tilla si:

- Shpenzimet kundrejt ndarjeve;
- Pagesat e përfitimeve, siç janë shtesat për fëmijët dhe pensionet kundrejt të dhënave demografike; dhe
- Interesi si përqindje e borxhit kombëtar në krahasim me normën e huamarrjes së qeverisë,

P8. Kur kryejnë vëzhgime dhe inspektime si pjesë e procedurave të vlerësimit të rrezikut të përshkruara në Paragrafin 6(c) dhe A11 të ISA-së, audituesit e sektorit publik mundën gjithashtu të vëzhgojnë dhe të inspektojnë zëra si:

- Dokumentet shtesë të përgatitura nga Drejtuesit për legjislativin, siç janë Raportet e Performancës ose kërkesat për financim;
- Dëshmitë e zyrtarëve të agjencisë;
- Direktivat ministrore dhe të tjera; dhe
- Të dhënat zyrtare të seancave të legjislativit

P9. Procesi i pranimit dhe vazhdimësisë, të cilit i referohemi në Paragrafin 7 të ISA-së nuk mund të jetë gjithmonë i zbatueshëm në mjedisin e sektorit publik. Audituesit e sektorit publik mund të mos e kenë alternativën e refuzimit ose ndërprerjes së auditimit. Megjithatë, audituesit e sektorit publik marrin në konsideratë informacionin që mund të marrin nga këto procese, ose të tilla të ngjashme, në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale.

P10. Gjatë përdorimit të informatave të marra nga përvoja e mëparshme me entitetin dhe auditimet e mëparshme siç përshkruhet në Paragrafin 9 të ISA-së, audituesit e sektorit publik mund të përdorin gjithashtu edhe raportet e mëparshme të auditimit të performancës dhe aktiviteteve të tjera të auditimit që janë relevante për entitetin në fjalë.

P11. Paragrafi 10 i ISA-së kërkon nga partneri i angazhimit dhe anëtarët e tjerë kyç të ekipit të angazhimit që të diskutojnë mbi ndjeshmërinë e pasqyrave financiare të entitetit ndaj anomalive materiale, si dhe për zbatimin e kornizës në fuqi të raportimit financiar për faktet dhe rrethanat e entitetit. Në sektorin publik, ky diskutim mund të mbulojë objektivat shtesë dhe rreziqet e ndërlidhura të anomalive materiale, siç trajtohen në Paragrafin P4 më sipër. Audituesit e sektorit publik mund të përfshijnë audituesit e angazhuar në auditimin e performancës dhe në aktivitete të tjera të auditimit të entitetit në një diskutim të tillë.

Nevoja për njohjen e mjedisit të entitetit, duke përfshirë edhe Kontrollin e Brendshëm të tij

P12. Në njohjen e entitetit dhe mjedisit të tij siç kërkohet në Paragrafin 11 të ISA-së, audituesi i sektorit publik merr parasysh se:

- a) Vendimet mund të fillohen të merren jashtë entitetit si rezultat i proceseve politike. Vendime të tilla ndikojnë në aktivitetet e drejtimin të entitetit. Shembujt përfshijnë:
 - Vendndodhje të reja gjeografike ose zhvendosja e vendndodhjes ekzistuese,
 - Riorganizimi, përfshirë transferimin e aktiviteteve tek entitetet e tjera,

- Fushat e programeve të reja, dhe
- Kufizimet ose shkurtime të buxhetore.

b) Faktorët relevante rregullative përfshijnë ligjet dhe rregulloret specifike të cilave i nënshtrohet entiteti dhe ndikimin e mundshëm të mos pajtueshmërisë me to;

c) Faktorë të tjerë të jashtëm, përfshi këtu kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, mund të ndikojnë në objektiva specifike të raportimit;

d) Të kuptuarit e operacioneve të biznesit mund të përfshijnë njohuri të aktiviteteve të kryera të qeverisë duke përfshirë programet përkatëse;

e) Objektivat e programit dhe strategjitë mund të përfshijnë elemente të politikës publike dhe për këtë arsye mund të ketë implikime për vlerësimin e rrezikut;

f) Pronësia e entiteteve të sektorit publik nuk mund të mos ketë rëndësinë e njëjtë si në sektorin privat. Në sektorin publik, fokusi bie tek të ngarkuarit për qeverisje në rolin e tyre si përfaqësues të qytetarëve;

g) Strukturat qeverisëse preken nga struktura ligjore e entitetit, p.sh. nëse entiteti është një agjenci, ministri, departament, apo lloj tjetër entiteti; dhe

h) Çështjet lidhur me supozimet dhe shqetësimet e vazhdueshme të Drejtuesve mund të mos jenë relevante.

P13. Paragrafi 11(e) i ISA-së, i referohet matjes dhe rishikimit të performancës financiare. Audituesit e sektorit publik mund të shfrytëzojnë informata jo-financiare siç janë arritja e rezultateve (p.sh. numri i njerëzve të ndihmuar nga programi) në matjen ose rishikimin e tyre. Gjithashtu, në sektorin publik ka palë të tjera të jashtme që mund të masin dhe rishikojnë performancën. Në këto palë të jashtme mund të përfshihen legjislativi, entitetet e tjera të sektorit publik dhe media.

P14. Në të kuptuarit e kontrollit të brendshëm siç kërkohet në Paragrafin 12 të ISA-së, audituesit e sektorit publik marrin parasysh si më poshtë:

- a) Çdo përgjegjësi shtesë të raportimit në lidhje me kontrollet e brendshme;
- b) Kontrollet përkatëse që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë me autoritetet;

- c) Kontrollat që kanë të bëjnë me monitorimin e performancës kundrejt buxhetit;
- d) Kontrollat në lidhje me transferimin e fondeve buxhetore tek entitetet e tjera;
- e) Kontrollat e të dhënave të klasifikuara që lidhen me sigurinë kombëtare dhe të dhënave personale të ndjeshme, siç janë tatimet dhe informacione për shëndetin;
- f) Mbikëqyrja dhe kontrollat e tjera që mund të kryhen nga palët jashtë entitetit dhe që lidhen me fusha të tilla si:
 - Pajtueshmëria me rregulloret e prokurimit,
 - Ekzekutimin e buxhetit,
 - Fusha të tjera të përcaktuara nga legjislacioni apo mandati i auditimit,
 - Llogaridhënia e drejtuesve,

P15. Në të kuptuarit e procesit të vlerësimit të rrezikut të entitetit siç kërkohet në Paragrafin 15 të ISA-së, audituesit e sektorit publik marrin parasysh se një proces i tillë mund të përcaktohet në legjislacion, të përfshihet në direktiva, ose të kryhet nga entitete të tjera të sektorit publik.

P16. Në disa mjedise të auditimit, siç është mjedisi i Gjykatës së Llogarive, audituesit e sektorit publik mund të punojnë ngushtë me prokurorët dhe policinë kur kane të bëjnë me mashtrim financiar. Prandaj, ata mund të marrin informata nga prokurorët dhe policia të cilat janë relevante për të kuptuar entitetin dhe mjedisin e tij dhe për vlerësimin e rrezikut.

Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të anomalive materiale

P17. Kur audituesit e sektorit publik i identifikojnë dhe vlerësojnë rreziqet e anomalive materiale në pajtim me Paragrafët 25 dhe 26 të ISA-së, audituesit e sektorit publik mund të marrin parasysh çështje siç janë:

- Fakti që identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve në nivel të pasqyrave financiare dhe në nivel të pohimit mund të përfshijë çështje që lidhen me klimën politike, interesin publik, ndjeshmërinë e programit; dhe

- Fakti se pohimet për klasat e transaksioneve, bilancet e llogarive, dhe shpalosjet mund të zgjerohen aq sa të përfshijnë pohimet se transaksionet dhe ngjarjet janë kryer në pajtim me legjislacionin ose autoritetin e duhur siç është përcaktuar në Paragrafin A113 të ISA-së.

P18. Në ushtrimin e gjykimit se cilat rreziqe janë rreziqe të rëndësishme siç kërkohet nga Paragrafi 28 të ISA-së, audituesit e sektorit publik gjithashtu marrin parasysh:

- a) Kompleksitetin dhe mos përputhshmërinë me rregulloret dhe direktivat;
- b) Mos pajtueshmërinë me autoritetet; dhe
- c) Procesin e buxhetit dhe ekzekutimin e buxhetit.

Buxheti në sektorin publik është një mjet i besueshëm i përcaktuar nga legjislativi. Prandaj, audituesit e sektorit publik zakonisht e përfshijnë procesin e buxhetit si një pjesë thelbësore në të kuptuarit e entitetit dhe mjedisit të tij, dhe të vlerësimit të rrezikut, sesa si një procedurë menaxhimi.

Shtojca: Shembuj shtesë të kushteve dhe ngjarjeve që mund të tregojnë rreziqe të anomalive materiale

Më poshtë jepen shembuj të kushteve dhe ngjarjeve të tjera që mund të tregojnë rreziqet e anomalive materiale për entitetet e sektorit publik:

- Buxheti i mbi shpenzuar për shkak të kontrolleve të dobëta buxhetore;
- Privatizimi;
- Programet e reja;
- Ndryshimet e mëdha në programet ekzistuese;
- Burimet e reja të financimit;
- Legjislacioni i ri dhe rregulloret ose direktivat;
- Vendimet politike siç janë zhvendosja e operacioneve;
- Programe pa burime dhe financime të mjaftueshme të alokuara;
- Rritja e pritshmërive të publikut;
- Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve në industri të tilla siç është mbrojtja;
- Kontraktimi jashtë i aktiviteteve të Qeverisë;
- Operacionet që i nënshtrohen hetimeve speciale;
- Ndryshimet në udhëheqjen politike;
- Treguesit për humbje dhe shpërdorim;
- Pritshmëritë për përmbushjen e buxhetit më të larta se ato normale;
- Partneriteti Publik- Privat

ISSAI 1320

Udhëzues i Auditimit Financiar

MATERIALITETI NË PLANIFIKIMIN DHE KRYERJEN E AUDITIMIT

Shënim Praktik për Standardin Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 320

PËRMBAJTJA

SHËNIMI PRAKTIK PËR ISA¹⁰¹⁾ 320

Paragrafi

Historiku

Hyrje në ISA

Përmbajtja e Shënimit Praktik P1

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik P2

Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik P3

Konsideratat e përgjithshme P4

Materialiteti sipas kontekstit të auditimit P5-P7

Përcaktimi i materialitetit dhe performanca e materialitetit
në planifikimin e auditimit P8-P11

Rishikimi i progresit të Auditimit P12

101) Të gjitha shënimet praktike konsiderohen së bashku me ISSAI 1000 — Hyrje e Përgjithshme në ONISA Udhëzime të Auditimit Financiar.

Materialiteti në planifikimin dhe kryerjen e auditimit

Historiku

Ky Shënim Praktik i ofron audituesve të sektorit publik udhëzime shtesë për ISA 320 -Materialiteti në planifikimin dhe kryerjen e auditimit. Ky lexohet së bashku me ISA. ISA 320 ka hyrë në fuqi për auditimin e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar 15 dhjetor 2009 ose më pas. Shënimi Praktik ka hyrë në fuqi në të njëjtën datë sikurse edhe ISA.

Hyrje në ISA

ISA 320 trajton përgjegjësinë e audituesit për të aplikuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e auditimit të pasqyrave financiare. ISA450¹⁰²⁾ shpjegon se si aplikohet materialiteti në vlerësimin e efektit të anomalive të identifikuar, dhe të anomalive të pa përmirësuara nëse ka, në auditimin e pasqyrave financiare.

Përmbajtja e Shënimit Praktik

P1. Ky Shënim Praktik ofron udhëzim shtesë për auditorët e sektorit publik lidhur me:

- a) Konsiderata të përgjithshme,
- b) Materialitetin në kontekst të auditimit,
- c) Përcaktimin e materialitetit dhe Performancën e materialitetit kur planifikohet një Auditim,
- d) Rishikimin e progresit të Auditimit,

102) ISA 450 Vlerësimi i anomalive të identifikuar gjatë auditimit*

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik

P2. ISA 320 është i aplikueshëm për audituesit e entiteteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të pasqyrave financiare.

Udhëzime shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

P3. ISA 320 përmban zbatimin dhe materialet tjera shpjeguese me konsiderata të veçanta për entitetet e sektorit publik në paragrafët A2 dhe A9 të ISA-së.

Konsideratat e përgjithshme

P4. Objektivat e një auditimi financiar në sektorin publik janë shpesh më të gjera se sa fushëveprimi i ISA-ve, i cili përfshin raportimin nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në pajtim me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar (fushëveprimi i ISA-ve). Mandati i auditimit gjithashtu mund të rezultojë në objektiva shtesë të marra në konsideratë lidhur me auditimin e pasqyrave financiare. Këto objektiva mund të përfshijnë përgjegjësitë shtesë të auditimit dhe raportimit, p.sh. në lidhje me raportimin, nëse auditori ka gjetur ndonjë rast të mos pajtueshmërisë me autoritetet duke përfshirë buxhetin dhe llogaridhënien dhe/ose raportimin mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme. Edhe në rastet kur nuk ka objektiva të tilla të raportimit shtesë, publiku i gjerë mund të ketë pritshmëritë e tij në lidhje me raportimin e auditorëve të sektorit publik për sa i përket mos pajtueshmërisë me autoritetet apo raportimin e efektivitetit të kontrollit të brendshëm. Prandaj, audituesit e sektorit publik i marrin parasysh pritshmëritë tilla kur përcaktojnë materialitetin. Përgjegjësitë shtesë lidhur me pajtueshmërinë me autoritetet trajtohen në Udhëzuesit e INTOSAI për Auditimin e Pajtueshmërisë (ISSAI 4000¹⁰³) dhe 4200¹⁰⁴). Audituesit e sektorit publik me përgjegjësi të tilla shtesë mund të marrin në konsideratë ISA 4000 dhe 4200 .

103) ISSAI 4000 “Hyrje e përgjithshme në Udhëzuesit e Auditimit të Pajtueshmërisë”

104) ISSAI 4200 “Udhëzuesit e Auditimit të Pajtueshmërisë lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare”

Materialiteti sipas kontekstit të auditimit

- P5. Kur përcaktohet materialiteti për qëllime të planifikimit në sektorin publik, çështjet, si nga ana sasiore edhe nga ana cilësore, dhe natyra e zërave janë të rëndësishme. Konteksti në të cilin këto çështje paraqiten mund të jenë me rëndësi. Për më tepër, natyra e vetvetishme ose karakteristikat e zërave, apo e një grupi të zërave, mund të bëhen materiale.
- P6. Në Paragrafin A2 të ISA 320 thuhet se ligjvënësit dhe rregullatorët janë shpesh përdoruesit kryesor të Pasqyrave Financiare të entiteteve të sektorit publik dhe se këto pasqyra financiare mund të përdoren për të marrë vendime, por jo vendime ekonomike. Ligjvënësit përfaqësojnë qytetarët dhe sigurojnë financim për programe, aktivitete, dhe funksione të ndryshme qeveritare. Ligjvënësit dhe/ose rregullatorët shpesh vlerësojnë ose marrin vendime në lidhje me aktivitetet e një entiteti. Përdoruesit e tjerë mund të jenë Drejtuesit e entitetit, mbajtësit e obligacioneve, ose media. Pasqyrat financiare që përmbushin nevojat e ligjvënësve dhe rregullatorëve përmbushin gjithashtu edhe nevojat e përdoruesve të tjerë.
- P7. Pasqyrat financiare mund të paraqesin gjithashtu një element kyç të llogaridhënies së një entiteti ndaj publikut. Korniza e llogaridhënies mund të paraqet faktorë tjerë që ndikojnë në përcaktimin e materialitetit në nivele të ndryshme. Si pasojë, materialiteti ka të ngjarë të jetë rezultat i të dy faktorëve, sasior dhe cilësor, dhe nivelet e materialitetit për klasa të veçanta të transaksioneve, bilanceve të llogarive, dhe të shpalosjeve shpesh mund të vendoset në një nivel më të ulët për këtë arsye.

Përcaktimi i materialitetit dhe performanca e materialitetit në planifikimin e auditimit

- P8. Siç u tha më lartë, materialiteti në sektorin publik përfshin aspektin sasior dhe cilësor (referuar në ISA, si aspekte që lidhen me – madhësinë dhe – natyrën e anomalive). Përcaktimi i nivelit ose niveleve të materialitetit përshkruhet në paragrafin 10 dhe 11 të ISA-së. Në sektorin publik, nivelet e materialitetit për klasat e transaksioneve, bilanceve të llogarive, dhe shpalosjeve mund të vendosen në një nivel më të ulët se sa nivelet e materialitetit që do të rridhnin duke ndjekur kërkesat e ISA. Kjo mund të jetë për një sërë arsyesh, përfshi edhe kontekstin e çështjes ose natyrën

dhe karakteristikat e sistemeve dhe subjekteve të përfshira siç shpjegohet në paragrafët P5 - P7 më sipër. Për më tepër, mund të jetë e nevojshme që procedura të caktuara të kryhen përmes mandatit të auditimit ose legjislacionit. Shembuj të procedurave të tilla mund të jenë analiza e pagave ministrore të cilat rregullohen me statut dhe pagesat e ndjeshme të tilla si udhëtimet dhe akomodimi i personelit të nivelit të lartë. Në rastet e rralla ku audituesit e sektorit publik duan të zbulojnë të gjitha anomali të tilla, ata testojnë të gjitha transaksionet relevante.

- P9. Kur audituesit e sektorit publik gjithashtu japin mendime për efektivitetin e kontroleve ose pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret, ata marrin në konsideratë, përveç materialitetit për pasqyrat financiare, edhe nevojën për krijimin e materialitetit për këto objektiva. Për shembull, për raportimin mbi efektivitetin e kontrollit, audituesi mund të përdorë një standard të bazuar në përqindjen e transaksioneve ose shumat monetare të marra si mostër për të përcaktuar materialitetin për vlerësimin e devijimeve të kontrollit.
- P10. Paragrafi A2 i ISA-së përshkruan konsideratat që janë specifike për përcaktimin e shkallës së materialitetit në sektorin publik. Kur përcaktohet nëse një klasë e veçantë e transaksioneve, bilancit të llogarisë, shpalosjes, ose një pohim tjetër që është pjesë e kornizës së raportimit financiar, është material nga natyra e tij audituesit e sektorit publik marrin parasysh aspekte cilësore siç janë:
- Konteksti në të cilën çështja shfaqet, për shembull, nëse çështja gjithashtu i nënshtrohet pajtueshmërisë me autoritetet, legjislacionin, rregulloret apo nëse se ligji ose rregullorja i ndalon mbishpenzimin e fondeve publike, pavarësisht nga shumat e përfshira;
 - Nevojat e palëve të ndryshme dhe mënyra se si ata i përdorin pasqyrat financiare;
 - Natyra e transaksioneve të cilat konsiderohen të ndjeshme për përdoruesit e pasqyrave financiare;
 - Pritshmëritë e publikut dhe interesi publik, duke theksuar çështjet e caktuara nga komisionet përkatëse në Parlament, siç është komisioni për mbikëqyrjen e financave publike, duke përfshirë edhe domosdoshmërinë e shpalosjeve të caktuara.

- Nevoja për mbikëqyrje legislative dhe rregullative në një fushë të veçantë dhe,
- Nevoja për të qenë i hapur dhe për transparencë, për shembull nëse ka ndonjë kërkesë të veçantë për shpalosje të mashtimeve dhe humbjeve.

P11. Paragrafi A9 i ISA-së trajton identifikimin e pikave të duhura të referimit për materialitetin e pasqyrave financiare. Për subjektet e sektorit publik që pritet t'i mbulojë shpenzimet ose pikën kritike, shpenzimet neto mund të mos jenë një pikë referimi e përshtatshme. Në këto raste shpenzimet bruto ose të ardhurat bruto mund të jenë një pikë referimi më relevante. Për subjektet e sektorit publik të cilët ruajnë në kuadër të tyre sasi të mëdha të pasurive, gjithsej pasuritë, gjithsej detyrimet, neto pasuritë ose neto detyrimet apo klasa të caktuara të pasurive mund të jenë pika referimi të përshtatshme nëse ato janë të regjistruara në pasqyrat financiare. Në disa raste, sidomos kur merret parasysh materialiteti cilësor, lloje të tjera pikash referimi mund të jenë të dobishme. Si për shembull:

- Numri i përdoruesve apo entiteteve të ndikuara si një përqindje e totalit të përdoruesve apo entiteteve të përfshira në programe të veçanta;
- Shumat e konsideruara më parë si materiale nga një komision përkatës në parlament, siç është komisioni për mbikëqyrjen e financave publike dhe;
- Pagesat e përfitimeve krahasuar me treguesit e kostos së jetesës, për shembull rëndësia që marrësit që përfitojnë pagesa mujore, siç janë pagesat e pensionit ose invaliditetit, të paguhen në pajtim me programet e sektorit publik.

Rishikimi i progresit të Auditimit

P12. Paragrafët 12,13 dhe A13 të ISA-së trajtojnë nevojën për rishikimin e niveleve të materialitetit në rast të informacioneve të reja gjatë auditimit. Për shkak të strukturave të qeverisjes dhe marrëdhënieve të entiteteve në Sektorin Publik, nuk është e pazakontë për audituesit në sektorin publik që të marrin informacione të reja gjatë procesit të auditimit.

ISSAI 1330

Udhëzues i Auditimit Financiar

*REAGIMET E AUDITUESIT NDAJ
RREZIQEVE TË VLERËSUARA*

Shënim Praktik për Standardin Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 330

PËRMBAJTJA

SHËNIMI PRAKTIK PËR ISA¹⁰⁵ 330

Paragrafi

Historiku

Hyrje në ISA

Përmbajtja e Shënimit Praktik P1

Zbatueshmëria e SNA (ISA) në Auditimin e Sektorit Publik P2

Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik P3

Konsideratat e përgjithshme P4

Procedurat e Auditimit që i Përgjigjen Rreziqeve të Vlerësuara të Anomalisë Materiale në Nivel Pohimi P5-P9

Vlerësimi i Mjaftueshmërisë dhe i Përshtatshmërisë së Evidencës së Auditimit P10

Konsiderata të Veçanta për Audituesit e Sektorit Publik me Rol Gjyqësor P11

105) Të gjitha shënimet praktike konsiderohen së bashku me ISSAI 1000 "Hyrje e Përgjithshme në ONISA Udhëzime të Auditimit Financiar.

Reagimet e Audituesit ndaj Rreziqeve të Vlerësuara

Historiku

Ky Shënim Praktik ofron udhëzim shtesë mbi ISA 330 - Reagimet e Audituesit ndaj Rreziqeve të Vlerësuara. Duhet të lexohet i lidhur ngushtë me ISA. ISA 330 ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 dhjetor 2009 e më pas. Shënimi Praktik ka hyrë në fuqi në të njëjtën datë si dhe ISA.

Hyrje në ISA

ISA 330 trajton përgjegjësinë që ka audituesi për të dizajnuar dhe përcaktuar mënyrën e reagimit dhe për të reaguar ndaj rreziqeve të anomalisë materiale të cilat janë identifikuar dhe vlerësuar nga audituesi në pajtim me ISA 315¹⁰⁶⁾ në një auditim të pasqyrave financiare.

Përmbajtja e Shënimit Praktik

P1. Shënimi Praktik ofron udhëzim shtesë për audituesit e sektorit publik lidhur me:

- a) Konsideratat e Përgjithshme.
- b) Procedurat e Auditimit që i Përgjigjen Rreziqeve të Vlerësuara të Anomalisë Materiale në Nivel Pohimi
- c) Vlerësimi i Mjaftueshmërisë dhe i Përshtatshmërisë së Evidencës së Auditimit.
- d) Konsiderata të Veçanta për Audituesit e Sektorit Publik me Rol Gjyqësor.

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik

106) ISA 315, – Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale Nëpërmjet Njohjes të Entitetit dhe Mjedisit të tij

P2. ISA 330 është i zbatueshëm për audituesit e entiteteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të pasqyrave financiare.

Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

P3. ISA 330 në paragrafin A17 të ISA përmban zbatimin dhe materialet e tjera shpjeguese me konsiderata të veçanta për entitetet e sektorit publik.

Konsideratat e Përgjithshme

P4. Objektivat e një auditimi financiar në sektorin publik janë shpesh më të gjera se sa shprehja e një opinioni nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar (p.sh. fushëveprimi i ISA-ve). Mandati i auditimit, apo detyrimet për entitetet e sektorit publik, që rrjedhin nga legjislati, rregullorja, udhëzimi ekzekutiv, kërkesat e politikave qeveritare, apo rezolutave të legjislaturës mund të rezultojë në objektiva të tjera. Këto objektiva shtesë mund të përfshijnë përgjegjësitë e auditimit dhe raportimit që ndërlidhen me raportimin nëse audituesit e sektorit publik gjetën papajtueshmëri me autoritetet përfshirë këtu buxhetin dhe kuadret e llogaridhënive, dhe/ose raportimin në lidhje me efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Këto objektiva shtesë mund të çojnë audituesit e sektorit publik për të identifikuar dhe vlerësuar rreziqet shtesë të anomalive materiale, të dizajnojnë dhe përcaktojnë reagimet e përgjithshme për të adresuar rreziqet e vlerësuara në nivelin e pasqyrës financiare dhe për të dizajnuar dhe për të kryer procedurat e mëtejshme të auditimit për të reaguar ndaj rreziqeve të vlerësuara në nivelin e pohimit. Megjithatë, edhe aty ku nuk ka objektiva të tilla shtesë, mund të ketë pritje të përgjithshme publike në lidhje me raportimin e audituesve të sektorit publik për mos-përputhje me autoritetet ose raportimin në lidhje me efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Prandaj, audituesit e sektorit publik i kanë parasysh pritjet e tilla dhe janë vigjilentë për rastet e nevojës për të reaguar ndaj rreziqeve të papajtueshmërisë ose rrezikut në lidhje me efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

Procedurat e Auditimit që i Përgjigjen Rreziqeve të Vlerësuara të Anomalisë Materiale në Nivel Pohimi

- P5. Kurbëhet planifikimi i afateve të procedurave të auditimit të përshkruara në paragrafin 6 të ISA, audituesit e sektorit publik gjithashtu marrin parasysh se testet e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret mund të kryhen gjatë vitit, ndërsa testet e ekzekutimit të buxhetit zakonisht kryhen në fundvit.
- P6. Në paragrafin A17 të ISA theksohet se mandati i auditimit dhe apo ndonjë kërkesë tjetër e veçantë e auditimit mund të ndikojë në vlerësimet e audituesit lidhur me përcaktimin e natyrës, afateve dhe shtrirjes së procedurave të mëtejshme të auditimit. Shembuj të këtyre kërkesave të tjera përfshijnë testimin dhe raportimin për mospërputhje me rregullat e caktuara, të tilla si ato lidhur me ekzekutimin e buxhetit apo fushën e prokurimit.
- P7. Paragrafi 8 i ISA përshkruan rrethanat ku nga audituesi kërkohet të kryejë testet e kontrolleve për të siguruar evidencë të mjaftueshme të auditimit qoftë për efektivitetin operativ apo kontrolleve përkatëse. Si rezultat i objektivave të tjera të përshkruara në paragrafin e mësipërm P4, testet e kontrolleve të një entiteti të sektorit publik mund të jetë më të gjera dhe më të detajuara sesa ato të një entiteti të sektorit privat. Ata gjithashtu mund të kryhen pavarësisht nga rrethanat e përshkruara në paragrafin 8 të ISA. Për shembull, audituesit e sektorit publik mund të kryejë teste të kontrollit mbi shpenzimet e udhëtimit ose pagesave të ndjeshme, apo të kontrolleve të dizajnuara për të parandaluar ose zbuluar mashtrimet brenda entitetit.
- P8. Gjatë dizajnit dhe kryerjes së testeve të kontrollit siç kërkohet në paragrafin 10 të ISA, audituesit e sektorit publik përcaktojnë nëse entiteti është pjesë e një mjedisi më të madh të kontrollit të qeverisë. Si rezultat, kontrollet mund të ekzistojnë jashtë entitetit. Audituesi përcakton nëse dhe si të sigurojë evidencë të përshtatshme dhe të mjaftueshme të auditimit për këto kontrolle.
- P9. Kur përdoret evidencë e auditimit në lidhje me efektivitetin operativ të kontrolleve të siguruar në auditimet e mëparshme, siç është e përmendur në paragrafin 13 të ISA, audituesit e sektorit publik mund të përdorin

evidenca nga auditimet e performancës ose aktivitete të tjera të auditimit që janë relevante për entitetin. Kur mbështetemi mbi evidenca të siguruara nga auditimet e mëparshme të performancës, audituesit e sektorit publik vlerësojnë nëse pohimet e përdorura dhe testet e kryera janë të përshtatshme për qëllime të auditimit të pasqyrave financiare.

Vlerësimi i Mjaftueshmërisë dhe i Përshtatshmërisë së Evidencës së Auditimit

P10. Paragrafi 27 i ISA kërkon nga audituesi të shpreh një opinion të kualifikuar ose të mohoj një opinion mbi pasqyrat financiare nëse audituesi nuk është në gjendje të sigurojë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit. A62 Paragrafi i ISA ofron faktorët që mund të ndikojnë në gjykimin e audituesit për atë se çka përbën evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit. Në vlerësimin e asaj se çka është evidencë e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit, audituesit e sektorit publik gjithashtu marrin parasysh nevojën për të siguruar dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të përmbushur ndonjë objektiv shtesë siç përshkruhet në paragrafin P4 me lart.

Konsiderata të Veçanta për Audituesit e Sektorit Publik me Rol Gjyqësor

P11. Në disa mjedise të sektorit publik, siç është Mjedisi i Gjykatës së Llogarive, raporti i audituesve shpesh është gjykuar dhe përdorur për të përcaktuar implikimet personale ligjore të atyre që janë përgjegjës për veprimet financiare, duke përfshirë çështje të rëndësishme, mangësitë e kontrollit dhe raste të mospërputhjes me autoritetet. Prandaj, audituesit e sektorit publik në mjedise të tilla, kur e bëjnë vlerësimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së evidencës së auditimit kryejnë edhe procedurat për të identifikuar përgjegjësit për veprimet financiare dhe për pajtueshmërinë me kërkesat ligjore.

ISSAI 1402

Udhëzues i Auditimit Financiar

*KONSIDERATA AUDITIMI PËR
NJË ENTITET QË PËRDOR NJË
ORGANIZATË SHËRBIMI*

Shënim Praktik për Standardin Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 402

PËRMBAJTJA

SHËNIMI PRAKTIK PËR ISA¹⁰⁷⁾ 402	Paragrafi
Historiku	
Hyrje në ISA	
Përmbajtja e Shënimit Praktik	P1
Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik	P2
Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik	P3
Konsideratat e Përgjithshme	P4
Fushëveprimi i ISA	P5
Objektivat	P6
Përkufizimet.....	P7
Sigurimi i njohjes së shërbimeve të ofruara nga një organizatë shërbimi përfshirë kontrollin e brendshëm.	P8-P13
Konsiderata të Veçanta për Audituesit e Sektorit Publik me Rol Gjqësor	P14

Shtojcë: Organizatat e Shërbimit në Kontekst të Sektorit Publik

107) Të gjitha shënimet praktike konsiderohen së bashku me ISSAI 1000 "Hyrje e Përgjithshme në ONISA Udhëzime të Auditimit Financiar.

Konsiderata Auditimi për një Entitet që përdor një Organizatë Shërbimi

Historiku

Ky Shënim Praktik ofron udhëzim shtesë mbi ISA 402 - Konsiderata Auditimi për një Entitet që përdor një Organizatë Shërbimi. Duhet të lexohet i lidhur ngushtë me ISA. ISA 402 ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 dhjetor 2009 e më pas. Shënimi Praktik ka hyrë në fuqi në të njëjtën datë si dhe ISA.

Hyrje në ISA

ISA 402 trajton përgjegjësinë e audituesit të entitetit përdorues për të siguruar evidencën e nevojshme ë auditimit kur një entitet përdorues shfrytëzon shërbimet e një ose më shumë organizatave të shërbimit. Veçanërisht, ai e shtrin fushën e veprimit në mënyrën se si audituesi i entitetit përdorues zbaton ISA 315¹⁰⁸⁾ dhe ISA 330¹⁰⁹⁾ në njohjen e entitetit përdorues, përfshirë kontrollin e brendshëm që lidhet me auditimin, në atë masë që është e përshtatshme për të identifikuar dhe vlerësuar rreziqet e anomalive materiale dhe në përcaktimin dhe kryerjen e procedurave të mëtejme të auditimit në përgjigje ndaj këtyre rreziqeve.

Përmbajtja e Shënimit Praktik

P1. Shënimi Praktik ofron udhëzim shtesë për audituesit e sektorit publik lidhur me:

- a) Konsideratat e Përgjithshme.
- b) Fushëveprimin e ISA.
- c) Objektivat.

108) ISA 315; – Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale Nëpërmjet Njohjes të Entitetit dhe Mjedisit të tij,

109) ISA 330, – Reagimet e Audituesit ndaj Rreziqeve të Vlerësuara

- d) Përkufizimet.
- e) Sigurimin e njohjes së shërbimeve të ofruara nga një organizatë shërbimi përfshirë kontrollin e brendshëm.
- f) Konsideratat e Veçanta për Audituesit e Sektorit Publik me Rol Gjyqësor.

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik

P2. ISA 402 është i zbatueshëm për audituesit e entiteteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të pasqyrave financiare.

Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

P3. ISA 402 në paragrafët A10 dhe A11 të ISA përmban zbatimin dhe materialet tjera shpjeguese me konsiderata të veçanta për entitetet e sektorit publik.

Reagimet e Përgjithshme

P4. Objektivat e një auditimi financiar në sektorin publik janë shpesh më të gjera se sa shprehja e një opinioni nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar (p.sh. fushëveprimi i ISA-ve). Mandati i auditimit, apo detyrimet për entitetet e sektorit publik, që rrjedhin nga legjislacioni, rregullorja, udhëzimi ekzekutiv, kërkesat e politikave qeveritare, apo rezolutave të legjislaturës mund të rezultojë në objektiva të tjera. Këto objektiva shtesë mund të përfshijnë përgjegjësitë e auditimit dhe raportimit që ndërlidhen me raportimin nëse audituesit e sektorit publik gjejnë papajtueshmëri me autoritetet përfshirë këtu buxhetin dhe kuadret e llogaridhënieve, dhe/ose raportimin në lidhje me efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Megjithatë, edhe aty ku nuk ka objektiva të tilla shtesë, mund të ketë pritje të përgjithshme publike në lidhje me raportimin e audituesve të sektorit publik për mospërputhje me autoritetet ose raportimin në lidhje me efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Prandaj, audituesit e sektorit publik i kanë parasysh pritje të tilla dhe janë vigjilentë për

rastet e nevojës për të reaguar ndaj rreziqeve të papajtueshmërisë ose rrezikut në lidhje me efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

Fushëveprimi i ISA

P5. Paragrafi 2 i ISA i referohet organizatave që ofrojnë shërbime që janë pjesë përbërëse të operacioneve të entitetit. Në sektorin publik, organizatat e shërbimit mund të jenë pjesë përbërëse e kapacitetit të një entiteti që të jetë në përputhje me autoritetet që e drejtojnë atë, të kryejë objektivat e programit të saj dhe të sigurojë efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Natyra dhe shtrirja e punës që duhet kryer nga audituesit e sektorit publik në këtë kontekst varet nga natyra dhe rëndësia e këtyre shërbimeve ndaj entitetit të sektorit publik dhe rëndësia e këtyre shërbimeve për mandatin e auditimit të sektorit publik. Në shtojcën e këtij Shënimi Praktik ofrohen shembuj të aktiviteteve të kryera nga organizatat e shërbimit në kontekst të sektorit publik.

Objektivat

P6. Objektivat për auditorët e sektorit publik mund të jenë më të gjera se ato të përcaktuara në paragrafin 7 të ISA. Objektivat e tilla të gjera mund të përfshijnë elemente që lidhen me kërkesat dhe pritshmëritë që audituesit e sektorit publik të raportojnë mbi pajtueshmërinë me autoritetet, arritjen e objektivave të programit dhe efektivitetit të kontrollit të brendshëm.

Përkufizimet

P7. Termat “organizatë shërbimi” dhe “Organizatë shërbimi e nënkontraktuar” janë të përcaktuara në paragrafin 8 (e) dhe (g) të ISA. Përveç kësaj për të qenë pjesë e një sistemi informativ të entitetit përdorues relevant me raportimin financiar, në sektorin publik këto terma mund të shtrihen te organizatat që ofrojnë shërbime përbërëse për aftësinë e entitetit përdorues për të arritur objektivat e programit të tij, siç është përcaktimi i të drejtave, dhe shpërndarja e pagesave të pensionit për individët, ose granteve për individë apo organizata.

Sigurimi i njohjes së shërbimeve të ofruara nga një organizatë shërbimi përfshirë kontrollin e brendshëm

- P8. Paragrafi 9 i ISA ka të bëjë me njohjen e entitetit përdorues nga ana e audituesit në mënyrën se si ky entitet përdor shërbimet e një organizate shërbimi në operacionet e tij. Kur të merret parasysh rëndësia e shërbimeve të ofruara ndaj entitetit përdorues, natyra dhe materialiteti i transaksioneve të përpunuara, si dhe natyrën e marrëdhënieve midis entitetit përdorues dhe organizatës së shërbimit, audituesit e sektorit publik mund gjithashtu të konsiderojnë rolin e organizatës të shërbimeve lidhur me pajtueshmërinë e entitetit përdorues me autoritetet, arritjen e objektivave të programit dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm.
- P9. Për më tepër, kur të merret parasysh natyra e transaksioneve të përpunuara nga një organizatë e shërbimit për një entitet përdorues, audituesit e sektorit publik mund të marrin parasysh shkallën e llogaridhënies së fluksit të mjeteve midis dy entiteteve. Llogaridhënia midis dy entiteteve mund të ndryshojnë nga:
- Një situatë ku entiteti përdorues përdor një organizatë shërbimi për të siguruar fonde të pakushtëzuara për përfituesit me të drejta, pa asnjë kërkesë për përfituesit apo për organizatën e shërbimit për të raportuar prapa entitetit përdorues në lidhje me përdorimin e këtyre fondeve;
 - Një situatë ku nuk ka përgjegjësi të plotë për fondet, ku për transaksionet e kryera nga organizatat e shërbimit të njëjtat japin llogari të plotë për ato, dhe i ofrohet siguri entitetit përdorues që transaksionet e kryera nga organizata e shërbimeve janë në përputhje me autoritetet që i drejtojnë ato, dhe se objektivat përkatëse të programit janë arritur.
- P10. Përveç kësaj, kur të merret parasysh natyra e marrëdhënieve midis entitetit përdorues dhe organizatës së shërbimit, audituesit e sektorit publik mund gjithashtu të konsiderojnë strukturat përkatëse të qeverisjes, gjithashtu edhe strukturën e llogaridhënies si dhe shtrirjen e ndikimit të entitetit që mund të ketë ndaj një entiteti tjetër.
- P11. Përkufizimet Audituesi i organizatës së shërbimit dhe audituesi i entitetit

përdorues' në paragrafin 8(d) dhe (h) të ISA nënkuptojnë se përfshihen në dy organizata të veçanta të auditimit. Megjithatë, në sektorin publik, një nivel i qeverisjes mund të ofrojë shërbime në nivele të tjera të qeverisjes. Këto nivele në fund të fundit mund të konsiderohen si pjesë e të njëjtës strukturë qeveritare dhe si rezultat i kësaj mund të auditohen nga e njëjta organizatë e auditimit të sektorit publik. Duke qenë pjesë e së njëjtës organizatë të auditimit të sektorit publik mund të ndikojë në mënyrën se si dy auditues individual përgjegjës për organizatën e shërbimit dhe entitetit përdorues komunikojnë dhe raportojnë ndaj njëri tjetrit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në paragrafët 12-18 të ISA. Për shembull, në situata të tilla, komunikimi mes audituesit, audituesit të organizatës së shërbimit dhe audituesit të entitetit përdorues në varësi të mandatit të tyre mund të mos nënshtrohen të njëjtave kërkesa të konfidencialitetit siç janë ato në sektorin privat.

P12. Për shembull, paragrafi 12 i ISA përshkruan opsionet ku audituesi i entitetit përdorues mund të punësojë tjetër auditues për të siguruar njohje përkatëse audituese për kontrollin e brendshëm të entitetit përdorues në mënyrë që të sigurojë një bazë për identifikimin dhe vlerësimin e riskut anomalive materiale. Kur audituesi i entitetit përdorues dhe audituesi i organizatës shërbyese janë nga e njëjta organizatë e auditimit të sektorit publik, disa ose të gjitha opsionet e përshkruara në paragrafin 12 të ISA mund të mos jenë praktike. Megjithatë, në raste të tilla, informacioni i shkëmbyer midis audituesit të entitetit përdorues dhe audituesit të organizatës shërbyese është i ndarë në mënyrë transparente. Ky informacion mund të përfshijë çështje të ngjashme me ato të përfshira në raportin e tipit 1 apo tipit 2.

P13. Për më tepër, në situata të tilla, dhënia e konsideratave të mjaftueshme në identifikimin dhe adresimin e nevojave, vijave dhe formave përkatëse të raportimit mund të jetë e dobishme në fazën e planifikimit të angazhimit.

Konsiderata të Veçanta për Audituesit e Sektorit Publik me Rol Gjyqësor

P14. Udhëzimet e vendosura më sipër janë relevante në lidhje me detyrimet e auditimit të Institucionit Suprem të Auditimit. Megjithatë, në lidhje me punën e kryer nga ana e audituesve të sektorit publik në disa mjedise, siç është Mjedisi i Gjykatës së Llogarive lidhur me obligimet e tyre juridike, mund të ketë konsiderata shtesë të cilat audituesit e sektorit publik duhet t'i marrin parasysh. Këto konsiderata mund të përfshijnë:

- Vlerësimin e rreziqeve të mundshme të mospërputhjes ose sjelljes nga ana e entitet përdorues ose organizatës së shërbimit, që mund të ketë një ndikim material në financat publike;
- Ndjekjen e rregullave më të rrepta të evidencave kur parregullsitë e mundshme apo rastet e sjelljes së keqe janë identifikuar, të tilla sa që kërkesat përkatëse për procedurë gjyqësore me një vendim zyrtar janë përmbushur; dhe
- Sigurimin e dëshmive të parregullsive të mundshme dhe rastet e sjelljes së keqe për departamentin juridik të Institucioneve të Gjykatës Supreme të Auditimit, dhe bashkëpunimin me departamentin juridik sipas nevojës. Informacione të tilla jepen zakonisht në formën e një raporti të veçantë për punën e auditimit të kryer dhe për gjetjet përkatëse.

Shtojcë: Organizatat e Shërbimit në Kontekst të Sektorit Publik

Listat e mëposhtme përfshijnë shembuj të aktiviteteve dhe situatave që lidhen me organizatat e shërbimeve që mund të jenë relevante në një kontekst të sektorit publik. Listat janë të destinuara të jenë ilustruese, por jo gjithëpërfshirëse.

Shembuj të aktiviteteve të kryera nga organizatat e shërbimit në Kontekst të Sektorit Publik

- Përpunimin e transaksioneve dhe mirëmbajtjen e regjistrave kontabël nga një agjenci qeveritare në emër të tjetrës (p.sh. procedimi i pagave);
- Vlerësimi dhe mbledhja e të ardhurave, të tilla si tatimet në të ardhura, nga një nivel i qeverisë në emër të një nivel tjetër qeverisës;
- Investimi i fondeve publike të mbledhura nga qeveria për një qëllim të caktuar, të tilla si kontributet e pensioneve apo të të ardhurave të caktuara;
- Mbledhja e borxhit në emër të qeverisë të tilla si kreditë e papaguara, borxhet e taksave, interesat, gjobat dhe përmirësimin e pagesave të gabuara;
- Pagesa të përfitimeve apo granteve për përfituesit, duke përfshirë përcaktimin e përfituesit me të drejta për përpunimin e pagesave; dhe
- Menaxhimi i pasurisë kapitale të një organizatë tjetër në emër të qeverisë.

Për këto aktiviteteve auditorët e sektorit publik mund gjithashtu të marrin në konsideratë kërkesat përkatëse dhe pritjet për të raportuar pajtueshmërinë me autoritetet, arritjen e objektivave të programit dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

Shembuj të Situatave ku Organizatat e shërbimit mund të kenë Përgjegjësi të Caktuara për të siguruar Pajtueshmërinë me Autoritetet

- Entitetet e investimeve të cilat kanë kufizime në strategjitë e tyre për investime prej legjislacionit të qeverisë, për shembull, kufizime për të investuar në subjekte jo të ndërgjegjshëm për ruajtjen e mjedisit;
- Institucionet bankare që janë të nevojshme për të zbatuar kërkesat specifike të sigurisë për personelin e tyre në përputhje me rregulloret e qeverisë për trajtimin e fondeve publike;
- Një organizatë përgjegjëse për shpërndarjen e fondeve qeveritare kur janë të paracaktuara limitet e shpenzimeve ose kriteret e përshtatshmërisë që duhet të respektohen; dhe
- Administrata ose mbledhja e taksave ose tarifave të tjera nga qeveria apo entiteti privat për llogari të qeverisë tjetër, ku organizata e cila administron ose mbledh këto pagesa duhet të respektojë legjislacionin e qeverisë.

Shembuj të Situatave ku Organizatat e Shërbimit mund të kenë Përgjegjësi të Caktuara për të Arritur Objektivat e Programeve

- Përcaktimin e të drejtës dhe shpërndarjen e pagesave të përfitimeve të qeverisë për individët, të tilla si pension, invaliditeti, kujdesit për fëmijë dhe të përfitimeve të papunësisë; dhe
- Administrimi dhe shpërndarja e fondeve të realizuara nga organizatat jo-qeveritare (të tilla si Kombet e Bashkuara) në emër të qeverisë për qëllime të tilla si zhvillimi ndërkombëtar ose të ndihmës ndërkombëtare.

ISSAI 1450

Udhëzues i Auditimit Financiar

*VLERËSIMI I ANOMALIVE TË
IDENTIFIKUARA GJATË
AUDITIMIT*

Shënim Praktik për Standardin Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 450

PËRMBAJTJA

SHËNIMI PRAKTIK PËR ISA 450¹¹⁰⁾	Paragraf
Historiku	
Hyrje në ISA	
Përmbajtja e Shënimit Praktik.. .. .	P1
Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik	P2
Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik.....	P4
Konsideratat e përgjithshme	P4
Vlerësimin e efektit të anomalive të pakorrigjuara.....	P5-P7
Deklarimet me shkrim	P8
Konsiderata të veçanta për audituesit e sektorit publik me rol gjyqësor	P9-P10

110) Të gjitha shënimet praktike konsiderohen së bashku me ISSAI 1000 – Hyrje e Përgjithshme në INTOSAI - Udhëzime të Auditimit Financiar.

Vlerësimi i Anomalive të Identifikuara Gjatë Auditimit

Historiku

Ky Shënim Praktik ofron udhëzim shtesë mbi ISA450 - Vlerësimi i Anomalive të Identifikuara Gjatë Auditimit. Ky lexohet së bashku me ISA. ISA 450 ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 dhjetor 2009 e më pas. Shënimi Praktik ka hyrë në fuqi në të njëjtën datë si dhe ISA.

Hyrje në ISA

ISA 450 trajton përgjegjësinë e audituesit për të vlerësuar efektin e anomalive të identifikuara në auditim dhe të anomalive të pakorrigjuara nëse ka, në pasqyrat financiare. ISA 700¹¹¹⁾ trajton përgjegjësinë e audituesit në formimin e një opinioni mbi pasqyrat financiare, për të arritur në përfundim nëse ka fituar një siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale. Konkluzioni i audituesit siç kërkohet me ISA 700 merr parasysh vlerësimin e audituesit për anomalitë e pakorrigjuara në pasqyrat financiare, nëse ka, në pajtim me ISA 450. ISA 320¹¹²⁾ trajton përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar siç duhet konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare.

111) ISA 700, – Formimi i një Opinioni dhe Raportimi mbi Pasqyrat Financiare, paragrafët 10-11.

112) ISA 320, – Materialiteti në Planifikimin dhe në Kryerjen e një Auditimi

Përmbajtja e Shënimit Praktik

P1.Shënimi Praktik ofron udhëzim shtesë për audituesit e sektorit publik lidhur me:

- a) Reagimet e Përgjithshme.
- b) Vlerësimin e efektit të anomalive të pakorrigjuara.
- c) Deklarimet me shkrim.
- d) Konsiderata të veçanta për audituesit e sektorit publik me rol gjyqësor.

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik

P2.ISA 450 është i zbatueshëm për audituesit e entiteteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të pasqyrave financiare.

Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

P3. ISA 450 në paragrafët A19 dhe A20 të ISA përmban zbatimin dhe materiale të tjera shpjeguese me konsiderata të veçanta për entitetet e sektorit publik.

Konsideratat e përgjithshme

P4. Objektivat e një auditimi financiar në sektorin publik janë shpesh më të gjera se sa shprehja e një opinionit nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar (p.sh. fushëveprimi i ISA-ve). Këto objektiva shtesë mund të përfshijnë përgjegjësitë e auditimit dhe raportimit që ndërlidhen me raportimin nëse audituesit e sektorit publik gjejnë papajtueshmëri me autoritetet përfshirë këtu buxhetin dhe kornizën e llogaridhënies dhe/ose raportimin në lidhje me efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Më tutje, për vlerësimin e anomalive, audituesit e sektorit publik mund të vlerësojnë rastet e mospërputhjes me autoritetet dhe të raportojnë për efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Kur audituesit e sektorit publik kanë përgjegjësi të tilla shtesë të raportimit, secila përgjegjësi raportimi është vlerësuar ndarazi.

Vlerësimin e efektit të anomalive të pakorrigjuara

P5. Në zbatimin e paragrafit 11 të ISA, audituesit e sektorit publik me përgjegjësi shtesë të raportimit që lidhen me papajtueshmërinë me autoritetet dhe mangësitë e kontrollit kryejnë vlerësimin e secilës prej këtyre objektivave veç e veç. Megjithatë, anomalitë, rastet e papajtueshmërisë me autoritetet dhe mangësitë e kontrollit mund të jenë të ndërlidhura dhe mund të rrisin rrezikun e secilit objektiv.

P6. Paragrafët 12 deri në 13 të ISA trajtojnë komunikimin e anomalive të pakorrigjuara personave të ngarkuar me qeverisjen. Aty ku është e nevojshme për mandatin e audituesve të sektorit publik ky komunikim mund të përfshijë rastet e mospërputhjes me autoritetet dhe mangësitë e kontrollit. Audituesit e sektorit publik mund të kenë nevojë të komunikojnë gjithashtu anomalitë, rastet e mospërputhjes me autoritetet dhe mangësitë e kontrollit edhe palëve të tjera siç janë zyrtarët qeveritare.

P7. Komunikimi me personat e ngarkuar me qeverisjen apo me palët e tjera të përshkruara në paragrafin P6 më lartë, prej audituesve të sektorit publik mund të pritet të komunikojnë të gjitha anomalitë, edhe ato të cilat janë korrigjuar nga entiteti. Gjatë komunikimit me personat e ngarkuar me qeverisjen, audituesit e sektorit publik përdorin mënyrat e raportimit duke iu përshtatur mjedisit të tyre. Audituesit e sektorit publik gjithashtu mund të thirren për të dëshmuar para legjislativit lidhur me rezultatet e auditimit të pasqyrave financiare.

Deklarimet me shkrim

P8. Paragrafi 14 i ISA kërkon nga audituesi që të marrë një deklaratë me shkrim nga drejtuesit ku thuhet se ata besojnë se efektet e anomalive të pakorrigjuara në pasqyrat financiare të jenë jomateriale. Kur Audituesit e sektorit publik kanë përgjegjësi shtesë për pajtueshmërinë me autoritetet dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm këto deklarime mund të bëhen në një dokument të vetëm.

Konsiderata të veçanta për audituesit sektorit publik me rol gjyqësor

P9. Në disa mjedise të sektorit publik, siç është Mjedisi i Gjykatës së Llogarive, raporti i audituesve shpesh është gjykuar dhe përdorur për të përcaktuar implikimet personale ligjore të atyre që janë përgjegjës për veprimet financiare, duke përfshirë çështje të rëndësishme të rasteve të mospërputhjes me autoritetet dhe mangësitë e kontrollit. Prandaj, audituesit e sektorit publik në mjedise të tilla, kur e bëjnë vlerësimin e anomalive, rasteve të mospërputhjes me autoritetet dhe vlerësimin e mangësive të kontrollit të identifikuar gjatë auditimit gjithashtu, kryejnë procedurat për të identifikuar përgjegjësit për veprimet financiare dhe për pajtueshmërinë me kërkesat ligjore.

P10. Paragrafi 8 i ISA kërkon nga audituesi të komunikojë në kohë të gjitha anomalitë e akumuluar gjatë auditimit në nivelin e duhur të drejtimit. Aty ku audituesit e sektorit publik kanë mandate, të cilat përfshijnë autoritetin ligjor për të urdhëruar entitetin të bëjë korrigjimin e ndonjë anomalie si dhe rastet e mospërputhjes me autoritetet, ata marrin parasysh nëse ushtrimi i autoritetit të tillë mund të dëmtojë pavarësinë e tyre dhe, nëse është kështu, të marrë masat e duhura për t'iu shmangur një dëmtimi të tillë.

ISSAI 1500

Udhëzues i Auditimit Financiar

EVIDENCA E AUDITIMIT

Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 500

TABELA E PËRMBAJTJES ISSAI 1500

Shënim praktik për ISA 500¹¹³⁾ **Paragrafi**

Historiku

Hyrje në ISA

Përmbajtja e shënit praktik P1

Zbatueshmëria e ISA në auditimin e sektorit publik P2

Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

Evidencë e duhur dhe e mjaftushme për Auditimi P3-P10

Shtojca: Burimet e Evidencës së Auditimit rreth Manaxhimit të Riskut në lidhje me

Ligjet dhe Rregulloret.

113) Të gjitha shënimet praktike konsiderohen së bashku me ISSAI 1000 – Hyrje e Përgjithshme në INTOSAI - Udhëzime të Auditimit Financiar

Evidenca e Auditimit

Historiku

Ky Shënim Praktik¹¹⁴⁾ jep udhëzime shitesë rreth ISA 500 - Evidenca Auditimit. Ajo lexohet së bashku me ISA. ISA 500 është efektive për auditime rreth deklaratave financiare, për periudhat gjatë ose pas 15 dhjetorit 2009. Shënimi praktik është efektiv në të njëjtën datë si ISA.

Hyrje në ISA.

ISA 500 shpjegon nga se përbëhet evidenca e auditimit në një auditim të pasqyrave financiare, dhe merret me përgjegjësinë e audituesit për të hartuar dhe për të kryer procedurat e auditimit, për të marrë evidencën e duhur dhe të mjaftueshme të auditimit, si dhe për të qenë në gjendje të nxjerrë konkluzione të arsyeshme mbi të cilat të bazohet opinionin e audituesit.

ISA 500 është i zbatueshëm për të gjitha evidencat e auditimit të marra gjatë auditimit. ISA të tjera merren me aspekte të veçanta të auditimit (për shembull ISA 315¹¹⁵⁾), evidenca e auditimit të sigurohet në lidhje me një temë të veçantë (për shembull ISA 570¹¹⁶⁾), procedura specifike për të marrë prova auditimi (për shembull ISA 520¹¹⁷⁾), dhe vlerësimi nëse evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit është marrë (për shembull ISA 200¹¹⁸⁾ dhe ISA 330¹¹⁹⁾.

114) Të gjitha Shënimet Praktike konsiderohen së bashku me ISSAI 1000 "Hyrje e Përgjithshme të Udhëzimeve Financiare Auditimit të INTOSAI-it."

115) ISA 315, "Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të anomalive materiale nëpërmjet të kuptuarit të Entitetit dhe mjedisit të tij."

116) ISA 570, "Shprehja e Shqetësimit".

117) ISA 520, "Procedurat analitike."

118) ISA 200, "Objektivat e përgjithshëm të Audituesit të Pavarur në kryerjen e një auditimi, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit."

119) ISA 330, "Përgjigjet e audituesit ndaj rreziqeve të vlerësuara"

Përmbajtja e Shënimit Praktik

P1. Shënimi Praktik jep udhëzime shtesë për audituesit e sektorit publik në lidhje me:

- a) Evidencën e duhur dhe të mjaftueshme për Auditimin

Zbatueshmëria e ISA në Auditimit e Sektorit Publik.

P2. ISA 500 është i aplikueshëm për audituesit e subjekteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të deklaratave financiare.

Udhëzime shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

Evidencë e Duhur dhe e Mjaftueshme për Auditimin

- P3. Siç është përmendur në paragrafin A7 të ISA disa evidenca auditimi merren duke kryer procedurat e auditimit për të testuar të dhënat e kontabilitetit. Evidenca e auditimit përfshin informacionin që mbështet dhe vërteton pohimet e menaxhimit, si dhe çfarëdo të dhëne që kundërshton pohime të tilla. Në rastin e pasqyrave financiare në menaxhimin e sektorit publik shpesh mund të pohohet se transaksionet dhe ngjarjet janë kryer në përputhje me legjislacionin ose me autoritetin përkatës. Pohime të tilla mund të bien brenda fushëveprimit të një auditimi¹²⁰⁾ financiar. Audituesit e sektorit publik mund të marrin parasysh ISSAI 4200¹²¹⁾.
- P4. Kur merret parasysh informacioni nga burime të pavarura nga subjekti siç janë referuar në paragrafin A9 të ISA, audituesit e sektorit publik mund të konsiderojnë burimet sa më të pavarura nga subjekti, edhe pse ata në përfundim raportojnë tek i njëjti autoritet p.sh. agjencitë e pavarura operative qeveritare raportojnë pranë të njëjtit autoritet. Natyra e të dhënave sasiore në sektorin publik mund të përfshijë burime të tjera p.sh. krahasimet mes programeve të ngjashme, apo treguesve të performancës.
- P5. Kur merren parasysh burimet e evidencave në pajtim me paragrafin A2 të ISA, audituesit e sektorit publik mund të marrin gjithashtu në konsideratë evidencat e marra në auditimet e performancës ose aktivitete të tjera të auditimit që lidhen me subjektin.

120) Auditimi Financiar në kuadër të udhëzimeve shtesë të dhëna në Shënimet Praktike i referohet auditimeve të pasqyrave financiare dhe pohimeve shtesë mbi rregullsinë dhe përputhshmërinë, kur realizon një auditim të pasqyrave financiare (auditimi financiar / i rregullsisë). ISA merren me auditimet e pasqyrave financiare.

121) ISSAI 4200, "Udhëzimet e Auditimit të Pajftueshmërisë të INTOSAI-t në lidhje me Auditimin e Pasqyrave Financiare."

- P6. Siç shpjegohet në paragrafin A11 të ISA evidencat e marra nga auditimet e mëparshme, në rrethana të caktuara, mund të sigurojnë evidencë të përshtatshme auditimi ku audituesi kryen procedurat e auditimit për të evidentuar rëndësinë e vijimësisë. Kur mbështetet mbi provat e nxjerra nga auditimet e mëparshme të performancës, audituesit e sektorit publik vlerësojnë nëse pohimet e përdorura dhe testet e kryera janë të përshtatshme për qëllimin e auditimit të pasqyrave financiare.
- P7. Kur mandati i Auditimit përfshin objektivat në lidhje me rregullsinë e transaksioneve, audituesit e sektorit publik mund të kenë nevojë të marrin në konsideratë natyrën dhe kohëzgjatjen e procedurave të auditimit siç shpjegohet në paragrafin A12 të ISA p.sh. aftësia për të aplikuar disa procedura të caktuara të auditimit për të krijuar rregullsinë e transaksionit ose efektiviteti i kontrolleve mund të ndikohet negativisht me kalimin e kohës.
- P8. Subjektet e sektorit publik zakonisht kanë vendosur kontrollet e brendshme të projektuara për të siguruar rregullsinë e transaksioneve. Megjithatë, kur subjekti i audituar është përgjegjës për dhënien e granteve apo ndonjë ndihme tjetër financiare për palët e tjera, ky është shpesh rasti që rregullsia e transaksionit varet pjesërisht tek palët e tjera që përmbushin kriteret dhe plotësojnë kushtet për marrjen e ndihmës. Evidenca mund të kërkohet në ushtrimin e përgjegjësiave të subjekteve për të kënaqur veten në lidhje me transaksionet e palëve të tjera (siç demonstrohet në Shtojcën 1 të këtij Shënimi Praktik).
- P9. Kur merren në konsideratë udhëzimet e paragrafit A13 të ISA audituesit e sektorit publik marrin parasysh se kërkesa për ruajtjen e të dhënave për subjektet e sektorit publik mund të jetë e ndryshme, siç përcaktohet nga legjislacioni përkatës. Audituesit e sektorit publik njihen me legjislacionin në fuqi në lidhje me ruajtjen e të dhënave.
- P10. Audituesit e sektorit publik në disa mjedise, si në atë të Gjykatës së

Llogarive, mund të jenë subjekt i ligjeve dhe rregulloreve, ku audituesit i nevojitet të kuptojë dhe të ndjekë procedurat e sakta që lidhen me rregullat e evidencës. Audituesit e sektorit publik njihen me këto lloj politikash dhe procedurash duke përshkruar nevojat shtesë që kanë të bëjnë me evidencën e auditimit dhe që janë projektuar për të siguruar përputhjen me rregullat e zbatueshme. Për shembull, audituesit e sektorit publik që veprojnë në një mjedis të tillë mund të kenë nevojë të marrin në konsideratë çështjet e mëposhtme që lidhen me mbledhjen e evidencës:

- Imponimi legjislacionit me kërkesa shtesë mbi evidencën e auditimit;
- Qëllimi i kërkesave shtesë (p.sh., janë ato që do imponohen në çdo dokument nga funksionet e auditimit, ose në dokumente të veçanta që lidhen me çështje të caktuara të auditimit);
- Përpunimi shtesë, formalitetet ose nevojat për të cilat evidenca e auditimit është subjekt;
- Qëllimi i çdo kërkesë shtesë për sa i përket procesit të rregullit ligjor në ndjekjen e hapave të auditimit, dhe
- Çdo lloj kufizimi që mund të vendoset mbi evidencën e auditimit për shkak të mënyrave të veçanta që janë mbledhur dhe / ose prodhuar.

Shtojca: Burimet e Evidencës së Auditimit në Lidhje me Menaxhimin e Rreziqeve të Lidhura me Ligjet dhe Rregulloret

Risku	Përshkrimi	Burime të mundshme mbi evidencën e auditimit
Kompleksiteti i rregulloreve	Sa më komplekse rregulloret aq më i madh rreziku i gabimit. Kjo mund të ndodhë nëpërmjet një keqkuptimi apo keqinterpretimi të kësaj rregulloreje ose nëpërmjet një gabimi në kërkesë	<ul style="list-style-type: none"> • Procedura formale dhe të dokumentuara për përkthimin e kërkesave ligjore në udhëzimet operative; • Plane kontrolli formale dhe të dokumentuara për monitorimin e aktiviteteve nga menaxherët e skemës; • Raport nishikimi nga auditimi i brendshëm ose disa lloje të tjera auditimi të pavarura nga planet e kontrollit të skemave dhe manualeve të përdorimit.
Legjislacioni Ri	Legjislacioni i ri mund të ketë nevojë për futjen e procedurave të reja të kontrollit dhe administrative. Kjo mund të rezultojë me gabime, në hartimin apo operimin e kontrolleve të nevojshme për të siguruar rregullsinë.	<ul style="list-style-type: none"> • Procedura formale dhe të dokumentuara për përkthimin e kërkesave ligjore në rregulla të skemës. • Kontrole plani formale dhe shqyrtim i pavarur i udhëzimeve operative dhe; gjithashtu planet e kontrollit mund të përbëjnë evidencën e auditimit ku skemat janë futur sipas legjislacionit të ri.
Skemat ndërkombëtare (të financuara nga Kombet e Bashkuara, ose BE-ja institucione të tjera	Atje ku institucionet merren me zhvillimin e të tilla rregulloreve ekziston dhe një risk që rregulloret dhe udhëzimet mund të jenë keqkuptuar ose hequr nga udhëzimet e brendshme.	Burimet e identifikuar të evidencës së auditimit në lidhje me kompleksitetin e rregullave, mund të aplikohen njësoj për këto skema të financuara.

Risku	Përshkrimi	Burime të mundshme mbi evidencën e auditimit
Shërbimet dhe programet e dorëzuara përmes palëve të treta.	Atje ku programet administrohen nga agjentë, departamentet humbasin një shkallë të kontrollit të drejtpërdrejtë dhe mund të mbështeten tek agjentët për të siguruar përputhjen me autoritetet.	<ul style="list-style-type: none"> • Marrëveshjet formale ndërmjet subjektit dhe agjentit që përcakton procedurat e kontrollit për tu aplikuar në administrimin e shërbimeve; • Procedurat e dokumentuara dhe rezultatet e kontrollit menaxherial dhe monitronit të aktiviteteve të palës së tretë; • Raportet nga vizitat inspektuese të auditimit të brendshëm ndaj palëve të treta, për shqyrtimin e sistemeve dhe procedurave, duke përfshirë ato për rregullsinë; • Një siguri apo marrëveshje mbi raport procedurat e pagesave dhe faturave, ose në kontrollet mbi pagesat dhe faturat, nga audituesit e palës së tretë.
Pagesat dhe arkëtimet e bëra në bazë të kërkesave apo deklaratave.	Aftësia e një subjekti për të konfirmuar pajtueshmërinë me autoritetet mund të kufizohet, në rastet kur p.sh. kriteret e specifikuar për pranimin e grantit nuk janë subjekt i verifikimit të drejtpërdrejtë.	<ul style="list-style-type: none"> • Instruksionet e departamenteve dhe udhëzimet për paditësit duke theksuar qartë kriteret për bërjen e padisë; • Kërkesat standarde për evidentimin e dokumentacionit rekomandues për t'u paraqitur në mbështetje të pretendimeve ekzistuese. (Ky mund të jetë një kusht i pagimit të grantit ose një kërkesë atëherë kur aktiviteti i përkrahur nga granti ka përfunduar); • Raportet nga inspektimi fizik i procesverbaleve, të dhënave etj.. për të vërtetuar të drejtën; • Procedura të dokumentuara për vlerësimin e gjendjes financiare të pretenduesve përpara dhënies së një granti dhe për monitorimin ekzistues të aftësive të vazhdueshme paguese. • Çertifikimi i Pavarur për aplikimin e grantit nga audituesi i jashtëm.

ISSAI 1501

Udhëzues i Auditimit Financiar

*EVIDENCA E AUDITIMIT -
KONSIDERATAT E VEÇANTA PËR
ARTIKUJT E ZGJEDHUR*

Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 501

Tabela e Përmbajtjes ISSAI 1501

SHËNIM PRAKTIK PËR ISA 501¹²²⁾	Paragrafi
Historiku	
Hyrje në ISA	
Përmbajtja e shënimit praktik	P1
Zbatueshmëria e ISA në auditimin e sektorit publik	P2
Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik Inventari.....	P3—P6
Gjyqësore dhe Kërkesa	P7—P11
Informacioni segmentuar	P12

122) Të gjitha shënimet praktike konsiderohen së bashku me ISSAI 1000 — Hyrje e Përgjithshme në INTOSAI - Udhëzime të Auditimit Financiar.

Evidenca e Auditimit - Konsideratat e Veçanta për Artikujt e Zgjedhur

Historiku

Ky Shënim Praktik jep udhëzime shtesë për audituesit e sektorit publik rreth ISA 501 -Evidenca Auditimit-Konsideratat e Veçanta Për Artikujt e Zgjedhur. Ajo lexohet së bashku me ISA. ISA 501 është efektive për auditime rreth deklaratave financiare, për periudhat gjatë ose pas 15 dhjetorit 2009. Shënimi praktik është efektiv në të njëjtën datë si ISA.

Hyrje në ISA.

ISA 501 meret me konsideratat specifike të audituesit në marrjen e dëshmisë së mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit në përputhje me ISA 330¹²³⁾, ISA 500¹²⁴⁾ dhe ISA-t e tjera përkatëse, në lidhje me aspekte të caktuara të procesit gjyqësor, të inventarit dhe kërkesave që përfshin subjektin dhe informacionin e segmentuar në auditimin e pasqyrave financiare.

Përmbajtja e Shënimit Praktik

P1. Shënimi Praktik jep udhëzime shtesë për auditorët e sektorit publik në lidhje me:

- a) Inventarin
- b) Gjyqësori dhe Kërkesa
- c) Informacioni specifik.

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik.

P2. ISA 501 është i aplikueshëm për audituesit e subjekteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të deklaratave financiare.

123) ISA 330, "Përgjigja e Audituesit ndaj rreziqeve të vlerësuar."

124) ISA 500, "Evidenca e Auditimit".

Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

Inventari

- P3. Inventari në sektorin publik është shpesh ndryshe nga inventari në sektorin privat. Për shembull, inventari në sektorin publik është mbajtur shpesh për përdorim në vend të rishitjes, prandaj natyra e kontrolleve të brendshme dhe rrezikut të vlerësuar të deklaratave të gabuara materiale mund të jetë ndryshe. Auditorët e sektorit publik përveç ekzistencës dhe gjendjes mund të kenë objektiva dhe pohime të tjera për të marrë në konsideratë. Për shembull, pritjet e publikut për menaxhimin efektiv të inventarit.
- P4. Kur zbatohen kërkesat e paragrafit 4 të ISA, për të vendosur nëse do të merret pjesë në akuza fizike, auditorët e sektorit publik marrin në konsideratë çështjet e përshkruara në paragrafin e mesipërm P3.
- P5. Kur audituesit e sektorit publik kufizohen nga menaxhimi, legjislacioni ose rregulloret dhe nuk mund të marrin pjesë në një akuzë fizike, siç kërkohet nga paragrafi 4 i ISA ose kur kërkohet konfirmim nga një palë e tretë, siç kërkohet nga paragrafi 8 i ISA dhe kur procedurat e tjera të auditimit nuk janë të mundshme, auditorët e sektorit publik marrin në konsideratë efektin mbi raportin e audituesit. Përgjigjja e Audituesve të sektorit Publik mund të jetë ndryshe kur kufizimet imponohen nga menaxhimi, në vend të imponimit nga legjislacioni apo rregulloret.
- P6. Në disa mjedise auditimi të sektorit publik, të tilla si Gjykata e Llogarive, audituesit e sektorit publik mund të kenë përgjegjësi të zgjeruara për identifikimin se kush është përgjegjës për ekzistencën dhe gjendjen e inventarit, duke përfshirë zhvillimin dhe zbatimin e kontrolleve. Atje ku është e aplikueshme kjo mund të përfshijë përcaktimin e sanksioneve.

Gjyqësori dhe Kërkesa

P7. Kur hartohen dhe zbatohen procedurat e auditimit në përputhje me kërkesat e paragrafit 9 dhe udhëzimet përkatëse në paragrafin A18 të ISA, audituesit e sektorit publik mund të kenë përgjegjësi shtesë në lidhje me çështjet gjyqësore dhe pretendimet. Këto përgjegjësi mund të përfshijnë identifikimin e pretendimeve të mundshme në të ardhmen dhe pasojat e mëdha të këtyre kërkesave në sektorin publik. Për shkak të kompleksitetit dhe strukturës së organizatave të sektorit publik, audituesit e sektorit publik mund të kenë nevojë të pyesin organizata të tjera të sektorit publik përveç menaxhimit të subjektit të audituar. Për shembull, një departament ligjor qendror mund të administrojë të gjitha kërkesat ose pretendimet kundrejt qeverisë; audituesit e sektorit publik mund të hetojnë atë departament përveç menaxhimit të subjektit të audituar.

P8. Kur këshillat ligjore brenda qeverisë nuk i ngarkohen subjektit të sektorit publik për shërbimet e tyre, subjektet e sektorit publik nuk mund të kenë llogari ligjore shpenzimi siç diskutohet në paragrafin 9 (c) të ISA.

P9. Auditorët e sektorit publik mund të kenë nevojë të marrin në konsideratë burime të tjera informacioni në kryerjen e procedurave të auditimit për të identifikuar çështjet gjyqësore dhe pretendimet që përfshijnë subjekte të tilla si:

- Raportet e medias;
- publiku përgjithshëm dhe reagimet e palëve të interesuara;
- Informacione të tjera të marra nga rregullatorët, zyrtarët, prokurorët publikë, ose
- Informacion nga ankesat e zyrtarëve dhe denoncuesit
- Rezultatet e performancës apo të auditimeve të tjera.

P10. Kur aplikohen kërkesat e paragrafit 10 të ISA, audituesit e sektorit publik, në përputhje me mandatin e tyre, mund të kenë të drejtë pa lejen e menaxhimit të komunikojë drejtpërdrejt me avokatin e jashtëm ligjor të

subjektit. Audituesit e sektorit publik e konsiderojnë pavarësinë dhe objektivitetin e një avokati ligjor i cili mund të jetë pjesë esubjektit apo pjesë e ndonjë organizate tjetër qeveritare. Kur pavarësia apo objektiviteti i avokatit ligjor është në dyshim, audituesit e sektorit publik mund të kenë dëshirë të marrin në konsideratë marrjen e këshillave ligjore nga një burim tjetër.

P11. Kur kërkohet komunikim i drejtpërdrejtë me anë të një letre të përgjithshme ose specifikehetimi, siç referohet në paragrafin A22 dhe A23 të ISA, audituesit e sektorit publik mund të përfshijnë hetime të tjera të veçanta në qoftë se u lejohet nga kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar. Për shembull, kjo mund të përfshijë faktin nëse subjekti është duke vepruar brenda mandatit të tij legjislativ.

Informacioni specifik.

P12. Paraqitja dhe dhënia e informacionit specifik nuk mund të kërkohet nga kornizat e caktuara të raportimit financiar ose në kuadrin përkatës të subjekteve të caktuara të sektorit publik. Megjithatë, mund të ketë informacione të tjera të ngjashme me informacionet specifike të kërkuara nga ligjet, rregulloret ose nga kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar. Për shembull, nga njësitë e sektorit publik mund të kërkohet të raportojnë të ardhurat dhe shpenzimet nga fondi, përvetësimi, programi ose kategoria; audituesve të sektorit publik mund t’ju duhet të auditojnë këtë informacion. Në rrethana të caktuara audituesve të sektorit publik mund t’ju duhet të shprehin një opinion mbi informacionin specifik ose të ngjashëm, ose si pjesë e opinionit të auditimit të përgjithshëm ose mbi baza të pavarura.

ISSAI 1505

Udhëzues i Auditimit Financiar

KONFIRMIMET E JASHTME

Shënim praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 505

Tabela e Përmbajtjes ISSAI 1505

Shënim praktik për ISA 505¹²⁵⁾	Paragrafi
Historiku	
Hyrje në ISA	
Përmbajtja e shënimit praktik	P1
Zbatueshmëria e ISA në auditimin e sektorit publik	P2
Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik	
Procedurat e konfirmimit të jashtëm për marrjen e provave të Auditimit	P3-P4
Refuzim i menaxhimit për te lejuar audituesin të dërgojë një kërkesë konfirmimi	P5

125) Të gjitha shënimet praktike konsiderohen së bashku me ISSAI 1000 — Hyrje e Përgjithshme në INTOSAI - Udhëzime të Auditimit Financiar.

Konfirmimet e Jashme

Historiku

Ky Shënim Praktik jep udhëzime shtesë për ISA 505 - konfirmimet e jashtme. Ajo lexohet së bashku me ISA. ISA 505 është efektive për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që fillojnë më ose pas 15 dhjetorit 2009. Shënimi Praktik është efektiv në të njëjtën datë si dhe ISA.

Hyrje në ISA

ISA 505 merret me përdorimin e procedurave të konfirmimit të jashtëm nga auditori për të marrë dëshmi auditimi në përputhje me kërkesat e ISA 330¹²⁶⁾ dhe ISA 500¹²⁷⁾. Nuk trajtohen kërkesa në lidhje me çështjet gjyqësore dhe pretendimet, të cilat trajtohen në ISA 501¹²⁸⁾

Përmbajtja e Shënimit Praktik

P1 Shënimi Praktik jep udhëzime shtesë për audituesit e sektorit publik në lidhje me:

- a) Procedurat e konfirmimit të jashtëm për marrjen e provave të Auditimit.
- b) Refuzim i menaxhimit për te lejuar audituesin të dërgojë një kërkesë konfirmimi.

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik

P2. ISA 505 është i aplikueshëm për audituesit e subjekteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të deklaratave financiare.

126) ISA 330, "Përgjigjet e Audituesit ndaj Rreziqeve të Vlerësuar."

127) ISA 500, "Duke marrë parasysh rëndësinë dhe besueshmërinë e dëshmimeve të auditimit".

128) ISA 501, "Dëshmi specifike të auditimit. Konsideratat për artikuj të zgjedhur."

Udhëzime shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

Procedurat e konfirmimit të jashtëm për marrjen e provave të Auditimit.

P3. Paragrafi A1 i ISA dhe paragrafi A48 i ISA 330 thekson se konfirmimet mund të përdoren për të marrë prova në lidhje me praninë apo mungesën e kushteve të caktuara (p.sh. “marrëveshjet anësore” që nuk janë përfshirë në marrëveshjet formale). Përveç pohimeve në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, konfirmimet në marrjen e provave mund t’ju duken të dobishme audituesve të sektorit publik, në lidhje me objektivat shtesë të auditimit të përcaktuara në mandatin e tyre ose që rrjedhin nga, legjislacioni, rregulloret, direktivat ministrore, kërkesat e politikave qeveritare, apo rezolutat e legjislaturës. Për shembull, konfirmimet e jashtme mund të përdoren për të marrë prova në lidhje me:

- Praninë ose mungesën e marrëveshjeve me të tretët e termave legjislative ose kushte të tjera si garancitë e performancës apo të financimit;
- Kryerjen e shpenzimeve të cilat ende nuk janë autorizuar nga legjislativi;
- E drejta e vazhdueshme e individëve në marrjen e pensioneve, asistencës për të ardhurat, pensioneve vjetore apo forma të tjera pagesash; ose
- Prania e “marrëveshjeve anësore” me furnizuesit për kthimin e mallrave për kredi në mënyrë që të përdorin fondet që do të kishin skaduar në një periudhë të mëvonshme fiskale.

P4. Paragrafi 2 i ISA thekson se informacioni vërtetues i marrë nga një burim i pavarur i subjektit mund të rrisë sigurinë që audituesi pajiset me prova brenda regjistrave kontabël ose nga përfaqësimet e bëra nga menaxhimi. Si i tillë, paragrafi 6 (a) përcakton një konfirmim të jashtëm si një përgjigje e drejtpërdrejtë me shkrim kundrejt audituesit nga një palë e tretë (pala konfirmuese), në formë letre, në mënyrë elektronike ose në forma të tjera. Duke pasur parasysh madhësinë dhe kompleksitetin e qeverive, audituesit e sektorit publik duhet të jenë vigjilentë për të siguruar që kërkesat e konfirmimeve të jashtme u janë drejtuar palëve të treta, të cilët janë të

pavarur nga subjekti i audituar dhe përgjigjet janë të besueshme në dritën e marrëdhënieve ndërmjet subjektit dhe palës konfirmuese.

Refuzim nga ana drejtuesve për të mundësuar audituesin me dërgesën e një kërkesë konfirmimi

P5. Audituesit e sektorit publik përveç kërkesës për të komunikuar me ato të ngarkuar me qeverisje, siç është e përmendur në paragrafin 9 të ISA mund t'u kërkohej ose të pritët të komunikojnë me trupin e legjislaturës ose atë mbikëqyrjes, gjithashtu.

ISSAI 1510

Udhëzues i Auditimit Financiar

*ANGAZHIMET FILLESTARE TË
AUDITIMIT - BILANCET HYRËSE*

Shënim praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 510

Tabela e Përmbajtjes ISSAI 1510

Shënim praktik për ISA 510¹²⁹⁾	Paragrafi
Historiku	
Hyrje në ISA	
Përmbajtja e shënimit praktik	P1
Zbatueshmëria e ISA në auditimin e sektorit publik	P2
Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik.....	P3-P4
Procedurat e Auditimit	P5
Konkluzionet e Auditimit dhe Raportimi	P6

129) Të gjitha shënimet praktike konsiderohen së bashku me ISSAI 1000 – Hyrje e Përgjithshme në INTOSAI - Udhëzime të Auditimit Financiar.

Angazhimet fillestare të Auditimit – Bilancet Hyrëse

Historiku

Ky Shënim Praktik jep udhëzime shtesë për ISA 510 - Angazhimet fillestare të Auditimit -Bilancet hyrëse. Ajo lexohet së bashku me ISA. ISA 510 është efektiv për auditimin e pasqyrave financiare për periudhat që fillojnë në ose pas 15 dhjetorit 2009. Shënimi Praktik është efektiv në të njëjtën datë si dhe ISA.

Hyrje në ISA

ISA 510 merret me përgjegjësitë e audituesit në lidhje me hapjen e bilanceve në një angazhim fillestar të auditimit. Përveç shumave të pasqyrave financiare, bilancet e hapjes përfshijnë çështjet e zbulimit që kanë ekzistuar në fillim të periudhës, të tilla si garancitë dhe angazhimet. Kur pasqyrat financiare përfshijnë informacion krahasues financiar, kërkesat dhe udhëzimet e ISA 710¹³⁰⁾ gjithashtu aplikohen. ISA 300¹³¹⁾ përfshin kërkesat shtesë dhe udhëzimet në lidhje me aktivitetet përpara se sa të fillohet njëauditim fillestar.

Përmbajtja e Shënimit Praktik

P1. Shënimi Praktik jep udhëzime shtesë për audituesit e sektorit publik në lidhje me:

- a) Procedurat e auditimit.
- b) Përfundimet e auditimit dhe raportimi.

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik.

P2. ISA 510 është i aplikueshëm për audituesit e subjekteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të deklaratave financiare.

130) ISA 710, “Informacioni Krahasues -Shifrat korresponduese dhe pasqyrat financiare krahasuese.”

131) ISA 300, “Planifikimi i Auditimit të Pasqyrave Financiare”.

Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

- P3. ISA 510 përmban aplikimin dhe materiale të tjera shpjeguese me konsiderata të veçanta për subjektet e sektorit publik në paragrafët A1 dhe A2 të ISA.
- P4. Një auditim fillestar mund të ndodhë kur, një njësi ekonomike shtetëzohet pa rezultuar në formimin e një subjekti të ri ose kur mandati i audituesit të sektorit publik ndryshohet për të përfshirë një auditim të ri të një subjekti ekzistues. Një auditim fillestar mund gjithashtu të ndodhë kur një subjekt i sektorit publik krijohet, dhe legjislacioni ose korniza rregullatore kërkojnë ndarjen e të gjitha pjesëve të bilanceve paraprake të një subjekti pararendës të sektorit publik, që është audituar nga një auditues i mëparshëm.

Procedurat e auditimit

- P5. Kur komunikohen deklaratat e gabuara siç kërkohet nga paragrafi 7 të ISA, audituesit e sektorit publik marin në konsideratë udhëzimet e ISSAI 1450 paragrafët P12 dhe P13.

Konkluzionet e Auditimit dhe Raportimi

- P6. Kur raporti paraprak i një audituesi për periudhën e shkuar të pasqyrave financiare përfshin një modifikim që mbetet i përshtatshëm dhe material për pasqyrat financiare të periudhës aktuale siç referohet në paragrafin 13 të ISA, modifikimi mund të ketë implikime në lidhje me përgjegjësitë e tjera të audituesit në sektorin publik.

ISSAI 1520

Udhëzues i Auditimit Financiar

PROCEDURAT ANALITIKE

Shënim praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 520

Tabela e Përmbajtjes ISSAI 1520

Shënim praktik për ISA 520¹³²⁾	Paragrafi
Historiku	
Hyrje në ISA	
Përmbajtja e shënimit praktik	P1
Zbatueshmëria e ISA në auditimin e sektorit publik	P2
Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik	P3
Konsideratat e	P4 – P5
Procedurat analitike thelbësore	P6 – P10
Rezultatet hetimore të procedurave	P11
Përkufizimi i procedurave	P12

132) Të gjitha shënimet praktike konsiderohen së bashku me ISSAI 1000 – Hyrje e Përgjithshme në INTOSAI - Udhëzime të Auditimit Financiar.

Procedurat Analitike

Historiku

Ky Shënim Praktik jep udhëzime shtesë për ISA 520 - Procedurat Analitike. Ajo lexohet së bashku me ISA. ISA 520 është efektive për auditimin e pasqyrave financiare për periudhat që fillojnë në ose pas 15 dhjetorit 2009. Shënimi Praktik është efektiv në të njëjtën datë si dhe ISA.

Hyrje në ISA

ISA 520 merret me përdorimin e procedurave analitike të audituesit si procedura thelbësore (“procedurat thelbësore analitike“). Ajo gjithashtu merret me përgjegjësinë e audituesit për kryerjen e procedurave analitike pranë përfundimit të auditimit, që të ndihmojë audituesin në krijimin e një konkluzioni të përgjithshëm mbi pasqyrat financiare.

ISA 3152 merret me përdorimin e procedurave analitike, si procedurat e vlerësimit të rrezikut. ISA 3303 përfshin kërkesat dhe udhëzimet në lidhje me kohën, natyrën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përgjigje të rreziqeve të vlerësuara; këto procedura auditimi mund të përfshijnë procedurat thelbësore analitike.

Përmbajtja e Shënimit Praktik

P1. Shënimi Praktik jep udhëzime shtesë për auditorët e sektorit publik në lidhje me:

- a) Konsideratat e përgjithshme
- b) Procedurat analitike thelbësore
- c) Rezultatet hetimore të procedurave analitike
- d) Përkufizimi i procedurave analitike

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik

P2. ISA 520 është i aplikueshëm për audituesit e subjekteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të deklaratave financiare.

Udhëzime shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

P3. ISA 520 përmban aplikime dhe materiale të tjera shpjeguese në lidhje me subjektet e sektorit publik siç përmendet ne paragrafin A11 të ISA.

Konsiderata të përgjithshme

P4. Objektivat e një auditimi financiar në sektorin publik janë shpesh më të gjera se sa shprehja e një opiniononi nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, (dmth qëllimi i ISA). Mandati i auditimit, apo detyrimet për subjektet e sektorit publik, që rrjedhin nga legjislacioni, rregullore, direktivat ministrore, kërkesat e politikave qeveritare, apo rezolutat e legjislativit mund të rezultojë në objektiva të tjera. Këto përgjegjësi mund të përfshijnë, për shembull, kryerjen e procedurave dhe raportimin e rasteve të mospërputhjes me autoritetet, dhe efektivitetin e kontrolleve të brendshme. Megjithatë, edhe aty ku nuk ka objektiva të tilla shtesë, mund të ketë pritje të përgjithshme publike. Audituesit e sektorit publik mund të projektojnë dhe të kryejnë procedurat analitike në dritën e këtyre përgjegjësive shtesë. Megjithatë, në vetvete këto procedura nuk mund të jenë efektive për plotësimin e këtyre përgjegjësive shtesë.

P5. Procedurat analitike në lidhje me shpenzimet e programit brenda sektorit publik ka të ngjarë të përfshijnë krahasime me të dhëna jo-financiare, sepse normalisht ka më pak informacion të krahasueshëm financiar për të kryer procedurat analitike. Prandaj, vlerësimi i kontrolleve mbi besueshmërinë e përdorimit të të dhënave jo-financiare në procedurat analitike është i rëndësishëm në kuadër të sektorit publik.

Procedurat thelbësore analitike.

P6. Kur hartohen dhe përmbushen procedurat thelbësore analitike, qoftë vetëm apo në kombinim me testet e detajeve, të përcaktuara në paragrafin

5 të ISA, audituesit e sektorit publik mund të konsiderojnë se procedurat analitike zakonisht nuk ofrojnë dëshmi për objektivat e caktuara shtesë, të tilla si pajtimi me autoritetet.

- P7. Kur hartohen procedurat analitike, kontrollorët e sektorit publik marrin në konsideratë informacionet e përfuara dhe konkluzionet e arritura në këto lloj aktiviteteve auditimi, duke përfshirë atë të performancës dhe auditime të tjera. Kur ka mbështetje në aktivitetet e tjera të auditimit, audituesit e sektorit publik vlerësojnë nëse objektivat e ndërlidhura, pohimet e mbuluara dhe testet e kryera janë të përshtatshme për qëllimet e auditimit të pasqyrave financiare.
- P8. Paragrafi 5 (d) i ISA kërkon që audituesi të përcaktojë ndryshimin e shumave të regjistruara nga vlerat e pritshme që janë te pranueshme pa hetim. Ky përcaktim është i ndikuar nga materialiteti, i cili në sektorin publik është ndikuar nga mandati i auditimit dhe pritjet publike. ISSAI 1315¹³³⁾ dhe ISSAI 1320¹³⁴⁾ japin udhëzime të mëtejshme për këtë çështje.
- P9. Kur vlerësohet besueshmëria e të dhënave siç referohet në paragrafin A12 (a) të ISA, audituesit e sektorit publik mund të përdorin informacionin e përfituar nga subjektet e tjera brenda qeverisë edhe pse ata përfundimisht raportojnë tek i njëjti autoritet. Për shembull, të dhënat krahasuese në sektorin publik mund të përfshijnë krahasime midis subjekteve të ngjashme dhe / ose programeve.
- P10. Kur merret në konsideratë paragrafi A13 për kryerjen e procedurave analitike, audituesit e sektorit publik kuptojnë projektimin dhe mund të kenë nevojë për të testuar efektivitetin operativ të kontrolleve mbi informacionin jo-financiar të njësisë në procedurat analitike.

Rezultatet hetimore të procedurave analitike

- P11. Auditorët e sektorit publik mendojnë se ata mund të kenë përgjegjësi shtesë kur menaxhimi nuk është në gjendje të japë shpjegime për dallimet

133) ISSAI 1315 “, Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të anomalive materiale nëpërmjet të kuptuarit të Entitetit dhe mjedisit të tij.”

134) ISSAI 1320, “Materialiteti në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi”.

e identifikuara në kryerjen e procedurave analitike të përmendura në paragrafin A21 të ISA. Për shembull, audituesit e sektorit publik në disa mjedise auditimi, të tilla si mjedisi i Gjykatës së Llogarive, mund të kenë nevojë për të hetuar më tej arsyet themelore për mungesën e informacionit dhe për të përcaktuar se kush është përgjegjës.

Përkufizimi i procedurave analitike

P12. Në kryerjen e procedurave analitike, qoftë si procedura thelbësore analitike ose për të ndihmuar në formimin e një konkluzioni të përgjithshëm, siç thuhet në paragrafin A1 të ISA, audituesit e sektorit publik mund të marrin në konsideratë, gjithashtu, marrëdhënie të tilla si:

- Shpenzimet kundrejt buxhetit ose ndarjet buxhetore;
- Pagesat e përfitimit, si mbështetje për fëmijët dhe pensionet kundrejt informacionit demografik;
- Të ardhurat tatimore kundrejt informacionit demografik ose kushteve ekonomike apo treguesve;
- Interesi si një përqindje e borxhit kombëtar në krahasim me normën e huamarrjes së qeverisë;
- Rezultatet e përfunduara në lidhje me shpenzimet, ku informacioni i performancës është përfshirë si pjesë e pasqyrave financiare dhe
- Grantet e Qeverisë për zhvillimin ekonomik dhe social, p.sh. grante të ulta për fermerët dhe grante për ndërtime shkollore, kundrejt treguesve ekonomikë dhe demografikë.

Në mënyrë që të jetë një procedurë efektive, të tilla teste duhet të jenë detajuar në një nivel të përshtatshëm.

ISSAI 1530

Udhëzues i Auditimit Financiar

*PËRZGJEDHJA E
DOKUMENTAVE TË AUDITIMIT*

Shënim praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 530

Tabela e Përmbajtjes ISSAI 1530

Shënim praktik për ISA 530¹³⁵⁾	Paragrafi
Historiku	
Hyrje në ISA	
Përmbajtja e shënimit praktik	P1
Zbatueshmëria e ISA në auditimin e sektorit publik	P2
Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit	
Konsideratat e përgjithshme	P3—P4
Projekti model, Madhësia dhe Përzgjedhja e artikujve për testim ...	P5—P8
Natyra dhe Shkaku i Devijimeve dhe Deklaratat e Gabuara	P9
Projektimi i Deklaratave të Gabuara	P10
Vlerësimi i Rezultateve në Përzgjedhjen e	
Dokumentave Të Auditimit	P11—P12

135) Të gjitha shënimet praktike konsiderohen së bashku me ISSAI 1000 – Hyrje e Përgjithshme në INTOSAI - Udhëzime të Auditimit Financiar.

Përzgjedhja e Dokumentave të Auditimit

Historiku

Ky Shënim Praktik jep udhëzime shtesë për ISA 530 - Përzgjedhja e Dokumentave Të Auditimit. Ajo lexohet së bashku me ISA. ISA 530 është efektive për auditimin e pasqyrave financiare për periudhat që fillojnë në ose pas 15 dhjetorit 2009. Shënimi Praktik është efektiv në të njëjtën datë si dhe ISA.

Hyrje në ISA

ISA 530 aplikohet kur audituesi ka vendosur të përzgjedhë dokumentat e auditimit në kryerjen e procedurave. Ajo merret me përdorimin e rasteve statistikore dhe jo-statistikore kur hartohen dhe zgjidhen dokumentat e auditimit, duke kryer testet e kontrollit, testet e detajevedhe vlerësimin e rezultateve nga rasti.

ISA 530 plotëson ISA 500¹³⁶⁾, e cila merret me përgjegjësinë e audituesit për të hartuar dhe për të kryer procedurat e auditimit për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, për të qënë në gjendje të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilat bazojmë opinionin e audituesit. ISA 500 jep udhëzime për mjetet që i vihen në dispozicion audituesit, për zgjedhjen e artikujve për testim, nga të cilat përzgjedhja e dokumentacionit është një mjet.

Përmbajtja e Shënimit Praktik

P1. Shënimi Praktik jep udhëzime shtesë për auditorët e sektorit publik në lidhje me:

- a) Konsiderata të përgjithshme.

136) ISA 500, "Marrja parasysh e rëndësisë dhe besueshmërisë së dëshmive të auditimit".

- b) Projekti model, Madhësia dhe Përzgjedhja e artikujve për testim.
- c) Natyra dhe Shkaku i Devijimeve dhe Deklaratave të Gabuara.
- d) Projektimi i Deklaratave të Gabuara.
- e) Vlerësimi i Rezultateve nga Përzgjedhja e Dokumentave Të Auditimit.

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik

P2. ISA 530 është i aplikueshëm për audituesit e subjekteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të deklaratave financiare.

Udhëzime shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

Konsiderata të përgjithshme

- P3. Objektivat e një auditimi financiar në sektorin publik janë shpesh më të gjera se shprehja e një opinion nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar (p.sh. fusha e ISA). Mandati auditimit, apo detyrimet për subjektet e sektorit publik, që rrjedhin nga legjislacioni, rregullore, direktiva ministrore, kërkesat e politikave qeveritare, apo rezolutat e legjislativit mund të rezultojë në objektiva të tjera. Këto objektiva shtesë mund të përfshijnë përgjegjësitë e auditimit dhe raportimit, për shembull, në lidhje me raportimet nëse audituesit e sektorit publik kanë gjetur ndonjë rast të mospërputhjes me autoritetet, përfshirë buxhetin dhe llogaridhënien, dhe / ose raportimin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Si rezultat, përzgjedhja e dokumentave të auditimit nga ana e audituesve të sektorit publik mund të ndikohet. Audituesit e sektorit publik mund të përdorin përzgjedhjen e dokumentacionit për këto përgjegjësi për të siguruar një opinion mbi pasqyrat financiare.
- P4. Përzgjedhja e dokumenteve të auditimit për testimin e pajtueshmërisë me autoritetet është i ngjashëm me modele të tjera të dokumenteve të auditimit në atë sektor publik:
- Përcaktoni projektimin e dokumentacionit dhe parametrat e auditimit, duke përfshirë materialitetin, nivelin e dëshiruar të besimit, dhe metodën e përzgjedhjes së dokumentacionit;
 - Kryeni procedurat përkatëse të auditimit për çdo përzgjedhje artikulli;
 - Kërkimi i natyrës dhe shkaqet e mos-pajtueshmërisë dhe
 - Vlerësimi i rezultateve, duke përfshirë projektimin e rezultateve të gjithë popullatës nëse mostra është zgjedhur duke përdorur procedurat statistikore.

Projekti model, Madhësia dhe Përzgjedhja e artikujve për testim

- P5. Kur projektohet përzgjedhja e dokumentave të auditimit siç kërkohet në paragrafin 6 të ISA, audituesit e sektorit publik mund të kenë përgjegjësi më të madhe nën mandat, siç thuhet në P3 më sipër. Në situata të tilla audituesit e sektorit publik mund të caktojë nivele të ndryshme të parametrave, duke përfshirë materialitetin si dhe një nivel më të lartë besueshmërie, dhe kjo mund të ndikojë në madhësinë e përzgjedhjes së dokumentacionit. Audituesit e sektorit publik shpesh përdorin përzgjedhjen e dokumentave të auditimit për të provuar efektivitetin e kontrolleve të brendshme dhe testimet thelbësore për përputhshmëri me autoritetet. Audituesit e sektorit publik mund të projektojnë modele të veçanta për të testuar kontrollin dhe përputhshmërinë ose mund të hartojnë një model për të testuar të dyja. Për shembull, një model i disbursimeve mund të përdoret për të testuar kontrollet mbi disbursimet si dhe nëse ato janë në përputhje me autoritetet.
- P6. Audituesit e sektorit publik kanë më shumë gjasa se audituesit e sektorit privat për të marrë në konsideratë nevojën për përzgjedhjen e informacionit jo-financiar. Si rezultat i objektivave të tjera të sektorit publik, të tilla si testimi i përputhshmërisë me autoritetet dhe rishqyrtimi i informacioneve jo-financiare që gjinden në pasqyrat financiare, audituesit e sektorit publik marrin në konsideratë nëse përzgjedhja e dokumentacionit do të jetë e dobishme në testimin e informacionit të tillë jo-financiar të përfshirë në pasqyrat financiare. Për shembull, nëse pasqyrat financiare të një spitali publik përdorin numrin e pacientëve të trajtuar për të llogaritur masat kyçe të performancës (të tilla si kosto për pacientin), audituesit e sektorit publik mund të marrin mostra për të testuar saktësinë e numrit të pacientëve të raportuar.
- P7. Audituesit e sektorit publik mund të jenë të detyruar të raportojnë informacion shtesë në lidhje me përzgjedhjen e dokumenteve të auditimit. Kërkesat të tilla mund të përfshijnë raportimin e metodave të përdorura në

përzgjedhje, nëse rezultatet e përzgjedhjes së dokumentacionit mund të projektohen në bazë të popullsisë, dhe në qoftë se është kështu, rezultatet e këtij parashikimi. Audituesit e sektorit publik mund të marrin parasysh këto nevoja, për të vendosur nëse do të përdorim metoda statistikore apo jo-statistikore.

- P8. Udhëzime në përcaktimin e materialitetit për audituesit e sektorit publik mund të gjenden në ISSAI 1320¹³⁷⁾.

Natyra dhe Shkaku i Devijimeve dhe Deklaratave të Gabuara.

- P9. Kur analizohen devijimet dhe identifikohen deklaratat e gabuara siç thuhet në paragrafin A17 të ISA, audituesit e sektorit publik mendojnë se ata mund të kenë zgjatur auditimin dhe raportimin përgjegjësive që lidhen me mashtrimin. ISSAI 1240¹³⁸⁾ jep informacion shtesë për audituesit e sektorit publik në lidhje me mashtrimin.

Projektimi i deklaratave të gabuara.

- P10. Një studim i qartë nevojitet për projektimin e deklaratave të gabuara për marrjen e provës materiale. Paragrafi A20 për ISA thekson se për testet e kontrolleve, asnjë projektim i qartë i devijimeve nuk është i nevojshëm përderisa kursi i devijimit të përzgjedhjes së dokumentacionit është gjithashtu shkalla e projektuar e devijimit për popullatën në tërësi. Gjatë përzgjedhjes së dokumentave për testimin kontrolleve, audituesit e sektorit publik mund të kenë nevojë të projektojnë kursin e devijimit të popullsisë, duke përfshirë një interval besueshmërie, dhe të raportojë rezultatet e përzgjedhjes siç janë shënuar në paragrafin e mësipërm P7. Në disa mjedise të auditimit, si në Gjykatën e Llogarive, që raporton për normat e devijimit mund t'i kërkohet të shpjegojë, për shembull, mangësitë në kontrollin e brendshëm apo të mos-pajtueshmërisë me autoritetet.

137) ISSAI 1320 “, Materialiteti në planifikimin dhe kryerjen e auditimit.”

138) ISSAI 1240, “Përgjegjësitë e Audituesit lidhur me Mashtrimin në një Auditim të Pasqyrave Financiare.”

Vlerësimi i Rezultateve nga Përzgjedhja e Dokumentave të Auditimit

- P11. Përveç udhëzimeve në paragrafin A23, audituesit e sektorit publik marrin në konsideratë përgjegjësitë në bazë të mandatit të tyre kur menaxhimi nuk është në gjendje të sigurojë një shpjegim adekuat për devijime dhe deklarata të gabuara. Për shembull, audituesit e sektorit publik në mjedisin e Gjykatës së Llogarive mund të kenë nevojë të hetojnë më tej a r s y e t themelore për mungesën e informacionit dhe në përcaktimin se kush është përgjegjës.
- P12. Përveç udhëzimeve të paragrafit A23 (pika e dytë), audituesit e sektorit publik marrin në konsideratë për të raportuar çdo lloj përgjegjësie shtesë mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme dhe në rastet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet.

ISSAI 1540

Udhëzues i Auditimit Financiar

*AUDITIMI I LLOGARIVE
FINANCIARE
DUKE PËRFSHIRË VLERSIMIN E
DREJTË TË LLOGARIVE
FINANCIARE TË LIDHURA ME
DHËNIEN E INFORMACIONEVE
SHPJEGUESE*

Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 540

Tabela e Përmbajtjes ISSAI 1540

Shënim praktik për ISA 540¹³⁹⁾	Paragrafi
Historiku	
Hyrje në ISA	
Përmbajtja e shënimit praktik	P1
Aplikimi i ISA në auditimin e sektorit publik	P2
Udhëzime shtesë në lidhje me çështjet e sektorit publik	P3
Natyra e Vlerësimeve Kontabël	P4-P6
Objektivat	P7
Procedurat e vlersimit të riskut dhe aktivitetet e lidhura	P8
Identifikimi dhe Vlerësimi i riskut të gabimeve materiale	P9
Përgjigjet ndaj rreziqeve të vlersimit të deklarimeve të gabuara	P10
Procedurat e mëtejshme në lidhje me përgjigjen ndaj rreziqeve të mëdha	P11
Vlersimii arsyeshmërisë së llogarive financiare dhe përcaktimi i gabimeve material	P12
Indikatorët e paragjykitimit të menaxhimit	P13-P14

139) Të gjitha shënimet praktike konsiderohen së bashku me ISSAI 1000 – Hyrje e Përgjithshme në INTOSAI - Udhëzime të Auditimit Financiar.

Auditimi i llogarive financiare duke përfshirë vlerësimin e drejtë të llogarive financiare të lidhura me dhënien e informacioneve shpjeguese

Historiku

Kjo praktikë synon një manual shtesë për përdorimin e ISA 540 në Auditimin financiar të llogarive, duke përfshirë, drejtësinë në llogarinë e vlerave financiare dhe në informacionet shpjeguese. Ajo lexohet sëbashku me ISA. ISA 540 është efektive për auditimin e llogarive financiare për periudhën mbas 15 dhjetorit 2009. Kjo praktikë në këtë datë ka të njëjtën efektivitet si ISA.

Hyrje në ISA

ISA 540 lidhet me përgjegjësinë e audituesve në lidhje me auditimin e llogarive financiare, duke përfshirë vlerësimin e drejtë të llogarive financiare dhe të informacioneve shpjeguese në auditimin e pasqyrave financiare. Në veçanti, ai lidhet me mënyrën se si ISA 315¹⁴⁰⁾ dhe ISA 330¹⁴¹⁾ dhe ISA e përshtatshme aplikohen në auditimin e llogarive financiare. Ai gjithashtu përfshin kërkesat dhe udhëzime mbi vlerësimin e anomalive të llogarive kontabël të veçanta, dhe të indikatorëve të mundshëm të ndikimit të drejtimit.

Përmbajtja e shënimit praktik

P1 Kjo përmbajtje e shënimit praktik siguron një udhëzim shtesë për audituesit e sektorit publik, që lidhet me:

- a) Natyrën e llogarive financiare.
- b) Objektivat .

140) ISA 315, “Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të anomalive materiale nëpërmjet të kuptuarit të Entitetit dhe mjedisit të tij”

141) ISA 330, “Përgjigjet e Audituesit ndaj rreziqeve të vlerësuara”.

- c) Proceduar e vlerësimit të riskut dhe aktivitetet e lidhura.
- d) Identifikimin dhe vlerësimin e riskut të materialitetit të gabimeve materiale
- e) Përgjigjen ndaj vlerësimit të gabimeve materiale në deklaratat e gabuara.
- f) Procedurat e mëtejshme që lidhen me përgjigjen e ndaj risqeve të rëndësishme
- g) Vlerësimin dhe arsyeshmërinë e llogarive financiare dhe përcaktimin e anomalive.
- h) Treguesit e mundshëm të ndikimit të menaxhimit

Zbatueshmëria e ISA në auditimin e realizuar në sektorin publik

P2. ISA 540 është i apikueshëm në auditimin e entiteteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të pasqyrave financiare.

Udhëzime shtesë për Çështje te sektorit publik

P3. ISA 540 përmban aplikimin dhe materiale të tjera shpjeguese që duhet të merren në konsideratë nga subjektet e veçanta publike të listuara në paragrafin A11 të ISA.

Natyra e Llogarive Financiare

P4. Kur dhe si subjektet e sektorit publik i përdorin llogaritë financiare varet nga lloji i zerave financiare dhe nga përmbajtja e zbatimit të raportit financiar . Disa llogari të rëndësishme të sektorit publik mund të lidhen me aktivet, detyrimet dhe informacionet shpjeguese të tilla si:

- Programet e sigurimit social;
- Programet e qeverisë në lidhje me pensionet;
- Programet e Kujdesit ndaj shëndetit;
- Programet e përfitimit të Veteranëve ;
- Programet qeveritare të Garancisë;
- Detyrimet mjedisore;
- Të ardhurat nga taksat dhe arkëtimet; dhe

- Prona dhe pajisje të veçanta, të tilla si pajisje të specializuara ushtarake dhe asete të trashëguara

P5. Në varësi të natyrës së operacioneve qeveritare, për disa llogari financiare të entiteteve publike do të duhet një nivel i lartë vlerësimi për të garantuar aktivitetin e subjekteve problematike.

P6. Në lidhje me praktiken e paraqitur në Paragrafin A11 të ISA, matja e vlerësimit të drejtë nuk kërkohet gjithmonë në kuadrin e zbatimit të raportit financiar. Në këto raste audituesit e sektorit publik vlerësojnë metoda alternative të përdorura dhe të kërkuara në përputhje me përmbajtjen e raportit financiar.

Objektivat

P7. Duke patur parasysh objektivat e ISA për të siguruar llogari të mjaftueshme, për të cilat llogaritë financiare janë përgjegjëse dhe informacionet shpjeguese janë të lidhura me përmbajtjen e raportit financiar, audituesit e sektorit publik duhet të marrin në konsideratë elementet e mëposhtëm:

- Raporti i përmbajtjes financiare mund të kërkojë përfshirjen e informacionit jo-financiar të tillë si rezultatet e programeve dhe informacione të tjera operative. Ky informacion mund të jetë bazuar mbi llogaritë ose
- Në subjektet e sektorit publik, disa detyrime kanë një nivel të lartë pasigurie që përmbajtja e raportit financiar nuk e lejon njohjen e tyre, por mund të kërkojë informacione shpjeguese për pasigurinë e llogarisë. Kur këto detyrime potenciale kërcënojnë qëndrueshmërinë e programeve financiare, audituesit e sektorit publik mund të përdorin “Cështjet e theksuara” ose “Cështjet e tjera” që nxjerrin në pah përdorimin e burimeve

Procedurat e vlerësimit të riskut dhe aktivitetet e lidhuara.

P8. Në sektorin publik, shumë aktuale e detyrimeve afatgjata të llogarisë mund të mos njihet për një periudhë kohe të caktuar. Si pasojë paragrafi 9 i ISA dhe aplikimi material i përfshirë në paragrafin A39-A42 mund të mos lidhet me disa lloqri specifike. Për shëmbull, detyrimet e sigurimit social japin ndikim për disa vite në të ardhmen, prandaj audituesit e sektorit publik nuk do të jenë në gjëndje të përdorin aktivitetet pasuese për t'i vlerësuar ato.

Identifikimi dhe Vlerësimi i Riskut të Gabimit të Materialitetit

P9. Shumë programe të raportit financiar në sektorin publik nuk përmbajnë manuale në lidhje me dallimin midis ndryshimeve në llogaritë financiare dhe anomali në pasqyrën financiare, të cilat nuk mund të ndryshohen siç shpjegohet në paragrafin A44 e ISA. Në mungesë të manualeve të aplikuara në përmbajtjen e raportit financiar, audituesit e sektorit publik mund të përdorin manuale të çështjeve të tjera.

Përgjigjet ndaj vlerësimit të riskut të gabimit material

P10. Kjo konsideron faktin se kërkohen aftësi dhe njohuri të specializuara në lidhje me një ose më shumë aspekte të llogarive financiare, në mënyrë që të përftohet dëshmi e përshtatshme dhe e mjaftueshme si në paragrafin 14 të ISA, disa aftësi të specializuara që mund të lidhen në mënyrë të veçantë me :

- Programet e shërbimit social;
- Planet qeveritare për pensionet në lidhje me të punësuarit; dhe
- Programet e kompensimit për veteranët

Udhëzimet e mëtejshme që lidhen me ekspertët, përfshihen në ISSAI 1620¹⁴²⁾.

142) ISSAI 1620 "Përdorimi i punës së një eksperti të Audituesit"

Procedurat e pavarura të mëtejshme për t'ju përgjigjur risqeve domethënëse

P11. Kur vlerësohen llogaritë financiare në përputhje me kërkesat e paragrafit 15 të ISA, audituesit e sektorit publik mund të përballen me faktin që menaxhimi nuk ndërmerr veprime të caktuara që nxjerrin elementë të caktuar të menaxhimit, mbi të cilat janë bazuar veprimet e tyre, të cilat mund të nxirren në pah gjatë auditimit të entitetit publik, si rrjedhojë e proceseve politike.

Vlerësimi i përgjegjësisë së llogarive financiare dhe Përcaktimi i deklaratave të gabuara

P12. Kur pasqyrat financiare të sektorit publik përfshijnë një numër të madh llogarish, të cilat mund të kenë një numër të madh llogarish të pasigurta, audituesit e sektorit publik duhet të vlerësojnë mjaftueshmërinë e dokumentave që lidhen me zërin e llogarisë së pasigurtë dhe të evidentojnë efektin në raportin e auditimit.

Indikatorët e paragjyqimeve të menaxhimit

P13. Audituesit e sektorit publik rishikojnë gjykimet dhe vendimet e marra nga menaxhimi në përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në përgatitjen e llogarive financiare, për të identifikuar indikatorët e mundshëm të paragjyqimit të menaxhimit në përputhje me paragrafin 21 të ISA. Në realizimin e kësaj, ata mund të paraqesin arsye paragjyquese që janë specifike për sektorin publik, të tilla si :

- Motive të politikave të forta
- Ndryshime ose jostabilitet të mjedisit politik
- Rritja e pritshmërive të publikut
- Pritjet më lart se normalisht për të arritur buxhetin
- Reduktimi i buxhetit pa u përputhur me pritshmërinë e ofruar nga shërbimet
- Bashkëpunimime publikun dhe me sektorin privat

- Tolerancë e gabimeve në pasqyrat financiare.

P14. Audituesit e sektorit publik që veprojnë në mjedise të tillë si mjedisi i Gjykatës së Llogarive, mund të kenë përgjegjësi shtesë, kur konsatojnë qëllimin e menaxhimit për të mashtruar. Përgjegjësitë e tilla shpesh përfshijnë identifikimin e individit, përgjegjës për veprimet e tilla dhe rekomandojnë paraqitjen e akuzave të duhura civile dhe penale kundër tyre.

ISSAI 1550

Udhëzues i Auditimit Financiar

PALËT E NDËRLIDHURA

Shënim për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 550

Tabela e përmbajtjes ISSAI 1550¹³⁶⁾

Shënim Praktik për ISA 550¹⁴³⁾

Paragrafi

Mjedisi

Prezantim me ISA

Përmbajtja e Shënimeve P1

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik P2

Udhëzues Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik P3

Konsiderata të Përgjithshme P4

Përkufizime P5-P7

Procedurat e vlerësimit të riskut dhe aktivitetet e ngjashme P8-P10

Identifikimi dhe vlerësimi i riskut të gabimeve materiale lidhur
me marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve. P11-P13

Përgjigjet ndaj riskut të gabimeve materiale që lidhen
me marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve P14-P16

143) Të gjitha Shënimet konsiderohen së bashku me ISSAI 1000, "Hyrje e Përgjithshme në Udhëzimet Financiare të Auditimit të INTOSAI-t."

Palët e ndërlidhura

Mjedisi

Ky Shënim jep udhëzime shtesë për ISA 550 - Palët e ndërlidhura. Lexohet së bashku me ISA-në. ISA 550 hyn në fuqi për auditimin e pasqyrave financiare për periudhën pas datës 15 dhjetor 2009. Ky shënim hyn në fuqi në të njëjtën datë si ISA-ja.

Hyrja në ISA

ISA550 merret me përgjegjësitë e audituesve lidhur me marrëdhëniet e palëve dhe transaksionet në pasqyrat e auditimit financiar. Aty trajtohet gjerësisht mënyra se si ISA 315, ISA330 dhe ISA 240¹⁴⁴⁾ duhet të zbatohen në lidhje me risqet e gabimeve materialeve lidhur me marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të ndërlidhura.

Përmbajtja e Shënimeve

P1. Shënimet japin udhëzime shtesë për audituesit e sektorit publik në lidhje me:

- a) Konsideratat e përgjithshme.
- b) Përkufizimet.
- c) Procedurat e vlerësimit të riskut dhe aktivitetet e ngjashme.
- d) Identifikimi dhe vlerësimi i riskut të gabimeve materiale lidhur me marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve.
- e) Përgjigjet ndaj riskut të gabimeve materiale lidhur me marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve.

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik

P2. ISA 550 është i aplikueshëm për audituesit e subjekteve të sektorit publik, në rolin e tyre si auditues të pasqyrave financiare.

144) ISA 315, "Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të anomaliave materiale nëpërmjet të kuptuarit të Entitetit dhe mjedisit të tij", ISA 330, "Përgjigjet e Audituesit ndaj rreziqeve të vlerësuar" dhe ISA 240, "Përgjegjësitë e Audituesit lidhur me Mashtrimin në një Auditim të Pasqyrave Financiare. "

Udhëzues Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

P3. ISA 550 përmban aplikimin dhe materiale të tjera shpjeguese, ku një vëmendje e veçantë i kushtohet subjekteve të sektorit publik, në paragrafin A8 të ISA-së.

Konsiderata të përgjithshme

P4. Njësitë e sektorit publik mund të jenë subjekt i kufizimeve të caktuara mbi natyrën dhe qëllimin e transaksioneve që ata mund të kenë në lidhje me palët. Kufizimet mund të ndalojnë kryerjen e transaksioneve ose praktikave që mund të jenë të lejueshme në marrëdhëniet mes palëve jashtë sektorit publik.

Përkufizimet

P5. Paragrafi 10 (b) i ISA-së, jep një përkufizim të palëve të ndërlidhura, ku kuadri i aplikueshëm financiar vendos kërkesat minimale të palëve, përfshirë këtu subjektin nën kontroll të përbashkët. Audituesit e sektorit publik do të vënë re se sipas këtij përkufizimi, subjektet që janë nën kontroll të përbashkët nga një shtet (dmth një qeveri kombëtare, rajonale apo lokale) nuk konsiderohen të lidhura, nëse ata nuk angazhohen në transaksione të rëndësishme ose të ndajnë pasuri të konsiderueshme me njëri-tjetrin.

P6. Audituesit e sektorit publik gjykojnë nëse përjashtimi nga përkufizimi i palëve të ndërlidhura, për subjektet nën kontrollin e përbashkët nga shteti, i drejton ata në rreziqe madhore në auditimin e subjekteve të sektorit publik. Për shembull, mund të jetë një situatë e tillë ku një ministër kontrollon një numër të caktuar subjektesh. Ndërsa këto subjekte nuk mund të ndajnë pasuri ose të kryejnë transaksione deri në një masë të konsiderueshme, atëherë do të ketë shumë transaksione në dukje të parëndësishme, të cilat mund të konsiderohen të parregullta. Gjithashtu mund të ketë situata ku nuk ka asnjë transaksion, për shembull ministri

mund të ushtrojë ndikim në një subjekt, duke bërë të mundur që të mos i paguaj dividend një subjekti tjetër në mënyrë që të ndikojë në likuiditet dhe në marrjen e vendimeve të përshtatshme për buxhetin.

P7. Audituesit e sektorit publik kanë parasysh përkufizimin më të gjerë të palëve të ndërlidhura kur zbatojnë ISA-në.

Procedurat e vlerësimit të riskut dhe aktivitetet e ngjashme

P8. Në kuptimin e subjektit të sektorit publik për marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve të ndërlidhura, si shtojcë e procedurave të përshkruara në paragrafët 11 deri 14 të ISA-së, audituesit e sektorit publik kanë lidhje me:

- Strukturat ligjore dhe kërkesat rregullatore që qeverisin subjektet dhe palët e ndërlidhura, për shembull nëse njësia ekonomike është një ministri, departament, agjenci apo një lloj tjetër organi publik;
- Kuptimi i operacioneve të biznesit shpesh do të përfshijë marrjen e njohurive për lloje të aktiviteteve që kryen qeveria duke përfshirë programet përkatëse dhe ku subjektet kryesore duhet të angazhohen në ekzekutimin e këtyre programeve;
 - Strukturat organizative për kontrollin e subjektit dhe krijimin e përgjegjshmërisë, duke pranuar se në sektorin publik personat që qeverisin shërbejnë si përfaqësues të qytetarëve. Pronësia e subjekteve të sektorit publik nuk mund të ketë rëndësi të njëjtë si në sektorin privat;
- Kuptimin e kërkesave të subjekteve ekonomike raportuese, duke përfshirë këtu edhe ato për zbulimin e marrëdhënieve dhe transaksioneve të palëve të ndërlidhura.
- Rregullore të tjera mund të jenë të rëndësishme për aftësinë e subjektit të sektorit publik për të ushtruar biznes mepalët e ndërlidhura. Kjo duhet të jetë në përputhje me rregulloret e prokurimit, të cilat mund të përfshijnë një kërkesë për subjektet e sektorit publik për të treguar se transaksionet

me palët e ndërlidhura kryhen në mënyrë të pavarur dhe të njëvlerëshme.

- P9. Në sektorin publik, diskutimi mbi ndjeshmërinë e pasqyrave financiare të subjektit për gabimet materiale mund të mbulojë gjithashtu objektivat shtesë dhe risqet e lidhura me gabimet e materialeve, si diskutohet në paragrafin A8 të ISA-së. Audituesit e sektorit publik mund të përfshijnë edhe auditues të angazhuar në auditimet e performancës dhe aktivitete të tjera të auditimit të subjektit në një diskutim të tillë.
- P10. Në sektorin publik, diskutimi midis ekipit të angazhuar në lidhje me mashtrimet mund të përfshijnë edhe ndjeshmërinë e procesit të prokurimit të subjektit që ka kryer mashtrimin mes palëve të ndërlidhura.

Identifikimi dhe vlerësimi i riskut të gabimeve materiale lidhur me marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve.

- P11. Përveç pohimeve të përcaktuara në paragrafin 113 të ISA-së 315, nga menaxhimi i subjekteve të sektorit publik mund të pohohet se transaksionet dhe ngjarjet janë kryer në përputhje me legjislacionin ose autoritetin e duhur. Pohimetë tilla mund të shtrihen në marrëdhëniet dhe transaksionet me palët e ndërlidhura për të arritur qëllimin e auditimit të pasqyrave financiare.
- P12. Audituesve të sektorit publik mund t'u kërkohet të marrin në konsideratë kuadrin ligjor, rregulloret që qeverisin subjektin dhe çfarëdo kërkesë specifike apo kufizime që mund t'í vendosin subjektit, personat që qeverisin dhe kryejnë transaksionet me njërën palë. Mund të ketë edhe kufizime në kapacitetin e subjektit për t'u përcaktuar tërësisht ose pjesërisht si pronë e subjekteve të cilat do të konsiderohen si palët e ndërlidhura.
- P13. Gjithashtu mund të ketë një kërkesë për ata që qeverisin, për subjektet e sektorit publik, menaxhimin dhe punonjësit për të deklaruar interesat e tyre për subjektet me të cilat ata veprojnë në baza profesionale ose tregtare. Kur kërkesa të tilla legjislative ekzistojnë, audituesit e sektorit publik duhet të zbatojnë procedurat e vlerësimit të riskut për të identifikuar dhe vlerësuar

rreziqet e anomalitë materiale që rrjedhin nga mos-përputhshmëria me këto kërkesa.

Përgjigjet ndaj riskut të gabimeve materiale që lidhen me marrëdhëniet dhe transaksionet e palëve

P14. Gjatë hartimit dhe kryerjes së procedurave të auditimit për t'iu përgjigjur rreziqeve të anomalive materiale që rezultojnë nga palët e lidhura, si përshkruhet në paragrafët 20 deri 24 të ISA-së, Audituesit e sektorit publik marrin në konsideratë nëse mund të ketë kërkesa shtesë për të raportuar në sektorin publik, të tilla si ato në rregullore.

P15. Paragrafi 23 (b) i ISA-së thekson se audituesit duhet të gjejnë prova ku tregohet që transaksionet e rëndësishme mes palëve të ndërlidhura, jashtë rrjedhës normale të subjektit të biznesit, janë të autorizuar në mënyrë të përshtatshme dhe të miratuara. Në sektorin publik, mandati i auditimit mund të përfshijë përgjegjësinë për të raportuar në përputhje me ligjet dhe rregulloret. Kjo mund të përfshijë një përgjegjësi për të marrë dëshmi se marrëdhëniet dhe transaksionet me palët e ndërlidhura janë në përputhje me ligjet dhe rregulloret si edhe janë të autorizuar dhe miratuara. Audituesve të sektorit publik mund t'i kërkohej gjithashtu të kërkojnë dëshmi që menaxhimi ka marrë autorizim dhe miratim nga parlamenti, ministria e financave, apo një mbikëqyrës ose një departament sponsorizues, ose nga organi përkatës mbikëqyrës. Këto procedura mund të aplikohen pavarësisht faktit nëse transaksionet janë të rëndësishme, ose jashtë rrjedhës normale të biznesit.

P16. Paragrafi 24 i ISA-së kërkon që audituesit të gjejnë dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme në lidhje me menaxhimin dhe që transaksionet e palëve të lidhura janë kryer në kushte të njëjta me ato mbizotëruese në një transaksion të kryer në mënyrë të pavarur dhe të njëvlerëshme. Në ligjet e sektorit publik dhe rregullat që lidhen me prokurimin mund të kërkohej që kontrata me palët e treta, duke përfshirë palët e ndërlidhura, të jenë subjekt i një tenderimi konkurrues apo ndonjë formë tjetër të testimit të tregut për të treguar vlerën e parasë.

ISSAI 1560

Udhëzues i Auditimit Financiar

NGJARJET VIJUESE

Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 560

Tabela e përmbajtjes ISSAI 560

Shënime për ISA 560 ¹⁴⁵⁾	Paragrafi
Mjedisi	
Prezantim me ISA-në	
Përmbajtja e Shënimeve	P1
Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik	P2
Udhëzues Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik	P3-P5
Ngjarjet që kanë ndodhur ndërmjet datës së pasqyrave financiare dhe datës së raportit tëaudituesit	P6-P7
Fakte që i bëhen të ditura audituesit pas publikimit të pasqyrave financiare	P8

145) Të gjitha shënimet praktike konsiderohen së bashku me ISSAI 1000 "Hyrje e Përgjithshme në ONSNA/ISA Udhëzime të Auditimit Financiar.

Ngjarjet vijuese

Mjedisi

Ky Shënim jep udhëzime shtesë për ISA-në 560 - Ngjarjet vijuese. Lexohet së bashku me ISAnë. ISA 560 hyn në fuqi për auditimin e pasqyrave financiare për periudhën pas datës 15 dhjetor 2009. Ky shënim hyn në fuqi në të njëjtën datë si ISA-ja.

Hyrja në ISA

ISA 560 merret me përgjegjësitë e audituesve lidhur me ngjarjet në vijim në pasqyrat e auditimitfinanciar. Pasqyrat financiare mund të ndikohen nga ngjarje të caktuara që ndodhin pas datës së pasqyrave financiare. Shumë raportime në kuadrin financiar i referohen në mënyrë specifike ngjarjeve të tilla¹⁴⁶). Këto raportime në kuadrin financiar zakonisht identifikojnë dy lloje ngjarjesh:

- a) Ata që japin prova të kushteve që ekzistojnë në datën e pasqyrave financiare,
- b) Ata që japin prova të kushteve që u ngritën pas datës së pasqyrave financiare.

ISA 700 shpjegon se data e raportit të audituesit informon lexuesin se audituesi ka marrë në konsideratë rezultatet e ngjarjeve dhe transaksioneve për të cilat audituesi bëhet i vetëdijshëm që kanë ndodhur deri në atë datë¹⁴⁷).

Përmbajtja e Shënimeve

P1. Shënimet japin udhëzime shtesë për audituesit e sektorit publik në lidhje me:

- a) Ngjarjet që kanë ndodhur ndërmjet datës së pasqyrave financiare dhe datës së raportit të audituesit
- b) Fakte që i bëhen të ditura audituesit pas publikimit të pasqyrave financiare.

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik

P2. ISA 560 është i aplikueshëm për audituesit e subjekteve të sektorit publik, në rolin e tyre si auditues të pasqyrave financiare.

146) Për shembull, Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit (IAS) 10, "Ngjarjet pas periudhës së raportimit" merret me trajtimin e pasqyrave financiare të ngjarjeve, si të favorshme ose të pafavorshme, që ndodhin midis datës së pasqyrave financiare (të referuara si "fondi i periudhës raportuese" në IAS) dhe datës kur pasqyrat financiare janë të autorizuar për këtë çështje.

147) ISA 700, "Formimi i mendimit dhe Raportimi mbi Pasqyrat Financiare". Paragrafi A38

Udhëzues Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

- P3. ISA 550 përmban aplikimin dhe materiale të tjera shpjeguese, ku një vëmendje e veçantë i kushtohet subjekteve të sektorit publik, në paragrafët A5, A10, A14 dhe A17 të ISA-së.
- P4. Kërkesat e sektorit publik në lidhje me ngjarjet e mëvonshme mund të jenë të ndryshme për sa i përket datës së raportit të audituesit dhe kërkesa të tjera siç përcaktohet nga legjislacioni përkatës. Audituesit e sektorit njihen me legjislacionin në fuqi si edhe me ngjarjet e mëvonshme.
- P5. Kur mandati i auditimit përfshin objektivat për rregullsinë e transaksioneve të audituesve të sektorit publik, ata mund të kenë nevojë të marrin në konsideratë ngjarjet e mëvonshme të cilat mund të ofrojnë prova të tjera mbi rregullsinë e transaksioneve, të tilla si rezultatit e një çështje gjyqësore. Audituesit e sektorit publik marrin në konsideratë ISSAI 420¹⁴⁸.

Ngjarjet që kanë ndodhur ndërmjet datës së pasqyrave financiare dhe datës së raportit të audituesit

- P6. Përveç pyetjeve specifike të identifikuara në paragrafin A9 të ISA-së, audituesit në sektorin publik mund të marrin në konsideratë ngjarjet që kanë ndodhur dhe të cilat:
- a) kanë rëndësi për aftësinë e subjektit qeverisës për të përmbushur objektivat e programit,
 - b) mund të ndikojë në paraqitjen e çdo informacioni të performancës në pasqyrat financiare.
- P7. Përveç procedurave të përshkruara në paragrafin A10 të ISA-së, audituesit e sektorit publik konsiderojnë çështje që rrjedhin nga procedurat përkatëse të legjislacionit dhe organeve të tjera përkatëse, për të cilat audituesit e

148) ISSAI 420, "Udhëzimet e Auditimit të Përputhshmërisë - Auditimi i Përputhshmërisë lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare."

sektorit publik ndërgjegjësohen gjatë auditimit, ku rezultatet e tyre mund të kërkojnë korrigjime në pasqyrat financiare

Fakte që i bëhen të ditura audituesit pas publikimit të pasqyrave financiare

P8. Si është përcaktuar në paragrafët A16 dhe A18 të ISA-së, audituesit e sektorit publik mund të kërkojnë këshilla ligjore dhe të shqyrtojnë raportimin në organet përkatëse ligjore.

ISSAI 1570

Udhëzues i Auditimit Financiar

PROBLEMET NË VIJIM

Shënimi për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 570

Tabela e përmbajtjes ISSAI 1570

Shënime për ISA-në 570¹⁴⁹⁾ **Paragrafi**

Mjedisi

Prezantim me ISA-në

Përmbajtja e Shënimeve P1

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik P2-P3

Udhëzues Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik P4

Problemet në vijim P5-P9

Vlerësimi i njohurive menaxhuese P10

Procedurat plotësuese të auditimit kur ngjarjet ose kushtet

janë identifikuar P11-P12

Identifikimi i problemeve në vijim nuk nënkupton se mund të mos

ekzistojnë pasiguri materiale P13-P16

149) Të gjitha Shënimet konsiderohen së bashku me ISSAI 1000, "Hyrje e përgjithshme në Udhëzimet Financiare të Auditimit të INTOSAI-t."

Problemet në vijim

Mjedisi

Ky Shënim jep udhëzime shtesë për ISA 570 - Problemet në vijim. Lexohet së bashku me ISAnë. ISA 570 hyn në fuqi për auditimin e pasqyrave financiare për periudhën pas datës 15 dhjetor 2009. Ky shënim hyn në fuqi në të njëjtën datë si ISA-ja.

Hyrja në ISA

ISA 570 merret me përgjegjësitë e audituesve në pasqyrat financiare lidhur me menaxhimin dhe vlerësimin e problemeve në vazhdimësi gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare.

Përmbajtja e Shënimeve

P1. Shënimet japin udhëzime shtesë për audituesit e sektorit publik në lidhje me:

- a) Problemet në vijim.
- b) Vlerësimin e njohurive menaxhuese.
- c) Procedurat plotësuese të auditimit kur ngjarjet ose kushtet janë identifikuar.
- d) Identifikimi i problemeve në vijim nuk nënkupton se mund të mos ekzistojnë pasiguri materiale.

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik

- P2. ISA 570 është i aplikueshëm për audituesit e subjekteve të sektorit publik, në rolin e tyre si auditues të pasqyrave financiare.
- P3. Sikurse shpjegohet në paragrafin A1 të ISA-së, përdorimi i menaxhimit të problemeve në vijimësi është i përshtatshëm edhe për subjektet e sektorit publik. Qeveritë sovrane dhe në veçanti, qeveritë sovrane qendrore, zakonisht nuk falimentojnë ligjërisht sepse ato kanë kompetenca të gjera për të vënë normat, tarifatat ose taksat dhe kështu janë në gjendje për të menaxhuar të ardhurat si edhe për të përmbushur detyrimet e tyre. Megjithatë, në disa raste qeveritë mund të kenë detyrime të konsiderueshme neto sipas ekonomisë ose aftësisë së tyre për të vënë norma, taksa apo tatime, ose mund të varen nga ndihma e qeverive të tjera. Edhe pse nuk është e zakonshme, qeveritë sovrane, duke përfshirë edhe qeveritë sovrane qendrore, mund të mos jenë në gjendje për të përmbushur detyrimet e tyre, për shembull, kur gjërat e planifikuara për t'u përmbushur nuk kryhen. Paaftësia e qeverisë që të përmbushë detyrimet e veta mund të ndikohet gjithashtu edhe nëse sasia e monedhave të hedhura në treg nga qeveria, ose nga banka qendrore në mënyrë të saj, vazhdon të pranohet si një mjet shkëmbimi për të shlyer detyrimet financiare të qeverisë. Për këtë arsye, audituesit e sektorit publik aplikojnë kërkesat dhe udhëzimet e ISA-së.

Udhëzues Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

P3. ISA 570 përmban aplikimin dhe materiale të tjera shpjeguese, ku një vëmendje e veçantë i kushtohet subjekteve të sektorit publik, në paragrafët A1 të ISA-së.

Problemet në vijim

P5. Audituesit e sektorit publik mund të kenë përgjegjësi në lidhje me vijimësi të tjera nga ato që përmenden drejtpërdrejt në ISA 570. Audituesve të sektorit publik mund t'u kërkohej që të rishikojnë dhe raportojnë mbi marrëveshjet e subjekteve për të ruajtur pozitën e përgjithshme financiare.

P6. Subjektet e sektorit publik mund të shpenzojnë më shumë gjatë një viti sesa kanë burime në dispozicion, të tilla që të ardhurat mund të jenë më të pakëta se shpenzimet e tyre, ose ekziston një borxh mbi pasuritë. Megjithatë, kjo është e pazakontë për ekzistencën e një subjekti të sektorit publik, ku shkalla e tyre e operacioneve ulet detyrimisht si rezultat i një paaftësie për të financuar operacionet e saj ose detyrimet neto.

P7. Ndërprerja e veprimtarisë së një subjekti të sektorit publik ka shumë gjasa të rezultojë nga një vendim i

politikave të qeverisë. Një vendim politik mund të merret për të shpërbërë një subjekt në tërësinë e tij, të zvogëlojë operacionet e tij dhe të transferojë disanga funksionet e tij në një tjetër subjekt publik, të shkrihet me një tjetër subjekt publik ose ta privatizojnë subjektin. Në secilin prej këtyre rasteve veprimtaria ekzistuese e të gjithës ose e një pjese të subjektit pushon së ekzistuari. Vetëm në rastin e shpërbërjes pa ndonjë vazhdimësi të veprimtarisë së subjektit nuk do të mund të ishin të përshtatshme të zbatoheshin këto standarde. Në raste të tjera audituesit e sektorit publik marrin në konsideratë bazat mbi të cilat aktivitetet janë transferuar, nga pikëpamja e subjektit që po heq dorë nga pronat dhe detyrimet.

P8. Në formimin e një panorame të aftësisë së subjektit për të vazhduar

operacionet e tij, audituesit e sektorit publik marrin në konsideratë dy faktorë të veçantë, por që nganjëherë dhe mbivendosen me njëri-tjetrin:

- Rreziku më i madh lidhur me ndryshimet në drejtim të politikave (për shembull, kuka një ndryshim në qeveri)
- Rreziku duhet të jetë sa më i ulët për veprimet e zakonshme ose ato të biznesit (për shembull, kur një subjekt nuk ka kapital të mjaftueshëm për të vazhduar operacionet e tij në nivelin ekzistues).

P9. Për të minimizuar rrezikun e ndryshimeve në politikat qeveritare, të cilat nuk janë në vëmendjen e audituesit dhe që mund të ndikojnë në vijimësisë, audituesi konstaton se:

- Qeveria ka shpallur synimin e saj për të shqyrtuar një sërë politikash që ndikojnë në subjektin e audituar,
- Një përmbledhje është shpallur dhe është në progres.
- Një përmbledhje ka treguar se e ardhmja e një subjekti mund të rishqyrtohet,
- Ekziston një politikë e qeverisë për privatizimin e aktiviteteve të subjektit të audituar.

Vlerësimi i njohurive menaxhuese

P10. Audituesit e sektorit publik janë të vetëdijshëm se ndryshimet e politikave të qeverisë mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në statusin dhe funksionimin e subjekteve të sektorit publik. Megjithatë, vendimet politike janë shpesh më të pasigurta sesa risqet e paparashikuara me të cilat përballen subjektet e sektorit privat.

Procedurat plotësuese të auditimit kur ngjarjet ose kushtet janë identifikuar

P11. Kur merren parasysh kërkesat e paragrafit 16 të ISA-së, audituesit e sektorit publik gjykojnë nëse subjekti duhet të kërkoj konfirmimin e drejtpërdrejt nga departamenti apo organi ekzekutiv përgjegjës për të siguruar

mbështetjen financiare apo fondet e ardhshme të subjektit. Kur kërkojnë një konfirmim të tillë, audituesit e sektorit publik duhet të marrin parasysh çdo kufizim të vendosur nga procesi politik. Në rrethana të tilla, një përfaqësim i mundësuar nga nëpunësi përgjegjës financiar i subjektit, që do të marrë mbështetje financiare mund të mos jetë i mjaftueshem për të siguruar të ardhmen e subjektit. Kjo ndodh për shkak se synimet e përkrahësve financiarë nuk mund të jenë të njohura nga subjekti.

P12. Përveç procedurave të auditimit të përcaktuara në A15 të ISA-së, audituesit e sektorit publik mund të lexojnë edhe të dhënat zyrtare të ndryshimeve në politikë, procedurat përkatëse të legjislacionit dhe të hetojë në lidhje me çështjet e trajtuara në procedurat për të cilat të dhënat zyrtare nuk janë ende në dispozicion.

Identifikimi i problemeve në vijim nuk nënkupton se mund të mos ekzistojnë pasiguri materiale

P13. Paragrafët 19 dhe 20 të ISA-së përmbajnë kërkesa për audituesin kur zbulohet gabim në materialet e pasqyrës financiare si edhe kur zbulimi i tillë nuk është bërë. Paragrafët A21 deri në A24 të ISA-së japin ilustrime të paragrafëve me rëndësi në lidhje me çështjen, kur zbulimi është kryer ose kur ai nuk është kryer. Ilustrimet lidhur me sektorin publik janë dhënë në paragrafët P14 deri në P16 si më poshtë.

P14. Ilustrimi i paragrafit me rëndësi në lidhje me çështjen, kur kontrollorët e sektorit publik janë të kënaqur për sa i përket mjaftueshmërisë së zbulimit:

Rëndësia për çështjen

Pa e cilësuar opinionin tonë, ne tërheqim vëmendjen ndaj Shënimit X në pasqyrat financiare që tregon se qeveria ka ndërmarrë një rishikim të operacioneve të ardhshme të agjencisë, por nuk ka vendosur ende një kurs veprimi. Kjo situatë, së bashku me çështje të tjera siç përcaktohet në shënimin X, tregon ekzistencën e pasigurisë materiale që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme në lidhje me aftësinë e agjencisë për të vazhduar.

P15. Ilustrim i paragrafëve përkatës kur një opinion i kualifikuar duhet të shprehet për shkak të deklarimit të pasigurisë materiale:

Baza për mendimin e kualifikuar

Qeveria ka ndërmarrë një rishikim të operacioneve të ardhshme të agjencisë, por nuk ka vendosur ende si të veprojë. Kjo situatë tregon për ekzistencën e një pasigurie materiale që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme në aftësinë e agjencisë për të vazhduar si një problem në vijim dhe për këtë arsye agjencia mund të mos jetë në gjendje të realizojë të ardhurat e saj dhe të paguajë detyrimet e saj në veprimtarinë normale. Pasqyrat financiare (dhe shënimet në to) nuk e nxjerrin këtë fakt.

Opinion i kualifikuar

Sipas mendimit tonë, me përjashtim të heqjes së informacionit të përmendur në paragrafin për Bazat për Opinion të Kualifikuar, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale (ose “japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë”) të pozicionit financiar të agjencisë më 31 dhjetor të vitit “X”, të performancës së saj financiare dhe të likuiditetit për vitin ushtrimor.

P16. Ilustrim i paragrafëve përkatës kur një opinion i kundërt duhet të shprehet për shkak të zbulimit të papërshtatshëm të një pasigurie materiale:

Bazat për opinion të kundërt

Qeveria ka vendosur që agjencia do të pushojë veprimtarinë dhe do të shpërndahet brenda vitit të ardhshëm. Kjo tregon një pasiguri materiale që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme në aftësinë e agjencisë për të vazhduar dhe për këtë arsye agjencia mund të mos jetë në gjendje të realizojë të ardhurat e saj dhe të paguajë detyrimet e saj në veprimtarinë normale. Pasqyrat financiare (dhe shënimet në to) nuk e nxjerrin këtë fakt.

Opinion i kundërt

Sipas mendimit tonë, për shkak të heqjes së informacionit të përmendur në paragrafin për Bazat për Opinion të Kualifikuar, pasqyrat financiare nuk paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale (ose nuk “japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë”) të pozicionit financiar të agjencisë më 31 dhjetor të vitit “X”, të performancës së saj financiare dhe të likuiditetit për vitin ushtrimor.

ISSAI 1580

Udhëzues i Auditimit Financiar

PASQYRIMI ME SHKRIM

Shënimi për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 580

Tabela e përmbajtjes ISSAI 1580

Shënime për ISA-në 580¹⁵⁰⁾ **Paragrafi**

Mjedisi

Prezantim me ISA-në

Përmbajtja e Shënimeve P1

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik P2

Udhëzues Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik P3

Konsiderata të përgjithshme P4-P5

Identifikimi i personave që bëjnë pasqyrimin me P6

Komunikimi i një pragu P7

Data dhe periudhat e nevojshme për përfaqësimet me shkrim P8

Dyshim për sa i përket besueshmërisë së përfaqësive të shkruara
dhe përfaqësimet e kërkuara me shkrim që nuk mundësohen P 9

Shtojca 1: Shembuj shtesë për Shtojcën 2 të ISA-së

“Letër Ilustruese Përfaqësimi”

150) Të gjitha Shënimet konsiderohen së bashku me Issai 1000, “Hyrje e përgjithshme në Udhëzimet Financiare të Auditimit të INTOSAI-t.”

Pasqyrimi me shkrim

Historiku

Ky Shënim jep udhëzime shtesë për ISA-në 580 - Pasqyrimi me shkrim. Lexohet së bashku me ISA-në. ISA 580 hyn në fuqi për auditimin e pasqyrave financiare për periudhën pas datës 15 dhjetor 2009. Ky shënim hyn në fuqi në të njëjtën datë si ISA-ja.

Hyrja në ISA

ISA 580 merret me përgjegjësitë e audituesve për të marrë pasqyrime me shkrim nga drejtuesi dhe kur është e përshtatshme edhe nga ata që qeverisin.

Shtojca 1 e listave të ISA-së dhe ISA- të e tjera përmbajnë kërkesat specifike për pasqyrimet e shkruara. Këto kërkesa specifike për pasqyrimet me shkrim nuk e kufizojnë zbatimin e ISA-së.

Përmbajtja e Shënimeve

P1. Shënimet japin udhëzime shtesë për audituesit e sektorit publik në lidhje me:

- a) Konsiderata të përgjithshme.
- b) Identifikimi i personave që bëjnë pasqyrimin me shkrim.
- c) Komunikimi i një pragu
- d) Data dhe periudhat e nevojshme për përfaqësimet me shkrim
- e) Dyshimin për sa i përket besueshmërisë së përfaqësive të shkruara dhe përfaqësimet e kërkuara me shkrim që nuk mundësohen

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik

P2. ISA 580 është i aplikueshëm për audituesit e subjekteve të sektorit publik, në rolin e tyre si auditues të pasqyrave financiare. Ajo lexohet së bashku me ISA-në. ISA 580 është efektive për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që fillojnë më ose pas datës 15 dhjetor 2009. Shënimi është efektiv në të njëjtën datë si ISA-ja.

Udhëzues Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

P3. ISA 570 përmban aplikimin dhe materiale të tjera shpjeguese, ku një vëmendje e veçantë i kushtohet subjekteve të sektorit publik, në paragrafët A9 të ISA-së.

Konsiderata të përgjithshme

P4. Objektivat e një auditimi financiar në sektorin publik janë shpesh më të gjera se sa shprehja e një opinioni nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar (p.sh. qëllimi i ISA-së). Mandati i auditimit, apo detyrimet që rrjedhin nga ligjet, rregulloret, direktivat ministrore, kërkesat e politikave qeveritare, apo vendimet e legjislacionit mund të rezultojnë në objektiva të tjera. Këto objektiva shtesë mund të përfshijnë auditimin dhe përgjegjësitë e raportimit, për shembull, në lidhje me raportimet ku audituesi ka gjetur ndonjë rast të mospërputhjes me autoritetet, duke përfshirë buxhetin dhe llogaridhënien dhe / ose raportimin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

P5. Përgjegjësitë e menaxhimit të sektorit publik mund të jenë edhe më të gjera se ato në sektorin privat. Kur kërkohen përfaqësime të shkruara në lidhje me përgjegjësitë e menaxhmentit, audituesit e sektorit publik marrin parasysh premisën më të gjerë.

Identifikimi i personave që bëjnë pasqyrimin me shkrim

P6. Kur marrim në konsideratë udhëzimin në paragrafin A2 të ISA-së, audituesit e sektorit publik marrin parasysh se kërkesat në lidhje me përgjegjësinë për përgatitjen e pasqyrave financiare mund të ndryshojnë, si përcaktohet nga legjislacioni. Audituesit e sektorit publik njihen me legjislacionin në fuqi për të identifikuar personat përgjegjës të cilëve do t'u kërkohen pasqyrat me shkrim. Audituesit e sektorit publik mund të informojnë dhe të bien dakord, në fazën e planifikimit, me personat që

qeverisin për individët e identifikuar si përgjegjës për mundësimin e pasqyrave të shkruara.

Komunikimi i një Pragu

P7. Në përputhje me paragrafin A14 të ISA-së, audituesi mund ta konsiderojë komunikimin me drejtuesit si një prag për qëllimet e pasqyrave të kërkuara me shkrim. Audituesi isektorit publik merr parasysh perspektivën e gjerë të sektorit publik me anë të cilave atij mund ti kërkohej të komunikojë për të gjitha anomalitë, madje edhe ato që janë korrigjuar nga ana e subjektit, të gjitha mangësitë e kontrollit dhe raste të mospërputhjes me autoritetet. Për arsye të pasqyrave të shkruara, audituesit e sektorit publik mund të marrin parasysh komunikimin e kërkesave të tilla.

Data dhe periudhat e nevojshme për pasqyrimet me shkrim

P8. Siç thuhet në paragrafin A15 të ISA-së, data e përfaqësive të shkruara duhet të jetë sa më afër me datën e raportit të audituesit mbi pasqyrat financiare. Përfaqësitë e menaxhimit të sektorit publik ndonjëherë mund të merren nga nivele të larta të qeverisjes dhe për këtë arsye është e rëndësishme për audituesit e sektorit publik ta planifikojnë më parë, në mënyrë që përfaqësimet e shkruara të mund të merren në kohë për të shmangur çdo vonesë në lëshimin e raportit të auditimit.

Dyshim për sa i përket besueshmërisë së përfaqësive të shkruara dhe pasqyrimet e kërkuara me shkrim që nuk mundësohen

P9. Audituesit e sektorit publik mund të caktohen në përputhje me procedurat statutores dhe për këtë arsye nuk mund të tërhiqen nga një angazhim, sikurse sugjerohet në paragrafin A24 të ISA-së. Në raste të tilla, audituesit e sektorit publik mund t'i raportojnë legjislativit si e konsiderojnë ata më të përshtatshme.

Shtojca 1: Shembuj shtesë për Shtojcën 2 të ISA-së “Letër Ilustruese Përfaqësimi”

Shtojca 2 e ISA-së ofron një shembull ilustrues të një letre të përfaqësimit. Bazuar në legjislacionin në fuqi dhe mandatin e auditimit, audituesit e sektorit publik mund të përfshijnë çështje të tjera të tilla si:

- Nëse aktivitetet dhe transaksionet financiare janë në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato;
- Nëse sistemet e kontrollit të brendshëm kanë funksionuar në mënyrë efektive gjatë periudhës së mbuluar nga auditimi;
- Nëse funksioni i auditimit të brendshëm ka operuar në mënyrë efektive gjatë periudhës së mbuluar nga auditimi;
- Nëse programi i qeverisë XYZ është kryer në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive;
- Nëse drejtuesi e ka dhënë interpretimin e tij për pëlqimin e kërkesave që mund të kenë interpretime të ndryshme;
- Nëse të gjitha kontratat, marrëveshjet e granteve dhe korrespondenca të tjera në lidhje me marrëveshjet që përfshijnë përdorimin e fondeve të programit ka qenë në dispozicion, ose
- Nëse drejtuesi i ka bërë të ditur të gjitha kontratat dhe marrëveshjet me organizatat e shërbimit, duke përfshirë komunikimin me organizatat e shërbimeve që lidhen me rastet e mos-përputhshmërisë.

Shtojca 2

(Referenca: . Paragrafi A21)

Letër Ilustruese Përfaqësimi

Letra e mëposhtme ilustruese përfshin përfaqësime të kërkuara nga ky dhe të tjerë ISA në fuqi për auditime të pasqyrave financiare për periudha që fillojnë në ose pas datës 15 dhjetor 2009.

Supozohet se në këtë ilustrim, Korniza e aplikueshme e raportimit financiar është ajo e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar; Kërkesa e ISA 570¹⁵¹⁾ për të marrë një përfaqësim të shkruar nuk është relevante, po ashtu nuk ka përjashtime ndaj përfaqësive të shkruara të kërkuara.

Nëse do të kishte përjashtime, përfaqësitë do të duhej të ndryshoheshin për të pasqyruar përjashtimet .

(Letër me kokë e Entitetit)

(Për Audituesin X Y) (Data)

Kjo letër përfaqësimi lëshohet në lidhje me auditimin tuaj të pasqyrave financiare të Kompanisë ABC për fundvitin 31 Dhjetor të vitit “X”¹⁵²⁾ për qëllimin e dhënies së një opinioni nëse pasqyrat financiare janë të paraqitura në mënyrë të drejtë , në të gjitha aspektet materiale , (ose japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë) në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar .

Ne konfirmojmë se, (për aq njohuri sa kemi, duke bërë hulumtime të tilla për aq sa ne e konsideruam të nevojshme për qëllimin e informimit tonë të përshtatshëm):

151) ISA 570-“Problemët në vijim”

152) Ku raportet financiare mbulojnë më shumë se një periudhë ,audituesi përshtat datën, në mënyrë që letra të japë të gjitha periudhat e mbuluara nga raporti i audituesit .

Pasqyrat Financiare

- Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona, siç është përcaktuar në kushtet e angazhimit të auditimit

Date ____ . ____ . ____ , për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare

të Raportimit Financiar , në veçanti, pasqyrat financiare janë prezantuar në mënyrë të drejtë

(ose të japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë) në përputhje me shifrat që ofrojnë .

- Supozimet e rëndësishme të përdorura nga ne në bërjen e vlerësimeve kontabël, duke përfshirë ato të matura me vlerën e drejtë, janë të arsyeshme . (ISA 540)
- Marrëdhëniet e palëve të ndërlidhura dhe transaksionet janë llogaritur në mënyrë të përshtatshme dhe janë deklaruar në përputhje me kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar . (ISA 550)
- Të gjitha ngjarjet pas datës së pasqyrave financiare dhe për të cilat Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar kërkojnë rregullim ose deklarim, janë rregulluar ose deklaruar. (ISA 560)
- Efektet e deklaratave të gabuara të pakorrigjuara janë jomateriale, si individualisht dhe në total, për pasqyrat financiare si tërësi. Një listë e deklaratave të gabuara të pakorrigjuara i është bashkangjitur kësaj letre përfaqësimi. (ISA 450)
- [Çdo çështje tjetër që audituesi mund të mendojë të përshtatshme (shih paragrafin A10 e këtij ISA).]

Informacioni i dhënë

- Ne ju kemi siguruar:
 - Qasje për të gjitha informacionet të cilat ne jemi të vetëdijshëm se janë të rëndësishme për përgatitjen e pasqyrave financiare, të tilla si të dhënat e dokumentacionit dhe çështje të tjera ;
 - Informacion shtesë që ju keni kërkuar prej nesh për qëllimin e auditimit; dhe
 - Qasje të pakufizuar për personat brenda njësisë ekonomike, të cilët ju i keni përcaktuar të nevojshme për të marrë dëshmi të auditimit .
 - Të gjitha transaksionet janë regjistruar në regjistrat e kontabilitetit dhe janë reflektuar në pasqyrat financiare.
 - Ne kemi ju kemi paraqitur rezultatet e vlerësimit tonë të rrezikut që pasqyrat financiare mund të jenë me anomali materiale , si pasojë e një mashtrimi . (ISA240)
 - Ne ju kemi paraqitur të gjithë informacionin në lidhje me mashtrimin
- Mashtrimi që ne jemi të vetëdijshëm dhe se ndikon në entitetin dhe përfshin:
- Menaxhimin ;
 - Të punësuarit të cilët kanë role të rëndësishme në kontrollin e brendshëm; ose
 - Të tjerë, ku mashtrimi mund të ketë një efekt material në pasqyrat financiare.
- Deklaratat . (ISA 240)
- Ne kemi ju kemi paraqitur të gjithë informacionin në lidhje me akuzat e

mashtimit, ose Mashtimit të dyshuar , që ndikojnë në pasqyrat financiare të njësisë së komunikuar nga punonjësit, ish-punonjës , analistët, rregullatorët apo të tjerë. (ISA 240)

- Ne kemi zbuluar për ju të gjitha rastet e njohura apo të dyshuara të mosrespektimit, jo- pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret, efektet e të cilave duhet të konsiderohen gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare. (ISA 250)

- Ne kemi zbuluar për ju identitetin e palëve të lidhura të njësisë ekonomike dhe të gjitha marrëdhëniet me palët e lidhura dhe transaksionet, për të cilat ne jemi të vetëdijshëm . (ISA 550)

- [Çdo çështje tjetër qëaudituesi mund ta konsiderojë të nevojshme (shih paragrafin A11 te këtij ISA) .]

Menaxhimi

Menaxhimi

ISSAI 1600

Udhëzues i Auditimit Financiar

*KONSIDERATAT E VEÇANTA –
AUDITIMET E PASQYRAVE
FINANCIARE NË GRUP
(PËRFSHIRË PUNËN E
AUDITUESVE SHITESË)*

Shënim për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 600

Tabela e përmbajtjes ISSAI 600

Shënime për ISA 600¹⁵³⁾	Paragrafi
Mjedisi	
Prezantim me ISA	
Përmbajtja e Shënimeve	P1
Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik	P2-P4
Udhëzues Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik	
Konsiderata të përgjithshme	P5
Përkufizimet	P6
Pranimi dhe vazhdimi	P7-P9
Kuptimi i grupit, komponentëve të tij dhe mjedisit	P10
Kuptimi i audituesit shtesë	P11-P14
Materialiteti	P15-P16
Reagimi ndaj rreziqeve të vlerësuara	P17
Procesi i konsolidimit	P18
Komunikimi me Audituesin	P19
Komunikimi me Grupin e Menaxhimit dhe personat që qeverisin	P20

153) Të gjitha Shënimet konsiderohen së bashku me ISSAI 1000, "Hyrje e përgjithshme në Udhëzimet Financiare të Auditimit të INTOSAI-t."

Shtojca 1: Shembull i Bazave për mendimin e kualifikuar dhe Raportin mbi kërkesat e tjera ligjore dhe Kërkesat Rregullatore për përdorim në sektorin publik

Shtojca 2: Shembuj mbi Çështjet për të cilat Grupi i angazhuar merr një Kuptim

Shtojca 3: Shembuj të kushteve ose ngjarjeve që mund të tregojnë mundësitë për gabimemateriale të pasqyrave financiare të Grupit

Shtojca 4: Çështjet e nevojshme dhe shtesë të përfshira

KONSIDERATAT E VEÇANTA -AUDITIMET E PASQYRAVE FINANCIARE NË GRUP (PËRFSHIRË PUNËN E AUDITUESVE SHITESË)

Historiku

Ky Shënim jep udhëzime shtesë për ISA-në 600 - Konsiderata të vecanta-Auditimi në grup i pasqyrave financiare (Përfshirë këtu punën e audituesve shtesë). Lexohet së bashku me ISA-në. ISA 600 hyn në fuqi për auditimin e pasqyrave financiare për periudhën pas datës 15 dhjetor 2009. Ky shënim hyn në fuqi në të njëjtën datë si ISA.

Hyrja në ISA

ISA-ja zbatohet për auditimet e grupit. ISA 600 merret me konsiderata të veçantë që zbatohen për auditimet grupore, në veçanti ato që përfshijë auditues shtesë.

Një auditues mund ta gjejë të dobishëm ISA 600, të përshtatur sipas rrethanave, kur audituesi përfshin auditues të tjerë në auditimin e pasqyrave financiare, të cilat nuk janë pasqyrat financiare në grup. Për shembull, një auditues mund të përfshijë një auditues tjetër për të vëzhguar numërimin e inventarit apo të inspektojë asetet fizike në një vend të largët.

Një auditues shtesë mund të kërkohet me statut, rregullore apo për njëarsye tjetër, për të shprehur një opinion të auditimit mbi pasqyrat financiare. Grupi i angazhuar mund të vendosë të përdorë dëshmitë e auditimit në të cilat opinionin i auditimit mbi pasqyrat financiare të bazohet për të siguruar evidencë për auditimin në grup.

Sipas ISA-së 220, grupi partner i angazhuar duhet të jetë i kënaqur se ata që kryejnë auditimin në grup, duke përfshirë këtu edhe audituesit shtesë, kanë

kolektivisht kompetencën dhe aftësitë e duhura. Grupi partner është gjithashtu përgjegjës për drejtimin, mbikëqyrjen dhe performancën e grupit të angazhuar në auditim.

Grupi partner zbaton kërkesat e ISA 220, pavarësisht nëse gupi i angazhuar ose një auditues shtesë kryen punën me të dhënat financiare. ISA 600 ndihmon partnerin për të përmbushur kërkesat e ISA 220¹⁵⁴⁾, ku audituesit shtesë punojnë për të siguruar informacionin financiar.

Rreziku i auditimit është një funksion i rrezikut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare dhe rrezikut që audituesi nuk do të zbulojë gabime të tilla¹⁵⁵⁾. Në një auditim në grup, ekziston rreziku që audituesi shtesë nuk mund të zbulojë një gabim në informacionin financiar që mund të shkaktojë një gabim material të pasqyrave financiare të grupit, dhe rreziku se as grupi i angazhuar nuk mund të zbulojë këto gabime. ISA 600 shpjegon çështjet që grupi i angazhuar i merr në konsideratë kur përcakton kohën, natyrën dhe shkallën e përfshirjes së tij në procedurat e vlerësimit të rrezikut dhe procedurat e mëtejshme të kryera të auditimit nga audituesit shtesë në të dhënat financiare. Qëllimi i kësaj përfshirje është që të marrë dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme të auditimit, në të cilat do të bazojë opinionin e auditimit në pasqyrat financiare të grupit.

Përmbajtja e Shënimeve

P1.Shënimet japin udhëzime shtesë për audituesit e sektorit publik në lidhje me:

- a) Konsiderata të përgjithshme.
- b) Përkufizime.
- c) Pranimi dhe Vazhdimi.
- d) Kuptimi i grupit, përbërësve të tij dhe mjedisit.

154) ISA 220 “Kontrolli i Cilësisë për Auditimin e Pasqyrave Financiare.” Paragrafët 14 dhe 15

155) ISA 200, “Objektivat e përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe kryerja e një auditimit sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit.” Paragrafi A32

- e) Kuptimi i audituesit shtesë
- f) Materialiteti
- g) Përgjigja ndaj rreziqeve të vlerësuara.
- h) Procesi i konsolidimit.
- i) Komunikimi me audituesin shtesë.
- j) Komunikimi me drejtuesin e grupit dhe ata që e qeverisin atë.

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik

- P2. ISA 600 është i aplikueshëm për audituesit e subjekteve të sektorit publik, në rolin e tyre si auditues të pasqyrave financiare.
- P3. Në disa mjedise të sektorit publik mund të kërkohet me ligj, me rregullore ose ndermjetnjë praktike të përbashkët për t'iu drejtuar një audituesi shtesë në raportin e grupit të audituesve mbi pasqyrat financiare të grupit. Në këto situata, nëse raporti i grupit të audituesve nuk tregon qartë se ky referim nuk i zvogëlon përgjegjësitë e audituesve të grupit për opinionin e tij, atëherë auditimi nuk është në përputhje me paragrafin 11 të ISA-së.
- P4. Grupi i audituesve të sektorit publik, të cilët i referohen një audituesi shtesë në raportin e auditimit të grupit, pa bërë dallim të tillë të përgjegjësisë siç përshkruhet në paragrafin 11 të ISA, këshillohen që të kërkojnë udhëzime nga burime të tjera, të tilla si standardet kombëtare të auditimit dhe burime të tjera, përgjithësisht nga burime të pranueshme. Këto burime të tjera mund t'i drejtojnë grupet e audituesve të sektorit publik për të pyetur në lidhje me reputacionin profesional dhe pavarësinë e audituesit shtesë si edhe për të zhvilluar masat e duhura për të siguruar koordinimin e aktiviteteve me ato të audituesit shtesë, në mënyrë që të arrihet një rishikim i duhur i çështjeve që prekin procesin e konsolidimit të grupit të pasqyrave financiare.

Udhëzues Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

Konsiderata të përgjithshme

P5. Objektivat e një auditimi financiar në sektorin publik janë shpesh më të gjera se sa shprehja e një opinioni nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar (p.sh. qëllimi i ISA-së). Objektivat mund të përfshijnë kontrollin shtesë dhe objektivat e raportimit nëlidhje me, për shembull, përputhjen me autoritetet, duke përfshirë buxhetet dhe kuadrin e përgjegjshmërisë dhe / ose efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Mandati i auditimit, apo detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni, rregullore, direktivat ministrore, kërkesat e politikave qeveritare, apo rezolutat e legjislacionit, mund të rezultojnë në kërkesa raportimi të tjera. Megjithatë, edhe aty ku nuk ka kërkesa të tilla shtesë të raportimit, mund të ketë pritshmëri publike në lidhje me përputhjen me autoritetet ose efektivitetin e kontrolleve të brendshme dhe vëmendjen e audituesit për çështje të tilla. Prandaj, grupet e audituesve të sektorit publik kanë parasysh këto pritshmëri, janë vigjilent gjatë kontrollit në zonat që mund të sjellin mos-përputhshmëri të tillë dhe komunikojnë me audituesit shtesë në lidhje me pritshmëritë e tilla.

Përkufizimet

P6. Kur marrim në konsideratë përkufizimet në paragrafin 9 të ISA-së, duke iu referuar udhëzimeve në paragrafët A2 deri në A4 të ISA-së, karakteristikat shtesë mund të aplikohen në sektorin publik si më poshtë;

a) Komponentët - në një mjedis të sektorit publik, komponentët mund të përfshijnë edhe agjenci, departamente, zyra, korporata, fonde, njësitë përbërëse, rrethe, ndërmarrje të përbashkëta dhe organizata jo-qeveritare dhe

b) Komponenti i rëndësishëm-Në një mjedis të sektorit publik, përcaktimi

i komponentëve të rëndësishem mund të përfshijë edhe çështje që kanë rritur ndjeshmërinë e publikut, të tilla si çështje të sigurisë kombëtare, projektet e financuara nga donatorë apo raportimin mbi të ardhurat tatimore.

Pranimi dhe Vazhdimi

P7.Paragrafët 12 deri 14 të ISA-së përcaktojnë kërkesat për pranimin dhe vazhdimësinë, si auditues i grupit. Pamundësia për t'u përfshirë në punën e audituesit shtesë si diskutohet në paragrafin 12 të ISA-së dhe pamundësia për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ka pak gjasa të ndodhë në një mjedis të sektorit publik, sepse ligjet apo rregulloret mund të ndalojnë kufizimin e të drejtës së informacionit.

P8. Në përputhje me kërkesat e paragrafit 13 të ISA-së, përveç se i referohen udhëzimit në paragrafin A18 të ISA-së, grupet e audituesve të sektorit publik mund të konsultohen me legjislacionin apo të komunikojnë me organe të tjera rregullatore sipas nevojës, për të hequr kufizimet në qasjen për të audituar provat e vendosura nga drejtuesit e grupit, ligjet ose rregulloret. Shtojca 1 e këtij Shënimi ofron një shembull të një mendimi të modifikuar për shkak të kufizimit të së drejtës së informacionit për prova dhe një shembull raporti sipas legjislaturës.

P9. Ndryshimet e rëndësishme që ndikojnë në aftësinë e angazhimit të grupit për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, si janë përmendur në paragrafin A12 të ISA-së, në sektorin publik mund të ndikohet nga ndryshimet shtesë, të tilla si;

- Ndryshime në ligjet dhe rregulloret që ndikojnë në sistemin informativ të menaxhimit dhe / apo të kuadrit të raportimit financiar, dhe

- Ndryshimet në natyrë, burimet aq shumë e financimit, duke përfshirë ndryshimet në strukturën e borxhit publik.

Kuptimi i Grupit, komponentëve të tij dhe mjediseve

P10. Paragrafët 17-18 të ISA-së krijojnë kushte për audituesin e grupit për të

kuptuar grupin dhekomponentët e tij dhe udhëzimi është dhënë në paragrafët A23-A26 të ISA-së. Në raste të caktuara, qeveria mund të ketë marrëdhënie me subjekte të pavarura nëpërmjet transfertave apo përmes rolit të saj si një rregullator për industri të caktuara. Në këto raste mund të jetë e vështirë për të përcaktuar nëse marrëdhëniet e qeverisë me një subjekt justifikojnë përfshirjen e tyre në grup.

Për shembull;

- Zbatimi i kuadrit të raportimit financiar mund të rezultojë në përjashtimin e një lloji të veçantë agjencie, departamenti, zyre, shoqërie, fondi, qarku, sipërmarrje të përbashkët ose organizate jo-qeveritare nga deklaratat e grupeve financiare. Në raste të tilla, nëse grupi i audituesve të sektorit publik mendon se ky përfundim do të rezultojë në një prezantim të gabuar të pasqyrave financiare, atëherë grupi i audituesve të sektorit publik përveç se duhet të ketë parasysh ndikimin në raportin e audituesit duhet të marrë në konsideratë nevojën për të komunikuar çështjen në legjislativ apo organet e tjera të përshtatshme rregullatore, ose
- Korniza e raportimit financiar nuk mund të japë udhëzime specifike për përfshirjen ose përjashtimin e një lloji të veçantë të agjencisë, departamentit, zyrës, shoqërisë, fondit, qarkut, sipërmarrje së përbashkët ose organizatave jo-qeveritare në pasqyrat financiare të grupit. Në raste të tilla, grupi i audituesve të sektorit publik mund të marrë pjesë në diskutimet mes grupit të menaxhimit dhe atij shtesë për të përcaktuar nëse trajtimi i komponentit në pasqyrat financiare të grupit do të rezultojë i drejtë.

Përveç kësaj, kjo mund të krijojë vështirësi gjatë përdorimit të punës së audituesve shtesë. Është e mundur që grupi imenaxhimit mund të mos pajtohet me përfshirjen e komponentit në pasqyrat financiare të grupit, të cilat, nga ana tjetër, mund të kufizojnë aftësinë e audituesit të grupit për të komunikuar me të si edhe të përdorin punën e audituesit shtesë.

Kuptimi i Audituesit shtesë

P11. Aty ku grupi i auditueve të sektorit publik planifikon të kërkojë një auditues shtesë për të kryer punë shtesë të auditimit mbi informacionet financiare lidhur me një komponent ose grup, udhëzimi në paragrafin A33 i ISA-së është veçanërisht i rëndësishëm. Në mjedise të caktuara të sektorit publik metodologjia e grupit auditues mund të ndryshojnë nga metodologjia apo praktikat e audituesve shtesë. Në raste të tilla grupi auditues mund të përshkruajë procedurat në përputhje me metodologjinë e përdorur për auditimin në grup.

P12. Kur marrin në konsideratë paragrafin A37 të ISA-së, audituesit e sektorit publik dhe audituesit shtesë mund të jenë subjekt i kërkesave të Kodit të INTOSAI për Etikën¹⁵⁶⁾ miratuar nga organizata e auditimit të sektorit publik.

P13. Pika e dytë e paragrafit A38 të ISA-së thekson kuptimin e përgjegjësisë profesionale të audituesit shtesë nga grupi i audituesve si edhe nëse audituesi shtesë zotëron aftësi të veçanta (p.sh. njohuri specifike industriale) të nevojshme për të kryer punën. Në kontekstin e mjedisit të sektorit publik kjo do të përfshijë njohuri për atë mjedis, ligjet e aplikueshme dhe rregulloret e rëndësishme për auditimin e grupit.

P14. Paragrafi A41 i ISA-së diskuton rrethanat kur ligji apo rregullore ndalojnë qasjen në pjesët përkatëse të dokumentacionit të auditimit të audituesit shtesë. Në rrethana të tilla, sektori publik gjithashtu duhet të marrë në konsideratë nëse çështjet i duhen komunikuar legjislativit ose organeve të tjera përkatëse rregullatore.

Materialiteti

P15. Kur përcaktohet materialiteti për pasqyrat financiare të grupit të kërkuara nga paragrafët 21 deri 23 të ISA-së, audituesit e sektorit publik mund të përdorin udhëzimet e ISSAI 1320¹⁵⁷⁾, paragrafët P8 dhe P9, të cilët e adresojnë materialitetin vendimtar në sektorin publik. Në kontekstin e

156) ISSAI 30, “Kodi i Etikës së INTOSAI-t.

157) ISSAI 1320, “Materialiteti në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi.”

pasqyrave financiare të grupit, materialiteti për klasat e transaksioneve, bilancet e llogarive, dhënies së informacioneve shpjeguese, si dhe materialiteti komponent mund të vlerësohet në një nivel të ulët në sektorin publik. Kjo mund të ndodhë për një sërë arsyesh, përfshirë kontekstin e çështjes ose natyrës dhe karakteristikat e sistemeve dhe subjekteve të përfshira. Përveç kësaj, mund të ketë kërkesa për mendime të veçanta për komponentët, duke treguar një nevojë për materialitetit të ulët për komponentët. Për më tepër, procedura të caktuara mund të jenë të nevojshme të kryhen nga mandati i auditimit, legjislacioni ose audituesit e sektorit publik mund të përcaktojnë procedurat e auditimit për transaksionet që janë të rëndësishme vetëm për shkak të natyrës së tyre.

P16. Si kërkohet nga paragrafi 21 (d) i ISA-së, përcaktimi i një pragu, mbi të cilat gabimet nuk mund të konsiderohen si të parëndësishme për pasqyrat financiare të grupit, mund të ndikohen nga natyra e lëndës dhe ndjeshmërisë publike. Grupi i audituesve të sektorit publik duhet të marrë parasysh perspektivën e gjerë të sektorit publik me të cilat atyre mund t'u kërkohet të komunikojnë të gjitha anomalitë, duke përfshirë edhe ato që janë korrigjuar nga vetë subjekti, të gjitha mangësitë e kontrollit dhe raste të mospërputhjes me autoritetet. Në raste të tilla nuk mund të krijohen kufij.

Reagimi ndaj rreziqeve të vlerësuara

P17. Kur janë zbatuar kërkesat e paragrafit 24 të ISA-së në nivel të grupit, grupi i audituesve të sektorit publik mund të mendojnë se në sektorin publik natyra e aktiviteteve të kryera nga komponentët e ndryshëm është një përcaktues kryesor i rrezikut të gabimeve materiale. Për shembull, rreziku i anomalisë materiale gjatë një operacioni shpëtues zakonisht do të jetë më i lartë sesa rreziku i anomalisë materiale gjatë një operacioni më të qëndrueshëm si pagesa e rrogave të mësuesve të shkollave. Për të vlerësuar rrezikun e anomalisë materiale në operacionet e shumta të grupit, grupi i audituesve duhet t'i kategorizojë komponentët sipas natyrës së operacioneve të tyre dhe të vlerësojë rrezikun për çdo kategori në mënyrë të veçantë. Ky ushtrim mund t'i mundësojë grupit të auditimit mënyrën për të përcaktuar kohën, natyrën dhe shtrirjen e punës që duhet kryer.

Procesi i konsolidimit

P18. Kur marrim në konsideratë udhëzimin në paragrafin A56 të ISA-së, në kontekstin e sektorit publik mund të ketë një shumëllojshmëri të transaksioneve të regjistruara vetëmnë nivel të grupit, veçanërisht në pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisë. Transaksione të tilla mund të përfshijnë regjistrimin e burimeve natyrore apo thesaret historike. Në raste të tilla, grupi i audituesve të sektorit publik është përgjegjës për marrjen e dëshmive të mjaftueshme e të përshtatshme të auditimit për këto transaksione.

Komunikimi me Audituesin Shtesë

P19. Komunikimi me audituesin shtesë në përputhje me paragrafin 40 të ISA-së, në grupine audituesve të sektorit publik mund t'ju duket e rëndësishme për të informuar audituesit shtesë mbi rrezikun e mospërputhjes me ligjet dhe rregulloret që mund të sjellin një gabim material në grupin e pasqyrave financiare ose të ndikojë në kohën, natyrën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit dhe kërkesat e raportimit.

Komunikimi me drejtuesin e grupit dhe ata që qeverisin

P20. Grupi i audituesve të sektorit publik mund të ketë përgjegjësi raportimi në lidhje me komunikimin e mashtrimit të identifikuar, përveç kërkesave në paragrafin 47 të ISA-së. Këto përgjegjësi mund të përfshijnë raportimin për palët jashtë subjektit, të tilla si autoritetet rregullatore dhe ato të zbatimit. Udhëzime të mëtejshme mbi përgjegjësitë e audituesit në sektorin publik në raportimin e mashtrimit është përfshirë në ISSAI 1240¹⁵⁸).

158) ISSAI 1240, "Përgjegjësitë e Audituesit Lidhur me Mashtrim në Auditimin e Pasqyrave Financiare."

Shtojca 1: Shembull i bazës për mendimin e kualifikuar dhe raporti mbi kërkesat e tjera ligjore dhe rregullatore për përdorim në sektorin publik

Shtojca 1 e ISA-së përmban një shembull të një raporti të audituesit, përmban një mendim të kualifikuar në bazë të paaftësisë së angazhimit të grupit për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme të auditimit në lidhje me një komponent të rëndësishëm sipas metodës së kapitalit neto të kontabilitetit.

Issai 4200¹⁵⁹⁾ jep shembuj të opinioneve në përputhje me ligjet dhe rregulloret. Në sektorin publik, si një bazë për mendimin e kualifikuar dhe një raport mbi kërkesat e tjera ligjore dhe rregulluese duhet të jetë t si më poshtë:

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

[Komunikimi i duhur]

Raport mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara .

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Menaxhimi është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara ...

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare të konsoliduara bazuar në auditimin tonë ...

... Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për mendimin e kualifikuar të auditimit tonë.

159) ISSAI 4200, “Udhëzimet e Auditimit të Përputhshmërisë në lidhje me auditimin e Pasqyrave Financiare.”

Baza për mendimin e kualifikuar

Shpenzimet e qeverisë për programi XX janë raportuar rreth 15 milion dollarë në pasqyrën e të ardhurave të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 200x. Ne nuk ishim në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit rreth këtyre shpenzimeve, sepse na u mohua aksesimi në informacionin financiar, të menaxhimit dhe / ose audituesit e tij shtesë. Si pasojë, ne nuk ishim në gjendje për të përcaktuar nëse rregullimet e këtyre shumave ishin të nevojshme.

Opinionimi i kualifikuar

Sipas mendimit tonë, përveç efekteve të mundshme të çështjes përshkruar në paragraf, bazat për mendimin e kualifikuar, pasqyrat e konsoliduara financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale ...

Raport mbi kërkesat e tjera ligjore dhe rregullatore

Siç përshkruhet në paragraf, bazat për mendimin e kualifikuar e përmendur më lartë, ne na u mohua aksesimi në informacionin financiar, menaxhimin dhe / ose audituesit shtesë përgjegjës për programin XX. Ligji XXX (sipas të cilit zyra jonë vepron) i mundëson zyrës tonë qasje të plotë dhe të pakufizuar në të gjitha informatat e qeverisë dhe punonjësit. Si rezultat i mohimit të informacionit në lidhje me programin XX vihet re një shkelje e ligjit XXX dhe ne kemi filluar veprime ligjore për të marrë këtë informacion. Ne gjithashtu kemi kërkuar ligjërisht shqyrtimin e kësaj çështje.

[Nënshkrimi audituesit]

[Data e raportit të audituesit] [Adresa e audituesit]

Shtojca 2: Shembuj të çështjeve për të cilat angazhimi i grupit merr kuptim

Shembuj të tjerë të sektorit publik lidhur me çështjet mund të përfshijnë:

- Kontroll mbi përputhjen me ligjet dhe rregulloret;
- Respektimi i kërkesave buxhetore dhe autoriteteve shpenzuese;
- Klasifikimi konsekuent i kodeve për raportimin e shumave buxhetore dhe aktuale; ose
- Pjesëmarrja e grupit dhe / ose komponentëve në partneritete publike dhe private.

Shtojca 3: Shembuj të kushteve ose ngjarjeve që mund të tregojnë rreziqet e gabimeve materiale të pasqyrave financiare të grupit

Këto janë shembuj të kushteve të sektorit publik të lidhura me shembuj të përfshira në Shtojcën 3 të ISA-së, të cilat mund të tregojnë rreziqet e anomalitë materiale të pasqyrave financiare të grupit.

- Mungesa e njohjes së ligjeve dhe rregulloreve në fuqi;
- Buxheti i shpërdoruar për shkak të kontrolleve të dobëta buxhetore;
- Privatizimet e komponentëve;
- Programet e reja apo komponentet;
- Ndryshimet e mëdha në programet ekzistuese apo komponentet;
- Burimet e reja financuese për grupin apo komponentët;
- Ndryshimet në legjislacion, rregulloret apo direktivat;
- Vendimet politike si riorganizimi i përbërësve;
- Programe të mëdha brenda një komponenti pa burime të mjaftueshme të alokuara dhe / ose të financimit;
- Rritja e pritshmërisë publike;
- Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve në komponente të caktuara, të tilla si mbrojtja ose siguria kombëtare;
- Delegimi i veprimtarive përbërëse;
- Komponentët i nënshtrohen hetimeve të veçanta ose mbikëqyrjes parlamentare apo legjislative;
- Ndryshime në udhëheqjen politike;
- Të tregohen humbjet apo abuzimet;
- Pritshmëritë më të mëdha se normalja për të plotësuar buxhetin;
- Partneriteti publik dhe privat;
- Ndërhyrja politike në shpërndarjen e burimeve publike ose
- Ndikimi i drejtpërdrejtë i qeverisë në menaxhimin dhe / ose mungesa e përvojës profesionale në menaxhimin kundrejt emërimit politik.

Shtojca 4: Çështjet e nevojshme dhe shtesë përfshirë në letrën e udhëzimeve të grupit të angazhuar.

Çështje të tjera që mund të jenë të rëndësishme në sektorin publik, përveç çështjeve të kërkuara ose sugjeruara në shtojcën 5 të ISA-së mund të përfshijnë:

- Një listë të ligjeve dhe rregulloreve të rëndësishme në lidhje me auditimin e audituesit shtesë, si dhe një listë të ligjeve dhe rregulloreve të rëndësishme në auditimin e grupit, ose
- Një listë e procedurave të tjera që grupi i audituesve përcakton si të nevojshme dhe që duhet të kryhen nga audituesi shtesë.

ISSAI 1610

Udhëzues i Auditimit Financiar

SI TË PËRDORIM PUNËN E AUDITUESVE TË BRENDSHËM

Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 610

Tabela e përmbajtjes ISSAI 1610

Shënime per ISA 610¹⁶⁰⁾ **Paragrafi**

Mjedisi

Hyrje në ISA

Përmbajtja e shënimeve P1

Zbatimet e ISA-së në sektorin publik të auditimit P2

Udhëzime shtesë mbi çështjet e sektorit publik

Konsiderata të përgjithshme P3

Të përcaktojmë nëse duhet apo jo të përdorim punën e audituesve të
brendshëm..... P4

160) Të gjitha shënimet praktike konsiderohen së bashku me ISSAI 1000 — Hyrje e Përgjithshme në INTOSAI - Udhëzime të Auditimit Financiar.

Si të përdorim punën e audituesve të brendshëm

Mjedisi

Shënimet ofrojnë udhëzime shtesë të ISA 610- duke përdorur punën e audituesve të brendshëm. Lexohet bashkë me ISA-në. ISA 610 hyn në fuqi për auditimin e pasqyrave financiare për periudhën pas datës 15 dhjetor 2009. Shënimet hyjnë në fuqi në të njëjtën datë si ISA-ja.

Hyrje në ISA

ISA 610 ka të bëjë me përgjegjësinë e audituesve të jashtëm lidhur me punën e audituesve të brendshëm kur audituesit e jashtëm kanë përcaktuar sipas ISA 315¹⁶¹⁾ se funksioni i auditimit të brendshëm ka gjasa të jetë i rëndësishëm për auditimin. ISA-ja 610 nuk merret me rastet kur audituesit e brendshëm i mundësojnë ndihmë të drejtpërdrejtë audituesve të jashtëm në vazhdimin e procedurave të auditimit.

Përmbajtja e Shënimeve

P1. Shenimet mundësojnë udhëzime shtesë për audituesit e sektorit publik të lidhur me:

- a) Konsiderata të përgjithshme.
- b) Përcaktimi nëse duhet apo jo të përdorin punën e audituesve të brendshëm.

Zbatimet e ISA në Sektorin Publik të Auditimit

P2. ISA 610 zbatohet për audituesit e subjekteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të pasqyrave financiare.

¹⁶¹⁾ ISA 315, "Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të anomalive materiale nëpërmjet të kuptuarit të Entitetit dhe mjedisit të tij"

Udhëzime shtesë për çështjet e sektorit publik

Konsiderata të përgjithshme:

P3. Objektivat e auditimit financiar në sektorin publik janë shpesh më të gjera sesa shprehja e një opinioni, edhe nëse deklaratat financiare janë përgatitur sipas rregullave dhe sipas kuadrit raportues të zbatimit financiar (që do të thotë qëllimi i ISA-ve). Objektivat shtesë mund të përfshijnë përgjegjësitë e auditimit dhe raportimit, p.sh, raportimi nëse audituesit e sektorit publik kanë gjetur ndonjë rast të mospërputhjes me autoritetet, përfshirë kuadrin e buxheteve dhe të llogarisë, ose raportimin e efektshmërisë të kontrollit të brendshëm. Audituesit e sektorit publik mund të zbulojnë aktivitete të zhvilluara nga auditimi i brendshëm i subjektit lidhur me mospërputhjen me autoritetet, përfshirë buxhetin dhe llogarinë dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit në përputhje me auditimin. Në të tilla raste audituesit e sektorit publik mund të përdorin punën e audituesve të brendshëm të subjektit për të plotësuar punën e auditimit të jashtëm në këto zona.

Të përcaktojmë nëse duhet apo jo të përdorim punën e audituesve të brendshëm

P4. Audituesi i sektorit publik, në vendosmërinë e tij nëse puna e audituesve të brendshëm ka gjasa të jetë objektive për qëllimin e auditimit, sic theksohet në paragrafin 9(a) të ISA, merr në konsideratë udhëzime të INTOSAI-t lidhur me përmirësimin e objektivitetit të audituesve të brendshëm dhe nëse është e nevojshme edhe egzistencën dhe mbikëqyrjen e raporteve të auditimit. Megjithatë, kur funksioni i auditimit të brendshëm është i përcaktuar nga legjislacioni ose rregullorja dhe kriteret e mëposhtme janë plotësuar, atëherë ka një tregues të fortë që funksionimi i auditimit të brendshëm presupozohet të jetë objektiv:

- a) Përgjegjësia për një menaxhim sa më të mirë është e drejtuesit të subjektit qeverisës dhe atyre që merren me qeverisjen;
- b) Raporton rezultatet e auditimit të të dy palëve, për shembull drejtuesi

- i subjektit qeverisës dhe ata që meren me qeverisjen;
- c) Stafi nuk është pjesë e organizimit dhe funksionit menaxhues të departamentit që po auditohet;
 - d) Audituesi nuk duhet të ndikohet nga presioni politik gjatë auditimit dhe duhet të raportojë gjetjet, opinionet dhe konkluzionet në mënyrë objektive pa frikën e presionit politik;
 - e) Nuk lejon stafin e auditimit të brenshëm të auditojë veprimet për të cilat kanë qenë përgjegjës më parë, për të shmangur ndonjë konflikt të mundshëm interesi: dhe
 - f) Ka kontakte me personat që qeverisin.

ISSAI 1620

Udhëzues i Auditimit Financiar

*SI TË PËRDORIM PUNËN E NJË
EKSPERTI TË AUDITIMIT*

Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 620

Tabela e përmbajtjes ISSAI 1620

Shënime per ISA 620¹⁶²⁾	Paragrafi
Mjedisi	
Hyrje në ISA	
Përmbajtja e shënimeve	P1
Zbatimet e ISA-ve në sektorin publik të auditimit	P2
Udhëzime shtesë mbi çështjet e Sektorit Publik	
Konsiderata të përgjithshme	P3
Përcaktimi i nevojës për një auditues ekspert	P4
Kompetencat, aftësitë dhe objektiviteti i një audituesi ekspert	P5
Marrëveshja me një auditues ekspert	P6-P9

162) Të gjitha shënimet praktike konsiderohen së bashku me ISSAI 1000 – Hyrje e Përgjithshme në INTOSAI - Udhëzime të Auditimit Financiar.

Si të përdorim punën e një eksperti të auditimit

Mjedisi

Shënimet ofrojnë udhëzime shtesë të ISA 620 duke përdorur punën e audituesve ekspert. Lexohet bashkë me ISA. ISA 620 hyn në fuqi për auditimin e pasqyrave financiare për periudhën pas datës 15 dhjetor 2009. Shënimet hyjnë në fuqi në të njëjtën datë si ISA.

Hyrje në ISA

ISA 620 ka të bëjë më shumë me përgjegjësinë e audituesve lidhur me punën e një individ ose organizate në fushën e ekspertizës, sesa me fushën e kontabilitetit dhe auditimit, atëherë kur kjo punë përdoret për të ndihmuar audituesin në gjetjen e provave të mjaftueshme dhe të përshtatshme për auditimin.

ISA 620 nuk merret me rastet kur :

- a) Personat e ngarkuar për auditim përfshijnë një anëtar ose konsultohen me një individ ose organizatë të specializuar në llogari dhe auditim, të cilat trajtohen në ISA 220; ose
- b) Përdorimi i punës së një audituesi nga një individ ose organizatë që është e specializuar në një fushë të ndryshme nga llogaria dhe auditimi dhe që përdoret për të ndihmuar subjektin në përgatitjen e pasqyrave financiare (një ekspert menaxhimi), e cila trajtohet në ISA 500.

Përmbajtja e shënimeve

P1. Shenimet mundësojnë udhëzime shtesë për audituesit e sektorit publik të lidhur me:

- a) Konsiderata të përgjithshme.
- b) Përcaktimi i nevojës për një ekspert auditimi.
- c) Nevojitet një ekspert i aftë dhe objektiv.
- d) Të arrihet marrëveshja me ekspertin e auditimit.

Zbatimet e ISA-së në sektorin publik të auditimit

P2. ISA 620 zbatohet për audituesit e subjekteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të pasqyrave financiare.

Udhëzime shtesë për çështjet e sektorit publik

Konsiderata të përgjithshme.

P3. Objektivat e auditimit financiar në sektorin publik janë shpesh më të gjera sesa shprehja e një opinionit nëse deklaratat financiare janë përgatitur sipas rregullave të materialeve sipas kuadrit raportues të zbatimit financiar (që do të thotë qëllimi i ISA-ve). Mandati i audituesit ose detyrimet e subjektit të sektorit publik, që vijnë nga legjislacioni, rregullorja, direktivat ministrore, politikat qeverisëse ose rezolutat ligjore mund të rezultojnë si objektiva shtesë. Këto përgjegjësi mund të përfshijnë p.sh, procedurat performuesedhe raportimin e rasteve kur ka mospërputhje me autoritetet dhe efektshmëria e kontrolleve të brendshme. Megjithatë edhe pse nuk ka objektiva të tilla shtesë, ka gjithmonë pritshmëri në lidhje me këtë. Mungesa e përputhshmërisë me legjislacionin me buxhetet e miratuara, mosrespektimi i kontratave ose marrëveshjeve të granteve, shpenzime të paautorizuara ose të papërshtatshme, çështje me interes parlamentar ose mediatik, çështje të lidhura me mashtrimin, korrupsionin, humbjet ose abuzimet janë shembuj për atë që është përmendur më sipër. Audituesit e sektorit publik mund të konsiderojnë marrjen në punë së një eksperti që të përmbushë këto përgjegjësi shtesë.

Të përcaktojmë kur është i nevojshëm një ekspert auditimi

P4. Kur përcaktojmë nevojën për të punësuar një ekspert auditimi siç është përmendur në paragrafin 9 të ISA-së, audituesit e sektorit publik marrin në konsideratë këtë çështje duke u bazuar në legjislacion, në rregullore ose mandate ku auditimi financiar mund të përfshijë përgjegjësitë shtesë në lidhje me këtë mashtrim. Në raste të tilla, audituesit e sektorit publik mund të kenë nevojë për ndërhyrjen e ekspertëve ose zyrës së anti-korrupsionit. Për disa sektorë të mjedisit publik, si mjedisi i Gjykatës së Llogarive, përfshirë këtu edhe mandatet e gjykuara, vendimet mund të bazohen në provat e ekspertëve duke mundësuar kështu ligjërisht që personi i përgjegjshëm për mashtrimin ose korrupsionin të paguajëgjjobën ose borxhin. Prokurorët mund të padisin subjektin përgjegjës për mashtrim ose korrupsion si edhe mund të sekuestrojnë asetet për të mundësuar pagesën e borxhit.

Kompetencat, aftësitë dhe objektivat e një eksperti të auditimit

P5. Çështja e pavarësisë është me shumë rëndësi në sektorin publik dhe mund të përfshijë kërkesa legjislative ose politika qeverisëse, të cilat audituesit dhe ekspertët e sektorit publik duhet të përmbushin. Procedurat e rekomanduara në paragrafin A20 të ISA-së, lidhur me vlerësimin e objektivitetit, audituesit e sektorit publik mund të përvetësojnë dhe vlerësojnë pavarësinë e ekspertit. Kur bëhet fjalë për pavarësinë, audituesit e sektorit publik duhet gjithashtu të marrin në konsideratë vlerësimin aktual dhe të mëparshëm politik të tij, pra të jëtë neutral ose i depolitizuar. Aktivitetet që mund të vendosin në pikëpyetje neutralitetin politik të ekspertit, përfshijnë konkurimin për një post drejtues zyrtar, pjesëmarrje në evenimente të sponsorizuara nga partitë politike, grupe ose organizata me pikëpamje politike. Këta faktorë mund të merren në konsideratë në rastet kur përfshirja e ekspertit dhe mundësia e pjesëmarrjes bëhet për arsye përfitimi.

Marrëveshjet me ekspertët e auditimit

P6. Kodi IFAC i Etikës për Kontabilistin Profesionist, paragrafi 140.1, pjesa A, kërkon që audituesit të respektojnë konfidencialitetin në çdo kohë nëse autoritetit të veçantë i është dhënë e drejta të zbulojë disa informacione, ose ky autoritet ka të drejtën ligjore, profesionale ose e ka për detyrë të veprojë kështu. Një dallim thelbësor ndërmjet sektorit privat dhe atij publik qëndron në faktin që mund të ketë kërkesa të veçanta legjislative në sektorin publik lidhur, nga njëra ane me besueshmërinë dhe nga ana tjetër me palët e treta. Është e nevojshme që sektori publik të balancojë vazhdimisht besueshmërinë dhe nevojën për transparencë dhe përgjegjshmëri. Kur marrim në konsideratë çështjen e besueshmërisë si theksohet në paragrafin 11(d) të ISA-së, audituesit e sektorit publik duhet të jenë të ndergjegjshëm për egzistencën e legjislacionit që i jep të drejtë publike punesimit të një eksperti për auditim në sektorin privat.

P7. Kërkesa nga subjektet për ndihmë të jashtme, policia, prokurorët dhe gjykatësit për të marrë në punë një ekspert nuk është e pazakontë në sektorin publik. Audituesit e sektorit publik duhet të informojnë ekspertin që provat

ose raportimet e tij mund te kerkohen edhe jashtë organizatës të sektorit publik të auditimit dhe të përdoren në procese ose hetime të tjera.

- P8. Për më tepër, eksperti që punon për sektorin publik mund të ketë përgjegjësi shtesë lidhur me besueshmërinë, e cila bazohet në mandatin në Institucionit përkatës të Auditimit Suprem, ose në ligjet të lidhura me sekrete zyrtare ose veprime private. Legjislacione të tilla për shembull, mund të trajtojnë auditimet që kryhen në sektorin e mbrojtjes, shëndetësisë, shërbimeve sociale ose agjencive tatimore. Audituesi i sektorit publik duhet të familjarizohet me kërkesat e veçanta lidhur me besueshmërinë në lidhje me punën e tij/saj. Audituesit e sektorit publik mund t'i kërkojnë ekspertit të nënshkruajë një klauzolë ose marrëveshje besueshmërie.
- P9. Balanca ndërmjet besueshmërisë dhe transparencës kërkon që audituesit e sektorit publik të përdorin gjykim profesional për t'u siguruar që puna e ekspertit me një natyrë te besushme identifikohet dhe trajtohet si e tillë, nderkohë që në të njëjtën kohë duhet të kete aksesin e përshtatshëm. Audituesit e sektorit publik duhet të jene të vetëdijshëm për procedurat e përcaktuara qartësisht nga organizatat e auditimit.

ISSAI 1700

Udhëzues i Auditimit Financiar

*KRIJIMI I NJË MENDIMI MBI
RAPORTIMIN
E PASQYRAVE FINANCIARE*

Shënim praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 700

Tabela e përmbajtjes ISSAI 1700

Shënime per ISA 700¹⁶³⁾	Paragrafi
Mjedisi	
Hyrje në ISA	
Përmbajtja e shënimeve	P1
Zbatimet e ISA-së në sektorin publik të auditimit	P2
Udhëzime shtesë mbi çështjet e Sektorit Publik	
Konsiderata të përgjithshme	P3
Qëllimi i ISA	P4-P6
Raportet e Audituesve	P7-P13
Zbulimi i efektit të transaksioneve materiale dhe informacioni i mbledhur në Pasqyrat Financiare	P14

163) Të gjitha Shënimet e Praktikës konsiderohen së bashku me ISSAI 1000, “Hyrje e përgjithshme në Udhëzimet Financiare të Auditimit të INTOSAI-t.”

Krijimi i një mendimi mbi raportimin e pasqyrave financiare

Mjedisi

Shënimet ofrojnë udhëzime shtesë të ISA 700 - Formimin e një opinionin dhe raportimin mbi pasqyrat financiare. Lexohet bashkë me ISA. ISA 700 hyn në fuqi për auditin e pasqyrave financiare për periudhën pas datës 15 dhjetor 2009. Shënimet hyjnë në fuqi në të njëjtën datë si ISA.

Hyrje në ISA

ISA 700 ka të bëjë me përgjegjësinë e audituesve për të formuar një opinion mbi deklaratat financiare. Gjithashtu merret me formën dhe përmbajtjen e raporteve të lëshuara si pasojë e auditimit të pasqyrave financiare.

ISA 705¹⁶⁴⁾ dhe ISA 706¹⁶⁵⁾ merren me mënyrën se si forma dhe përmbajtja e raportit të audituesit mund të influencojë në shprehjen e një opinionit të modifikuar ose në vendosjen e theksit në një çështje të veçantë, si dhe në përfshirjen e një paragrafi me çështjet më të rëndësishme në raport.

ISA 700 është shkruar në kontekstin e një serie të plotë të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme. ISA 800¹⁶⁶⁾ ISA 800, “Konsiderata të veçanta - Auditimi i pasqyrave financiare të përgatitura sipas Kornizave për çështje specifike.” merr në konsideratë pasqyrat financiare që janë përgatitur në përputhje me një kuadër të veçantë. ISA 805¹⁶⁷⁾ merret me konsiderata të veçanta përkatëse të auditimit të një instrumenti financiar të vetëm ose një element i veçantë, llogari ose çështje e një deklaratë financiare.

ISA 700 promovon qëndrueshmërinë në raportin e audituesit. Përputhshmëria në raportin e audituesit, kur auditimi është kryer në përputhje me ISA-në, nxit besueshmëri në tregun global, duke identifikuar më lehtë auditimet që janë kryer në përputhje me standardet globale. Ajo gjithashtu ndihmon për të nxitur kuptimin e përdoruesit dhe për të identifikuar rrethanat e pazakonta kur ato ndodhin.

164) ISA 705, “Modifikimet e Opinionit në Raportin e Audituesit të Pavarur”.

165) ISA 706, “Rëndësia e paragrafëve dhe çështjeve të tjera në raportin e Audituesit të Pavarur”.

166) ISA 800, “Konsiderata të veçanta - Auditimi i pasqyrave financiare të përgatitura sipas Kornizave për çështje specifike.”

167) ISA) 805, “Konsiderata të veçanta - Auditimi i Pasqyrave Financiare të Vetme dhe Elementëve të veçanta, Llogarive ose zërave të një Pasqyre Financiare”

Përmbajtja e shënimeve

P1. Shënimet Praktike japin udhëzime shtesë për audituesit e sektorit publik në lidhje me:

- a) Konsiderata të përgjithshme.
- b) Qëllimi i ISA.
- c) Raportet e Audituesve.
- d) Zbulimi i efektit të transaksioneve materiale dhe informacioni i mbledhur në Pasqyrat Financiare.

Zbatimet e ISA-së në sektorin publik të auditimit

P2. ISA 700 zbatohet për audituesit e subjekteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të pasqyrave financiare.

Udhëzime shtesë për çështjet e sektorit publik

Konsiderata të përgjithshme

P3. Objektivat e një auditimi financiar në sektorin publik janë shpesh më të gjera sesa shprehja e një opiniononi nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin në fuqi për raportimin financiar (dmthqëllimin e ISA). Mandati i auditimit, apo detyrimet për subjektet e sektorit publik, që rrjedhin nga legjislacioni, rregulloret, direktivat ministrore, kërkesat e politikave qeveritare, apo rezolutat e legjislacionit mund të rezultojnë si objektivat shtesë. Këto objektiva shtesë, që mund të jenë të një rëndësie të barabartë me atë të opinionit mbi pasqyrat financiare, mund të përfshijë përgjegjësitë e auditimit dhe raportimit, për shembull, në lidhje me raportimin nëse audituesit e sektorit publik kanë gjetur ndonjë rast të mos-pajtueshmërisë me autoritetet duke përfshirë buxhetet dhe kornizat e llogaridhënies dhe/ose raportimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Megjithatë, edhe aty ku nuk ka objektiva të tilla shtesë, mund të ketë pritshmëri të përgjithshme publike në lidhje me raportimin e audituesve të sektorit publik dhe të mos përputhjes me autoritetet ose raportimin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Përgjegjësitë tilla shtesë do të raportohen në një seksion të veçantë të raportit të audituesit, si përshkruhet më poshtë në paragrafin P5.

Qëllimi i ISA-së

P4. Qëndrueshmëria në raportin e audituesit, kur auditimi është kryer në përputhje me ISA-në, siç paraqitet në paragrafin 4 të ISA-së, nxit besueshmëri në mjediset e sektorit publik si edhe në vendet me tregje globale. Për subjektet e sektorit publik, ligjvënësit dhe rregullatorët janë shpesh përdoruesit kryesorë të pasqyrave të tyre financiare. Ligjvënësit përfaqësojnë qytetarët, të cilët janë përdoruesit e fundit të pasqyrave financiare.

- P5. Në sektorin publik, ligjet dhe rregulloret ose mandati i auditimit mund t'i orientojnë audituesit e sektorit publik për të raportuar gjetjet në raportin e audituesit sipas ISA-së. Gjetjet shpesh, shpalosjet, konkluzionet, rekomandimet dhe përgjigjet e menaxhimit mund të raportohen në një raport të veçantë. Një raportim i tillë është suplementar për raportin e audituesit sipas ISA-së dhe prandaj duhet të jetë bërë në një raport të veçantë kur aplikohet kuadri i ISA-së. Ky raport i veçantë mund të lëshohet së bashku me raportin e audituesit ose në pajtim me ligjet dhe rregulloret.
- P6. Audituesit e sektorit publik me përgjegjësi që lidhen me raportimin mbi përputhshmërinë ose jo-përputhshmërinë me autoritetet, mund të marrë në konsideratë Udhëzimet e Përputhshmërisë së Auditimit të INTOSAI-it (ISSAI 4000¹⁶⁸) dhe ISSAI 4200¹⁶⁹). Audituesit e sektorit publik mund të kërkojnë ISSAI 3000¹⁷⁰, si dhe ISSAI 4100¹⁷¹ për sigurimin në angazhimet e tjera.

Raportet e Audituesve

- P7. Përgjegjësia e drejtimit në sektorin publik mund të jetë më e gjerë se përgjegjësia në sektorin privat. Për këtë arsye audituesit e sektorit publik mund të kenë nevojë të marrin në konsideratë premiset, në lidhje me përgjegjësitë e drejtimit, kur i përshkruan ato siç është përcaktuar në paragrafin 26 të ISA.
- P8. Për sa i përket kërkesave etike të përmendura në seksionin e përgjegjësisë të audituesit në raport, mund të jenë të rëndësishëm edhe kodet e tjera të etikës, po aq kufizues sa Kodi i Etikës për Kontabilistët Profesionistë të IFAC. Kodi i Etikës¹⁷² të INTOSAI-t është një kod etik i rëndësishëm, lidhur me paragrafin 30 të ISA.

168) ISSAI 4000, "Hyrje e përgjithshme në Udhëzimet për Auditimin e Pajtuëshmërisë".

169) ISSAI 4200, "Udhëzimet e Auditimit të Pajtuëshmërisë në lidhje me Auditimin e Pasqyrave Financiare."

170) ISSAI 3000, "Angazhimet e tjera të Sigurimit se auditimet apo rishikimet e Informacioneve Historike financiare".

171) ISSAI 4100, "Udhëzimet e Pajtuëshmërisë së Auditimit për auditimet e bera nga Pasqyrat Financiare."

172) ISSAI 30, "Kodi i Etikës INTOSAI"

- P9. Në rastet kur kontrollorëve të sektorit publik u janë kërkuar nga ligjet ose rregulloret, të përdorin planin e veçantë urbanistik për formulimin e raportit të audituesit, audituesve të sektorit publik u kërkohet të vlerësojnë nëse të tilla plane urbanistike ose formulimi përmban elementët minimale siç është përshkruar në paragrafin 43 të ISA-së. Nëse elemente të tilla nuk janë të përfshira, audituesit e sektorit publik nuk mund të deklarojnë se auditimi është kryer në përputhje me ISA-në.
- P10. Shembujt ilustrues të parashikuara në ISA, janë të ndryshuara sipas nevojavedhe rëndësisë për sektorin publik. Përveç shembujve ilustrues të parashikuar në ISA, një shembull i përgjithshëm i raportit të audituesit për pasqyrat financiare në sektorin publik, është përfshirë në ISSAI 4200¹⁷³⁾ në shtojcën nr. 7.
- P11. Kur zbatoni paragrafin A16 të ISA-së dhe kur ligjet dhe rregulloret nukspecifikojnë se kujt i referohet për raportin e audituesit, audituesit e sektorit publik ju a referojnë raportin personave që qeverisin ose pjesës përkatëse të legjislaturës, sipas rastit.
- P12. Në varësi të standardeve të aplikuara, audituesit e sektorit publik mund t'i referohen auditimit përkatës të standardeve në një nga mënyrat e mëposhtme:
- a) Në përputhje me ISA-në, që nënkupton përputhjen e plotë me të gjitha ISA-të përkatëse dhe nëse është e rëndësishme, me udhëzimin plotësues të përcaktuar në praktikën e INTOSAI-t.
 - b) Në përputhje me Parimet Themelore të auditimit të INTOSAI, por jo në përputhje të plotë me ISA-të, të cilat janë përfshirë aktualisht si pjesë e udhëzimeve të auditimit financiar të INTOSAI-t (ISSAIs 1000-2999); ose

173) ISSAI 4200, "Udhëzimet e Auditimit të Pajtuëshmërisë për auditimet e bëra nga Pasqyrat Financiare."

c) Në përputhje me standarde të tjera të rëndësishme kombëtare të auditimit.

P13. Ligjet dhe rregulloret mund të përcaktojnë afatet për datën e raportit të audituesit, në rrethanat kur audituesit e sektorit publik nuk janë në gjendje për të përmbushur afatin, për këtë audituesit e sektorit publik mund të marrin parasysh veprimet e duhura të tilla si p.sh. të informojnë organet qeverisëse apo ligjvënëse.

Zbulimi i efektit të transaksioneve materiale dhe informacioni i mbledhur në Pasqyrat Financiare.

P14. Përgatitja e pasqyrave financiare të qëllimit të përgjithshëm në sektorin publik mund të përfshijë raporte shtesë, të tilla si raporti i krahasimit të buxhetit dhe sasive aktuale, raportet përperformancën dhe përvetësimin, duke bërë një përmbledhje të plotë të pasqyrave financiare. Në të tilla rrethana, audituesit e sektorit publik i vlerësojnë keto raporte në përputhje me udhëzimin e dhënë në A4 të ISA.

ISSAI 1705

Udhëzues i Auditimit Financiar

*NDRYSHIMET E OPINIONIT NË
RAPORTIN E PAVARUR TË
AUDITUESIT*

Shënim për Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (ISA) 705

Tabela e përmbajtjes ISSAI 1705

Shënime per ISA 705¹⁷⁴⁾	Paragrafi
Mjedisi	
Hyrje në ISA	
Përmbajtja e shënimeve	P1
Zbatimet e ISA-së në sektorin publik të auditimit	P2
Udhëzime shtesë mbi çështjet e Sektorit Publik	P3
Konsiderata të përgjithshme	P4-P5
Rrethanat kur modifikimi i opinionit të audituesit është i nevojshëm.....	P6
Përcaktimi i llojit të modifikimit të opinionit të audituesit	P7
Natyra e keqkuptimeve materiale	P8
Paaftësia për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të duhura për auditim	P9-P10
Forma dhe përmbajtja e raportit të audituesit kur opinionit është i modifikuar	P11-P12
Komunikimi me personat që qeverisin	P13

174) Të gjitha Shënime konsiderohen së bashku me ISSAI 1000, “Hyrje e përgjithshme në Udhëzimet Financiare Auditimit të INTOSAI-t.”

Ndryshimet e opinionit në raportin e pavarur të audituesit

Mjedisi

Shënimet ofrojnë udhëzime shtesë të ISA 705 - Ndryshimet e opinionit në raportin e pavarur të audituesit. Lexohet bashkë me ISA. ISA 705 hyn në fuqi për auditimin e pasqyrave financiare për periudhën pas datës 15 dhjetor 2009. Shënimet hyjnë në fuqi në të njëjtën datë si ISA.

Hyrje në ISA

ISA 705 ka të bëjë me përgjegjësinë e audituesve për të përgatitur një raport të përshtatshëm, në kushtet kur gjatë krijimit të një opinionit në përputhje me ISA 700¹⁷⁵⁾, audituesi arrin në përfundimin që modifikimet e opinionit janë të nevojshme për pasqyrat financiare.

Llojet e Opinioneve të modifikuara sipas ISA 705 përcaktojnë tri lloje të mendimeve të modifikuara, një opinion të kualifikuar, një opinion të kundërt, dhe një mospranim të opinionit. Vendimi në lidhje me llojin e opinionit të modifikuar varet nga:

- a) Natyra e çështjes i jep shkasë modifikimit, që audituesit të kuptojnë nëse kanë të bëjnë me gabime në materialet e pasqyrave financiare, apo me një pamundësi për të siguruar dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, të cilat mund të trajtohen si gabime.
- b) Gjykimi i audituesit për efektet e mundshme të çështjes në pasqyrat financiare

175) ISA 700, "Formimin e mendimit dhe Raportimin mbi Pasqyrat Financiare".

Përmbajtja e shënimeve

P1. Shënimet Praktike japin udhëzime shtesë për audituesit e sektorit publik në lidhje me:

- a) Konsiderata të përgjithshme.
- b) Rrethanat kur modifikimi i opinionit të audituesit është i nevojshëm.
- c) Përcaktimin e llojit të modifikimit të opinionit të audituesit.
- d) Natyra e keqkuptimeve materiale.
- e) Paaftësia për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të duhura për auditimin.
- f) Forma dhe përmbajtja e raportit të audituesit kur opinionit është i modifikuar.
- g) Komunikimi me personat që qeverisin.

Zbatimet e ISA-së në sektorin publik të auditimit

P2. ISA 705 zbatohet për audituesit e subjekteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të pasqyrave financiare.

Udhëzime shtesë për çështjet e sektorit publik

P3. ISA 705 përmban aplikime dhe materiale të tjera shpjeguese ku i kushton një vëmendje të veçantë subjekteve të sektorit publik në paragrafin A14 të ISA-së.

Konsiderata të përgjithshme.

P4. Objektivat e një auditimi financiar në sektorin publik janë shpesh më të gjera sesa shprehja e një opinionit nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin në fuqi për raportimin financiar (dmth.qëllimin e ISA-së). Mandati i auditimit, apo detyrimet për subjektet e sektorit publik, që rrjedhin nga legjislacioni, rregulloret, direktivat ministrore, kërkesat e politikave qeveritare, apo rezolutat e legjislaturës mund të rezultojnë si objektivat shtesë. Këto objektiva shtesë, që mund të jenë të një rëndësie të barabartë me atë të opinionit mbi pasqyrat financiare, mund të përfshijnë përgjegjësitë e auditimit dhe raportimit, për shembull, në lidhje me raportimin nëse audituesit e sektorit publik kanë gjetur ndonjë rast të mos-pajtueshmërisë me autoritetet duke përfshirë buxhetet dhe kornizat e llogaridhënies, dhe / ose raportimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Megjithatë, edhe aty ku nuk ka objektiva të tilla shtesë, mund të ketë pritsmëri të përgjithshme publike në lidhje me raportimin e audituesve të sektorit publik dhe të mos përputhjes me autoritetet ose raportimin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Audituesit e sektorit publik me përgjegjësi që kanë lidhje me mos-pajtueshmërinë me autoritetet, marrin në konsideratë Udhëzimet e Përputhshmërisë së Auditimit, INTOSAI (ISSAI 4000¹⁷⁶) dhe 4200¹⁷⁷).

P5. Kur marrim në konsideratë tabelën në paragrafin A1 të ISA-së, audituesit e sektorit publik që kanë përgjegjësi raportuese në lidhje me mospërputhjen me autoritetet, mund të kenë nevojë të zbatojnë udhëzimet e ISSAI 4200. Ai tregon udhëzime në lidhje më gjykimin e audituesit rreth natyrës së çështjeve që i japin shkas modifikimit dhe se si përhapja e efekteve të tyre apo efekteve

176) ISSAI 4000, "Hyrje e përgjithshme në Udhëzimet për Auditimin e Përputhshmërisë".

177) ISSAI 4200, "Udhëzimet e Auditimit të Përputhshmërisë në lidhje me auditimin e Pasqyrave Financiare."

të mundshme, ndikon në llojin e opinionit për mos-përputhshmërinë me autoritetet. Audituesit e sektorit publik mund të zbatojnë ISSAI 3000¹⁷⁸⁾ si dhe ISSAI 4100¹⁷⁹⁾ për sigurimin e angazhimeve të tjera.

Rrethanat kur modifikimi i opinionit të audituesit është i nevojshëm

P6. Përveç kërkesave në paragrafin 6 të ISA-së, audituesit e sektorit publik kanë përgjegjësi në lidhje me mos-përputhshmërinë me autoritetet, të cilët konsiderojnë se një opinion i modifikuar mbi mos-përputhshmërinë, nuk të çon në një opinion të modifikuar të pasqyrave financiare. Audituesit e sektorit publik konsiderojnë nëse çështja në lidhje me mos-përputhshmërinë është:

- a) Zbatuar në mënyrë të përshtatshme siç kërkohet në kuadrin e aplikueshëm të raporteve financiare
- b) Në bërjen e llogarive të duhura në pasqyrat financiare për sa i përket pasojave financiare nga mos-përputhshmëria; dhe
- c) Materiali është publikuar dhe për këtë arsye kërkon një mendim më të modifikuar në pasqyrat financiare.

Përcaktimin e llojit të modifikimit të opinionit të audituesit

P7. Përveç përgjigjeve të kërkuara nga paragrafi 13 (b) i ISA-së, audituesve të sektorit publik mund t'u kërkohet ose të vendosin të raportojnë para ligjvënësve ose organeve të tjera rregullatore sipas nevojës të çdo instance në menaxhim për të hequr kufizimet në raportin e audituesit.

Natyra e keqkuptimeve materiale

P8. Kur zbatojnë paragrafin A3 të ISA-së, audituesit e sektorit publik gjithashtu do të gjejnë udhëzime të mëtejshme në ISSAI 1450¹⁸⁰⁾, paragrafi P14.

178) ISSAI 3000, "Angazhimet e tjera të Sigurimit se auditimet apo rishikimet e Informacioneve Historike financiare".

179) ISSAI 4100, "Udhëzimet e Auditimit të Pajtuësishmërisë për auditimet e bëra nga Pasqyrat Financiare."

180) ISSAI 1450, "Vlerësimi i gabimeve të identifikuara gjatë auditimit".

Paaftësia për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të duhura për auditimin

P9. Shembuj shtesë të rrethanave jashtë kompetencat e subjektit siç përshkruhet në paragrafin A10 të ISA-së, të cilat mund të përfshijnë në sektorin publik kufizimet e imponuara nga:

- Qeveritarët ose nga organe të tjera ligjvënëse.
- Rregullat për klasifikimin e informacionit për shkak të sigurisë kombëtare dhe pronësisë.

P10. Shembujt shtesë të rrethanave që lidhen me natyrën apo kohën e punës së audituesit siç përshkruhet në paragrafin A11 të ISA-së mund të përfshijnë në sektorin publik ndryshimet legjislative, fatkeqësitë kombëtare natyrore dhe vendimet politike të tilla si operacionet ushtarake dhe zhvendosjet e veprimeve të qeverisë.

Forma dhe përmbajtja e raportit të audituesit kur opinionit është i modifikuar

P11. Në sektorin publik, nuk mund të jetë gjithmonë e rëndësishme përcaktimi i efektit në sasinë e të ardhurave, të ardhurave nga taksat, si dhe të ardhurat neto dhe kapitalit, siç sugjerohet në paragrafin A18 të ISA-së. Audituesit e sektorit publik në vend të përcaktojnë efektet në pasqyrat financiare mund të përcaktojnë sasinë në terma të tjera të tilla si shpenzimet bruto, të ardhurat bruto, borxhi kombëtar apo sufiçiti.

P12. Ilustrimet e parashikuara në shtojcën e ISA-së dhe në ISSAI 4200¹⁸¹⁾ shtojcat 8, 9 dhe 10 mund të jenë të dobishme për audituesit e sektorit publik në zhvillimin e opinionit të modifikuar të audituesit.

Komunikimi me personat që qeverisin

P13. Audituesve të sektorit publik mund t'ju kërkohet ose mund të vendoset të komunikojnë me palet e tjera të tilla si p.sh. legjislativi, përveç personave që merren me qeverisjen siç është përcaktuar në paragrafin 28 të ISA-s

181) ISSAI 4200, "Udhëzimet e Auditimit të Përputhshmërisë në lidhje me auditimin e Pasqyrave Financiare."

ISSAI 1706

Udhëzues i Auditimit Financiar

*RËNDËSIA E PARAGRAFËVE DHE
ÇËSHTJEVE TË TJERA NË
RAPORTIN E PAVARURTË
AUDITUESIT*

Shënim i Praktikës për Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (ISA) 706

Tabela e përmbajtjes ISSAI 1706

Shënime për ISA 706¹⁸²⁾ **Paragrafi**

Mjedisi

Hyrje në ISA

Përmbajtja e shënimeve P1

Zbatimet e ISA në sektorin publik të auditimit P2

Udhëzime shtesë mbi çështjet e sektorit publik

Theksi në paragrafin e raportit të audituesit P3-P4

Paragrafë të tjerë me rëndësi në raportin audituesit P5-P6

Komunikimi me personat që qeverisin P7-P8

182) Të gjitha Shënime konsiderohen së bashku me ISSAI 1000, “Hyrje e përgjithshme në Udhëzimet Financiare të Auditimit të INTOSAI-t.”

Rëndësia e paragrafëve dhe çështjeve të tjera në raportin e pavarur të audituesit

Mjedisi

Shënimet ofrojnë udhëzime shtesë të ISA 706 - Rëndësia e paragrafëve dhe çështjeve të tjera në raportin e pavarur të audituesit. Lexohet bashkë me ISA. ISA 706 hyn në fuqi për auditimin e pasqyrave financiare për periudhën pas datës 15 dhjetor 2009. Shënimet hyjnë në fuqi në të njëjtën datë si ISA.

Hyrje në ISA

ISA 706 ka të bëjë me komunikime shtesë në raportin e audituesit. Audituesi e konsideron të nevojshëm këtë veprim në rastin kur:

- a) Tërheq vëmendjen e përdoruesve për çështje, të paraqitura ose të shpalosura në pasqyrat financiare që janë të një rëndësie thelbësore për përdoruesit e pasqyrat financiare; ose
- b) Tërheq vëmendjen e përdoruesve për çdo çështje të paraqitur ose të shpalosur në pasqyrat financiare që janë të rëndësishme për të kuptuar përgjegjësinë e audituesit në raportin e tij.

Shtojcat 1 dhe 2 të ISA-së përmbajnë kërkesat specifike për audituesin, që theksojnë rëndësinë e paragrafëve dhe çështjeve të tjera në raportin e audituesit. Në këto rrethana, forma dhe vendosja e paragrafëve është e përcaktuar sipas kërkesave të ISA-së.

Përmbajtja e shënimeve

P1. Shënimet japin udhëzime shtesë për audituesit e sektorit publik në lidhje me:

- a) Theksi në paragrafin e raportit të audituesit.
- b) Paragrafë të tjerë me rëndësi në raportin e audituesit
- c) Komunikimi me personat që qeverisin

Zbatimet e ISA-së në Sektorin Publik të Auditimit

P2. ISA 706 zbatohet për audituesit e subjekteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të pasqyrave financiare.

Udhëzime shtesë mbi çështjet e sektorit publik

Theksi në paragrafët kryesorë në raportin e audituesit

P3. Mandatet e auditimit apo pritshmëritë në auditimin e sektorit publik mund të zgjerojnë rrethanat e përshtatshme për theksin mbi paragrafët me rëndësi apo paragrafë me çështje të tjera. Shembuj të tjerë që mund të jenë të rëndësishëm për tu theksuar në paragrafin e lëndës, nëse shikohet me vëmendje në pasqyrat financiare, përveç në pikën A1 të ISAsë mund të përfshijnë:

- Veprime legislative mbi programet apo buxhetin;
- Ligjet kontradiktore, rregulloret apo direktivat me efekt të rëndësishëm në njësinë ekonomike;
- Mashtrimet, abuzimet apo humbjet
- Transaksione të rëndësishme
- Mangësi të dukshme të kontrollit të brendshëm
- Praktikant e diskutueshme të biznesit;
- Transaksionet hyrëse pa marrë parasysh ekonomikitetin, Ri-paraqitja para periudhës së caktuar
- Mungesa e qëndrueshmërisë fiskale
- Çështjet mjedisore;
- Përgjegjësisë sociale të korporatave
- Çështjet etike (sjellja e duhur nga zyrtarët publikë) ose
- Përdorimi i joefikas dhe joeficient i aseteve publike

P4. Audituesit e sektorit publik mund të përfshijnë një paragraf me çështjet kryesore për çështjet që lidhen me mos-përputhshmërinë ndaj autoriteteve, nëse janë kontrolluar me saktësi pasqyrat financiare. Një shembull i tillë është çështja e keqpërdorimit të fondeve. Megjithatë, theksojmë se në

çështjen lidhur me mos-përputhshmërinë nuk kërkohet një mendim nga autoritetet.

Të tjerë paragrafë të rëndësishëm në raportin audituesit

P5. Shembuj të njëjtë të parashikuar në paragrafin e mësipërm P3, mund të jenë të rëndësishëm për çështje të tjera siç përcaktohet në paragrafin 8 të ISA-së, kur informacioni nuk është i përfshirë në deklaratën e pasqyrave financiare.

P6. Raportet e audituesit në sektorin publik, sikurse sugjerohet në paragrafin A9 të ISA-së, janë të kufizuara në përdorim ose në shpërndarje. Udhëzime të mëtejshme mbi kufizimin në shpërndarje ose në përdorimin e këtyre raporteve janë dhënë në ISSAI 1800¹⁸³⁾ paragrafi P12.

Komunikimi me personat që qeverisin

P7. Paragrafi 9 i ISA-së kërkon që audituesi të komunikojë me personat që qeverisin nëse ai mendon të shtojë çështje apo paragrafë më të rëndësishëm në raportin e tij. Audituesve të sektorit publik mund t'u kërkohet për të komunikuar me palët e tjera ligjvënëse, përveç atyre të ngarkuar me qeverisje.

P8. Kur marrim në konsideratë paragrafin A12 të ISA-së, audituesit e sektorit publik mund të komunikojnë me personat që qeverisin për të gjitha çështjet dhe paragrafët e përfshira, madje edhe ato çështje që janë të përsëritura. Audituesit e sektorit publik mund t'ju komunikojnë çështje të përsëritura palëve të tjera ligjvënëse.

183) ISSAI 1800, "Konsiderata të veçanta -për auditimin e pasqyrave financiare të përgatitura për qëllime të veçanta në përputhje me kornizat."

ISSAI 1710

Udhëzues i Auditimit Financiar

*INFORMACION KRAHASUES –
SHIFRAT PËRKATËSE DHE
PASQYRAT FINANCIARE
KRAHASUESE*

Shënim për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 710

Përmbajtja ISSAI 1710:

SHËNIM PËR ISA-në 710¹⁸⁴⁾ **Paragrafi**

Mjedisi

Hyrje në ISA-në 710

Përmbajtja e Shënimit të Praktikës P1

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik P2

Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

Qëllimi i ISA P3

Raportimi i Auditimit P4-P5

184) Të gjitha shënimet konsiderohen së bashku me ISSAI 1000, "Hyrje e përgjithshme në Udhëzimet Financiare të Auditimit të INTOSAI-t."

Informacion Krahasues - Shifrat përkatëse dhe Pasqyrat Financiare Krahasuese

Mjedisi

Ky Shënim jep udhëzime shtesë për ISA-në 710 - Informacion Krahasues - Shifrat përkatëse dhe Pasqyrat Financiare Krahasuese. Lexohet së bashku me ISA. ISA 710 hyn në fuqi për auditimin e pasqyrave financiare për periudhat pas datës 15 dhjetor 2009. Edhe ky shënim hyn në fuqi në të njëjtën datë si ISA.

Hyrje në ISA

ISA 710 ka të bëjë me përgjegjësitë e audituesit në lidhje me informacionin krahasues të deklaratave të auditimeve financiare. Kur pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme janë audituar nga një auditues tjetër apo nuk janë audituar, zbatohen kërkesat dhe udhëzimet e ISA 510¹⁸⁵⁾ në lidhje me bilancet e hapura.

Natyra e informacionit krahasues

Natyra e informacionit krahasues, që paraqitet në pasqyrat financiare të një subjekti ekonomik, varet nga kërkesat e kuadrit në fuqi për raportimin financiar. Ka dy rrugë të ndryshme raportimi të përgjegjësive të audituesit në lidhje me informacione të tilla krahasuese, shifrat korresponduese dhe deklaratat financiare krahasuese. Rruga për tu miratuar përcaktohet shpesh nga ligjet ose rregulloret, por gjithashtu mund të specifikohet edhe nga kushtet e angazhimit.

Dallimet themelore të përqasjeve në raportimin e auditimit janë:

- a) Për shifrat përkatëse, opinionin e audituesit mbi pasqyrat financiare duhet ti referohet vetëm periudhës aktuale, ndërsa

185) ISA 510, "Angazhimet fillestare - Bilancet e hapura

- b) Për pasqyrat financiare krahasuese opinioni i audituesit i referohet çdo periudhe në të cilën janë paraqitur deklaratat financiare.

ISA 710 i adreson veçmas kërkesat e raportimit të audituesit për çdo qasje.

Përmbajtja e Shënimit të Praktikës

P1. Shënimi jep udhëzime shtesë për audituesit e sektorit publik në lidhje me:

- a) Qëllimin e ISA.
- b) Raportimin e auditimit.

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik

P2. ISA 710 është e aplikueshme për audituesit e subjekteve publike në rolin e tyre si auditues të deklaratave financiare.

Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

Qëllimi i ISA

P3. Siç është përmendur në paragrafin 2 të ISA-së qasja që do të miratohet në lidhje me raportimin e përgjegjësive, që ka të bëjë me informacionin krahasues, është përcaktuar shpesh nga ligjet ose rregulloret. Audituesit e sektorit publik duhet të marrin parasysh mandatin e auditimit përveç kushteve të angazhimit.

Raportimi i Auditimit

P4. Normalisht situatat e përshkruara në paragrafët 13, 17 dhe 18 të ISA-së kanë më pak gjasa të ndodhin në sektorin publik, pasi përgjegjësia për të audituar deklaratat financiare mund të jetë e Institucionit të Auditimit Suprem, sikurse përcaktohet në mandatin e tij. Situatat ku koncepti i audituesit paraardhës mund të jetë i rëndësishëm, janë shtetëzimi dhe privatizimi. Kur auditimi i pasqyrave financiare është kontaktuar nga jashtë dhe përgjegjësia i mbetet Institucionit të Auditimit Suprem, koncepti i një audituesi paraprak nuk do të jetë i nevojshëm. Ka më pak gjasa që të ndodhin situatat e përshkruara në paragrafët 14 dhe 19 të ISA-së, si p.sh. periudha e mëparëshme nuk është audituar.

P5. Nëse shifrat korresponduese ndryshohen sipas parashikimeve në paragrafin A3 të ISA-së, audituesi nuk e ka të nevojshme t'u përmbahet këtyre shifrave në raportin e auditimit. Megjithatë mund të jetë e përshtatshme të përfshihet një tjetër paragraf në përputhje me ISA-në 706¹⁸⁶⁾.

186) ISA 706, "Rëndësia e paragrafëve dhe çështjeve të tjera në raportin e Audituesit të Pavarur".

ISSAI 1720

Udhëzues i Auditimit Financiar

*PËRGJEGJËSITË E AUDITUESIT
LIDHUR ME INFORMACIONE TË
TJERA NË DOKUMENTAT QË
PËRMBAJNË PASQYRAT
FINANCIARE TË AUDITUARA*

Shënim i Praktikës për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 720

Përmbajtja e ISSAI 1720

SHËNIM PËR ISA 720¹⁸⁷⁾

Paragrafi

Mjedisi

Prezantimi me ISA

Përmbajtja e shënimit	P1
Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik	P2
Udhëzime Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik.....	P3
Përkufizimi i informacioneve të tjera	P4
Mospërputhjet e informacioneve	P5
Keq-interpretimi i fakteve	P6

187) Të gjitha shënimet konsiderohen së bashku me ISSAI 1000, “Hyrje e përgjithshme në Udhëzimet Financiare të Auditimit të INTOSAI-t.”

Përgjegjësitë e Audituesit Lidhur me Informacione të tjera në Dokumentat që Përmbajnë Pasqyrat Financiare të Audituar.

Mjedisi

Ky Shënim jep udhëzime shtesë për ISA 720 - Përgjegjësitë e Audituesit Lidhur me Informacione të tjera në Dokumentat që Përmbajnë Pasqyrat Financiare të Audituar. Lexohet së bashku me ISA. ISA 720 hyn në fuqi për auditimin e pasqyrave financiare për periudhat pas datës 15 dhjetor 2009. Edhe ky shënim hyn në fuqi në të njëjtën datë si ISA.

Hyrja në ISA

ISA 720 ka të bëjë me përgjegjësitë e audituesve në lidhje me informacionet e tjera në dokumentat që përmbajnë raporte financiare dhe raportimet e audituesve. Në mungesë të ndonjë kërkesë në rrethana të veçanta të angazhimit, opinionin e audituesit nuk mbulon informacionet e tjera dhe audituesi nuk ka përgjegjësinë të përcaktojë nëse informacionet e tjera janë dhënë në mënyre të saktë ose jo. Megjithatë, audituesi i lexon informacionet e tjera pasi besueshmëria e pasqyrave financiare mund të kërcënohet nga mospërputhjet materiale me informacionet e tjera.

Në ISA 720 – dokumentat që përmbajnë auditimin e pasqyrave financiare, i referohen raporteve të përvitëshme (ose dokumentave të ngjashme) që u janë lëshuar pronarëve (ose grupeve të tjera të interesit), përmbajnë pasqyrat financiare të audituar dhe raportin e audituesit. ISA gjithashtu mund të aplikohet dhe përshtatet sipas nevojave të rrethanave, me dokumenta të tjera që përmbajnë auditimin e pasqyrave financiare, siç janë ofertat e letrave me vlerë.

Përmbajtja e Shënimeve

P1. Shënimi jep udhëzime shtesë për audituesit e sektorit publik në lidhje me:

- a) Përkufizimin e informacioneve të tjera.
- b) Mospërputhjet e informacioneve.
- c) Keq-interpretimin e fakteve.

P2. ISA 720 është i aplikueshëm për audituesit e subjekteve të sektorit publik në rolin e tyre si auditues të pasqyrave financiare. Udhëzues Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

P3. ISA 720 përmban aplikime dhe materjale të tjera shpjeguese në veçanti për njësitë e sektorit publik në paragrafin A7 të ISA-së.

Përkufizimi i informacioneve të tjera.

P4. Paragrafi A3 i ISA-së mundëson shembuj të informacioneve të tjera në dokumentat që përmbajnë auditimin e pasqyrave financiare. Shembuj të tjerë të rëndësishëm për sektorin publik mund të përfshijnë pohimet mbi kontrollin e brendshëm apo informacione mbi performancën, të tilla si:

- Informacioni mbi performancën kundrejt informacionit financiar. Cilësia e shërbimeve.
- Vëllimi i punës.
- Objektivat e efijencës dhe çështje të tjera të performancës.

Mospërputhjet materiale.

P5. Paragrafi 13 i ISA-së kërkon që audituesi të njoftojë personat që qeverisin për shqetësimet e audituesit, kur është i nevojshëm rishikimi i informacioneve të tjera, por menaxhuesi refuzon ti bëjë rishikimet. Audituesve të sektorit publik mund t'u kërkohej ose mund të vendoset të komunikojnë me palët e tjera, siç është legjislativi, përveç atyre që kanë rol qeverisës.

Keqinterpretimi material i faktit

P6. Paragrafi 16 i ISA kërkon që audituesi të njoftojë personat që qeverisin për shqetësimet e tij, si në rastin kur audituesi arrin në përfundimin se ka një keqinterpretim të fakteve në informacionet e tjera të cilat menaxhuesi refuzon ti korrigjojë. Audituesve të sektorit publik mund t'u kërkohej të komunikojnë me palët e tjera, siç është legjislativi, përveç atyre që kanë rol qeverisës.

ISSAI 1800

Udhëzues i Auditimit Financiar

*KONSIDERATA TË VEÇANTA -
AUDITIMI I PASQYRAVE
FINANCIARE I PËRGATITUR SIPAS
KORNIZAVE PËR QËLLIME
SPECIFIKE.*

Shënim i Praktikës për Standardet Ndërkombëtare të AuditimitISA 800

Përmbajtja e ISSAI 1800

Shënime për ISA 800¹⁸⁸⁾ **Paragrafi**

Mjedisi

Prezantim me ISA

Përmbajtja e shënimit të praktikës P1

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik P2

**Udhëzime shtesë në Çështjet e Sektorit Publik Konsiderata të
përgjithëshme P3**

Përkufizimi i kornizës së qëllimeve të veçanta P4-P6

Konsideratat gjatë pranimit të angazhimit P7

Krijimi i opinionit dhe raportimi i konsideratave P8-P11

188) Të gjitha shënimet konsiderohen së bashku me ISSAI 1000, “Hyrje e përgjithshme në Udhëzimet Financiare të Auditimit të INTOSAI-t.”

Konsiderata të veçanta - Auditimi i Pasqyrave financiare i përgatitur sipas kornizave për qëllime specifike

Mjedisi

Ky Shënim i Praktikës jep udhëzime shtesë për ISA 800 - Konsiderata të veçanta - Auditimi i Pasqyrave financiare i përgatitur sipas kornizave për qëllime specifike.

Lexohet së bashku me ISA. ISA 800 hyn në fuqi për auditimin e pasqyrave financiare për periudhat pas datës 15 dhjetor 2009. Edhe ky shënim hyn në fuqi në të njëjtën datë si ISA.

Prezantim i ISA-s

ISA-të me rradhë nga 100-700 zbatohen për auditimin e pasqyrave financiare. ISA 800 ka të bëjë me konsiderata të veçanta në zbatimin e këtyre ISA-ve për një auditim të pasqyrave financiare të përgatitura sipas kornizave për qëllime specifike.

ISA 800 është shkruar në kontekstin e një serie të plotë pasqyrash financiare të përgatitura sipas kornizave për qëllime specifike. ISA 805¹⁸⁹⁾ ka të bëjë me auditimin e një deklarate të vetme financiare, e një llogarie të veçantë, apo pika të veçanta të një deklarate financiare.

ISA 800 nuk i shkel kërkesat e ISA të tjera dhe as nuk ka për qëllim të merret me të gjitha konsideratat e veçanta që mund të jenë të rëndësishme në rrethanat e angazhimit.

Përmbajtja e Shënimit të Praktikës

P1. Shënimi përmban udhëzues shtesë për auditimin e sektorit publik në lidhje me:

189) ISA 805, — Konsiderata të veçanta - Auditimi i Pasqyrave Financiare të Vetme dhe Llogarive të Veçanta ose Zërat e një Deklarate Financiare

- a) Konsideratat e përgjithëshme.
- b) Përcaktimin e kornizave për qëllime të veçanta.
- c) Konsideratat në rastet e pranimit të angazhimit.
- d) Krijimin e nje opinionit dhe raportimit konsideratave.

Zbatueshmëria e ISA ne Auditimin e Sektorit Publik

P2.ISA 800 është e zbatueshme tek audituesit e sektorit publik kur ata janë të angazhuar në auditimin e pasqyrave financiare të përgatitura sipas kornizave për qëllime specifike.

Udhëzues Shtesë në Çështjet e Sektorit Publik

Konsiderata të përgjithshme

P3. Objektivat e një auditimi financiar në sektorin publik janë shpesh më të gjera sesa thjesht shprehja e një opinioni nëse pasqyrat financiare për qëllime të veçanta janë përgatitur në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar (p.sh. qëllimi i ISA-ve). Mandati i auditimit, apo detyrimet për subjektet e sektorit publik, që rrjedhin nga legjislacioni, rregullore, direktiva ministrore, kërkesat e politikave qeverisëse, apo rezolutat legjislative, mund të rezultojnë në objektiva të tjera. Këto objektiva shtesë mund të përfshijnë përgjegjësitë e auditimit dhe raportimit, për shembull, në lidhje me raportimin nëse audituesi ka gjetur ndonjë rast mospërputhje, përfshirë buxhetin dhe llogaridhënien, dhe / ose raportimin për efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

Angazhimi për të raportuar për pasqyrat financiare të përgatitura sipas kornizave për qëllime specifike mund të përfshijë të tilla objektiva shtesë. Edhe në rastet kur nuk ka objektiva të tillë shtesë, mund të ketë përjashtime në lidhje me raportimin për mospërputhje apo mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Për këtë arsye, gjatë auditimit të pasqyrave financiare të përgatitura sipas kornizave për qëllime specifike, audituesit e sektorit publik janë më vigjilentë në zonat që përmbajnë mospërputhje apo efektivitet të kontrollit të brendshëm.

Përcaktimi i Kornizave për Qëllime të Veçanta

P4. Ashtu siç është përcaktuar në paragrafin 6(b) të ISA-së, pasqyrat financiare të një qëllimi të veçantë, janë pasqyra financiare të përgatitura sipas kornizave për qëllime specifike, e cila është një kornizë e dizenuar për të përmbushur nevojat për informacione financiare nga përdorues të veçantë.

P5. Përveç përgatitjes së pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme, një sektor publik mund të përgatisë pasqyra financiare edhe për palë të tjera (siç janë organet qeverisëse, legjislacioni apo palët e tjera që kryejnë një funksion mbikëqyrës) të cilët mund t'i kërkojnë pasqyrat financiare të përshtatura për të përmbushur nevojat e tyre specifike për informacion. Në disa mjedise deklarata të tilla financiare janë vetëm pasqyrat financiare të përgatitura nga subjekti i sektorit publik. Bazuar në paragrafin A4 të

ISA-së, edhe kur pasqyra të tilla financiare janë vetëm pasqyrat financiare të përgatitura nga subjekti publik, ato konsiderohen deklarata për qëllime të veçanta financiare. Audituesit në sektorin publik shqyrtojnë me kujdes nëse korniza e raportimit financiar është dizenuar për të përmbushur nevojat për informacion financiar për një gamë të gjerë përdoruesish (kornizë e qëllimeve të përgjithshme), ose informacione financiare që i nevojiten përdoruesëve të veçantë.

- P6. Paragrafi A1 i ISA-se jep shembuj të kornizave për qëllime të veçanta. Shembuj të tjerë mund të përfshijnë dispozita të raportimit financiar për të siguruar lehtësira ose një program specifik për sektorin publik.

Çfarë duhet marrë parasysh kur pranohet marrëveshja :

- P7. Paragrafi 8 i ISA-së shpjegon që kuptimi i hapave që do ndërmerren nga menaxhimi për të përcaktuar nëse struktura financiare e raportimit është e pranueshme sipas rrethanave, mund të asistojë auditimin në përcaktimin e pranueshmërisë së asaj strukture në përputhje me kërkesat e ISA 210¹⁹⁰. Sidoqoftë, në sektorin publik, struktura financiare e raportimit mund të përshkruhet nga ligji apo rregullorja. Paragrafi A6 i ISA shpjegon se, aty ku ligji ose rregullorja përshkruan strukturën financiare të raportimit, që duhet përdorur nga menaxhuesi në përgatitjen e strukturave të veçanta financiare, ajo strukturë merret si e pranueshme në mungesë të provave që tregojnë të kundërtën.

Krijimi i një opinioni dhe raportimi i konsideratave

- P8. Paragrafi 11 i ISA kërkon që gjatë krijimit të një opinioni, audituesi të përmbahet kërkesave të ISA 700. Në sektorin publik, legjislacioni që rregullon mandatin e auditimit mund të përcaktojë shtrirjen apo fjalët që duhet të përdoren në raportimin e audituesit. Kur audituesit e sektorit publik përgatisin raportin e auditimit duke përdorur kërkesat e përcaktuara në legjislacion, raporti i audituesit mund të referohet ISA dhe legjislacionit që rregullon mandatin e auditimit, vetëm në rast se raporti i audituesit përmban në minimum, secilin nga elementët e përcaktuar në paragrafin 43(a) - (i) të ISA 700.

- P9. Raporti i audituesit mbi strukturat e veçanta të sistemeve financiare mund

190) ISA210 “, Duke iu përmbajtur — Kushteve të Angazhimeve të Auditimit”, paragrafi 6 (a) 4 SNA/ISA 700 — Krijimi i Opinioni dhe raportimi i Pasqyrave Financiare

të reflektojë një përgjegjësi raportimi shtesë, në varësi të faktit nëse strukturat financiare me qëllim të vecantë janë përgatitur në përputhje me mjedisin e aplikueshëm financiar të raportimit. Në këtë rast, raporti i auditimit përshkruan kërkesat e cdo legjislacioni përkatës apo mandatit të auditimit. Ky përshkrim përfshihet në një seksion të ndarë të raportit të auditimit. Nëse legjislacioni përkatës, ose mandati i auditimit specifikojnë formatin ose formulimin e përdorur në këtë seksion, audituesit e sektorit publik përdorin këtë formulim.

- P10. Kur menaxhuesit i duhet të bëjnë një zgjedhje midis strukturave financiare të raportimit, paragrafi (13b) i ISA kërkon që referenca tek struktura e aplikueshme financiare e raportimit në skemën e përgjegjësive të menaxhimit për kornizat financiare me qëllim të vecantë, të zgjerohet në mënyrë që të përfshijë edhe përgjegjësinë për përcaktimin nëse mjedisi i aplikueshëm financiar i raportimit është i pranueshëm në rrethanat e marrëveshjes. Siç u diskutua në paragrafin P7 më sipër, ndodh rrallë që në sektorin publik, menaxhimi të ketë një zgjedhje të tillë. Në secilin rast, audituesit e sektorit publik përcaktojnë nëse duhet të zgjerojnë strukturën e përgjegjësive të menaxhimit në mënyrë që mjedisi financiar me qëllim të dyfishtë të referojë burimin që përcakton strukturën e aplikuar financiare të raportimit.
- P11. Paragrafi 14 i ISA kërkon që raporti i audituesit të përfshijë një paragraf "Theksi mbi Çështjen, për të bërë me dije përdoruesit e raporteve të auditimit, se pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me kornizën për qëllime të veçanta dhe për pasojë pasqyrat financiare nuk mund të përdoren për një qëllim tjetër. Paragrafi A15 i ISA shpjegon gjithashtu se audituesi, në raportin e auditimit, mund të përfshijë një deklaratë të krijuar vetëm për përdoruesit e veçantë dhe që në varësi të ligjit ose rregullores kjo mund të arrihet duke kufizuar shpërndarjen apo përdorimin e raportit të auditimit. Në sektorin publik kjo nuk mund të konsiderohet një alternativë, pasi raporti i auditimit është një dokument publik i zakonshëm. Megjithatë, për të shmangur keqpërdoruesit e raporteve të auditimit, audituesit e sektorit publik përfshijnë në raportet e tyre deklaratat se pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me kornizat për qëllime të veçanta.

ISSAI 1805

Udhëzues i Auditimit Financiar

*KONSIDERATA TË VEÇANTA -
AUDITIMI I PASQYRAVE
FINANCIARE TË VETME DHE
ELEMENTËVE SPECIFIKË,
LLOGARIVE OSE ZËRAVE TË NJË
DEKLARATE FINANCIARE.*

Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 805

Tabela e përmbajtjes ISSAI 1805

Shënime për ISA 805¹⁹¹⁾	Paragrafi
Mjedisi	
Prezantim me ISA 805	
Përmbajtja e Shënimit të Praktikës	P1
Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik	
Udhëzues Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik	
Konsiderata të Përgjithshme	P2
Për t'u Marrë Parasysh Kur Pranohet Marrëveshja	P3-P6
Krijimi i një Opinioni dhe Raportimi i Konsideratave	P7-P9

191) Të gjitha shënimet praktike konsiderohen së bashku me ISSAI 1000 – Hyrje e Përgjithshme në INTOSAI - Udhëzime të Auditimit Financiar.

Konsiderata të Veçanta - Auditimi i Pasqyrave Financiare të Vetme dhe Elementëve Specifikë, Llogarive ose Zërave të një Deklarate Financiare.

Mjedisi

Ky Shënim jep udhëzime shtesë për ISA 805 - Konsiderata të Veçanta - Auditimi i Pasqyrave Financiare të Vetme dhe Elementëve Specifikë, Llogarive ose Zërave të një Deklarate Financiare. Lexohet sëbashku me ISA. ISA 805 hyn në fuqi për auditimin e pasqyrave financiare të vetme ose të elementëve specifikë, llogarive ose zërave, për periudhat pas datës 15 dhjetor 2009. Në rastin e auditimit të pasqyrave financiare të vetme dhe elementëve specifikë, llogarive ose zërave të një deklarate financiare përgatitur sipas një date të caktuar, ISA 805 është efektive për auditimet e informacioneve të tilla në ose pas datës 14 Dhjetor 2010. Edhe ky shënim hyn në fuqi në të njëjtën datë si ISA.

Prezantim me ISA 805

ISA në seritë 100-700 zbatohet për auditimin e pasqyrave financiare, te cilat duhet të përshtaten sipas nevojës në rrethanat kur aplikohet për auditimin dhe informacione të tjera historike financiare. ISA 805 ka të bëjë me konsiderata të veçanta në zbatimin e atyre ISA-ve për auditimin e pasqyrave financiare të vetme dhe elementëve specifikë, llogarive ose zërave të këtyre deklaratave. Pasqyrat financiare të vetme dhe elementët specifikë, llogaritë ose zërat e këtyre deklaratave mund të përgatiten në përputhje me një kornizë të përgjithshme të qëllimeve të veçanta. Nëse përgatitet në përputhje me këto kushte, ISA 800¹⁹²⁾ vlen edhe për auditimin. ISA 805 nuk është e aplikueshme për raportet e auditimevetë përbëra, lëshuar si rezultat i punës së kryer nga një angazhim në ekip për auditimin e një grupi pasqyrash financiare. (referoju ISA 600¹⁹³⁾) ISA 805 nuk i shkel kërkesat e ISA-ve të tjera dhe as nuk ka për qëllim të merret me të gjitha konsideratat e veçanta që mund të jenë relevante në rrethanat e angazhimit.

192) ISA 800, "Konsiderata të veçanta - Auditimi i pasqyrave financiare të përgatitura në përputhje me kornizat për qëllime të veçanta."

193) ISA 600, "Konsiderata të veçanta - auditimi i pasqyrave financiare (duke përfshirë Punën të Audituesëve Shtesë)."

Përmbajtja e Shënimit të Praktikës

P1. Shënimi përmban udhëzues shtesë për auditimin e sektorit publik në lidhje me:

- a) Konsiderata të Përgjithshme
- b) Konsideratat në Rastet e Pranimit të Angazhimit
- c) Krijimi i nje Opinioni dhe Raportimi i Konsideratve

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik

P1. ISA 805 është e zbatueshme tek audituesit e sektorit publik kur ata janë të angazhuar në auditimin e pasqyrave financiare të vetme dhe elementëve specifikë, llogarive ose zërave të këtyre deklaratave.

Udhëzues Shtesë për Çështjet e Sektorit Publik

Konsiderata të përgjithshme

P2. Objektivat e një auditimi financiar në sektorin publik janë shpesh më të gjera sesa thjesht shprehja e një opinioni nëse pasqyrat financiare për qëllime të veçanta janë përgatitur në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar (p.sh. qëllimi i ISA-ve). Mandati i auditimit, apo detyrimet për subjektet e sektorit publik, që rrjedhin nga legjislacioni, rregullore, direktiva ministrore, kërkesat e politikave qeverisëse, apo rezolutat legjislativë, mund të rezultojnë në objektiva të tjera. Këto objektiva shtesë mund të përfshijnë përgjegjësitë e auditimit dhe raportimit, për shembull, në lidhje me raportimin nëse audituesi ka gjetur ndonjë rast mospërputhje, përfshirë buxhetin dhe llogaridhënien, dhe / ose raportimin për efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

Angazhimi për të raportuar për pasqyrat financiare të përgatitura sipas kornizave për qëllime specifike mund të përfshijë të tilla objektiva shtesë. Edhe në rastet kur nuk ka objektiva të tillë shtesë mund të ketë përjashtime në lidhje me raportimin për mospërputhje apo mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Për këtë arsye, gjatë auditimit të pasqyrave financiare të vetme dhe elementëve specifikë, llogarive ose zërave të këtyre deklaratave, audituesit e sektorit publik janë më vigjilentë në zonat që përmbajnë mospërputhje apo efektivitet të kontrollit të brendshëm.

Konsiderata kur pranon Angazhimin

P3. Kur merret parasysh paragrafi 7 i ISA audituesit e sektorit publik mund të angazhohen në auditimin e pasqyrave financiare të vetme dhe elementëve specifikë, llogarive ose zërave të këtyre deklaratave të organizatave të financuara nga qeveria, në të cilat ata nuk janë të angazhuar për auditimin e pasqyrave të plota financiare. Udhëzimi në paragrafin A6 të ISA, ka të

bëjë me diskutimin me menaxhimin nëse një tjetër lloj marrëveshjeje, kur auditimi në përputhje me ISA nuk konsiderohet i praktikueshëm, nuk është i mundshëm për audituesit e sektorit publik. Për audituesit e sektorit publik mund të jetë e nevojshme të përcaktohet dhe të bihet dakort me çështje të tilla legislative ose me përgjegjësinë për të drejtuar organizimin e auditimit.

- P4. Një subjekt i sektorit publik mund të përgatisë informacione financiare, duke përfshirë pasqyra financiare të vetme dhe elementë specifikë, llogari ose zëra të një deklarate për palët e tjera (të tilla si organet qeverisëse, legislative apo palët e tjera që kryejnë një funksion mbikëqyrës). Një informacion i tillë mund të jetë nën kompetencën e një organizate për auditimin e sektorit publik. Audituesit e sektorit publik të angazhuar në auditime të tilla, duhet të shqyrtojnë me kujdes paragrafët A5-A9 të ISA.
- P5. Kur audituesit e sektorit publik ngarkohen në raportimin e pasqyrave financiare të vetme dhe elementëve specifikë, llogarive ose zërave të një deklarate, në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare të njësisë ekonomike, ata përcaktojnë nëse ligjet, rregulloret apo mandati i auditimit mund të përmbajë opinionin e audituesit kur ai ndryshon nga udhëzimet e paragrafit A8 dhe A9 të ISA. Paragrafët 18-21 të ISA 210¹⁹⁴⁾ kanë të bëjnë me konsideratat shtesë të audituesit në pranimin e angazhimit.
- P6. Paragrafi 6 i ISA shpjegon se nëse audituesi ka kuptuar qartë hapat e ndërmarra nga menaxhimi në përcaktimin e strukturës së raportimit financiar, ai mund ta ketë më të lehtë përcaktimin e pranueshmërisë së kesaj strukture. Megjithatë, në sektorin publik, struktura e raportimit financiar mund të përcaktohet me rregullore ose me ligj.

Krijimi i një Opinioni dhe Raportimi i Konsideratave

- P7. Në sektorin publik, legjislacioni që rregullon mandatin e auditimit mund të përcaktojë shtrirjen, apo termat që duhet të përdoren në raportin e audituesit. Kur audituesit e sektorit publik përgatisin raportin e auditimit

194) ISA 210 — Pranimi i kushteve për angazhimet e auditimit.

duke përdorur kërkesat e përcaktuara në legjislacion, raporti i audituesit mund ti referohet ISA dhe legjislacionit që rregullon mandatin e auditimit, vetëm në rast se raporti i audituesit përmban në minimum, secilin nga elementët e përcaktuar në paragrafin 43(a) - (i) të ISA 700¹⁹⁵⁾

- P8. Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të vetme dhe elementëve specifikë, llogarive ose zërave të një deklarate mund të pasqyrojë një përgjegjësi të raportimit përveç përgjegjësisë për të raportuar nëse pasqyrat financiare të vetme dhe elementët specifikë, llogaritë ose zërat e një deklarate janë përgatitur në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar (ose në përputhje me formën e rënë dakord). Në këtë rast, raporti i audituesit i përmbahet kërkesave të legjislacionit përkatës apo mandatin të auditimit.
- P9. Paragrafi 14 i ISA kërkon që audituesi të ketë parasyshë që ndryshimet e bëra në raportet e auditimit për elementë të pasqyrave financiare, të jenë të ngjashme me ndryshimet në pasqyrat e plota financiare të subjektit. Audituesit e sektorit publik gjithashtu duhet të marrin parasysh këto ndryshime edhe në rastin e pasqyrave financiare që lidhen me objektivat shtesë. Edhe në rast se një opinion i tillë i ndryshuar nuk ka të bëjë me elementin e audituar, audituesit e sektorit publik duhet të paraqesin një referencë në lidhje me opinionin e modifikuar. Faktorët që ndikojnë në vlerësimin e audituesëve përfshijnë kërkesat e legjislacionit përkatës ose të mandatin të auditimit, dispozita të tjera të veçanta për angazhimin dhe faktin nëse mospërfshirja e një reference të tillë në raport mund të jetë çorientuese.

195) ISA 700 — Krijimi i Opinioneve dhe raportimi i Pasqyrave Financiare

ISSAI 1810

Udhëzues i Auditimit Financiar

ANGAZHIMET NË RAPORTIMIN E PËRMBLEDHJEVE TË DEKLARATAVE FINANCIARE

Shënim Praktik për Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) 810

Tabela e përmbajtjes ISSAI 1810

Shënime për ISA 810¹⁹⁶⁾ **Paragrafi**

Mjedisi

Prezantim me ISA

Përmbajtja e Shënimeve P1

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e Sektorit Publik P2

Udhëzime shtesë mbi Çështjet e Sektorit Publik

Raporti i audituesit mbi përmbledhjen e deklaratave financiare P3-P5

Kufizimi në shpërndarje, përdorimi apo informimi i
përdoruesve mbi Bazat e Kontabilitetit P6

Shoqata Audituese P7

196) Të gjitha shënimet praktike konsiderohen së bashku me ISSAI 1000 – Hyrje e Përgjithshme në INTOSAI - Udhëzime të Auditimit Financiar.

Angazhimet në Raportimin e Përmbledhjeve të Deklarateve Financiare

Mjedisi

Ky shënim përmban udhëzime shtesë mbi ISA 810 - Angazhimet në Raportimin e Përmbledhjeve të Deklarateve Financiare. Lexohet sëbashku me ISA. ISA 810 hyn në fuqi për angazhimet për periudhat pas datës 15 dhjetor 2009. Edhe ky shënim hyn në fuqi në të njëjtën datë si ISA.

Prezantim me ISA

ISA 810 ka të bëjë me përgjegjësitë e audituesit në lidhje me angazhimin për raportimin mbi pasqyrat përmbledhëse financiare që rrjedhin nga pasqyrat financiare të audituara, në përputhje me ISA.

Përmbajtja e Shënimit të Praktikës

P1. Shënimi përmban udhëzime shtesë për auditimin e sektorit publik në lidhje me:

- a) Raportine audituesit mbi Përmbledhjen e Pasqyrave Financiare
- b) Kufizimin në shpërndarje, përdorimin apo informimin e përdoruesëve, mbi Bazat e Kontabilitetit
- c) Shoqata Audituese

Zbatueshmëria e ISA në Auditimin e sektorit publik

P2. ISA 810 aplikohet për audituesit e subjekteve të sektorit publik, kur ata janë të angazhuar në raportimin e pasqyrave financiare përmbledhëse.

Udhëzime shtesë në Çështjet e Sektorit Publik

Raporti i Audituesit mbi Përmbledhjet e Pasqyrave Financiare.

- P3. Gjatë raportimit mbi pasqyrat financiare prej të cilave kanë rrjedhur përmbledhjet e tyre, audituesit e sektorit publik mund të kenë shprehur një mendim shtesë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, sipas të gjitha aspekteve, në përputhje me strukturën financiare të raportimit. Për shembull, audituesit e sektorit publik mund të kenë raportuar nëse kanë gjetur raste mos-përputhshmërie duke përfshirë buxhetin dhe përgjegjësitë, ose mund të kenë shprehur një mendim mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Në raste të tilla, përveç kërkesave të përcaktuara në paragrafin 14 të ISA, audituesit e sektorit publik përfshijnë një referencë për këtë mendim shtesë në raportin e tyre mbi përmbledhjet e pasqyrave financiare.
- P4. Në sektorin publik, elementët e raportit të auditimit, përfshi trajtën dhe formulimin e opinionit, përcaktohen nga ligji apo rregullorja, si dhe nga mandati i auditimit. Në rrethana të tilla, audituesit e sektorit publik përdorin formulimin e përcaktuar, duke marrë në konsideratë paragrafin 10 të ISA.
- P5. Paragrafi 17 i ISA gjen zbatim gjithashtu në rrethanat kur raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare nga të cilat kanë rrjedhur përmbledhjet e tyre, përmban një opinion profesional, një paragraf mbi “Çështjet Thelbësore” ose një paragraf mbi “Çështje të Tjera” që kanë të bëjnë me qëllimet shtesë.

Kufizimi në shpërndarje, përdorim apo informim të përdoruesve mbi Bazat e Kontabilitetit

- P6. Duke marrë parasysh paragrafin 20 të ISA, kufizimi i shpërndarjes apo përdorimit të një raporti mbi auditimin e një sektori publik, zakonisht nuk është një opsion pasi raporti i audituesit është një dokument publik.

Referimi ndaj Audituesit

P7.Paragrafët 25 dhe 26 të ISA kërkojnë që audituesit të ndërmarrin veprime për të shmangur referimin për ta dhe përgjegjësinë në lidhje me përmbledhjet e pasqyrave financiare mbi të cilat ata nuk kanë raportuar. Audituesit e sektorit publik gjithashtu mund të ndërmarrin veprime në varësi të legjislacionit përkatës dhe mandatit të auditimit. Një veprim i tillë mund të konsiderohet një raport formal ndaj legjislacionit.



Academic Journal Online
Business & Economics Research, Vol. 5,
Issue 14, Fall 2014, pp. 24-28
www.iiste.org or www.ijonline.org